RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Tiranë, më 04.10.2018

Nr.	***Përmbajtja***	***Faqe***
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....**	4
II.	**HYRJA.....**	10
	a. Objektivat dhe qëllimi.....	10
	b. Identifikimi i çështjes.....	11
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	11
	ç. Përgjegjësitë e audituesve.....	11
	d. Kriteret e vlerësimit.....	12
	dh. Standardet e auditimit.....	12
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....**	13
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET.....**	14
	1. Drejtimi/Pika 1 e Programit të Auditimit.	
	Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave doganore dhe ecuria e borxhit doganor.....	14
	- Zbatimi i kritereve në planifikimin e të ardhurave doganore të vitit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.	
	- Realizimi i të ardhurave doganore, analiza dhe krahasimi i treguesve.....	
	- Borxhi doganor, ecuria dhe masat shtrënguese të marra për rikuperimin e tij. Auditimi i dokumentacionit lidhur me transferimin e akcizës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.....	22
	2. Drejtimi/Pika 2 e Programit të Auditimit.	
	Auditimi i Buxhetit dhe pasqyrave financiare të institucionit për vitin 2018.	
	- Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.	
	- Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse. Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare.....	36
	3. Drejtimi/Pika 3 e Programit të Auditimit.	
	Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Vlerësimit në Qendër.	66
	4. Drejtimi/Pika 4 e Programit të Auditimit.	
	Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit si dhe Drejtorisë së Politikave të Vlerësimit Doganor. Rimbursimi i akcizës në përputhje me afatet dhe procedurat e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.....	93
	5. Drejtimi/Pika 5 e Programit të Auditimit.	

Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit Operativ Hetimor lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Antikontrabandës si dhe Drejtorisë së Kontrolleve të Paszhdoganimit (Aposterior operativ 5 ditor)..... 98

6. Drejtimi/Pika 6 e Programit të Auditimit.

Përputhshmëria ligjore në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime si dhe ankande të realizuara nga Autoriteti Kontraktor.

- Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë e shërbime nga subjekti i audituar. Zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike. Argumentimi dhe përllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra, punë e shërbime.

- Përputhshmëria ligjore në realizimin e prokurimeve të fondeve publike dhe zbatimi i kontratave..... 109

7. Drejtimi/Pika 7 e Programit të Auditimit.

Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerezore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Rekrutimet, transferimet dhe largimet për periudhën nën auditim, si dhe impakti i tyre në Buxhetin e Shtetit. Procedurat e ndjekura në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike për plotësimin e vendeve vakante të organikës. Radha e ndjekur e rekrutimeve për punonjësit që kanë fituar konkurimin.

- Mënyra dhe radha e ndjekur për pagesën e punonjësve gjyqfitues me vendim gjykate të formës së prerë..... 129

8. Drejtimi/Pika 8 e Programit të Auditimit.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme..... 158

9. Drejtimi/Pika 9 e Programit të Auditimit.

Të tjera gjatë auditimit..... 173

IV/1 GJETJET..... 173

IV/2 REKOMANDIMET..... 186

V. ANEKSE..... 195

VI. DOKUMENTE SHOQËRUESE..... 265

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH"*, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 242/1 prot., datë 06.06.2019, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 07.06.2019 deri në datë 16.08.2019, ushtroi auditim *"Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare",* në subjektin Drejtoria e Pwrgjithshme e Doganave, për periudhën nga 01.01.2018 deri në 31.12.2018, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve qe lidhen me realizimin e të ardhurave në dogana dhe zbatimin e legjislacionit doganor. Veç kësaj është pasur në qendër të vëmendjes siguria e nivelit të menaxhimit si dhe transparenca me biznesin dhe publikun.

Nga auditimi si dhe nga ballafaqimi me personat përgjegjës gjatë auditimit në terren, shqyrtimit të observacioneve së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur për aktet e mbajtura gjatë ballafaqimit në terren, si dhe shqyrtimit të observacioneve me dokumentacionin bashkëlidhur pas fazës së auditimit në terren, është konstatuar se në dinamikën e veprimeve të përditshme të Drejtorisw sw Pwrgjithshme tw Doganave, ka mospërputhje në procedura; të meta e mangësi në zbatimin e legjislacionit dhe akteve administrative që rregullojnë funksionimin e institucionit si në drejtim të procesit të vlerësimit e pranimit të deklaratave doganore të subjekteve të biznesit dhe individëve, objekt i veprimtarisë së doganave, të cilat kanë sjellë për pasojë **mungesë të ardhurash për Buxhetin e Shtetit në shumën 919,541,437 lekë**, nga të cilat shuma prej **919,463,101 lekë** në fushën e auditimit të klasifikimit tarifor dhe vlerësimit doganor pwr **5003 raste** dhe shuma prej **78,336 lekë** në fushën e auditimit të procedurave të ndjekura lidhur me prokurimet publike.

Objektivat kryesore për këto çështje kanë qenë rritja e kapaciteteve institucionale për t'u përgjigjur me efektivitet dhe efiçensë kërkesave të zhvillimit, shfrytëzimi në maksimum i burimeve për rritjen e të ardhurave nga dogana, përmirësimi i shërbimeve që institucioni i afron subjekteve të biznesit dhe individëve, rritja e transparencës me biznesin e publikun dhe zvogëlimi i mundësive për veprime e ngjarje antiligjore si ato të kontrabandës dhe të shmangies nga detyrimet doganore.

I. b. Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	REFERENCA ME RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
6; 7 & 8	Nga auditimi i dokumentacionit tregtar bashkëlidhur praktikave doganore IM4 dhe procedurave të ndjekura lidhur me vlerësimin doganor dhe klasifikimin tarifor në deklarimin e mallrave nga Sektori i Vlerësimit në Qendër dhe Sektori i Kontrollit Aposterior Operativ, u konstatua: **a.** trajtim me transaksion i mallrave të importuar, veprime këto, jo në përputhje me: kërkesat e Sesionit I dhe II të të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...."*; pikës 7, të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore"*; Urdhërit nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*; b. keqklasifikim i kodit tarifor të artikujve në kuadratin 31 dhe 33 të DAV me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, në shkelje të neneve: 67, pika 1, shkronja "d/i"; 70, pika 2, shkronja "a"; 70, pika 3; 250, pika 4; 251, pika 2, gërma "a"; 256, pika 1, shkronja "a" dhe "b", të	**Drejtimi nr. 3. *"Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Vlerësimit në Qendër."*** Më hollësisht trajtuar në faqet 30-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, aneksi *3; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8; 3.9; 3.10 dhe 3.11*, rekomandimi nr. 1 *"Masa për shpërblim dëmi"*.	I Lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të analizojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, me qëllim kryerjen e procedurave doganore verifikuese sipas legjislacionit doganor në fuqi dhe zbatimin në rrugë ligjore për vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kontabilizimit dhe arkëtimin e detyrimeve doganore **për 5003 raste**, **në vlerën 919,463,101 lekë,** referuar nenit: 67, pika 1, shkronja "d/i"; 70, pika 2, shkronja "a"; 70, pika 3; 250, pika 4; 251, pika 2, shkronja "a"; 256, pika 1, shkronja "a" dhe "b", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*.

	Kodit Doganor. ***Në total gjetjet për 5003 raste, në vlerën 919,463,1 mijë lekë.***			
9.	Nga auditimi i dokumentacionit tregtar bashkëlidhur praktikave doganore IM4 dhe procedurave të ndjekura lidhur me vlerësimin doganor dhe klasifikimin tarifor në deklarimin e mallrave nga Sektori i Vlerësimit në Qendër dhe Sektori i Kontrollit Aposterior Operativ, u konstatua: **a.** trajtim me transaksion i mallrave të importuar, veprime këto, jo në përputhje me: kërkesat e Sesionit I dhe II të të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...."*; pikës 7, të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore"*; Urdhërit nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*; b. keqklasifikim i kodit tarifor të artikujve në kuadratin 31 dhe 33 të DAV me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, në shkelje të neneve: 67, pika 1, shkronja "d/i"; 70, pika 2, shkronja "a"; 70, pika 3; 250, pika 4; 251, pika 2, gërma "a"; 256, pika 1, shkronja "a" dhe "b", të Kodit Doganor. ***Në total gjetjet për 5003 raste, në vlerën 919,463,1 mijë lekë.***	**<u>Drejtimi nr. 5</u>** ***"Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit Operativ Hetimor lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Antikontrabandës si dhe Drejtorisë së Kontrolleve të Paszhdoganimit (Aposterior operativ 5 ditor, SKAO)"*** Më hollësisht trajtuar në faqet 30-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, aneksi *3; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8; 3.9; 3.10 dhe 3.11*, rekomandimi nr. 1 *"Masa për shpërblim dëmi"*.	I Lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të analizojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, me qëllim kryerjen e procedurave doganore verifikuese sipas legjislacionit doganor në fuqi dhe zbatimin në rrugë ligjore për vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kontabilizimit dhe arkëtimin e detyrimeve doganore **për 5003 raste**, **në vlerën 919,463,101 lekë,** referuar nenit: 67, pika 1, shkronja "d/i"; 70, pika 2, shkronja "a"; 70, pika 3; 250, pika 4; 251, pika 2, shkronja "a"; 256, pika 1, shkronja "a" dhe "b", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".*
10.	Në procedurën e prokurimit me objekt **"*Projekt për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë*"**, me fond limit 4,493,213 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues O. "Gj..... & C." sh.p.k, me vlerë 4,080,000 lekë, u konstatua se komisioni i ngritur për monitorimin dhe zbatimin e kontratës nuk ka aplikuar penalitetit për vonesa në furnizimin e mallit në afat pasi është dorëzuar 16 ditë me vonesë, duke shkaktuar **78,336 lekë sanksione të pambajtura dëm ekonomik të arkëtueshëm nga subjekti sipërmarrës**. Veprime në kundërshtim me kontratën bazë nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018 neni 12 dhe amendimit të kontratës nr. 19094 prot., datë 17.08.2018. ***Në total gjetjet janë 486 raste**, në vlerën **33,210 mijë lekë penalitet.***	**<u>Drejtimi nr. 6</u>**. ***"Mbi përputhshmërinë ligjore në planifikimin dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime si dhe ankande të realizuara nga Autoriteti Kontraktor".*** Më hollësisht trajtuar në faqet 109-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, aneksi 74.2, rekomandimi nr. 2 *"Masa për shpërblim dëmi"*.	I Lartë	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **78,336 lekë** nga O.. ***"G..... & C." shpk***, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018 me objekt *"Projekt për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë"*, vlerë kjo e cila përfaqëson penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuara në përfundimin e shërbimeve.
11 & 12.	Në auditimin e procedurave të prokurimeve, të zhvilluara në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, u konstatua se **2 procedura prokurimi** janë kryer në kundërshtim me nenin 2, "Parimet e përzgjedhjes", nenin 55, "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", nenin 24, "Anulimi i një procedure prokurimi" dhe pika 5 e nenit 53, "Shqyrtimi i ofertave", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, pasi: Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), duke mos anuluar këtë procedurë, veprime me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura fituese në **vlerën totale të fondit limit 8,235,213 lekë, duke favorizuar operatorët ekonomikë, në shumën 1,095,888 lekë, mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet i fondeve, të**	**<u>Drejtimi nr. 6</u>**. ***"Mbi përputhshmërinë ligjore në planifikimin dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime si dhe ankande të realizuara nga Autoriteti Kontraktor".*** Më hollësisht trajtuar në faqet 78-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, aneksi 4, rekomandimi nr. 1 *"Pwrdorimi jo me efektivitet, efiçencw dhe ekonomicitet i shpenzimeve nw fushwn e prokurimeve publike.".*	I Lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet strukturave përkatëse, të analizojë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kritereve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

	llogaritur si diferencë e vlerës të ofertës ekonomike në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kritere të paplota.			
2.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, materialeve, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, rezulton se gjendja e borxhit doganor më 01.01.2018 paraqitet me 4521 raste, 2978 subjekte debitorë në vlerën 23,946,599 mijë lekë. Gjendja e borxhit më datë 31.12.2018 paraqitet me 4520 raste, 3211 subjekte debitorë në vlerën 27,596,148 mijë lekë, pra gjatë vitit ushtrimor 2018, borxhi doganor është shtuar me 233 subjekte debitorë ose 7.8 %, ndërsa në vlerë 3,649,549 mijë lekë ose 15.2 %. Nga zyra e borxhit pranë degëve doganore nuk janë ndjekur hap pas hapi masat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin doganor si dhe udhëzimet përkatëse të nxjerra për këtë qëllim për rikuperimin e detyrimeve të papaguara nga subjektet debitoë, ku për 1203 raste, për vlerën **3,299,965,219 lekë**, nuk kanë vijuar procedurat me nxjerrjen e Urdhër Ekzekutimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, duke bërë të mundur vazhdimin e veprimtarisë doganore në sistem të subjekteve debitore, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e: nenit 245, pika 3, të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar; nenit 106, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*; nenit 103, pika 3 dhe 4, të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 *"Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar; si dhe pikës 2.2.1, shkronja "a", pjesa IX të Udhëzimit të DPD nr. 4, datë 07.04.2016, ndryshuar me pikën 2.6, pjesa VII, të Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*.	**<u>Drejtimi nr. 1</u>. *"Auditimi i borxhit doganor, ecuria dhe masat shtrënguese të marra për rikuperimin e tij. Auditimi i dokumentacionit lidhur me transferimin e akcizës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë"*.** Më hollësisht trajtuar në faqet 145-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, aneksi 7, rekomandimi nr. 2 *"Masa organizative"*.	I Lartë	**1.** DPD të marrë të gjitha masat për analizimin e situatës për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor në vlerën 27,596,148 mijë lekë. **2.** DPD të marrë të gjitha masat duke ngritur një grup pune për verifikimin, analizimin e situatës për veprimet kryera nga zyrat e borxhit pranë degëve doganore jo në përputhje me dispozitat ligjore për procedurat e ndjekura lidhur me rikuperimin e borxhit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit dhe nxjerrjen e përgjegjësive për të gjitha rastet e mosveprimeve ku subjektet apo agjensitë doganore edhe pse debitorë kanë vijuar aktivitetin doganor në import - eksport.
1.	Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2018 rezultoi se, plani i të ardhurave për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave është përcaktuar nga Drejtoria e Analizës dhe Politikave Fiskale në MFE në vlerën 168,982 milionë lekë ndërsa realizimi nga DPD është në vlerën 162,621 milionë lekë ose në masën 96.2 %, pra 6,361 milionë lekë më pak nga planifikimi, ku për rrjedhojë DPD ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat, duke mos angazhuar strukturat e saj, sikurse është Drejtoria e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave (Sektori i Monitorimit të Ardhurave, Analizës dhe Statistikës), në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4, neni 24, ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", kap. IV. "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave".	**<u>Drejtimi nr. 1</u>. *"Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave doganore.*** Më hollësisht trajtuar në faqet 111-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, aneksi 4.3 dhe 4.4, rekomandimi nr. 1 *"Masa organizative"*.	I Lartë	Strukturat e **Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave** të DPD në bashkëpunim me strukturat përkatëse të MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, të riorganizojnë dhe mundësojnë **programimin e të ardhurave** në të gjitha fazat edhe me strukturat e DPD, duke shtuar kështu bashkëpunimin për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese që mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhurave të mos vijnë të gatshëm në DPD, si dhe të programohen drejt e pa rezerva.
21.	Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse,	**<u>Drejtimi nr. 8</u> *"Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme"*.** Më hollësisht trajtuar në faqet	I Lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e organit epror dhe Degët Doganore në cilësinë e "autoritetit doganor kompetent" të analizojnë në bashkëpunim të plotë rekomandimet

	përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 280/11 prot., datë 05.10.2018 dhe protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 22995 prot., datë 08.10.2018 në DPD, konkretisht: **a**. Zbatimin e rekomandimeve për 11 masa organizative; **b.** Zbatimin e rekomandimeve për 7 masa për shpërblim dëmi në vlerën 105,142 mijë lekë; **c.** Zbatimin e rekomandimeve për 16 masa disiplinore.	104-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, aneksi 4.3 dhe 4.1, rekomandimi nr. 3 *"Masa organizative".*		e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për kontabilizimin e shumës prej ***105,142 mijë lekë,*** rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 280/11 prot., datë 05.10.2018 dhe protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 22995 prot., datë 08.10.2018.
3; 4 & 5.	Nga auditimi mbi veprimet e arkës dhe bankës u konstatuan likujdim me vonesë në tejkalim të afatit për 55 raste në vlerën 67,759,304 lekë, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Nr. 9, datë 20.3.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", pika 184 ku citohet: "*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik".*	**<u>Drejtimi nr. 2</u>. *"Auditimi i Buxhetit dhe pasqyrave financiare të institucionit për vitin 2018".*** Më hollësisht trajtuar në faqet 141-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, aneksi 6, rekomandimi nr. 4 *"Masa organizative"* dhe rekomandimi **C** *"Masa administrative".*	I Lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e organit epror dhe strukturat përgjegjëse të marrin të gjitha masat për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet kryera jo në përputhje me dispozitat ligjore në lidhje me likujdimin e e detyrimeve në tejkalim të afateve të parashkruara, pasi likuidimi me vonesë i tyre përbën risk potencial ne rritjen e shpenzimeve buxhetore, si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet për mos likuidim brenda afateve ligjore.
13; 14; 15; 16; 17; 18; 19 & 20.	**1.** Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore u konstatua se DPD ka zbatuar 47 vendime gjyqësore për shpërblim dëmi në total prej **49,338 mijë lekë**. Këto vendime gjyqësore kanë objekt të tyre rikthimin në punë të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga vendi i punës pagimin e pagave nga momenti i largimit deri në ekzekutimin e vendimit për ish-punonjësit me status ose dëmshpërblimin për largimin nga puna të ish-punonjësve me kod pune. **Akumulimi i detyrimeve ka ardhur si pasojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore ndër vite dhe zgjatjes së proceseve gjyqësore**. Referuar vendimeve të gjykatave, këto vendime i përkasin periudhave përpara çeljes së vitit 2018, shumë e shpenzuar pa efektivitet dhe në mbivlerësim të shpenzimeve të vitit 2018. <u>Nga auditimi është konstatuar se nuk është zbatuar radha e shlyerjes së vendimeve gjyqësore sipas databazës së vendimeve gjyqësore dhe grafiku i shlyerjes nuk është bërë publik në faqen on-line.</u> Grupi i auditimit konstatoi se shumica e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore janë kryer me përmbarues privat, duke e kaluar afatin për likuidimin vullnetar, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 04.06.2014 *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit,* pikën 3, 5, 9, si dhe Urdhrit Nr.5151 datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil", pika 3, 4,	**<u>Drejtimi nr. 7</u>. *"Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerezore në përputhje me legjislacionin në fuqi"*.** Më hollësisht trajtuar në faqet 17-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandimet: nr.5; nr.6; nr.7; nr.8; nr.9; nr.10 & nr.11 *"Masa Organizative"*	I Lartë	**1.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për analizimin e të gjitha vendimet gjyqësore me objekt rikthimin në punë dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative ndaj personave shkaktarë. Në çdo rast, shlyerja e detyrimeve të lidhura me këto vendime të ndjekë radhën e paraqitjes së tyre në MFE, nëpërmjet publikimit të databazës dhe grafikut të shlyerjes edhe në faqen zyrtare të Institucionit **2.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për sistemimin e punonjësve të cilët presin rikthimin në detyrë, në mënyrë që të ndërpritet rritja e shpenzimeve jo efektive. Institucioni duhet gjithashtu të vendosi mbikqyrje të përshtashme mbi këtë proces për të garantuar funksionimin e kontrolleve të brendshme për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë pa asnjë vonesë subjektive për të mos rënduar buxhetin e shtetit si dhe të marrë masa për hartimin e saktë dhe të përditësuar të databazës së vendimeve gjyqësore në mënyrë të menjëhershme në mënyrë që të shmangen impaktet negative në lidhje me krijimin e detyrimeve të prapambetura.

	5. **2.** Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore u konstatuan 5 ish-punonjës të cilët nuk na u vunë të dhëna në dispozicion në databazën e vendimeve gjyqësore për të cilët gjykata ka dhënë vendime që janë larguar padrejtësisht nga puna dhe që DPD duhet ti rikthejë në vendet e tyre të punës dhe pagimin e pagave nga data që janë larguar deri në rikthimin në detyrë. Pas lënies së akt-konstatimeve u evidentua se 1 prej punonjësve është në fazën e akt-rekomandimit në DAP, 1 është punësuar në dhjetor 2018 i cili nuk na u raportua në listën e të punësuarve për 2018 me vendim gjykate dhe 1 është rikthye rë punë në 23.08.2019, pas përfundimit të auditimit nga KLSH. Strukturat përgjegjëse në DPD, pjesë e komisionit të Posaçëm, nuk kanë ekzekutuar këto vendime gjyqësore që kanë sjellë situatën e krijimit të detyrimeve për DPD si pasojë e pagave vjetore të maturuara, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Urdhërit nr. 5151, datë 28.10.2015 *"Për Zbatimin e vendimeve Gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil"*, pika 1 dhe pika 3 e Kreut IV. **3.** Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore u konstatua se nuk kemi evidencë për praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi i transferimit (metodologjia dhe sistemi i pikëzimit). Reflektimi i Ristrukturimit të DPPD është bërë pa ndjekur fillimisht një përshkrim të pozicioneve të punës si proces paraprak vlerësimi përpara vendimmarrjes së transferimit të punonjësve. Tejkalim me 1 vit i afateve ligjore të procesit të Ristrukturimit. Transferime të punonjësve pa kritere duke rritur riskun e cënimit të cilësisë së punës. Mungesa e shpalljes së vendeve vakante në DAP për shkak të procesit të Ristrukturimit. Mungesë e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësive për secilin pozicion pune. Kryerja e procesit të Ristrukturimit formalisht pa kritere specifike. Përshkrimet e punës janë miratuar nga me shkresën Nr.17960/1 Prot datë 18.09.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Ndërkohë Ristrukturimi i DPD ka nisur në shkurt 2018, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e VKM Nr.125 datë 17.02.2016, *"Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nënpunësve civil"*, pika 16, 17, 20. **4.** Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore u konstatuan numër i lartë vendesh vakante i shpërndarë në drejtori të ndryshme si në Drejtori të Përgjithshme ashtu dhe në Degë Doganore. Vlerat më të larta të vendeve vakante janë gjatë kohës së ndryshimit të strukurës dhe në vazhdim duke qënë se në proces Ristrukturimi nuk mund të shpallen vende të lira në DAP, duke ndikuar në performancën e disa drejtorive pasi, diferenca e numrit të punonjësve nga plani në fakt lë hapësirë interpretimi se puna kryhet nga punonjësit ekzistues të cilët mbingarkohen me funksione që nuk janë kompetencë e tyre dhe kështu riskon të cënohet cilësia e punës, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e shkresës Nr.87			**3.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për një planifikim më të kujdesshëm në respekt të afateve të përcaktuara me VKM dhe shmangie nga ana e Institucioneve të procesit të Ristrukturimit, proces që ndikon në stabilitetin e tyre. Të administrohen në kohë reale dhe të trajtohen me përparësi rastet e ankesave për ristrukturimin në mënyrë që të shmangen problemet e mundshme që shpesh përfundojnë edhe në konflikte gjyqësore. Pjesë e rëndësishme e reformës në administratë është konsolidimi i strukturave të ministrive. Për këtë arsye rekomandohet që ndryshimet e strukturave të mos jenë objekt i riskut në cilësinë e punës, stabilitetin e institucionit dhe punonjësve. **4.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për që vendet vakante të plotësohen nga punonjës që përmbushin kriteret sipas pozicionit. Rekrutimi i punonjësve të jetë sa më i hapur, transparent dhe duke plotësuar të gjitha kriteret e nevojshëm në kualifikim sipas përcaktimeve të bëra në vendet e lira të punës. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren të gjitha masat për respektimin e afateve të dokumentacioneve. Komiteti i Pranimit të Përhershëm të mbaj relacion dhe evidenca mbi vlerësimin e të gjithë kandidatëve që marrin pjesë në intervistë për shpalljet e vendeve të punës. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marr masa për kryerjen e procedurave të konkurimit edhe për punonjësit me kontratë të përkohshme, për të garantuar transparencë në përzgjedhje sipas kritereve të caktuara. **5.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për një hetim administrativ duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për veprimet jo në përputhje të dispozitave ligjore në lidhje me afatet kohore për transferimet e përkohshme të punonjësve dhe transferimet e shpeshta në mënyrë që të shmanget risku i transferimeve të detyruara në Drejtori apo struktura të tjera varësie dhe qëndrueshmëria e funksionimit të Institucionit. **6.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të analizojë dhe të marrë masa të menjëhershme për procedurat e ndjekura nga Komisioni Disiplinor gjatë shqyrtimit të cështjeve për ecurinë disiplinore, në respect të afateve për

	Prot, datë 09.01.2018 e Këshillit të Ministrave prot në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me Nr.436 Prot, datë 09.01.2018, Vendimi Nr.2 datë 08.01.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.921 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Personelin e Administratës Doganore", të ndryshuar. Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit prej 3 antarësh për punonjësit me kontratë të përkohshme, është nxjerr një listë e fituesit vlerësuar me pikë për këto pozicione. Në disa raste pikët e grumbulluara janë shënuar vetëm për fituesin. Nuk ka vlerësim me pikë për konkurentët e tjerë duke mos lënë gjurmë për pjesëmarrjen e konkurentëve të tjerë dhe nivelin e tyre, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.8485 datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 60, pika 1, shkronja "c". **5.** Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore u konstatua se nëpunësit civil janë transferuar dhe kanë tejkaluar afatet e përcaktuara për Transferimin e Përkohshëm, nga të cilët 134 janë punonjës civilë dhe 41 punonjës administrativë, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 48, pika 1, shkronja "a", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, pasi transferimi ka tejkaluar afatet e përcaktuara (mbi 6 muaj). **6.** Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore në lidhje me veprimtarinë e Komisionit Disiplinor u konstatuan se: në dosjen e punonjësit për të cilën ka filluar ecuria disiplinore, mungon arsyetimi i eprorit direkt për fillimin e ecurisë disiplinore të punonjësve; në disa raste data e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore është më vonë se 16 ditë nga dita e marrjes së njoftimit nga nëpunësi; në disa raste, deklaratat për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të KD janë të nënshkruara nga anëtarët, por nuk tregohet se për cilin/cilën punonjës bëhet kjo deklaratë; si dhe nuk disponohen shkresa për shtyrje të seancës dëgjimore, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Vendimi nr. 115, datë 5.3.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil"*, Kreut II *"Komisioni Disiplinor"*, pika 13/c, pika 7. **7.** Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore u konstatua se në dosjet personale të punonjësve ka mungesa të pjesshme në dokumentacion dhe vlerësimi vjetor i tyre është me mangësi në procedurë. Në disa raste nuk administrohet në dosje raporti mjeko ligjor, vërtetim nga prokuroria autorizimi i konfliktit të interesit, dokumenta të kurseve kualifikuese apo gjuhëve të huaja, vërtetim nga tatim-taksat si dhe në disa raste nuk është plotësuar/përditësuar fletë inventari i dosjes, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Urdhrit Nr.15339 Prot., datë 27.06.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm *"Për kryerjen e vlerësimeve vjetore për të gjithë punonjësit Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degëve Doganore"*, si dhe Lidhja Nr.1 dhe Lidhjen Nr.2 të Vendimit Nr.117 datë 05.03.2014 *"Për përmbajtjen, procedurën dhe*			shyrtimin e shkeljeve disiplinore, të marrë masa për plotësimin e deklaratave për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të KD sipas formateve standarteve si dhe të trajtojë të gjithë rastet me vëmendje maksimale për të shmangur largime të padrejta nga puna të cilat në vazhdim mund të rezultojnë me dëme dhe efekte financiare në Buxhetin e Shtetit. **7.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin dhe rritjen e aftësive profesionale të punonjësve. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat e menjëhershme për plotësimin e dosjeve të personelit sipas kërkesave ligjore, dhe realizimin e kujdesshëm të vlerësimeve vjetore të punonjësve tyre për çdo Drejtori në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe për Degët Doganore.

	administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".			

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH"*, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 242/1 prot., datë 06.06.2019, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 07.06.2019 deri në datë 16.08.2019, në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për periudhën nga 01.01.2018 deri në 31.12.2019 u krye auditimi *"Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare"* nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Agron Opari, Përgjegjës Grupi;
2. Altin Dinaj, Auditues (*nuk u angazhua në auditim*);
3. Xhein Xhindoli, Auditues;
4. Eriola Hoxha, Auditues;
5. Aleksandra Trebicka, Auditues.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi *"Auditim të Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare"* në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (këtu e në vazhdim DPD), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me realizimin e të ardhurave dhe zbatimin e legjislacionit doganor. Auditimi u krye mbi bazë risku me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit ushtron veprimtarinë DPD.

Objektivat dhe qëllimi.

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga DPD gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi janë:

-Evidentimi i shmangieve në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së DPD me kriteret e vlerësimit në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator për periudhën objekt i auditimit;

-Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (këtu e në vazhdim MFE) si dhe nga vetë DPD;

-Vlerësimi ekonomik e financiar i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë dëm ekonomik, mungesë të ardhurash dhe ato të kontrabandës.

-Vlerësimi ekonomik e financiar i veprimeve në lidhje me prokurimet publike, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë dëm ekonomik.

-Vlerësimi ekonomik e financiar i veprimeve në lidhje me rekrutimet, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë dëm ekonomik

-Vlerësimi i realizimit të treguesve të të ardhurave, shpenzimeve, mënyrës dhe saktësisë në pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare dhe rakordimit me thesarin.

-Vlerësimi i transparencës me publikun dhe biznesin, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit.

-Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.

-Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen.

Qëllimi i auditimit është: vlerësimi objektiv dhe i pavarur i sistemeve të ngritura, vlerësimi profesional i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe

kërkesat e legjislacionit në fuqi; vlerësimi objektiv dhe i pavarur i parimeve, normave, rregullave dhe përcaktimeve në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me liritë dhe kufizimet në sistemin doganor të Republikës së Shqipërisë *(këtu e në vazhdim RSH)*; evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike si dhe dhënia e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e punës të DPD gjatë veprimtarisë së saj.

Identifikimi i çështjes

Veprimtaria e personelit doganor të DPD, realizohet në përputhje me: Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"KD i RSH"*; Ligjin nr. 8474 datë 14.04.1999 *"Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore"*, i ndryshuar; Ligjin nr. 61/2012, datë 24.05.2012 *"Për Akcizat në RSH"*, i ndryshuar; VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017 *"Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 'Kodi i Republikës së Shqipërisë'"*, i ndryshuar; Urdhërave dhe Udhëzimeve të MFE dhe DPD, si dhe detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloret e e nxjerra dhe të miratuara për mirëfunksionimin e Administratës Doganore *(këtu e në vazhdim AD)*. Veprimtaria e DPD në bashkërendim me strukturat e varësisë, realizon kontrollin dhe përputhshmërinë e deklarimeve dhe procedurave të kryera nga operatorë ekonomikë sipas legjislacionit të fushës. Gjithashtu përgatitja dhe miratimi i pasqyrave financiare në DPD, është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *"Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"* i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

- Drejtori i Përgjithshëm i DPD (*Përgjegjës Menaxherial i Institucionit*) është përgjegjës për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë. Për të siguruar administrim efektiv dhe përmbushjen e misioneve, kompetencave dhe detyrave funksionale të administratës doganore, bashkëpunon dhe bashkërendon punën nëpërmjet zëvendësdrejtorëve dhe drejtuesve që ka në varësi të drejtëpërdrejtë.
- Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Doganave (*nëpunësi autorizues*) janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit doganor sipas funksioneve dhe përgjegjësive të përcaktuara për të siguruar një administrim të efektshëm si dhe drejton, bashkërendon punën dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryer nga drejtoritë e departamentit që mbulon.
- Drejtorët e Drejtorive së bashku me sektorët përkatës *(nëpunësi zbatues)* janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit doganor sipas funksioneve dhe përgjegjësive të përcaktuara në rregulloren e brendshme të DPD në të cilën janë përcaktuar edhe detyrat sipas pozicioneve të punës.

Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar të bëjmë të mundur që:
- Të evidentojmë dhe vlerësojmë nëse informacioni mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, si dhe në çfarë mase subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100*);
- Të krijojmë bindjet mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne si audites t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimeve të ndjekura nga subjekti i audituar, për faktin nëse pasqyrat

financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi;
- Të kryejmë në mënyrë efektive auditimin sipas standardeve (ISSAI 1300);
- Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe, nëse bazuar në ketë evidencë, nga ana jonë mund të arrijmë në konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).
-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.

Kriteret e vlerësimit

Kriteret bazë mbi të cilat grupi i auditimit ushtroi punën audituese janë:
- Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë si dhe vendimet teknike të DPD;
- Ligji nr. 8474 datë 14.04.1999 *"Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i RSH"*, ;
- Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 *"Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil";*
- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 *"Për kontabilitetin"*, i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore në funksion të tyre;
- Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 109/2017 *"Për Buxhetin e Vitit 2018"*; ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008 *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligj gjatë vitit;
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 *"Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 *"Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar,
VKM nr. 914, dt. 29.12.14 *"Rregullat e Prokurimit Publik"*, VKM nr. 432, datë 28.06.2006 *"Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore"*, VKM nr. 717, datë 23.06.2009 *"Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore"*, me ndryshimet
Udhëzimin nr. 10, datë 27.02.2008 të Ministrisë së Financave *"Për ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 dhe nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucionet qendrore, vendore dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj, etj"*.
UMF nr. 7, datë 28.02.2014*"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe tabelat e tavaneve për PBA 2015-2017"*; nr. 7, datë 11.02.2015 *"Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limiteve të angazhimit"*; nr. 1, datë 04.06.2014, *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit"*; nr. 2, datë 06.02.2012 *"Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit"*; etj.
- Udhëzimi i MF, nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik"*;
- Rregullore e Brendshme e Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012;

Standardet e auditimit

Për kryerjen e punës audituese u aplikuan standardet e auditimit në përputhje me kërkesat e:
- Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH*" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë i miratuar nga Kryetari i KLSH;
- Rregullores së Proçedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017. të Kryetarit të KLSH-së;
- Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë.
- Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISAI) të IFAC

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit. Mbështetur në ISSAI 1315.

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit konkluduan në metodologjinë e aplikuar gjatë planifikimit në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshmë në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

1.1. Kontrolli aritmetik që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

1.2. Kontrolli i vlerësimit për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

2. Verifikimi i transaksioneve duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese

3. Intervistimi i personelit që ka pasë role specifike në subjektin që u auditua.

4. Raporte dhe informacione nga shfrytëzimi i raporteve/informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit.

5. Pyetsorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në lidhje me informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit

6. Pyetsorët sipas teknikës së grumbullimit të të dhënave në rastet kur veprime të caktuara kanë karakteristikatëngjashme dhe janë të përsëritura në struktura të ndryshme të organizatës.

7. Teknika të ndryshme të ekzaminimeve nëpërmjet sistemit IDEA të raporteve të përpunuara në sistemin ORACLE, si dhe Assycuda ŴORLD duke përdorur metodat e ekzaminimit kryq, rishikimit analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim teknikash: si shqyrtimi i dokumentave justifikuese dhe krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimi analitik (auditimi i vërtetësisë, rakordimet, krahasimet).

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

DPD, është një njësi funksionale që varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga MFE në RSH. DPD ka në varësi të saj 17 DD që operojnë në territorin e RSH, të cilat kryejnë operacione të deklarimit dhe zhdoganimit. Si pozicion gjeografik është në Tiranë. Nga pikëpamja doganore kryen funksione në mbledhjen e të ardhurave doganore sipas legjislacioni doganor në fuqi të RSH. Kuadri rregullator nga e cila udhëhiqet administrata e DPD, është legjislacioni doganor ku respektivisht detyrat funksionale sipas funksionit organik janë sanksionuar në Rregulloret e Brendshme të miratuara nga MFE.

DPD ka si objektiva kryesore:
- Rritjen e nivelit të të ardhurave doganore nëpërmjet rritjes së eficencës ne punë të stafit doganor, zbatimin korrekt të legjislacionit, uljen e kohës së përpunimit të deklaratës doganore, duke ulur njëkohësisht dhe kostot shtesë të operatorëve ekonomikë që kryejnë veprime doganore në këtë pikë doganore;
- Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj udhëtareve dhe subjekteve që operojnë nëpër DD duke krijuar lehtësi në lëvizje, e kontroll eficient duke synuar uljen e evazionit fiskal nëpërmjet zbulimit dhe ndëshkimit të shkeljeve doganore sipas legjislacionit në fuqi.

Për institucionin tonë, kryerja e këtij auditimi, ka rëndësi lidhur me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe anomalive materiale me pasojë të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshmë në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Objekt i këtij auditimi është auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të subjektit DPD, përgjatë vitit ushtrimor 2018.

Qëllimi i auditimit në DPD është: vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, në përputhje me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me liritë dhe kufizimet në sistemin doganor; vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si dhe shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 4100, ISSAI 4000 dhe ISSAI 1315)[1] dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e punës në të ardhmen, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Fushëveprimi i auditimit ka qënë: auditimi i të ardhurave të realizuara nga Administrata Doganore; auditimi i procedurave të deklarimeve doganore të subjekteve që operojnë pranë kësaj administrate në fushën e importit, eksportit, regjimeve ekonomike, akcizës, shpenzimeve si dhe auditimi i procedurave të ndjekura për rikuperimin e borxhit doganor të shkaktuar nga subjektet debitorë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave doganore dhe ecuria e borxhit doganor.

- Zbatimi i kritereve në planifikimin e të ardhurave doganore të vitit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.
- Realizimi i të ardhurave doganore, analiza dhe krahasimi i treguesve.
- Borxhi doganor, ecuria dhe masat shtrënguese të marra për rikuperimin e tij. Auditimi i dokumentacionit lidhur me transferimin e akcizës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi, lidhur me dokumentacionin e të ardhurave, gjatë periudhës së auditimit duke analizuar të ardhurat sipas llojit të taksave, konstatohet se taksa doganore, akciza, TVSH dhe renta minerare, janë me performancë negative në krahasim me planin.

Konkretisht

1. Zbatimi i kritereve në planifikimin e të ardhurave doganore të vitit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.

Plani i të ardhurave për DPD, për vitin 2018 është akorduar në zbatim të Ligjit Nr. 109/2017 "për buxhetin e vitit 2018". Me shkresën nr. 22848, datë 05.10.2018 të MFE është dërguar plani pwrfundimtar i të ardhurave të planifikuara për t'u mbledhur nga AD në vlerën 168,982 milion lekë dhe bashkëlidhur është bërë detajimi i planit të të ardhurave sipas muajve dhe në strukturë. Plani i të ardhurave paraqitet në tabelën si më poshtë vijon:

(në milion lekë)

Nr	Zërat e të ardhurave	Viti 2017		Viti 2018 (Plan fillestar)		Rritja e planit të të ardhurave të vitit 2018 kundrejt vitit 2017, (në %)
		Plan	Pesha specifike zëri/totalit	Plan	Pesha specifike zëri/totalit	
1	TVSH	102,517	65%	109,974	65.09%	7.27
2	Akciza	46,700	29.6%	49,000	28.99%	4.92
3	Taksë Doganore	6,400	4.06%	6,998	4.14%	9.34
4	Taksë Ncionale(renta)	2,100	1.34%	3,010	1.78%	43.33
5	Total (bruto)	157,717	100%	168,982	100%	7.14

(Të dhënat: DPD Punoi:KLSH)

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme plani i të ardhurave doganore në vitin 2018 është në vlerën 168,982 milionë lekë, i cili në krahasim me planin e të ardhurave të vitit 2017 ka pësuar rritje me 7.14 %, ose në vlerë absolute në shumën 11,265 milionë lekë.

- Në planifikimin e të ardhurave sipas zërave, në krahasim me vitin e mëparshëm buxhetor, të ardhurat nga TVSH, janë planifikuar me një rritje në masën 7.27 %, ose në vlerë absolute në shumën 7,457 milionë lekë, të ardhurat nga akciza me një rritje në masën 4.92 %, por në vlerë absolute në shumën 2.300 milionë lekë, si dhe të ardhurat nga renta minerare janë planifikuar me rritje në masën 43.33 %, ose në vlerën 910 milionë lekë më shumë se viti 2017. Ndërsa të ardhurat nga taksa doganore janë planifikuar me rritje në masën 9.34 %, ose më shumë në vlerë 598 milionë lekë.

Planifikimi të ardhurave doganore për vitet 2016-2018 pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

(në milion lekë)

Zërat e të ardhurave	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Takse doganore	5,480	5941	5323	6,036	6,400	6,998	7,392
TVSH	86,316	97765	101759	100,301	102,517	109,974	114,813
Akcizë	35,030	44520	44900	44,653	46,700	49,000	48,300
Renta	8,831	7999	4218	4,100	2,100	3,010	2,800
Totali	135,657	156,225	156,200	155,090	157,717	168,982	173,305

(Të dhënat: DPD Punoi:KLSH)

Plani i të ardhurave për DPD nga viti në vit ka pësuar këto ndryshime:

2014 në krahasim me vitin 2013 është rritur me 15.16 %
2015 në krahasim me vitin 2014 është rritur me -0.01 %
2016 në krahasim me vitin 2015 është rritur me -0.71 %
2017 në krahasim me vitin 2016 është rritur me 1.69 %
2018 në krahasim me vitin 2017 është rritur me 7.14 %

Plani për Degwt Doganore *(kwtu e nw vazhdim DD),* është përcjellë çdo muaj nga DPD, me shkresat përkatëse dhe progresiv për periudhën Janar-Dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

(në mijë lekë)

Degët Doganore	*Taksa doganore*	*TVSH*	*Akciza*	*Taksë (renta)*	*Totali*	*Pesha (%) specifike/totali*
Tiranë	3,590,258	12,188,303	41,806,082	702	57,585,344	36.20
Rinas	136,355	11,983	2,461,010	3	2,609,350	1.64
Durrës	1,376,186	21,007,304	40,720,511	395,917	63,499,918	39.91
Shkodër	60,539	198,441	2,986,623	15,302	3,260,906	2.05
Pogradec	147,498	108,531	1,408,960	11,695	1,676,684	1.05
Gjirokastër	379,642	6,883,916	5,106,878	2,440	12,372,875	7.78
Korçë	17,390	176,483	362,193	77	556,142	0.35
Kapshticë	90,319	365,101	2,570,633	208	3,026,262	1.90
Vlorë	96,450	1,254,911	2,255,443	2,052,108	5,658,913	3.56
Fier	150,675	3,903,273	2,436,470	29,101	6,519,520	4.10
Sarandë	11,101	8,295	281,331	1,236	301,964	0.19
Elbasan	120,934	358,211	2,102,619	69,655	2,651,419	1.67
Lezhë	18,723	61,095	928,033	745	1,008,597	0.63
Berat	17,004	64,332	412,643	2,977	496,957	0.31
Kukës	3,122	8,302	1,088,164	35,601	1,135,190	0.71
Peshkopi	574	27,878	221,697	403	250,552	0.16
Tri Urat	167	2,597	7,509	42	10,315	0.01
Totali	6,216,936	46,628,958	107,156,799	2,618,214	162,620,906	100

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme shohim se në planin e të ardhurave në nivel DD ndaj totalit, DD. Durrës zë 39.91% të planit, DD. Tiranë zënë rreth 36.20 % të planit, DD. Gjirokastër me 7.78 %, DD. Vlorë me 3.56 %, DD. Fier me 4.10 %, DD. Shkodër me 2.05 % të të ardhurave doganore, ndërsa degët e tjera doganore kanë një peshë specifike të ulët ndaj totalit të të ardhurave, duke variuar nga 0.01 % deri në 1.67 %.

2. Realizimi i të ardhurave doganore, analiza dhe krahasimi i treguesve.

Realizimi të ardhurave sipas zërave të të ardhurave doganore për vitin 2018 rezultojnë si më poshtë vijon:

(në mijë/lekë)

Nr	*Zërat e të ardhurave*	*Fakt 2017*	*Plan 2018*	*Fakt 2018*	*Diferenca*	*Realizimi % Plan Fakt 2017, 2018*
1	TVSH (neto)	104,586,054				
	TVSH (bruto)	104,586,054	109,974,001	107,156,799	-2,817,202	97%
	Rimbursim	0				
2	Akciza (neto)	45,101,231	49,000,000	44,986,014	4,013,986	91.8%
	Akciza (bruto)	45,679,922	49,000,000	46,628,958	2,371,042	95%
	Rimbursime	578691		1,642,944		
3	Taksë Doganore (neto)	6,491,512				
	Taksë Doganore (bruto)	6,491,512	6,998,000	6,216,936	-781,064	89%
	Rimbursim	0				
4	Taksë nacionale (renta)	2,332,965	3,010,000	2,618,214	-391,786	875
5	Total bruto	159,090,453	168,982,001	162,620,907	-6,361,094	96.2%
6	Total rimbursime	578,691		1,642,944,		
7	Total neto	158,511,762	168,982,001	164,263,851	-6,361,094	96.2%

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Referuar të dhënave të mësipërme të ardhurat nga AD janë realizuar në vlerën 162,620,906 mijë lekë, duke u paraqitur me një mosrealizim në vlerën 6,361,095 mijë lekë kundrejt planit, ose me realizim në masën 96.2 %. Analiza mbi realizimin e treguesve është mbështetur në të dhënat statistikore, ndryshimi i të cilave në krahasim me të ardhurat e realizuar sipas rakordimit me thesarin nuk ndikon në analizën e treguesve, të cilët sipas llojit të të ardhurave doganore të DD paraqitet si më poshtë:
Realizimi i të ardhurave(neto) krahasuar me vitin 2017

(në mijë lekë)

Lloji/ Periudha	*Fakt 2017*	*Fakt 2018*	*Dif. 2018 - 2017*

Taksë doganore	6,491,512	6,216,936	-274,576
Akcizë	45,101,231	44,986,014	-115,217
Tvsh	104,596,054	107,156,799	2,560,745
Rentë	2,332,965	2,618,214	285,249
Totali	158,511,762	160,977,963	2,456,201

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Analizuar sipas llojit të taksave doganore, konstatohet se të gjitha taksat nuk janë realizuar në krahasim me planin. (bruto). Me mosrealizim paraqitet realizimi i të ardhurave nga TVSH, në vlerën 2,817,202 mijë lekë kundrejt planit, ose me realizim në masën 97.3 %. Me mosrealizim paraqiten të ardhurat nga akciza në vlerën 2,371,042 mijë lekë kundrejt planit, ose me realizim në masën 95 %. Me mosrealizim paraqiten të ardhurat nga taksat nacionale (renta minerare) në vlerën 391,787 mijë lekë kundrejt planit, ose me realizim në masën 87 %. Me mosrealizim paraqiten të ardhurat nga taksa doganore në vlerën 781,064 mijë lekë, ose më realizim në masën 89 %. Në mosrealizimin e këtyre treguesve ka ndikuar niveli i import -eksporteve si më poshtë:

Të dhëna mbi volumet e import - eksportit në vlerë

(në milionë/lekë)

Muajt	***Import Total***	***Import me TVSH të Përjashtuar Makineri dhe Pajisje***	***Import me TVSH të Përjashtuar Barna dhe Ar I pastër***	***Përjashtim për ndihma humanitare etj***	***Import i Taksuar***	***Eksport Total***	***Eksport Definitiv***	***Rieksport nga Përpunimi Aktiv***
Progresive 2017	627,014	8,889	26,216	7,415	496,986	272,902	104,803	165,622
Progresive 2018	642,267	8,582	25,559	16,829	493,432	310,344	124,599	184,463
Dif. në Vlerë	15,253	-307	-657	9,414	-3,554	37,442	19,795	18,841
Diferenca në %	2.4	-3.5	-2.5	127.0	-0.7	13.7	19	11.4

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Të dhëna mbi volumet e import - eksportit në peshë

(në ton)

Përshkrimi	***Import Total***	***Import me TVSH te Perjashtuar Makineri dhe Pajisje***	***Import me TVSH te Perjashtuar Barna dhe Ar I paster***	***Përjashtim për ndihma humanitare etj***	***Import i Taksuar***	***Eksport Total***	***Eksport Definitiv***	***Rieksport nga Perpunimi Aktiv***
Progresive 2017	4,280,359	9,552	6,992	21,236	3,970,692	3,947,552	3,690,427	243,414
Progresive 2018	4,487,839	7,986	6,880	22,597	4,002,471	3,943,689	3,555,499	379,531
Diferenca në peshë	207,480	-1,566	-112	1,361	31,779	-3,863	-134,927	136,117
Diferenca në %	4.8	-16.4	-1.6	6.4	0.8	-0.1	-4	55.9

(Të dhënat: DPD Punoi:KLSH)

a-Realizimi i të ardhurave nga taksa doganore

(në mijë/lekë)

Dogana	***Plan***	***Fakt***	***Diferencë***	***%***
Tiranë	3,975,493	3,590,258	- 385,235	90.3%
Rinas	153,517	136,355	- 17,163	88.8%
Durrës	1,690,192	1,376,186	- 314,006	81.4%
Shkodër	74,255	60,539	- 13,715	81.5%
Pogradec	135,453	147,498	12,045	108.9%
Gjirokastër	400,701	379,642	- 21,059	94.7%
Korçë	16,121	17,390	1,269	107.9%
Kapshticë	94,729	90,319	- 4,410	95.3%
Vlorë	117,497	96,450	- 21,047	82.1%
Fier	174,017	150,675	- 23,343	86.6%
Sarandë	6,055	11,101	5,045	183.3%
Elbasan	113,177	120,934	7,757	106.9%
Lezhë	26,528	18,723	- 7,805	70.6%
Berat	16,021	17,004	983	106.1%
Kukës	3,298	3,122	- 176	94.7%
Peshkopi	522	574	52	110.0%
Tri Urat	424	167	- 256	39.4%
Totali	6,998,000	6,216,936	- 781,064	88.8%

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Të ardhurat nga "Taksa doganore", rezultojnë me një mosrealizim në vlerën 781,064 mijë lekë, ose në masën 88.8 %, kundrejt planit. Në analizën e realizimit të të ardhurave sipas DD rezulton se:

Në planin e të ardhurave nga "Taksa doganore", peshën specifike më të lartë e ka DD. Tiranë, e cila paraqitet me mosrealizim në masën 9.7 %, kundrejt planit.

Një peshë tjetër të rëndësishme në planin e të ardhurave nga "Taksa doganore" ka patur DD. Durrës e cila paraqitet me mosrealizim në masën 18.6 % kundrejt planit.

Pothuajse, të gjitha degët doganore paraqiten me mos realizim të këtij treguesi, me përjashtim të DD Peshkopi, Berat, Elbasan dhe Sarandë por që nuk kanë peshë specifike të ndjeshme ndaj totalit të të ardhurave nga taksa doganore.

Rënia e të ardhurave nga taksa doganore është ndikuar nga dy faktorë:

Nga heqja e kuotave të importit të lëndëve të para të prodhimit të sheqerit nga BE, prej datës 30 Nëntor 2017, pasi, sasitë me të mëdha sheqeri eksportohen drejt vendeve të Ballkanit me origjinë preferenciale evropiane, ku për vitin 2018 humbja nga ky ndryshim i BE është 328,6 milion lekë; mos-importimi i rreth 248 ton cigare ka sjell një humbje në Taksën Doganore prej 82,7 milion lekë, si dhe humbja në taksën doganore nga rënia e kursit të këmbimit është rreth 370,8 milion lekë

b-Realizimi i të ardhurave nga akciza

(në mijë/lekë)

Dogana	*Plan*	*Fakt*	*Diferencë*	*Rimbursim*	*Realiz. Progr. me AKC të Rimb.*	*%*
Tiranë	13,205,707	12,188,303	-1,017,405	45,398	12,142,904	92.0%
Rinas	8,601	11,983	3,382	-	11,983	139.3%
Durrës	22,655,730	21,007,304	-1,648,426	513,808	20,493,496	90.5%
Shkodër	172,838	198,441	25,603	-	198,441	114.8%
Pogradec	108,488	108,531	43		108,531	100.0%
Gjirokastër	6,898,605	6,883,916	-14,689	-	6,883,916	99.8%
Korçë	177,839	176,483	-1,357	256	176,227	99.1%
Kapshticë	452,677	365,101	- 87,576	-	365,101	80.7%
Vlorë	1,201,531	1,254,911	53,380	-	1,254,911	104.4%
Fier	3,479,720	3,903,273	423,553	971,073	2,932,201	84.3%
Sarandë	8,076	8,295	220	-	8,295	102.7%
Elbasan	343,475	358,211	14,736	112,408	245,803	71.6%
Lezhë	169,655	61,095	- 108,559	-	61,095	36.0%
Berat	80,330	64,332	- 15,997	-	64,332	80.1%
Kukës	9,587	8,302	- 1,284	-	8,302	86.6%
Peshkopi	24,626	27,878	3,251	-	27,878	113.2%
Tri Urat	2,513	2,597	85	-	2,597	103.4%
Totali	49,000,000	46,628,958	- 2,371,042	1,642,944	44,986,014	95.2%

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Të ardhurat neto nga akciza nga 49,000 mijë lekë që ishte planifikuar realizuan në masën 46,629 mijë lekë i ose rreth -2,371 mijë lekë më pak. Në realizimin e të ardhurave nga akciza, me përjashtim të DD: Tre Urat; Peshkopi; Elbasan; Sarandë; Vlorw; Pogradec; Shkodër; Rinas dhe Fier, të gjitha DD, janë paraqitur me mosrealizim, ose me realizim në masën 93.8 % kundrejt planit.

Të ardhurat neto nga realizimi akcizës, sipas DD janë si më poshtë vijon:

- Me mosrealizim në të ardhurat nga "Akciza" kanë rezultuar DD Durrës me një mosrealizim në vlerën 1,648,426 mijë lekë, ose me realizim në masën 90.5 %; DD Tiranë me një mosrealizim në vlerën 1,017,405 mijë lekë ose realizim në vlerë 92%, DD Kapshticë me një mosrealizim në vlerën 87,576 mijë lekë, ose me realizim në masën 80.7%: DD Fier me një mosrealizim në vlerën 423,553 mijë lekë, ose me realizim në masën 84.3%; DD Lezhe me një mosrealizim në vlerën 108,559 mijë lekë, ose me realizim në masën 36%. Degët e tjera doganore, por që nuk kanë peshë specifike të ndjeshme ndaj totalit të të ardhurave nga akciza paraqiten me mos realizim të këtij treguesi.

Të ardhurat nga Akciza, janë realizuar vetëm nga dega doganore DD Rinas me tejkalim 3,382 mijë lekëose139.3 % kundrejt planit, DD Shkodër me tejkalim 25,603 mijë lekë ose 114.8% kundrejt planit dhe DD Vlorë me tejkalim 53,380 mijë lekë ose 104.4 % kundrejt planit, DD Sarandë me tejkalim 220 mijë lekë ose 102.7 % kundrejt planit, DD Peshkopi me tejkalim 3,251 mijë lekë ose 113.2 % kundrejt planit, DD Tre Urat me tejkalim 85 mijë lekë ose 103.4 % kundrejt planit dhe DD Pogradec me tejkalim 43 mijë lekë ose 100 % kundrejt planit.
Produkteve e akcizës që kanë shënuar rënie gjatë vitit 2018, janë produkte prodhim vendas kryesisht:

në sasi

Produktet e akcizës	*Njësia*	*2017*	*2018*	*Dif 2018-2017*	*Dif 2018-2017*
Birrë Prodhim Vendi	mijë litra	41,949	41,593	-1%	-356
Karburante Prodhim Vendi	Ton	156,636	95,188	-39	-61,448
Pije Alkolike Prodhim Vendi	mijë litra	1,021	1,080	-10	-121
Duhan Prodhim Vendi	Ton	12	25	106	13

në sasi

Produktet e akcizës	*Njësia*	*2017*	*2018*	*Dif 2018-2017*	*%*
Pije Alkolike Prodhim Vendi	Mijë litra	1,080	1,201	-121	-10
Pije Alkolike Import	Mijë litra	1,038	967	-71	-7
Cigare Puro Import	Ton	3	3.857	0.825	27
Cigare	Ton	3,106	2,858	-248	-8
Verë Prodhim Vendi	Mië litra	1,775	1,582	-193	-11
Duhan Importi	Ton	82	98	16	19
Verë Import	Mijë litra	4,967	4,651	-316	-6
Karburante Import	Ton	400,256	501,797	101,541	25
Birrë Importi	Mijë litra	41,817	43,399	1,582	4
Kafe	Ton	8,485	,334	849	10

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Në analizën e të ardhurave nga akciza, rezulton se këtë vit janë mbledhur akciza bruto 46,628,958 mijë lekë nga 45,679,922 mijë lekë ose 949,036 mijë lekë më shumë se akciza bruto e vitit paraardhës. Gjatë vitit është rimbursuar akcizë në vlerën 1,642,944 mijë lekë duke realizuar të ardhura neto nga akciza 44,986,014 mijë lekë. Nëse analizojmë të ardhurat nga akciza bruto, rimbursimet e dhëna dhe akciza neto, rezulton se në vitin 2018 janë mbledhur akciza bruto 0.9 miliard lekë më shumë të ardhura nga akciza bruto se vitin e kaluar, por për efekt të rimbursimit të ardhurat neto nga akciza janë realizuar 2.37 miliard lekë më pak se plani.

(në miliard lekë)

Emërtimi	*2017*	*Plan2018*	*Fakt 2018*	*Dif.Fakt/Plan 2018*	*Dif. 2018.2017*
Akciza bruto	45.7	49	46.6	(2.4)	0.9

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Gjatë vitit 2018 është rimbursuar 1,439,039 mijë lekë kundrejt 566,533 mijë lekë të rimbursuar në vitin 2017, nga e cila akciza e rimbursuar për biokarburet është më shumë në vlerën 43,377 mijë lekë dhe akciza e rimbursuar për serat dhe industrinë është më shumë në vlerën 829,129 mijë lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

(në mijë lekë)

Periudha	*Akcizë e përjashtuar për peshkimin*	*Akcizë e rimbursuar për biokarburantet*	*Akcizë e rimbursiar për serat dhe industrinë*	*Total rimbursimi*
	a	b	c	d=b+c
Viti 2018	362,551	367,444	1,071,595	1,439,039
Viti 2017	301,941	324,067	242,466	566,533
Dif.2018-2017	60,610	43,377	829,129	872,506

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Sipas tabelës së mëposhtëm rezulton se produktet kryesorë të akcizës të cilat kanë gjeneruar të ardhura më të larta se viti 2017 janë: karburantet import me 4,2 miliard lekë më shumë; birra import me 304

milion lekë më shumë; birra prodhim vend me 173 milion lekë më shumë; duhan import me 59 milion lekë më shumë; vaj lubrifikant me 39 milion lekë më shumë; duhan prodhim vend me 37 milion lekë më shumë.

Të vetmit produkte akcize të cilët kanë gjeneruar më pak të ardhura nga akciza janë: karburanti prodhim vend me minus 2.9 miliard lekë *(lidhur me mosfunksionimin e rafinerisë për Janar-Prill 2018)*; cigare me -657 milion lekë; pijet energjike import -222 milion lekë, akciza e të cilave është hequr në Janar 2018; gaz i lëngshëm me -40 milion lekë, si dhe artikuj të tjerë të pa specifikuar me -37 milion lekë.

c. Realizimi i të ardhurave nga taksa nacionale (renta minerare) sipas DD realizimi rezulton si më poshtë:

(në mijë/lekë)

Dogana	*Plan*	*Fakt*	*Diferencë*	*%*
Tiranë	734	702	- 31	95.8%
Rinas	10	3	- 7	28.8%
Durrës	521,502	395,917	- 125,585	75.9%
Shkodër	14,461	15,302	841	105.8%
Pogradec	9,301	11,695	2,394	125.7%
Gjirokastër	2,514	2,440	- 74	97.1%
Korçë	34	77	43	225.7%
Kapshticë	403	208	- 195	51.7%
Vlorë	2,175,695	2,052,108	- 123,587	94.3%
Fier	160,440	29,101	- 131,339	18.1%
Sarandë	1,235	1,236	1	100.1%
Elbasan	85,778	69,655	- 16,123	81.2%
Lezhë	597	745	148	124.8%
Berat	2,678	2,977	299	111.2%
Kukës	34,336	35,601	1,266	103.7%
Peshkopi	204	403	199	197.5%
Tri Urat	78	42	- 37	53.2%
Totali	3,010,000	2,618,214	- 391,786	87.0%

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Të ardhurat nga renta minerale rezultojnë me mosrealizim në vlerën 391,796 mijë lekë, ose në masën 87 %, kundrejt planit, ku sipas DD rezulton: *Me mosrealizim* në të ardhurat nga "Renta minerare" ka rezultuar DD Vlorë me një mosrealizim në vlerën 123,587 mijë lekë, ose në masën 94.3 %; DD. Durrës, me një mosrealizim në vlerën 125,585 mijë lekë, ose në masën 75.92% dhe DD Fier me një mosrealizim në vlerën 131,339 mijë lekë, ose në masën 18.1 %, të cilat kanë peshe specifike te lartë ndaj planit. Degët e tjera doganore kanë mosrealizim, por zënë një peshë specifike të ulët kundrejt planit të kësaj të ardhure. me realizim të të ardhurave nga renta minerare, paraqiten DD: Shkodër; Korçë; Lezhë; Berat; Kukës dhe Peshkopi, me tejkalim plani, por me peshë specifike shumë ulët kundrejt planit.

Nr	*Emërtimi*	*Njësia*	*Eksporte 2017*	*Eksporte 2017*	*Diferenca*
1	Mineralet dhe minerale të tjera	Ton	2,250,727	2,103,269	-147,457
2	Nafta dhe gazi (Nafta bruto)	Ton	493,931	582,787	88,857
3	Mineralet dhe minerale të tjera	Mijë Lekë	887,555	540,925	-346,631
4	Nafta dhe gazi (Nafta bruto)	Mijë Lekë	1,448,927	2,075,114	626,187

(Të dhënat: DPD Punoi:KLSH)

Dy faktorët kryesore negative që kanë ndikuar në këtë ulje të të ardhurave nga renta e mineraleve të tjera:

1) ulja e sasive të eksportuar me -6,6% (në vitin 2017 ishin 2,250 Mijë ton ndërsa në vitin 2018 ishin 2,103 Mijë ton eksport minerale të tjera) si dhe 2) një ulje e të ardhurave mesatare për njësi të rentës

(në periudhën Janar-Nëntor 2018 merret mesatarisht 0.26 lekë / njësi minerale, ndërsa në vitin 2017 merrej 0.39 lekë / njësi minerali).

d. Realizimi i të ardhurave nga TVSH

(në mijë lekë)

Dogana	*Plan*	*Fakt*	*Diferencë*	*%*
Tiranë	41,973,084	41,806,082	- 167,003	99.6%
Rinas	2,521,586	2,461,010	- 60,576	97.6%
Durrës	41,307,183	40,720,511	- 586,672	98.6%
Shkodër	3,233,309	2,986,623	- 246,686	92.4%
Pogradec	1,511,403	1,408,960	- 102,443	93.2%
Gjirokastër	5,677,525	5,106,878	- 570,648	89.9%
Korçë	396,695	362,193	- 34,501	91.3%
Kapshticë	2,608,182	2,570,633	- 37,549	98.6%
Vlorë	2,395,110	2,255,443	- 139,667	94.2%
Fier	2,764,666	2,436,470	- 328,196	88.1%
Sarandë	298,084	281,331	- 16,752	94.4%
Elbasan	2,536,995	2,102,619	- 434,376	82.9%
Lezhë	903,154	928,033	24,880	102.8%
Berat	427,632	412,643	- 14,989	96.5%
Kukës	1,176,598	1,088,164	- 88,433	92.5%
Peshkopi	231,392	221,697	- 9,695	95.8%
Tri Urat	11,404	7,509	- 3,895	65.8%
Totali	109,974,001	107,156,799	- 2,817,202	97.4%

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

- Me mosrealizim që ka ndikim në të ardhurat nga "TVSH" kanë rezultuar DD: Durrës, me mosrealizim në vlerën 586,672 mijë lekë, ose me realizim në masën 98.6 %; Gjirokastër, me mosrealizim në masën 570,648 mijë lekë, ose me realizim në masën 89.9 %; Fier, me mosrealizim në vlerën 328,196 mijë lekë, ose me realizim në masën 88.1 %; Shkodër, me mosrealizim në masën 246,686 mijë lekë, ose realizim 92.4%; Elbasan, me mosrealizim në vlerën 434,376 mijë lekë, ose me realizim në masën 82.9%; Pogradec, me mosrealizim në masën 102,443 mijë lekë, ose realizim 93.2%; Kukës, me mosrealizim në vlerën 88,433 mijë lekë, ose me realizim në masën 92.5 %; Elbasan, etj.
- Të ardhurat nga TVSH, janë realizuar vetëm nga DD: Lezhë me tejkalim 24,880 mijë lekë, ose me realizim 105 %; Kapshticë, me tejkalim 166,157 mijë lekë, ose realizim 102.8 % kundrejt planit.

Grup mallrat që kanë që kanë ndikuar negativisht në mosrealizimin e të ardhurave nga TVSH, krahasuar me të ardhurat e vitit 2017 janë: energji elektrike -1,970 milion lekë; metalet bazë -771 milion lekë, për arsye të uljes së sasisë së importit të materialeve të projektit TAP; sheqeri -509 milion lekë, për arsye të rënies së importeve për këtë njëmbëdhjetë mujor; efekti "TAP" ka pasur ndikim të dukshëm në të ardhurat doganore. Gjatë vitit 2017 janë arkëtuar rreth 1.46 miliard lekë të ardhura, ndërsa në vitin 2018 janë arkëtuar 33% e kësaj shumë dhe pikërisht 480 milion lekë. Diferenca prej 977 milion lekë është vetëm nga të ardhurat e drejt për drejta, sepse të ardhurat e tërthorta janë akoma edhe më shumë, si dhe cigare -193 milion lekë

Grup mallrat që kanë që kanë ndikuar pozitivisht në realizimin e të ardhurave nga TVSH, krahasuar me të ardhurat e vitit 2017 janë: karburant import (+3,815 milion lekë); artikujt të tjerë (të paspecifikuar) (+1,894 milion lekë); autovetura të përdorura (+541 milion lekë); fruta & perime (+206 milion lekë); ndikimi negativ i kursit të këmbimit. Në këto të dhëna vlen të theksohet se rënia drastike e kursit të këmbimit ka dhënë një impak negative në realizimin e të ardhurave. Rënia e kursit mesatar të dollarit me 12.29 pikë dhe i Euros me 5.96 pikë ka sjellë për Administratës Doganore një humbje prej rreth 7.6 miliard lekë, si në tabelën e mëposhtme:

Muajt	*Humbje në Taksë Doganore*	*Humbje në TVSH*	*Humbje në Rentë të mineraleve te tjera*	*Humbje në Rentë të Naftës Bruto*	*TOTAL*
Janar	28,924,188	446,443,879	8,155,281	22,883,288	506,406,636

Shkurt	34,414,756	540,944,908	21,867,704	35,518,712	632,746,081
Mars	38,779,866	551,615,183	11,927,554	33,333,971	635,656,574
Prill	40,483,861	749,030,126	8,684,368	42,371,352	840,569,707
Maj	48,494,808	753,741,341	5,166,404	36,600,516	844,003,069
Qershor	39,889,871	678,208,821	2,269,403	18,424,713	738,792,809
Korrrik	35,149,527	564,675,696	2,138,115	11,003,387	612,966,726
Gusht	28,248,168	500,192,065	3,322,919	20,364,874	552,128,026
Shtator	21,933,272	452,015,882	1,471,867	5,954,691	481,375,712
Tetor	26,646,747	506,718,522	1,842,455	10,305,666	545,513,390
Nëntor	27,881,587	532,182,231	2,449,913	5,175,270	567,689,002
Dhjetor	29,436,054	596,964,436	478,437	3,100,222	629,979,149
Viti 2018	400,282,705	6,872,733,092	69,774,420	245,036,663	7,587,826,880

(Të dhënat: DPD-SIFQ Punoi:KLSH)

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se duke analizuar të ardhurat sipas llojit të taksave, konstatohet se Taksa Doganore, Akciza, TVSH dhe Renta Minerare, janë me performancë negative në krahasim me planin. Kështu, ulja më e madhe e të ardhurave vjen kryesisht nga TVSH me rreth 2. 817 milion lekë më pak nga planifikimi

Për vitin 2018, në të ardhurat doganore, faktorët pozitivë kanë qënë:

Vlerat e deklaruara në import kanë dhënë një rritje prej rreth 10 miliard lekë krahasuar me vitin 2017;

Sasitë e importuara kanë dhënë efekt pozitiv me rreth 3 miliard lekë, e lidhur kjo me rritjen importeve të karburantit;

Efekti i ndikimit të çmimeve ndërkombëtare, kryesisht të karburanteve, që sipas modelit vlerësohet rreth 3 miliard lekë më tepër;

Faktori "Renta Minerare" e cili reflekton kontributin e kësaj takse në të ardhura me 494 milion lekë më tepër.

Pavarësisht nga ndikimi i këtyre faktorëve pozitivë, faktorët të cilët kanë ndikuar negativisht në të ardhurat doganore, janë si vijon:

-Efekti i kursit të këmbimit vazhdon të jetë negativ në të ardhurat doganore, me rreth 7.6 miliard lekë, ku vetëm për muajin Dhjetor 2018, ky efekt negativ ka qënë me 630 milion lekë më pak. Efektin më të madh negativ e jep ulja e madhe e kursit të këmbimit të Dollarit Amerikan, me mesatarisht -11.52 pikë si vit;

-Aplikimi i çmimeve referuese (transaksionit), ka dhënë një impakt negative prej – 486 milion lekë;

-Ulja e të ardhurave nga politikat fiskale me rreth 601 milion lekë është ngushtësisht e lidhur me uljen e të ardhurave nga pijet energjike;

-Faktori NET AAD ka të bëjë me rënien e të ardhurave nga DSHA duke qenë se gjatë vitit 2018 ka patur vetëm rreth 60.000 Ton prodhim Gazoil nga rafineria vendase. Rënia e këtij faktori është rreth 634 milion lekë;

-Faktori "Interaction Term" ka ndikuar negativisht tek të ardhurat doganore me 2,526 milion lekë më pak. Ky faktor shpjegon ndyshimin me minus të të ardhurave doganore nga ndërthurja e elementëve të tillë si kursi i këmbimi; politikat fiskale, vlera doganore, etj.

-Faktorë të tjerë me efekt negativ prej 1,281 milion lekë më pak.

3. Borxhi doganor, ecuria dhe masat shtrënguese të marra për rikuperimin e tij. Auditimi i dokumentacionit lidhur me transferimin e akcizës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 242/1 prot., datë 06.06.2019 "Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare" të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistrin elektronik (data base), i të dhënave për shkeljet në fushën doganore të administruara nga Sektori i Monitorimit të Borxhit;

2. Raportimet zyrtare mujore lidhur me gjendjen e detyrimeve të papaguara si dhe procedurat e ndjekura nga sektori i borxhit pranë degëve doganore për rikuperimin e tij;
3. Dosjet e subjekteve me detyrimeve të papaguara, historikun si dhe veprimtarinë e tyre lidhur me procedurat doganore të kryera pas daljes debitor, të verifikuara në sistemin Asycuda Ŵorld.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion (data base apo manual), në lidhje me detyrimet e papaguara të subjekteve që kanë rezultuar debitor si pasojë e shkeljeve të legjislacionit doganor si dhe legjislacionit të akcizës, konstatohet që:

Nga ana e: zj. A..... Sh....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Shkodër; zj. J... M..... (periudha 01.01.2018 – 06.03.2018), z. Sh..... T..... (për periudhën 06.03.2018 – 24.09.2018), zj. A..... U... (për periudhën 24.09.2018 – 31.12.2018), me detyrë dhe në cilësinë e specialist borxhi në DD. Tiranë; z. F..... N....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Morinë; z. E.... D..., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Lezhë; z. B..... K....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Bllatë; z. K..... E..... (për periudhën 01.01.2018 – 19.11.2018), z. A..... S..... (për periudhën 19.11.2018 – 31.12.2018), me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Rinas; zj. N.... Gj..., zj. A... R....., me detyrë dhe në cilësinë e specialist borxhi në DD. Durrës; zj. B.... K..., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Qafë Thanë; zj. Atina Irakli, me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Korçë; zj. A.... G....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Fier; z. E... M.., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Vlorë; z. S.... R...., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Berat; z. H..... M...., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Sarandë; si dhe zj. A..... T...., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Kakavie & DD. Tre Urat, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra legjislacionin doganor lidhur me procedurat e ndjekura për rikuperimin e borxhit doganor referuar kërkesave të Udhëzimit nr. 4, datë 07.04.2016, ndryshuar me Udhëzimin nr. 15, datë 03.12.2018, të DPD *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* nxjerrë për këtë qëllim.

Referuar nenit 245, pika 3, të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

Autoritetet doganore mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente edhe pezullimin e aktivitetit ekonomik të debitorit në lidhje me importimin, eksportimin, dhe tranzitimin e mallrave ose të aktiviteteve të tjera prodhuese për ushtrimin e të cilave debitori është regjitstruar pranë autoriteteve te taksave.

Referuar nenit 106, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që: në të përcaktohet qartë që:

Kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit nuk është paguar brenda afatit të caktuar, autoritetet doganore përdorin të gjitha mjetet ligjore në fuqi për të siguruar ekzekutimin e pagesës.

Referuar nenit 103, pika 3, të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 *"Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, në të përcaktohet qartë që:

Autoritetet doganore, përveç ushtrimit të kompetencave të tyre, sipas këtij ligji, mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente edhe marrjen e masave të tjera specifike, si pezullimi i veprimtarive ekonomike të debitorit ose të veprimtarive të tjera prodhuese, për ushtrimin e të cilave debitori është regjistruar pranë këtyre autoriteteve.

Referuar nenit 103, pika 4, nr. 61/2012, datë 24.05.2012 *"Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, në të përcaktohet qartë që:

Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për

rikuperimin me forcë të borxhit të akcizës bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit.

Referuar pikës 2.2.1, germa "a", të pjesës IX, të Udhëzimit nr. 4, datë 07.04.2016, të DPD *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, në të përcaktohet qartë që:

Menjëherë pas kalimit të afatit për ekzekutimin vullnetar të urdhrit të ekzekutimit, me qëllim mundësimin e ekzekutimit të detyrimeve të papaguara, Dega Doganore në zbatim të neneve 100, 245 dhe 289 të Kodit Doganor dhe nenit 103 të Ligjit 61/2012, në mbështetje të nenit 138 të Kodit të Procedurës Administrative fillon ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Për këtë qëllim DD kërkon nga DPD kryerjen e procedurave si vijon: iv. Bllokimin në sistem të subjektit debitor.

Referuar pikës 2.6, të pjesës VII, të Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018, të DPD *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, në të përcaktohet qartë që:

Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import qoftë në eksport.

Referuar pikës 4, germa "c", të pjesës IV, të Udhëzimit nr. 4, datë 07.04.2016, ndryshuar me pikën 7.1, germa "ç" të Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018, të DPD *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, në të përcaktohet qartë që:

Identifikimin e deklaruesit/subjektit debitor të cilit i drejtohet akti (NIPT/NUIS, numrin e identifikimit).

3.1. *Auditimi i borxhit doganor dhe ecuria e tij. Masat shtrënguese të marra për rikuperimin e borxhit doganor.*

3.1.1. Auditimi i borxhit doganor dhe ecuria e tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, materialeve, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, rezulton se gjendja e borxhit doganor më 01.01.2018 paraqitet me 4521 raste, 2978 subjekte debitorë në vlerën 23,946,599 mijë lekë. Gjendja e borxhit më datë 31.12.2018 paraqitet me 4520 raste, 3211 subjekte debitorë në vlerën 27,596,148 mijë lekë, pra gjatë vitit ushtrimor 2018, borxhi doganor është shtuar me 233 subjekte debitorë ose 7.8 %, ndërsa në vlerë 3,649,549 mijë lekë ose 15.2 %. *Nga një analizë e shkurtër e të dhënave për borxhin në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor, rezulton se kemi pothuaj* ***në të gjitha Degët Doganore një rritje*** *të treguesve të borxhit, ku përjashtim bëjnë* ***Dega e Doganës Vlorë*** *ku borxhi është* ***paksuar*** *në vlerën 24,347,700 lekë, si dhe* ***Dega e Doganës Pogradec*** *ku borxhi është* ***paksuar*** *në vlerën 574,469 lekë. Më konkretisht gjendja e borxhit sipas degëve doganore dhe në total, paraqitet në aneksin nr. 1 të Projektraportit të Auditimit.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, materialeve, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, lidhur me ecurinë e borxhit doganor rezulton se borxhi doganor përgjatë vitit ushtrimor 2018 është shtuar me **4554 raste/3280 debitorë** në vlerën **5,456,153,802 lekë,** ndërsa është pakësuar me **4285 raste/3047 debitorë** në vlerën **1,806,605,004 lekë**. Pra nga sa më sipër, nga një analizë e shkurtër e ecurisë së tij, borxhi doganor përgjatë vitit ushtrimor 2018 është shtuar kundrejt pakësuar me **269 raste** (5.9 %)/**233 debitorë** (7.1 %), në vlerën **3,649,548,798 lekë** (66.8 %). *Edhe në këtë analizë lidhur me shtesat dhe paksimet, gjatë vitit ushtrimor, rezulton se kemi më shumë një borxh të shtuar se sa të pakësuar* ***në të gjitha Degët Doganore****, ku përjashtim bëjnë sërish* ***Dega e Doganës Vlorë*** *ku borxhi është* ***paksuar*** *në vlerën*

24,347,700 lekë, si dhe ***Dega e Doganës Pogradec*** *ku borxhi është* ***paksuar*** *në vlerën 574,469 lekë.* Më konkretisht ecuria e borxhit sipas degëve doganore dhe në total, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Ecuria e borxhit, shtuar, pakësuar përgjatë vitit ushtrimor. ***Pasqyra nr.1***

në lekë

DEGA	*DEBITORE TE SHTUAR*			*DEBITORE TE PAKESUAR*		
	Raste	*Debitore*	*Vlere*	*Raste*	*Debitore*	*Vlere*
TIRANE	1,797	935	*829,945,982*	1,624	781	*640,900,390*
RINAS	81	58	*8,464,355*	81	55	*6,222,099*
DURRES	898	815	*1,133,593,368*	1,003	903	*241,026,361*
SHKODER	122	118	*37,987,772*	117	116	*15,734,024*
POGRADEC	57	53	*3,913,416*	68	67	*4,487,885*
KAKAVIJE	49	44	*17,749,736*	62	59	*6,428,820*
KORCE	104	82	*46,428,823*	111	90	*12,740,939*
KAPSHTICE	158	135	*15,434,811*	164	143	*10,037,265*
VLORE	403	227	*38,297,686*	324	166	*62,645,386*
FIER	306	267	*3,091,060,081*	171	141	*715,533,970*
SARANDE	35	34	*15,563,363*	47	43	*2,407,789*
ELBASAN	136	136	*34,475,770*	141	136	*14,293,575*
LEZHE	84	80	*85,737,193*	89	87	*4,532,357*
BERAT	92	73	*64,047,927*	82	67	*54,385,796*
KUKES	139	130	*11,088,584*	126	122	*4,897,963*
PESHKOPI	49	49	*5,048,155*	52	50	*3,425,154*
TRE URAT	44	44	*17,316,780*	23	21	*6,905,232*
TOTALI	**4,554**	**3,280**	**5,456,153,802**	**4,285**	**3,047**	**1,806,605,004**

(Burimi: DPD Punoi : KLSH)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, lidhur me strukturën e borxhit doganor rezulton se borxhi doganor është i përbërë nga: **detyrime doganore** në vlerën **8,011,488,659 lekë** ose rreth 29 % të totalit; **penalitete** në vlerën **15,755,533,409 lekë** ose rreth 57 % të totalit, si dhe **kamatëvonesa** në vlerën **3,829,126,210 lekë** ose rreth 14 % të totalit. *Edhe në këtë analizë lidhur me strukturën e borxhit vihet re që kamatëvonesat (interesat), kanë një peshë të konsiderueshme në strukturën e borxhit si pasojë e mos rikuperimit në kohë të tij.* Më konkretisht ecuria e borxhit sipas degëve doganore dhe në total, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Gjendja e borxhit doganor sipas zërave më 31.12.2018. ***Pasqyra nr. 2.***

në lekë

DEGA	*Numer Rastesh*	*Detyrime Doganore*	*Penalitete*	*Kamate Vonesa*	*Total Borxhi*
TIRANE	1,723	*1,240,630,854*	*2,912,940,560*	*706,298,633*	***4,859,870,047***
RINAS	21	*1,267,791*	*2,829,447*	*331,677*	***4,428,915***
DURRES	784	*912,858,551*	*2,502,079,051*	*808,383,314*	***4,223,320,916***
SHKODER	136	*63,502,541*	*228,864,927*	*83,797,757*	***376,165,225***
POGRADEC	43	*5,663,769*	*3,743,858*	*3,122,241*	***12,529,868***
KAKAVIJE	299	*137,964,228*	*151,964,042*	*106,951,125*	***396,879,395***
KORCE	102	*183,645,163*	*161,138,606*	*127,602,976*	***472,386,745***
KAPSHTICE	99	*15,572,778*	*33,896,595*	*12,944,213*	***62,413,586***
VLORE	253	*170,170,379*	*448,974,001*	*98,508,596*	***717,652,976***
FIER	462	*4,627,474,042*	*7,719,381,875*	*1,177,245,617*	***13,524,101,534***
SARANDE	95	*39,921,721*	*58,913,560*	*38,112,581*	***136,947,862***
ELBASAN	98	*14,808,772*	*162,804,689*	*54,971,180*	***232,584,641***
LEZHE	86	*468,373,321*	*936,012,809*	*440,447,091*	***1,844,833,221***
BERAT	83	*72,760,590*	*337,487,904*	*111,448,693*	***521,697,187***
KUKES	96	*36,772,889*	*22,377,624*	*21,135,969*	***80,286,482***
PESHKOPI	28	*14,640,823*	*56,281,808*	*34,462,118*	***105,384,749***
TRE URAT	112	*5,460,446*	*15,842,053*	*3,362,429*	***24,664,928***
TOTALI	**4,520**	**8,011,488,659**	**15,755,533,409**	**3,829,126,210**	**27,596,148,278**

(Burimi: DPD Punoi : KLSH)

3.1.2 Masat shtrënguese të marra për rikuperimin e borxhit doganor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, materialeve, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, u konstatua se nga zyra e borxhit pranë degeve doganore nuk janë ndjekur hap pas hapi masat e përcaktuara në legjislacionin doganor si dhe udhëzimet përkatëse të nxjerra për këtë qëllim. Nga 4520 raste në total të subjekteve debitore në vlerën 27,596,148,278 lekë, vetëm për 1682 (37.2 %) raste, për vlerën 17,882,502,047 lekë, kanë vijuar procedurat me nxjerrjen e Urdhër Ekzekutimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara për të cilët është bllokuar edhe në system subjekti debitor sipas kërkesave të udhëzimeve të sipërcituara. Ndërsa për 2838 raste për vlerën 9,713,646,231 lekë, procedurat nuk janë kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor, duke bërë të mundur vazhdimin e veprimtarisë doganore në system të subjekteve debitore. Situata më e rëndë paraqitet në: DD. Tiranë, ku nga 1732 raste për vlerën 4,859,870,048 lekë, rezultojnë pa Urdhër Ekzekutimi, 1618 raste për vlerën 2,326,277,212 lekë; DD. Fier, ku nga 462 raste për vlerën 13,524,101,534 lekë, rezultojnë pa Urdhër Ekzekutimi, 389 raste për vlerën 6,330,752,539 lekë. Më konkretisht gjendja e borxhit sipas degëve doganore dhe në total, me dhe pa Urdhër Ekzekutimi, paraqitet në pasqyraat e mëposhtme *(Pasqyra nr. 3 & Pasqyra nr.4)*

Gjendja e borxhit doganor më 31.12.2018 me urdhra ekzekutimi ***Pasqyra nr. 3.***

në lekë

Deget Doganore	Borxhi i trasheguar deri me 31 Dhjetort 2018					
	Total Borxhi deri me 31 Dhjetor 2018		Borxhi me Urdher Ekzekutimi			
			Borxhi Total me Urdher Ekzekutimi		Nga kjo ne Proces Gjyqesor	
	Nr.	Shume	Nr	Shume	Nr	Shume
TIRANE	**1,723**	*4,859,870,048*	**105**	*2,533,592,836*	**15**	*266,461,737*
RINAS	**21**	*4,428,915*	**9**	*4,024,346*	**1**	*2,647,946*
DURRES	**784**	*4,223,320,916*	**647**	*4,116,340,258*	**76**	*289,027,831*
SHKODER	**136**	*376,165,225*	**70**	*338,370,940*	**1**	*1,489,040*
POGRADEC	**43**	*12,529,868*	**25**	*11,559,407*	**2**	*750,223*
KAKAVIJE	**299**	*396,879,395*	**177**	*328,042,605*	**13**	*103,364,446*
KORCE	**102**	*472,386,745*	**96**	*343,267,482*	**5**	*37,487,781*
KAPSHTICE	**99**	*62,413,586*	**89**	*50,946,788*		
VLORE	**253**	*717,652,976*	**166**	*709,239,418*	**50**	*618,519,573*
FIER	**462**	*13,524,101,534*	**73**	*7,193,348,995*	**12**	*5,405,006,645*
SARANDE	**95**	*136,947,862*	**40**	*108,649,495*	**13**	*79,098,194*
ELBASAN	**98**	*232,584,641*	**20**	*7,797,133*		
LEZHE	**86**	*1,844,833,221*	**34**	*1,788,003,288*	**4**	*93,882,708*
BERAT	**83**	*521,697,187*	**12**	*160,688,357*		
KUKES	**96**	*80,286,482*	**29**	*72,969,807*	**1**	*709,369*
PESHKOPI	**28**	*105,384,749*	**14**	*103,287,579*		
TRE URAT	**112**	*24,664,928*	**76**	*12,373,313*		
TOTALI	**4,520**	**27,596,148,278**	**1,682**	**17,882,502,047**	**193**	**6,898,445,493**

(Burimi: DPD Punoi : KLSH)

Gjendja e borxhit doganor më 31.12.2018 pa urdhra ekzekutimi ***Pasqyra nr. 4.***

në lekë

Deget Doganore	Borxhi i trasheguar deri me 31 Dhjetort 2018					
	Total Borxhi deri me 31 Dhjetor 2018		Borxhi pa Urdher Ekzekutimi			
			Borxhi total pa Urdher Ekzekutimi		Nga kjo ne Proces Gjyqesor	
	Nr.	Shume	Nr	Shume	Nr	Shume
TIRANE	**1,723**	*4,859,870,048*	**1,618**	*2,326,277,212*	178	*973,515,118*
RINAS	**21**	*4,428,915*	**12**	*404,569*		
DURRES	**784**	*4,223,320,916*	**137**	*106,980,658*	5	*12,963,042*
SHKODER	**136**	*376,165,225*	**66**	*37,794,285*	10	*10,286,942*
POGRADEC	**43**	*12,529,868*	**18**	*970,461*		
KAKAVIJE	**299**	*396,879,395*	**122**	*68,836,790*	34	*28,618,320*
KORCE	**102**	*472,386,745*	**6**	*129,119,262*	5	*128,419,602*

KAPSHTICE	**99**	*62,413,586*	**10**	*11,466,798*	4	*8,997,563*
VLORE	**253**	*717,652,976*	**87**	*8,413,558*	1	*142,386*
FIER	**462**	*13,524,101,534*	**389**	*6,330,752,539*	22	*3,860,726,566*
SARANDE	**95**	*136,947,862*	**55**	*28,298,367*	13	*11,199,320*
ELBASAN	**98**	*232,584,641*	**78**	*224,787,508*	6	*196,724,164*
LEZHE	**86**	*1,844,833,221*	**52**	*56,829,933*	7	*29,450,951*
BERAT	**83**	*521,697,187*	**71**	*361,008,830*	6	*41,412,612*
KUKES	**96**	*80,286,482*	**67**	*7,316,675*	1	*527,193*
PESHKOPI	**28**	*105,384,749*	**14**	*2,097,170*	1	*1,319,953*
TRE URAT	**112**	*24,664,928*	**36**	*12,291,615*	3	*3,235,703*
TOTALI	**4,520**	**27,596,148,278**	**2,838**	**9,713,646,231**	**296**	**5,307,539,436**

(Burimi: DPD Punoi : KLSH)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, materialeve, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, si dhe verifikimi në sistemin Asycuda Ŵorld, u konstatua se nga zyra e borxhit pranë degeve doganore nuk janë ndjekur hap pas hapi masat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin doganor si dhe udhëzimet përkatëse të nxjerra për këtë qëllim për rikuperimin e detyrimeve të papaguara nga subjektet debitore. Nga 4520 raste në total të subjekteve debitore në vlerën 27,596,148,278 lekë, për 1203 raste, për vlerën **3,299,965,219 lekë**, nuk kanë vijuar procedurat me nxjerrjen e Urdhër Ekzekutimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, si dhe procedurat e tjera në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor, duke bërë të mundur vazhdimin e veprimtarisë doganore në sistem të subjekteve debitore. Situata më e rëndë paraqitet në: DD. Tiranë, ku subjekte debitore të vitit 2014 e ne vazhdim vazhdojnë veprimtarinë doganore të import – eksportit. Më konkretisht gjendja e borxhit sipas degëve doganore dhe në total, pa Urdhër Ekzekutimi por me aktivitet në sistemin Asycuda Ŵorld, paraqitet në paqyrët e mëposhtme.

Gjendja e borxhit doganor më 31.12.2018 pa urdhra ekzekutimi, por me aktivitet në operacionet doganore ***Paqyra nr. 5.***

në lekë

Nr	***Dogana***	***Raste***	***Det. Dog./L***	***Penalitet lekë***	***Kamatv. Lekë***	***Shuma lekë***	***Paguar lekë***	***Per tu pag./L***
1	Tirane	672	*278,923,274*	*518,839,063*	*28,414,607*	*826,176,944*	*119,981,423*	*706,195,521*
2	Rinas	12	*217,001*	*229,342*	-	*446,343*	*41,774*	*404,569*
3	Durres	85	*13,529,033*	*20,251,783*	*1,008,641*	*34,789,457*	*3,079,713*	*31,709,744*
4	Shkoder	16	*3,655,037*	*8,848,410*	*265,004*	*12,768,451*	*5,392,554*	*7,375,897*
5	Q. Thane	12	*518,506*	-	-	*518,506*	-	*518,506*
6	Gjirokaster	29	*7,150,853*	*11,901,365*	*2,054,406*	*21,106,624*	*4,882,705*	*16,223,919*
7	Korçe	2	*532,215*	*6,436,645*	*274,608*	*7,243,468*	*6,053,339*	*1,190,129*
8	Kapshtice	8	*4,702,943*	*13,765,931*	*1,103,112*	*19,571,986*	*8,248,609*	*11,323,377*
9	Vlore	48	*2,706,382*	*1,197,712*	*42,335*	*3,946,429*	*783,389*	*3,163,040*
10	Fier	197	*12,125,132*	*1,809,986,922*	*95,036,740*	*1,917,148,794*	*12,122,921*	*1,905,025,873*
11	Sarande	13	*4,346,302*	*1,881,753*	*977,822*	*7,205,877*	*54,388*	*7,151,489*
12	Elbasan	36	*78,642,567*	*224,277,389*	*49,685,850*	*352,605,806*	*146,514,240*	*206,091,566*
13	Lezhe	8	*20,230,206*	*1,615,593*	*459,141*	*22,304,940*	*1,653,654*	*20,651,286*
14	Berat	31	*52,468,012*	*8,556,844*	*3,568,159*	*64,593,015*	*37,900,755*	*26,692,260*
15	Kukes	28	*5,305,398*	*324,247*	*5,843*	*5,635,488*	*1,350,338*	*4,285,150*
16	Bllate	3	*722,264*	*1,778,085*	*165,404*	*2,665,753*	*1,165,390*	*1,500,363*
17	Tre Urat	3	*406,271*	*815,864*	*15,202*	*1,237,337*	*431,464*	*805,873*
SHUMA		***1203***	***486,181,396***	***2,630,706,948***	***183,076,875***	***3,299,965,219***	***349,656,656***	***2,950,308,563***

(Burimi: DPD Punoi : KLSH)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, materialeve, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, si dhe verifikimi në sistemin Asycuda Ŵorld, u konstatua se nga zyra e borxhit pranë degeve doganore nuk janë ndjekur hap pas hapi masat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin doganor si dhe udhëzimet përkatëse të nxjerra për këtë qëllim për rikuperimin e detyrimeve të papaguara nga agjencitë doganore. Nga 4520 raste në total të subjekteve debitore në vlerën 27,596,148,278 lekë, për 39 raste, për vlerën **2,382,396 lekë**, nuk kanë vijuar procedurat me nxjerrjen e Urdhër Ekzekutimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve të

papaguara, si dhe procedurat e tjera në prekjen e garancisë së këtyre agjencive në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor, duke bërë të mundur vazhdimin e veprimtarisë doganore në deklarimin e mallrave edhe pse këto të fundit liçensohen nga Administrata Doganore. Situata më e rëndë paraqitet në: DD. Tiranë, ku rezultojnë 30 agjenci doganore me detyrime të papaguara. Më konkretisht gjendja e borxhit sipas degëve doganore dhe në total, të agjencive doganore të penalizuara por me aktivitet në sistemin Asycuda World, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.

Gjendja e borxhit doganor më 31.12.2018 pa urdhra ekzekutimi, por me aktivitet nga agjencitë doganore ***Pasqyra nr. 6.***

në lekë

Nr.	*Dogana*	*Nr. Identif.*	*Vend. Nr.*	*Vend. Dt.*	*Shuma pa pag.*	*Të paguar.*	*E mbetur*
1	Tirane		5	26/01/2015	*18,085*		*18,085*
2	Tirane		814	12/06/2015	*210,797*	*80,000*	*130,797*
3	Tirane		1158	09/09/2015	*58,693*		*58,693*
4	Tirane		1383	17/11/2015	*58,190*		*58,190*
5	Tirane		1729	22/12/2015	*149,000*	*80,000*	*69,000*
6	Tirane		1762	29/12/2015	*218,818*	*80,000*	*138,818*
7	Tirane		291	29/04/2016	*56,694*		*56,694*
8	Tirane		392	11/08/2017	*143,015*		*143,015*
9	Tirane		404	11/08/2017	*104,180*	*63,250*	*40,930*
10	Tirane		410	11/08/2017	*53,169*		*53,169*
11	Tirane		412	11/08/2017	*53,169*		*53,169*
12	Tirane		546	31/08/2017	*21,207*		*21,207*
13	Tirane		714	30/11/2017	*20,535*		*20,535*
14	Tirane		801	22/12/2017	*25,669*		*25,669*
15	Tirane		859	30/12/2017	*20,470*		*20,470*
16	Tirane		66	23/02/2018	*51,338*		*51,338*
17	Tirane		173	28/03/2018	*50,505*		*50,505*
18	Tirane		188	28/03/2018	*50,505*		*50,505*
19	Tirane		196	28/03/2018	*50,505*		*50,505*
20	Tirane		197	28/03/2018	*50,505*		*50,505*
21	Tirane		278	18/04/2018	*102,431*		*102,431*
22	Tirane		339	10/05/2018	*133,423*		*133,423*
23	Tirane		344	10/05/2018	*100,000*		*100,000*
24	Tirane		415	17/05/2018	*25,674*		*25,674*
25	Tirane		588	28/06/2018	*30,660*		*30,660*
26	Tirane		589	28/06/2018	*25,550*		*25,550*
27	Tirane		609	29/06/2018	*35,765*		*35,765*
28	Tirane		1546	27/11/2018	*20,054*		*20,054*
29	Tirane		1617	07/12/2018	*63,757*		*63,757*
30	Tirane		1736	26/12/2018	*20,000*		*20,000*
31	Durres		133	19/03/2018	*103,920*	*0*	*103,920*
32	Durres		182	13/04/2018	*103,514*	*0*	*103,514*
33	Durres		237	25/04/2018	*51,477*	*0*	*51,477*
34	Durres		414	19/07/2018	*50,000*	*0*	*50,000*
35	Durres		602	25/09/2018	*20,000*	*0*	*20,000*
36	Shkoder		70	08/01/2018	*101,002*		*101,002*
37	Fier		196	10/09/2018	*20,280*	-	*20,280*
38	Sarande		28	03/01/2017	*159,817*		*159,817*
39	Sarande		29	03/02/2017	*53,272*		*53,272*
SHUMA LEKË					***2,685,646***	***303,250***	***2,382,396***

(Burimi: DPD Punoi : KLSH)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, materialeve, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, si dhe verifikimi në sistemin Asycuda World, u konstatua se nga zyra juridike dhe e borxhit pranë degëve doganore nuk janë evidentuar saktë subjektet debitore me NIPT (NUIS) apo edhe me numrin identifikues në rastin e importit të automjeteve apo personave fizik, kërkesë kjo e përcaktuar në legjislacionin doganor si dhe udhëzimet përkatëse të nxjerra për këtë qëllim. Nga 4520 raste në total të subjekteve debitore në vlerën 27,596,148,278 lekë, për 199 raste, me vlerën **255,147,153 lekë**, rezultojnë pa NIPT të saktë, pa numër identifikimi gjë e

cila e bën të pamundur bllokimin e tyre në sistem apo verifikimin e tyre, duke bërë të mundur vazhdimin e veprimtarisë doganore. Më konkretisht gjendja e borxhit sipas degëve doganore dhe në total për subjektet debitore pa numër të saktë identifikimi, me dhe pa Urdhër Ekzekutimi, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.

Subjektet me detyrime të papaguara pa NIPT apo numër i dentifikimi ***Pasqyra nr. 7.***

në lekë

Nr.	***Dogana***	***Raste***	***Detyrim/L***	***Penalitet/L***	***Kamatvon./L***	***Sh. Tot./L***	***Të pag./L***	***Per tu pag./L***
1	Tirane	112	*14,961,380*	*17,145,250*	*4,599,387*	*36,706,017*	*5,363,994*	*31,342,023*
2	Durres	3	*0*	*105,000*	*0*	*105,000*	*0*	*105,000*
3	Shkoder	5	*306,640*	*882,897*	*52,899*	*1,242,436*	-	*1,242,436*
4	Gjirokaster	31	*1,450,351*	*700,184*	*544,863*	*2,695,398*	*49,523*	*2,645,875*
5	Korçe	2	*631,117*	*595,851*	*374,063*	*1,601,031*	-	*1,601,031*
6	Kapshtice	1	-	*20,000*	-	*20,000*		*20,000*
7	Vlore	2	*2,812*	*489,788*	*120,774*	*613,374*	-	*613,374*
8	Fier	7	*196,915,178*	*233,112*	*1,033,251*	*198,181,541*		*198,181,541*
9	Sarande	6	*156,136*	*253,984*	*76,763*	*486,883*	-	*486,883*
10	Elbasan	6	*83,917*	*184,900*	*63,510*	*332,327*	-	*332,327*
11	Lezhe	8	*3,633,636*	*7,204,090*	*1,295,514*	*12,133,240*	-	*12,133,240*
12	Berat	1	*21,553*	-	*6,923*	*28,476*		*28,476*
13	Kukes	13	*49,110*	*844,697*	-	*893,807*	-	*893,807*
14	Bllate	1	*28,316*		*1,388*	*29,704*		*29,704*
15	Tre Urat	1	*58,216*	-	*19,703*	*77,919*	-	*77,919*
SHUMA		***199***	***218,298,362***	***28,659,753***	***8,189,038***	***255,147,153***	***5,413,517***	***249,733,636***

(Burimi: DPD Punoi : KLSH)

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga ana e nëpunësve: zj. A..... Sh....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Shkodër; zj. J..... M..... (periudha 01.01.2018 – 06.03.2018), z. Sh..... T..... (për periudhën 06.03.2018 – 24.09.2018), zj. A..... U..... (për periudhën 24.09.2018 – 31.12.2018), me detyrë dhe në cilësinë e specialist borxhi në DD. Tiranë; z. F..... N....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Morinë; z. E..... D....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Lezhë; z. B..... K....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Bllatë; z. K..... E..... (për periudhën 01.01.2018 – 19.11.2018), z. A..... S..... (për periudhën 19.11.2018 – 31.12.2018), me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Rinas; zj. N..... G....., zj. A..... R....., me detyrë dhe në cilësinë e specialist borxhi në DD. Durrës; zj. B..... K....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Qafë Thanë; zj. A..... I....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Korçë; zj. A..... G....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Fier; z. E..... M....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Vlorë; z. S..... R....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Berat; z. H..... M....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Sarandë; si dhe zj. A..... T....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Kakavie & DD. Tre Urat, është vepruar jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 14, pika 5 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, në kryerjen e detyrave funksionale për zbatimin e kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me procedurat e ndjekura për rikuperimin e borxhit doganor.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, neni 245, pika 3;

Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",* neni 106;

Ligjin nr. 61/2012, datë 24.05.2012 *"Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, neni 103, pika 3 dhe pika 4.

Udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016, të DPD, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*: pika 2.2.1, germa "a", pjesa IX; pika 4, germa "c", pjesa IV.

Udhëzimin nr. 15, datë 03.12.2018, të DPD *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*: pika 2.6, pjesa VII; pika 7.1, germa "ç"

Për 4520 raste, vlera prej 27,596,148,278 lekë *(nga të cilat 8,011,488,659 lekë detyrim doganor, 15,755,533,409 lekë penalitet dhe 3,829,126,210 lekë kamatëvonesa),* ***do të konsiderohen të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit.***

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Zj. A..... Sh....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Shkodër;
2. Zj. J..... M..... (periudha 01.01.2018 – 06.03.2018), Z. Sh..... T..... (për periudhën 06.03.2018 – 24.09.2018), Zj. A..... U..... (për periudhën 24.09.2018 – 31.12.2018), me detyrë dhe në cilësinë e specialist borxhi në DD. Tiranë;
3. Z. F..... N....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Morinë;
4. Z. E..... D....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Lezhë;
5. Z. B..... K....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Bllatë;
6. Z. K..... E..... (për periudhën 01.01.2018 – 19.11.2018), z. Arben Sula (për periudhën 19.11.2018 – 31.12.2018), me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Rinas;
7. Zj. N.....Gj....., Zj. A..... R....., me detyrë dhe në cilësinë e specialist borxhi në DD. Durrës;
8. Zj. B..... K....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Qafë Thanë;
9. Zj. A..... I....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Korçë;
10. Zj. A..... G....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Fier;
11. Z. E..... M....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Vlorë;
12. Z. S..... R....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Berat;
13. Z. H..... M....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Sarandë;
14. Zj. A..... T....., me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi në DD. Kakavie & DD. Tre Urat.

Nisur nga shqyrtimi i fakteve dhe dokumentacionit shtesë të observacioneve të vëna në dispozicion pas auditimit në terren, rezulton se nga ana e Sektorit të Monitorimit të Borxhit janë hartuar raportet mujore të ecurisë së tij drejtuar z. A.... S....., ish-Zv. Drejtor i Përgjithshëm për të cilat nuk rezulton të jenë analizuar dhe të jenë dhënë masa përkatëse personave përgjegjës pranë Degëve Doganore. Për të njëjtën problematikë ngarkohet me përgjegjësi edhe zj. B..... I..... me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm i Doganave.

3.2. *Auditimi i dokumentacionit lidhur me transferimin e akcizës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*

Nga shqyrtimi i dokumentacioni të vënë në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit rezultoi se, në mbështetje të pikës 1 dhe 3 të nenit 8, të VKM nr. 655, datë 31.10.2018 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 612, datë 05.09.2012 të Këshillit të Ministrave, 'Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar'",* si dhe Udhëzimit nr. 9, datë 11.03.2019, *"Mbi modalitetet e transferimit pranë Administratës Doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara",* Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 9206 prot., datë 07.05.2019, (nr. 11366 prot., datë 07.05.2019 të DPD), *"Transferimi i të dhënave për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara",* ka nisur pranë DPD të dhënat dhe dosjet e administruara për gjithsej **48 subjekte me detyrime të papaguara në vlerën 13,274,569.6 mijë lekë.**

Ky borxh, është një borxh i krijuar nga subjekte me detyrime akcize të papaguara, i mbartur nga Administrata Tatimore dhe i pa mbledhur në vite. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012, *"Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë",* si dhe VKM nr. 612, dt 05.09.2012 *"Për Dispozitat Zbatuese të ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat", i ndryshuar"*, administrimi i akcizës kalon pranë Administratës Doganore. Në nenin 157, pika 9, të VKM së sipërcituar, përcaktohet qartë se *"Për borxhin ekzistues për detyrimet e akcizës, të kontabilizuara në administratën tatimore para datës 1 tetor 2012, si dhe për borxhet që mund të lindin pas datës 1 tetor 2012, për detyrimet e akcizës, të rezultuara deri më 1 tetor 2012, administrata tatimore do të vijojë procedurën e mbledhjes së borxhit edhe pas datës 1 tetor 2012, sipas ligjit të procedurave tatimore."*

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 33/2017, datë 30.03.2017, *"Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore",* Ministri i Finanancave dhe Ekomnomisë në Udhëzimin nr.14, dt 03.05.2017 nxjerrë për këtë qëllimnë (në zbatim të këtij Ligji), udhëzonte: *"Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të dërgojë zyrtarisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave detyrimet e tatim paguesve për akcizë/gjobë/kamatëvonesa e dënim administrativ për periudhën tatimore Janar 2011 deri dhjetor 2014 sipas periudhave që i përkasin. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për këtë tatim do të zbatojë procedurën e fshirjes/shuarjes pjesore të detyrimeve të akcizës, në zbatim të dispozitave të nenit 6 të ligjit".* Në këtë moment nga ana e Adminstratës Tatimore u dërgua zyrtarish lista e debitorve me detyrime të papaguara të akcizës. Pretendimi kryesor për transferimin e këtyre detyrimeve ka qenë se sistemi i ri informatik i tatimeve e kishte të pamundur të gjeneronte urdhër pagesa për detyrime të akcizës. Nisur nga fakti që për Administratën Tatimore ky borxh ishte jashtë sistemit, lind e drejta të konkludojmë se edhe për Administratën Doganore ky borxh do të jetë jashtë sistemit informatik, përderisa nuk ka një dokumet të gjeneruar nga sistemi për të materializuar detyrimin e lindur para hyrjes në fuqi të ligjit të alcizave. Pra, të dy institucionet janë në pozita të barabarta në gjetjen e një zgjidhje teknike për realizimin e procesit të arkëtimit të pagesave në rastet e shlyerjes së detyrimeve të papaguara. Transferimi i këtij borxhi nga DPT në DPD është kundërshtuar nga Administrata Doganore, por argumentet e dhëna nuk janë marrë në konsideratë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Referuar nenit 8, pika 1 dhe 3 të VKM nr. 655, datë 31.10.2018 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 612, datë 05.09.2012 të Këshillit të Ministrave, 'Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar'"*, Administrata Doganore, ngarkohet për të marrë nën administrim nëpërmjet transferimit nga administrata tatimore të të gjitha detyrimeve të papaguara të akcizës, të periudhës pas vitit 2010, që janë kontabilizuar në administratën tatimore para datës 01.10.2012, si dhe pas kësaj date, për detyrimet e akcizës që i përkasin periudhës para datës 01.10.2012.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Udhëzimin nr. 9, dt 11.03.2019 " Mbi modalitetet e transferimit pranë administratës doganore të të dhënave për subjektet e akcizës, të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara", ka përcaktuara detyrimet e sejcilit prej institucioneve në këtë proces.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 9206 prot., datë 07.05.2019, protokolluar në DPD me nr. 11366 prot., datë 07.05.2019, në zbatim të VKM Nr. 655, ka dërguar dokumentacionin për **48** subjekte debitore me shumë totale **13,274,569,647 lekë**.

*Pasqyra e subjekteve me detyrime të papaguara paraqitet si më poshtë.....**Pasqyra nr.8***

në lekë

Nr	*NIPT*	*Subjektit*	*DRT*	*Detyrim të Papaguar*			
				Det. Akcizë	*Penalitet*	*K. Vonesë*	*Shuma Totale*
1			Berat	192,162,000	389,324,000	125,905,350	***707,391,350***

2			Berat	8,662	338	5,442	***14,442***
3			Berat	84,550	67,275	38,253	***190,078***
			Berat	**192,255,212**	**389,391,613**	**125,949,045**	***707,595,870***
4			Durrës	207,889	467,751	127,485	***803,125***
5			Durrës		500,000		***500,000***
6			Durrës		1,000,000		***1,000,000***
7			Durrës		500,000		***500,000***
8			Durrës		500,000		***500,000***
9			Durrës		500,000		***500,000***
10			Durrës		500,000		***500,000***
11			Durrës	571,120	142,780	348,669	***1,062,569***
12			Durrës	10,000	2,500	6,105	***18,605***
13			Durrës	5,120			***5,120***
14			Durrës	17,312			***17,312***
15			Durrës	3,800			***3,800***
16			Durrës	3,250			***3,250***
			Durrës	**818,491**	**613,031**	**482,259**	***1,913,781***
17			Elbasan	13,270,283	29,433,371	7,905,083	***50,608,737***
18			Elbasan	382,960	142,060	224,165	***749,185***
19			Elbasan	365,000	821,250	242,978	***1,429,228***
			Elbasan	**14,018,243**	**30,396,681**	**8,372,226**	***52,787,149***
20			Fier	33,620	8,405	9,342	***51,367***
21			Fier		5,299,109		***5,299,109***
22			Fier	176,250	44,063	273,590	***493,903***
23			Fier	109,850	27,463	39,947	***177,260***
			Fier	**319,720**	**5,379,040**	**322,879**	***6,021,639***
24			Korçë	3,236,000	7,209,000	1,853,341	***12,298,341***
25			Korçë	515,000	148,750	289,337	***953,087***
			Korçë	**3,751,000**	**7,357,750**	**2,142,678**	***13,251,428***
26			Shkodër		500,000		***500,000***
27			Shkodër		500,000		***500,000***
28			Shkodër		500,000		***500,000***
29			Shkodër		500,000		***500,000***
30			Shkodër		100		***100***
			Shkodër		**2,000,100**		***2,000,100***
31			Tiranë	82,418,150	200,573,622	43,693,918	***326,685,690***
32			Tiranë	397,200	2,393,700	191,293	***2,982,193***
33			Tiranë	3,587,656,087	6,591,775,004	1,830,280,165	***12,009,711,256***
39			Tiranë	32,003,668	72,309,085	15,844,115	***120,156,868***
			Tiranë	**3,702,475,105**	**6,867,051,411**	**1,890,009,491**	***12,459,536,007***
34			DTM		92,941		***92,941***
35			DTM				
36			DTM	283,430		166,073	***449,503***
37			DTM	97,286	24,322	48,830	***170,438***
38			DTM		38,384		***38,384***
			DTM	**380,716**	**155,647**	**214,903**	***751,266***
40			Vlorë		1,000,000		***1,000,000***
41			Vlorë		1,000,000		***1,000,000***
42			Vlorë		1,000,000		***1,000,000***
43			Vlorë		180,000		***180,000***
44			Vlorë		100,000		***100,000***
45			Vlorë		180,000		***180,000***
46			Vlorë		100,000		***100,000***
47			Vlorë		100,000		***100,000***
48			Vlorë	15,631,139	1,170,000	6,751,268	***23,552,407***
	Totali VL	**9**	**Vlorë**	**15,631,139**	**4,830,000**	**6,751,268**	***27,212,407***
48	***GJITHSEJ***	***48***		***3,929,649,626***	***7,310,675,273***	***2,034,244,749***	***13,274,569,647***

(Burimi: DPD Punoi : KLSH)

Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD ka shqyrtuar dhe verifikuar dokumentacionin sipas dosjeve të dërguara të subjekteve me detyrime akcize të papaguara lidhur me përputhshmërinë sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 9, datë 11.03.2019, *"Mbi modalitetet e transferimit pranë Administratës Doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara",* dhe në përfundim ka kostatuar se:

1. Dosjet për secilin subjekt nuk janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe kërkesat e arshivës, (pika 5 e udhëzimit);
2. Informacioni për detyrimet e tatimpaguesve është hartuar në një përmbledhëse për të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore, si dhe për të gjithë subjektet debitorë, por jo e specifikuar për secilin sipas rasteve konkrete;
3. Nga verifikimi i të dhënave sipas njoftim vlerësimeve, akt kontabilizimeve me të dhënat sipas tabelës përmbledhëse, rezulton se për disa subjekte ka mospërputhje në shumat sipas zërave (detyrime akcize dhe penalitete), për rrjedhojë nuk ka nje shpjegim të qartë për të konkluduar në vlerën totale të detyrimeve të papaguara të shumës **13,274,569,647 lekë**;
4. Nuk ka njoftim vlerësime për të gjitha subjektet debitore, që do të thotë që subjektet nuk janë njoftuar për detyrimet e papaguara ndaj administratës tatimore;
5. Nuk ka të dhëna të plota për proceset gjyqësore të zhvilluara dhe statusin e tyre;
6. Një pjesë e subjekteve janë me statusin *"Pasiv "* apo *"Të ç'regjistruar"*, për të cilat vështirësohet mbledhja e detyrimeve të papaguara.

Mangësitë e konstatuara në dosjet e subjekteve debitorë të akcizës..... ***Pasqyra nr.9***

Nr	*NIPT*	*Subjekti*	*Vendimi*		*Njoftim Vlerësimi*		*Dt. e kontabilizimit*	*Statusi i subjektit*
				Dt.	*Nr.*	*Dt.*		
1			691	07.04.11	1182	14.04.11	25.04.11	*Pasiv*
2			932	19.05.11	1653	03.06.11	07.07.11	*Aktiv*
3			1733	07.08.11	2932	20.08.12	30.01.13	*Aktiv*
					12429/2	08.06.11	15.05.11	*Aktiv*
					19452/5	20.01.11	27.07.12	*Aktiv*
					11123/2	05.05.12	25.06.12	*Aktiv*
4					11123/2	05.05.12	25.06.12	*Aktiv*
5							29.10.12	*Aktiv*
6					26532	25.10.11	01.11.11	*Aktiv*
7					23503	27.09.11	28.09.11	*Passiv*
8					21249	06.09.11	07.09.11	*Passiv*
9					18238	29.07.11	29.07.11	*Passiv*
10					7532	29.03.11	31.03.11	*Cregjistruar*
11							22.12.11	*Aktiv*
12							22.12.11	*Passiv*
13							23.02.17	*Aktiv*
14							23.02.17	*Aktiv*
15							23.02.17	*Aktiv*
16							23.02.17	*Aktiv*
				27.10.11	8322	07.11.11	07.11.11	*Pasiv*
				11.01.12	2146	12.03.12	12.03.12	*Pasiv*
				20.04.12	3363	20.04.12	20.04.12	*Pasiv*
					10183	30.12.11	22.12.11	
17				20.04.12	3363	20.04.12	20.04.12	*Pasiv*
				15.11.11	7896	24.10.11	24.10.11	*Pasiv*
				15.11.11	9245	13.12.11	13.12.11	*Pasiv*
18								
19				07.06.11	2626	10.05.11	10.05.11	*Pasiv*
							03.07.12	*Kerk. per cregj.*
							10.02.12	
							26.09.11	
20								
21					32855/24	28.04.2011	28.04.11	*Pasiv*
							10.02.12	*Aktiv*

							26.09.11	
22								
23							26.09.11	*Pasiv*
				15.11.11	19869	08.11.11	15.11.11	*Pasive*
24								
				25.01.12			25.01.11	*Aktiv*
				29.05.12			2012	*Aktiv*
				21.06.12			2012	*Aktiv*
				09.08.12			2012	*Aktiv*
				12.10.12			2012	*Aktiv*
				16.11.12			2012	*Aktiv*
25								
26					11579/9	22/12/11	22/12/11	*Cregjistruar*
27				40848	330/1	14.01.11	17/01/11	*Cregjistruar*
28				18/11/10	10913/3	29/12/10	13/01/11	*Kerk. per cregj.*
29				24.10.10	9100/10	24.10.11	25.10.11	*Pasiv*
30								
				41370	1647/7	29.09.11	31.12.14	*AKTIV*
								AKTIV
								AKTIV
31								*AKTIV*
32				02.06.14	4417/3	02.06.14	2010-2011	*AKTIV*
			24.03.11		KA	KA	KA	*Pasiv*
			13.10.11		KA	KA	KA	*Pasiv*
			26.09.11		KA	KA	KA	*Pasiv*
			28.06.11		KA	KA	KA	*Pasiv*
			14.04.11		KA	KA	KA	*Pasiv*
			16.12.11		KA	KA	KA	*Pasiv*
			09.08.12		KA	KA	KA	*Pasiv*
			07.09.12		KA	KA	KA	*Pasiv*
			21.05.12		SKA	SKA	SKA	*Pasiv*
			02.11.12					*Pasiv*
			19.01.12					*Pasiv*
			25.01.12					*Pasiv*
			28.03.13					*Pasiv*
			05.03.13					*Pasiv*
			06.06.13					*Pasiv*
			09.12.13					*Pasiv*
			11.09.13					*Pasiv*
			31.12.14					*Pasiv*
			03.02.14					*Pasiv*
			24.11.14					*Pasiv*
			14.05.14					*Pasiv*
			30.12.14					*Pasiv*
			12.12.14					*Pasiv*
			12.04.15					*Pasiv*
33								*Pasiv*
34					13797/1	25.07.12	25.07.12	*AKTIV*
35				15.04.19				
					20866/19	15.02.13		
36					vetdeklarim	2011	KA	*AKTIV*
					20869/1	31.12.14		
37				KA	KA	12.04.19	KA	*AKTIV*
38					15965	06.08.12	06.08.12	*AKTIV*
39					64750/6	22.11.12	31.12.14	*AKTIV*
40					3523	02.04.12	03.12.15	*Pasiv*
41					11490	19.09.12	24.05.16	*Pasiv*
42					17220	15.12.16	24.05.16	*Pasiv*
43					17220	15.12.11	25.09.17	*Aktiv*
44					17220	15.12.11	24.05.16	*Pasiv*
45					17220	15.12.11	24.05.16	*Pasiv*
					17220			
46					9856	11.08.16	24.05.16	*Aktiv*

47					17220	14.12.11	24.05.16	*Pasiv*
					31894	28.11.10	28.11.10	*Aktiv*
					20984/1	31.12.14	31.12.14	*Aktiv*
48								

(Burimi: DPD Punoi : KLSH)

Të gjitha këto mangësi të dokumentacionit në dosjet e subjekteve debitorë të konstatuara nga Sektori i Monitorimit të Borxhit përbëjnë shmangie nga kërkesat dhe kriteret e percaktuara në Udhëzimin e sipërcituar, mangësi të cilat e vënë në vështirësi operimin nga administrate doganore për të marrë në evidencë këtë borxh dhe për të vijuar procedurat për rikuperimin e tij. Është kusht i domosdoshëm plotësimi i dosjeve për çdo subjekt me dokumentacionin përkatës të kërkuar për të krijuar një profil për secilin debitor, profil i cili është i domosdoshem në momentin e ballafaqimit dhe vënien në dijeni për detyrimin, tashmë ndaj Administrates Doganore .

Ndodhur në këto kushte, DPD, me shkresën nr. 14440/1 prot., datë 20.06.2019, *"Kthim dokumentacioni për plotësim sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrit Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 11.03.2019",* drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kthyer gjithë dokumentacionin e ardhur nga DPT lidhur me subjektet me detyrime akcize të papaguara. Ndodhur në këto kushte të mungesës së dokumentacionit për shqyrtim, nga grupi i auditimit janë pasqyruar në material problematikat e konstatuara nga Sektori i Monitorimit të Borxhit pranë DPD të cituara në shkresën e sipërcituar.

Borxhi i akcizës i lindur pranë administratës tatimore është një borxh tatimor, i kontabilizuar pranë Administratës Tatimore, për mbledhjen e të cilit të gjitha procedurat janë mbeshtetur konform ligjeve në fuqi për procedurat tatimore. Pas rreth 7 (shtatë) vitesh (nga kalimi i akcizës pranë administratës doganore), ky borxh tatimor do të trajtohet si borxh doganor i akcizës. Administrata doganore zhvillon aktivitetin e saj në bazë të Kodit Doganor dhe Ligjit për Akciza, sipas të cilëve është e përcatuar me detaje procedura që nga lindja e borxhit deri në shuarjen e tij.

Disa nga shqetësimet dhe problematikat që gjykohen për tu pasqyruar nga audituesi referuar legjislacionit si dhe fakteve të cilat burojnë nga transferimi i këtij borxhi edhe n.q.s kompletohen dosjet e këtyre subjekteve me dokumentacionin janë:

1. Në legjislacionin doganor apo atë të akcizës përcaktohet qartë se lindja e një borxhi doganor apo të akcizës lind vetëm nëpërmjet një vendimi administrativ të nxjerrë nga autoriteti doganor kompetent. Në këto kushte lindin pyetjet:

1.1. *"Mbi çfarë baze ligjore do të merret vendimi administrativ për të shpallur debitorë, subjektet e dërguar nga administrata tatimore"*?;

1.2. *"Nëse do të marrim të mirëqenë nxjerrjen e një vendimi administrativ nga autoriteti doganor, në vendimin administrativ do të përdoret si referencë ligjore VKM nr. 655, datë 31.10.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 612, datë 05.09.2012 të Këshillit të Ministrave, 'Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar'", a mundet që kjo VKM të prevalojë mbi ligjin"* ?

Pwr sa mw sipwr, mendoj se DPD wshtw e humbur dhe borxhi do të shuhet me vendim gjyqësor të formës së prerw, nwse nuk tregohet kujdesi i domosdoshwm nw zbatimin e ligjit nw mbrojtje tw interesave tw ligjshme tw shtetit.

2. Vendimi administrativ do të ketë, numër dhe datë, pra do të trajtohet si borxh i vitit 2019, por DPD nuk mund ta mbledhë këtë borxh bazuar në procedurat e DPT mbi bazën e të cilave ai borxh ka lindur në zbatim të ligjit organik të tatimeve, por duhet të fillojnë nga e para procedurat në zbatim të Kodit Doganor dhe Ligjit 61/2012 për akcizat. Në këto kushte lind pyetja *"Pas kaq shumë vitesh a mundet që një borxh tatimor të trajtohet si borxh doganor"*?.

3. Për borxhin e transferuar nga DPT i cili ka lindur si rezultat i shkeljes nga subjektet të ligjit për procedurat tatimore, ku kanë qenë përcaktuar të gjitha procedurat ligjore për rikuperim me forcë nga DPT. Në këto kushte lindin pyetjet:
3.1. *"Çfare procedurash do te ndiqen që nga njoftimi deri në mbledhjen e tij"*?;
3.2. *"Si mundet që një borxh tatimor të ndryshojë emërtimin në vitin 2019, duke u kthyer në një borxh doganor/akcize duke patur parasysh Kodin Doganor dhe Ligjin 61/2012 'Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë"* ?;
3.3. *"A ka rrezik që duke e kontabilizuar dhe njoftuar këtë borxh në vitin 2019, ti krijohet mundësia subjekteve për ta rivendosur në afat dhe ta ankimojnë dhe nxjerrin nul në gjykatë sepse do të jenë brenda afatit"*?;
3.4. *"A ka mundësi që ky borxh të rivendoset në afat dhe të vijojë rikuperimi i tij kur kontabilizimi dhe mbledhja e tij janë jashtë sistemit Asycuda Ŵorld"* ?;
4. Nga eksperienca, sa herë kanë dalë ligje për falje, i janë referuar gjithmonë periudhave që janë pothuaj 3 vjet më parë, do me thënë nëse ligji del në vitin 2019, periudha që i referohet do të jetë para vitit 2016. Në rastet e daljes se ligjit për falje, mendoj se ky borxh do ti plotesonte kushtet nese do të qëndronte ne DPT. Në këto kushte lind pyetja *"Nëse do të miratohet një ligj për faljen e detyrimeve të papaguara, a do të mund të falet ky borxh"*?;
5. Nga shqyrtimi i statusit të subjekteve me detyrime të papaguara të akcizës rezultojnë shumë subjekte pasiv, të ç'regjistruar ose pa adresë *(nuk janë gjetur në adresën e deklaruar)*. Në këto kushte lind pyetja *"Çfarë qëndrimi do të mbahet ndaj subjekteve debitorë me statusin "Pasiv"/"Të çregjistruar"/"Pa adresë""*?.

2. Auditimi i Buxhetit dhe pasqyrave financiare të institucionit për vitin 2018.

- Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.
- Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse. Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare

Në zbatim të pikës 2, të programit të auditimit "242/1 Prot., datë 06.06.2019, për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Programi buxhetor afatmesëm *(këtu e në vazhdim PBA)*, faza e parë.
- Programi buxhetor afatmesëm faza e dytë.
- Programi buxhetor i miratuar nga MIE me shtesat plus pakësimet për vitin 2018.
- Pasqyrat financiare (bilanci) dhe formatet e pasqyrave financiare të vitit për periudhën objekt auditimi

Nga auditimi, lidhur PBA, gjatë periudhës së auditimit konstatohet që projekt buxheti për vitin 2018 është hartuar konform legjislacionit të mësipërm. Në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dorëzuar në MFE me relacionin shpjegues, dërguar brenda afatit si për fazën e parë dhe për fazën e dytë të PBA 2018-2020. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2018-2020, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas

programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Rishpërndarja e fondeve është bërë konform nenit 81 të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 *"Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, i ndryshuar, ku citohet: *"E drejta e njësisë së qeverisjes së përgjithëshme për rishpërndarjen e fondeve të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri me datë 15 nëntor të çdo viti, e cila konsiderohet data e fundit e paraqitjes së kërkesave tek Nëpunësi i Parë Autorizues"*

Planifikimi i PBA e strategjik

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi rregullshmërinë financiare në DPD, në lidhje me *"Auditimi i buxhetit dhe pasqyrave financiare të institucionit për vitin 2018"* rezultoi se:

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal *(këtu e në vazhdim KMF),* për periudhën 2018-2020, ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të Qeverisë. KMF përcaktohen pritshmëritë makroekonomike për një periudhë kohore afatmesme, si dhe parashikon nivelin e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesore të politikës fiskale si balancën e përgjithsëshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korerrente. KMF dhe KMF i rishikuar shërbejnë si pikënisje për përcaktimin e tavaneve për të filluar procesin e përgatitjes së PBA dhe si bazë për përcaktimin e tavaneve përfundimtare në fazën e dytë të procesit të përgatitjes së PBA-së në nivel ministrie.

Programimi i PBA 2018-2020 dhe programimi i buxhetit të vitit 2018.

PBA është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjërë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton konteksin afatmesëm të Buxhetit Vjetor. Dokumenti i PBA-së, pasqyron kërkesat buxhetore të ministrive të linjës duke paraqitur me detaje qëllimet, objektivat, dhe produktet e programeve prej sejcilës prej Ministrive të linjës për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Programimi në fazën e I-rë të PBA 2018-2020

Struktura e Programit nr.5, të Shpenzimeve Buxhetore *"Menaxhimi i të Ardhurave Doganore"* si dhe Ekipi i Menaxhimit të këtij Programi, është miratuar me urdhrin nr. 35, datë 18.04.2017, i MFE *"Për përcaktimin e strukturës së programeve të shpenzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekipeve të Menaxhimit të Tyre"*. Programimi në këtë fazë është bërë duke mbajtur parasysh limitin e përcaktuar nga MFE me shkresën datë 2739/10 datë 13.04.2017, *"Dërgim i tavaneve të PBA 2018-2020"* si dhe udhëzimin e MFE nr. 10, datë 28.02.2017 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020"*. Kërkesat buxhetore, përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2018-2020, si deklaratën e politikës së programit, shpenzimet e programit sipas produkteve, projektet me financim të brendshëm dhe të huaj, kërkesat shtesë sipas artikujve dhe produkteve si dhe argumentimin e kërkesave shtesë. Planifikimi në këtë fazë është bërë brenda limitit të përcaktuara nga MFE, në vlerë 3,430,000 mijë lekë, ndërsa kërkesat shtesë të institucionit janë 695,728 mijë lekë.

në mijë lekë

Llogaria	*Përshkrimi*	*Tavani Aktual*	*Kërkesa Shtesë*	*Tavani Rishikuar*
600-601	Paga Sigurime Shoqërore	1,080,000	128,400	1,208,400
602-606	Korente të Tjera	1,990,000	452,067	2,442,067
230-232	Kapitale të Brendshme	160,000	38,125	198,125
230-232	Kapitale të Huaja	200,000	77,136	277,136
	Totali	3,430,000	695,728	4,125,728

Kërkesat shtesë për këtë program janë:

-Llogaria 600-601, *"Paga, Sigurime Shoqërore"* për shumën 128,400 mijë lekë. Kjo shtesë kërkohet pasi në zbatim të VKM nr.9, datë 11.01.2017 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave , "Për personelin e administratës doganore"*, struktura organike e institucionit është shtuar me 52 punonjës: nga 1002 punonjës është bërë 1052 punonjës;
-Llogaria 602-606 , *"Korrente të tjera"* për 452.067 mijë lekë. Kjo kërkesë është prioritare me arsyetimin pasi vazhdimisht DPD, është ndodhur përpara faktit të vendosjes së sekuestros konservative të llogarisë pranë Degës së Thesarit Tiranë për mosekzekutimin e vendimeve për shkak të mungesës së fondeve në këtë llogari;
-Llogaria 230- 231, *"Kapitale të Trupëzuara të Brendshme"* në vlerën gjithsej 38,125 mijë (ku 8,985 mijë lekë për Rritja e sigurisë së aksesimit në sistemin Asycuda Ŵorld, ruajtja e të dhënave, pasi do të ndikojë në mirëfunksionimin e sistemit të proçesimit të të dhënave doganore, ruajtjen e tyre si dhe krijimin e lehtësirave ndaj biznesit; 24,000 mijë lekë për ndërtimin e një arkive qendrore dhe 5,140 mijë lekë për blerje pajisje zyre për degët doganore);
-Llogaria 230, *"Kapitale të patrupëzuara të Huaja"* në vlerën 77,136 mijë lekë. Në kuadër të Programit IPA 2013, DPD është përfituese në projektin;
Kontratë shërbimi për Zhvillimin e Moduleve të ITMS (Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Tarifës) totalisht të përputhshëm me ITMS e BE-së. Parashikohet të disbursohet për këtë projekt në vitin 2018 shuma prej 1 milion euro dhe tavani i vendosur nuk është i mjaftueshem.
Kërkesat buxhetore 2018-2020 (faza e parë) të DPD janë dërguar pranë MFE me shkresën nr. 10503, datë 28.04.2017, pra brenda afateve ligjore.

Programimi në fazën e II-të PBA 2018-2020 dhe projekt buxheti i vitit 2018.

Programimi i kërkesave buxhetore për këtë fazë është kryer në zbatim të Udhëzimit plotësues të MFE nr.10/3 datë 13.07.2017 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020"* si dhe në mbështetje të VKM 197, datë 15.03.2017 *"Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2018-2020"*, tavanet e shpenzimeve buxhetore të vendosura nga MFE për këtë fazë janë të njëjta me ato të fazës së parë.
Programimi në këtë fazë është dërguar në MFE me shkresën nr. 19731 datë 30.08.2017, *"Dërgohen kërkesat buxhetore për PBA 2018-2020"* (faza e dytë), si misionin deklaratat, shpenzimet sipas projekteve dhe produkteve me artikuj buxhetorë. Programimi në këtë fazë është bërë brenda limitit të përcaktuara nga MFE, në vlerë 3,400,000 mijë lekë, ndërsa kërkesat shtesë të DPD në këtë fazë të programimit janë në vlerë 1,118,482 mijë lekë, më shumë se tavani i planifikuar.

në mijë lekë

Llogaria	*Përshkrimi*	*Tavani Aktual*	*Kerkesa Shtesë*	*Tavani Rishikuar*
600-601	Paga Sigurime Shoqërore	1,080,000	234,292	1,314,292
602-606	Korente të Tjera	1,990,000	382,508	2,372,508
230-232	Kapitale të Brendshme	160,000	441,575	601,575
230-232	Kapitale të Huaja	200,000	60,107	260,107
	Totali	3,430,000	1,118,482	4,548,482

Kërkesat shtesë për këtë program janë:
-Llogaria 600-601, *"Paga, Sigurime Shoqërore" për shumën 234,292 mijë lekë. Kjo shtesë kërkohet pasi në zbatim të VKM nr.9 datë 11.01.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave , "Për personelin e administratës doganore"*, struktura organike e institucionit nga 1002 punonjës është bërë 1052 punonjës si dhe nga ana e institucionit është kërkuar shtesë në numrin e punonjësve me 81 punonës të dedikuar me kontrollet e mallrave dhe elementëve të sigurisë për efekt të kontrollit të shtuar në luftën kundër kanabisit.
-Llogaria 602, *"Mallra dhe shërbime"* për 382,508 mijë lekë Kjo kërkesë është prioritare me arsyetimin pasi vazhdimisht DPD, është ndodhur përpara faktit të vendosjes së sekuestros konservative

të llogarisë pranë Degës së Thesarit Tiranë për moseksekutimin e vendimeve për shkak të mungesës së fondeve në këtë llogari.

-Llogaria 231, *"Kapitale të Trupëzuara të Brendshme"* në shumën 441,575 mijë lekë nga të cilat për: Rikonstruksione dhe projektime të DD në vlerën 184,975 mijë lekë. Prarashikohet të realizohet hartimi i projektit për rikonstruksionin e DD: Vlorë & Kapshticë si dhe rikonstruksioni i DD: Kapshticë; Qafë Thanë; Kakavijë & blerje pajisje. Për vitin 2018 kërkohet fond shtesë prej 40 miljon lekë për pajisjen në 4 skanër mobil të DD të cilët do të shërbejnë për rritjen e cilësisë së kontrollit nëpër pikat kufitare duke forcuar luftën kundër kontrabandës si dhe trafikut të paligjshëm si dhe me 4 peshore portative në shumën 4.5 miljon lekë që do të përdoren nga grupet e Antikontrabandës, akcizës për kryerjen e peshimit të mjeteve në rrugë për të shmangur evazionin fiskal si dhe për kryerjen e një kontrolli sa më të shpejtë në shërbim të operatorëve ekonomik si dhe 6 miljon lekë për blerjen e stabilizator tensioni. Gjithsej 50.500 mijë lekë. Financim për projektin e NCTS në shumën 206,100 mijë lekë.

Llogaria 230 "Kapitale të patrupëzuara të huaja" në shumën 60,107 mijë lekë

Referuar sa më lart, në mënyrë të përmbledhur, shpenzimet buxhetore të programit *"Menaxhimi i të Ardhurave Doganore"*, janë programuar si më poshtë:

në mijë lekë

Llogaria	***Përshkrimi***	***Tavani***		***Kërkesa Shtesë***		***Diferenca***	
		Faza I	***Faza II***	***Faza I***	***Faza II***	***Tavani***	***Kërkesa shtesë***
		1	***2***	***3***	***4***	***5=2-1***	***6=3-4***
600-601	Paga Sigurime Shoqërore	1,080,000	1,080,000	128,400	234,292	0	105,892
602-606	Korente të Tjera	1,990,000	1,990,000	452,067	382,508	0	69,559
230-232	Kapitale Të Brendshme	160,000	160,000	38,125	441,575	0	403,450
230-232	Kapitale të Huaja	200,000	200,000	77,136	60,107	0	-17,029
	Totali	3,430,000	3,430,000	695,728	1,118,482	0	561,872

Tabela në vijim paraqet planifikimin e produkteve gjatë fazave të PBA-së si dhe shtesat dhe pakësimet e produkteve të ndryshme .

në mijë lekë

Produkti	***Sasia***	***Faza I***		***Faza II***		***Diferenca***	
		Shpenzimi	***Kosto/njesi***	***Shpenzimi***	***Kosto/njesi***	***Shpenzimi***	***Kosto/njësi***
		1	***2***	***3***	***4***	***5=1-3***	***6=2-4***
Pagesa për punën e kryer si dhe sigurimi i kushteve për ushtrimin e funksioneve të punonjësve të shërbimit doganor shqiptar	1,052	1,366,695	1,299	1,346,423	1,280	-20,272	-19
Marrëdhëniet Ndërkombëtare	2	13,156	6,578	12,149	6,075	-1,007	-504
Monitorimi i ndryshimeve dhe përditësimi i Ligjit "Kodi Doganor", VKM "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", i dhe Udhëzimeve përkatëse, në përputhje me Rregulloret dhe Direktivat e BE-së	3	700	233	700	233	0	0
Sistem informatik i mirëmbajtur dhe i modernizuar	1	119,515	119,515	68,500	68,500	-51,015	-51,015
Makina të shërbimit doganor funksionale	78	64,600	828	60,860	780	-3,740	-48
Vendime Gjyqësore të ekzekutuara	15		0	30,000	2,000	30,000	2,000
Shërbimi i skanimit të kontenierеve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë	5	1,615,918	323,184	1,615,918	323,184	0	0
Blerje pajisje për Laboratorin Kimik doganor	4	15,066	3,767	15,100	3,775	34	9
Godina të rikonstuara dhe projektuara	1		0	10,000	10,000	10,000	10,000
Blerje 2 minibuzë për transport	2		0	4,000	2,000	4,000	2,000

personeli							
Blerje dhe montim gjeneratore, stabilizator tensioni, skaner mobil, peshore portative	4		0	16,000	4,000	16,000	4,000
Blerje platforme metalike për Doganën Durrës, kabina zyre dhe pajisje sinjalistike për doganat	8		0	16,000	2,000	16,000	2,000
Pjesmarrje në programin "Doganat 2020"	1	25,007	25,007	17,862	17,862	-7,145	-7,145
Kontratë binjakëzimi për përafrimin e procedurave doganore dhe legjislacionit në fusheën e tarifës	1	129,843	129,843	129,843	129,843	0	0
Kontratë shërbimi për Zhvillimin e Moduleve të ITMS (Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Tarifës) totalisht të përputhshëm me ITMS e BE-së.	1	79,500	79,500	86,645	86,645	7,145	7,145
shuma e buxhetit të miratuar		3,430,000		3,430,000			

Nga auditimi i të dhënave konstatohet se tavani i buxhetit të miratuar në të dyja fazat e PBA 2018-2020 për programin 01150 "Menaxhimi i të ardhurave doganorë" është i njëjtë.
Nga ana e Institucionit me anë të shkresës nr.23631 prot, datë 17.10.2017 "Kërkesë për shtesë tavani për vitin 2018" nga ana e Institucionit është kërkuar shtësa sipas tabelës së mëposhtëme:

Llogaria	*Përshkrimi*	*Tavani Aktual*	*Tavani kërkuar*	*Shtesa e Kërkuar*	*Shtesa e kërkuar me prioritet*
600-601	Paga Sigurime Shoqërore	1,080,000	1,342,864	262,864	262,864
602-606	Korente të Tjera	1,990,000	2,449,532	459,532	459,532
230-232	Kapitale të Brendshme	160,000	951,427	791,427	476,367
230-232	Kapitale të Huaja	200,000	260,107	60,107	60,107
	Totali	3,430,000	5,003,930	1,573,930	1,258,870

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2018.
Çelja e buxhetit të DPD është përcjellë nga ana e MFE me shkresat; nr. 19650/3, datë 30.01.2018 me subjekt *"Dërgohet detajimi i fondeve të buxhetit të shpenzimeve korrente për vitin 2018"*, si dhe 19650/1 datë 20.0 02.2018 *"Dërgohet detajimi i fondeve buxhetore të shpenzimeve kapitale për vitin 2018"* mbështetur në Ligjin 109, datë 30.11.2017 *"Për buxhetin e vitit 2018"* si dhe udhëzimit të MFE, nr. 2, datë 06.02.2012 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*. Programi *"Menazhimi i të Ardhurave Doganore"*, për vitin 2018, çelet për vlerën 3,805,155 mijë lekë, të ndara për:
- Shpenzimet korrente në vlerën 3,230,155 mijë lekë të ndara me artikuj:
- Paga e shtesa artikulli 600 gjithësej në vlerë 1,072,000 mijë lekë.
- Sigurime shoqërore artikulli 601 gjithësej në vlerë 167,000 mijë lekë
- Blerje mallra e shërbime artikulli 602 gjithësej në vlerë 1,980,000 mijë lekë
- Transferta të jashme" artikulli 605, gjithësej në vlerë 9,618 mijë lekë.
- Transferta të buxheteve familjare" artikulli 606, gjithësej në vlerë 1,537 mijë lekë.
- Shpenzimet për investime artikulli 230-232 në vlerën 575,000 mijë lekë, nga të cilat:
- Investim i brendshëm në vlerë 350,000 mijë lekë, dhe
- Investim i huaj, në vlerë 225,000 mijë lekë

Me Aktin Normativ nr. 1, datë 26.07.2018, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018", dërguar pranë institucionit me shkresë nr.14250/4 prot, datë 03.08.2018 të MFE "Dërgohet detajim i aktit normativ nr.1 datë 26.07.2018". Ky ndryshim është miratuar dhe përcjellë me shkresë nr.14250/8 prot, datë 12.09.2018.

- Është pakësuar financim i brendshëm (230+231) nga buxheti në shumën 60,000 mijë lekë
-Janë kryer gjatë vitit buxhetor transferime fondesh nga artikujt 600,601,605 në artikullin 602 si dhe rilokime fondesh në zërin shpenzime kapitale.
- Është pakësuar artikulli 600 (Paga) në shumën 133,222 mijë lekë,
- Është pakësuar zëri 601(Kontributi i Sigurime shoqërore e shëndetësore) në shumën 9,708 mijë lekë,
- Është shtuar artikulli 602 (shpenzime operative) në shumën 132,279 mijë lekë,
- Është shtuar artikulli 605 (Transferta korrente të huaja) në shumën 6,044 mijë lekë,
- Është shtuar artikulli 606 (Transferta për buxh familjare e individë) në shumën 4,607 mijë lekë,
Gjithsej me rialokime fondesh shpenzimet personelit (Paga dhe Sigurime) janë pakësuar në vlerën 142,930 mijë lekë, ndërsa shpenzimet korrente (Mallra dhe Shërbime) janë shtuar gjithsej 142,930 mijë lekë.
Në nenin 81 të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 *"Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, i ndryshuar, citohet: *"E drejta e njësisë së qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri me datë 15 nëntor të çdo viti, e cila konsiderohet data e fundit e paraqitjes së kërkesave tek Nëpunësi i Parë Autorizues"*
- Me Aktin Normativ nr.2, datë 19.12.2018, "Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", dërguar me shkresën nr. 14250/22, datë 27.12.2018 të MFE. Ky ndryshim është miratuar dhe përcjellë nga ana e MFE me shkresë nr. 22452/100 prot, datë 31.12.2018.
- Është pakësuar artikulli 600 (Paga) në shumën 23,000 mijë lekë,
- Është pakësuar zëri 601 (Kontributi i Sigurime shoqërore e shëndetësore) në shumën 5,000 mijë lekë.
- Është pakësuar financim i brendshëm (230+231) nga buxheti në shumën 20,652 mijë lekë.
- Është pakësuar financimi i huaj (grande) në shumën 38,009 mijë lekë.
Gjithsej me këtë akt normativ shpenzimet korrente janë pakësuar 28,000 mijë lekë, ndërsa shpenzimet kapitale janë pakësuar gjithsej 58,661mijë lekë.
Të përmbledhura, në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar me ndryshimet e tij gjatë vitit dhe realizimi i tyre për vitet 2018, paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

në mijë lekë

Llogaria	*Struktura Buxhetore*	*Realizimi 2018*	*Buxheti Fillestar*	*Buxheti ndryshuar*
600-601	Paga Sigurime Shoqërore	1,061,737	1,239,000	965,700
602-606	Korente të Tjera	2,116,045	1,991,155	2,068,674
230-232	Kapitale Të Brendshme	164,112	350,000	153,284
230-232	Kapitale Të Huaja	132,278	225,000	372,323
	Totali	3,474,172	3,805,155	3,559,980

Plani përfundimtar i buxhetit të vitit 2018, mbas ndryshimeve gjatë vitit, ka rezultuar në vlerë 3,559,980 mijë lekë dhe duke e krahasuar me çeljen e buxhetit në vlerë 3,805,155 mijë lekë, plani përfundimtar është pakësuar për 245,175 mijë lekë.

-Auditim mbi saktësinë e realizimit të produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë, kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit.
Për vitin buxhetor 2018, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga MFE, ndërsa Raporti i Monitorimit të buxhetit të vitit 2018, është dërguar në MFE me shkresën nr. 12168 datë 22.05.2018 dhe me shkresën nr. 21607 datë 24.09.2018.

në mijë lekë

Përshkrimi	*Realizimi 2017*	*Buxheti 2018*	*Ndryshime*	*Buxheti përfund.*	*Realizimi*	*Diferenca*	*Realizimi/Buxh fillestar*	*Realizimi/Buxh përfund*
	1	*2*	*3*	*4*	*5*	*6=2-5*		
Paga,Sigurime	1,024,458	1,239,000	-170,930	1,068,070	1,061,737	177,263	86%	99%
Korente të Tjera	2,151,794	1,991,155	144,335	2,135,490	2,116,045	-124,890	106%	99%

Kapitale Të Brendshme	69,286	350,000	-80,653	269,347	164,112	185,888	47%	61%
Kapitale Të Huaja	208,519	225,000	38,009	186,691	132,278	92,722	59%	71%
Jashte Buxhetore	179,330	0	0	243,327	211,584	31,743		87%
Totali	3,633,387	3,805,155	-165,332	3,923,316	3,782,430	304,949	99%	96%

-Pra shpenzimet korrente janë çelur në vlerë 3,230,155 mijë lekë, nga 3,176,252 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 17% më shumë. Janë pakësuar në total gjatë vitit për 26,595 mijë lekë, duke arritur në vlerën 3,203,560 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 3,177,782 mijë lekë ose 98.4% të buxhetit fillestar dhe 99 % e buxhetit përfundimtar.

Shpenzime të personelit, janë realizuar në masën 1,061,737 mijë lekë ose 86% e buxhetit fillestar dhe 99 % e buxhetit përfundimtar, me një diferencë të pa realizuar për 177,263 mijë lekë nga buxheti fillestar dhe 6,333 mijë lekë nga plani i buxhetit përfundimtar.

Shpenzime të tjera korrente, janë realizuar në masën 2,116,045 mijë lekë ose 106 % e buxhetit fillestar dhe 99 % e buxhetit përfundimtar, me një diferencë të realizuar më shumë për 124,890 mijë lekë nga buxheti fillestar dhe shuma 19,445 mijë lekë nga buxheti përfundimtar.

-Shpenzimet për investime janë çelur në vlerë 575,000 mijë lekë nga 277,805 mijë lekë të realizuara një vit më parë, apo krahasuar me një vit më parë janë rritur në masën 2.1 herë më shumë. Janë pakësuar për 118,662 mijë lekë më pakë duke arritur në vlerën 456,338 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerë 296,390 mijë lekë, pra janë realizuar në masën 52% e planit fillestar dhe 65% e planit përfundimtar.

Paraqitur grafikisht, plani me ndryshimet dhe realizimi i tij paraqiten si më poshtë vijon.

Investime të brendshme në total janë çelur 350,000 mije lekë, plani i ndryshuar ka rezultuar në 269,347 lekë dhe janë realizuar në masën 61% ose në vlerë për 164,112 mijë lekë.

Veprimet e lartpërmendura bien në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar ndryshuar me Udhëzimin Nr. 5 datë 11.1.2018, neni 18. Ku citohet: Përjashtimisht, për blerjen e mallrave, apo për kryerjen e shërbimeve nga autoriteti kontraktor, vlera e përllogaritur e të cilave gjatë gjithë vitit kalendarik është në kufijtë e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël (më e madhe se 100.000 (njëqind mijë) lekë, por më e vogël se 800 000 (tetëqind mijë) lekë) në rast të krijimit të situatës emergjente, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël në formë shkresore, sipas formularit standard Nr. 4, në një vlerë deri 100 000 (njëqind mijë) lekë gjatë gjithë vitit.etj"

-Mandat pagesa nr. 44 datë 26.07.2018 likujduar urdhër - shërbimi për jashtë vendit në shumën 540 euro, nuk është fimosur nga punonjësi udhëtues znj. R..... K.....

-Mandat pagesa nr. 5 datë 06.02.2018 likujduar urdhër - shërbimi për jashtë vendit në shumën 850 euro, nuk është fimosur nga punonjësi udhëtues znj. F..... Sh..... si dhe nga nëpunësi zbatues znj. F..... M....., *në kundërshtim me udhëzimit të ministrit të financave Nr. 22, date 10.07.2013, Mbi "Zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të këshillit të ministrave "për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit"* ***pika5 , ku citohet ".....****Në përfundim të shërbimit, punonjësi dorëzon të firmosur pranë zyrës së financës së njësisë, Urdhër-Shërbimin duke i bashkëngjitur atij autorizimin e titullarit të institucionit qendror, ose të deleguarit të tij, dhe të gjithë dokumentet përkatëse që vërtetojnë shpenzimet e kryera për realizimin e shërbimit jashtë vendit. Urdhër-Shërbimi paraqitet sipas formatit nr.2, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij."*

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 4, datë 16/08/2019 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë *komente dhe shpjegime*, dhe konkretisht:

Me shkresën pa nr. prot., datë 22.08.2019, të D.P.D, ku **citohet** se: ***"...Nuk kam marrë lekë në dorë dhe nuk kam prerë asnjë biletë udhetimi pranë A..... G..... Për të kryer këtë shërbim mua më është dhënë bileta e fluturimit, rrjedhimisht nuk kam firmosur unë në lidhje me këtë pagesë...."***.

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH":

Në lidhje me komentet e bëra nga ***zj. Sh....,*** *sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, ndaj nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit pasi nga ana Juaj nuk është nënshkruar Urdhër Shërbimit në Bruksel, datë 05.02.2018.*

- Kohëzgjatja dhe destinacioni i udhëtimit në urdhër shërbimet e miratuara në të shumtën e rasteve nuk është shënuar ora e nisjes dhe kthimit duke ndikuar kështu vlerën jo të saktë të përllogaritjes së pagesave që udhëtuesi përfiton nga dieta, *në kundërshtim me udhëzimit të ministrit të financave Nr. 22, datë 10.07.2013, Mbi "Zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të këshillit të ministrave "për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me* shërbim jashtë vendit" **pika 5 , ku citohet:...** *Kur dërgimi i punonjësit me shërbim jashtë vendit në një ditë të caktuar kalendarike, bëhet para orës 8.00, dita e nisjes konsiderohet e plotë, ndërsa kur nisja bëhet pas orës 8.00, dita e nisjes konsiderohet gjysmë dite (1/2 dite).*
Kur kthimi nga shërbimi jashtë vendit në një ditë të caktuar kalendarike, bëhet pas orës 20.00, dita e kthimit konsiderohet e plotë, ndërsa kur kthimi behët para orës 20.00. dita e kthimit konsiderohet gjysmë dite (1/2 ditë).
Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se:
-Në muajin korrik me mandat pagesat e arkës nr. 3, 4, 5, 6, 7 janë likujduar **CASH për diferencë page 5 punonjës me vlerë 38,061 lekë ndërsa në muajin** gusht me mandat pagesat e ark**ë**s, nr 8 dhe 9, datë janë likujduar **CASH për diferencë page 2 punonjës me vlerë 21,451 lekë. Pra në total janë paguar** 7 punonjës në vlerën 59,512 lekë**,** kjo në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 64 ku citohet *"Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë".*

2.2. Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së saktësisë së veprimeve të kryera nëpërmjet bankës

Për vitin 2018, nga llogaria bankare e DPD janë kryer në total shpenzimet korrente në vlerën 3,177,782,000 lekë.
Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të pagesave me bankë zezultoi se,
-Konstatohen **kapërcime numrash në Urdhër shpenzime** psh nga urdhër shpenzimi Nr. 22 datë 11.01.2018 kalohet në ush nr.24 datë 12.01.2018, 26 datë 15.01.2018. Nga ush Nr.67 datë 07.02.2018 në ush Nr.69 datë 09.02.2018.
-Konstatohen gjithashtu **mosvijëmësi e numrave dhe datave** si psh ush nr 338 datë 16.05.2018 vazhdohet nga ush nr.339 datë 15.05.2018. Ush nr.658 datë 11.09.2018 vazhdohet nga ush nr.659 datë 04.09.2018, ush nr 660 datë 04.09.2018,
-Për urdhër shpenzimin Nr.47 datë 30.01.2018 **mungon shkresa/konfirmimi nga banka për kursin preferncial** të marrë nga DPD për transfertën e 14,892 dollar me përshkrimin likujdim fature e shërbimeve të të dhënave të bursës nga PLATTS.
-Konstatohen në masë të konsiderueshme, raste kur mungon bashkëlidhur ky konfirmim, dhe veprimet janë kryer me bankën Raiffeisen. Duke llogaritur që ka pagesa me vlerë të konsiderueshme, risku i konvertimit me kurs më të lartë se sa mund ta ofroj një bankë tjetër e nivelit të dytë është e lartë. DPD duke punuar vetëm me Raiffeisen Bank, **favorizon këtë si bankë** dhe duke mos marr minimumi 2 kurse prefernciale nuk arrijmë të gjykojmë mbi vlerën e fondeve të buxhetit të shtetit, të përdorura për këto transferta.
-Konstatohen raste kur marrja e kursit nga banka Raiffeisen është bërë një ditë më para se urdhër shpenzimi. Psh me urdhër shpenzimin Nr.168 datë 08.03.2018, është paguar vlera prej 1714 euro me kurs të marrë në datën 07.03.2018.
-Në urdhër-shpenzimin Nr. 227 datë 05.04.2018, për tërheqjen e vlerës prej 6000 euro nga Raiffeisen Bank kursi i marrë është 132,5 në euro në datën 04.04.2018. Në urdhër shpenzimin Nr.600 datë 14.08.2018 kursi është marrë në datën 13.08.2018 dhe urdhër shpenzimi është bërë në datën

14.08.2018. Po kështu kursi për 65,000 euro është marrë në datë 04.07.2018 dhe veprimet në urdhër shpenzim janë bërë në datën 05.07.2018.

2.3. Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë, me Degën e Thesarit, konstatohet se nuk janë respektuar afatet ligjore të pagesave si vijon:

Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave të marra nga Dega e Thesarit të urdhër shpenzimeve konstatohen se **55 raste në vlerën 67,759,304 lekë**, janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 9, datë 20.3.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", pika 184, ***ku citohet***: "*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik".* Të detajuara paraqiten në tabelën si më poshtë.

Tabela e detajuar në numër rastesh dhe vlerë të urdhër shpenzimeve, për tejkalim të afatit 30 ditorë nga data e faturës origjinale të operatorit.

NUMRI_FATUR	KODI_ INST	EC_ ACCOUNT	Klasa	FURNITORI	SHUMA	DT_ FURNITOR	DATA_URDHER_ SHPENZIMIT	GL_ DATE	DATA REGJISTRIM	DATA_ EKZEKUTIMI	GL Year	30 dite	
113410100772018	1010077	6027400	60		856,128	23-Aug-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	118	94
113310100772018	1010077	6027400	60		432,563	24-Jul-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	148	118
1129110100772010	1010077	6022004	60		1,896	30-Nov-17	30-Jan-18	29-Dec-17	30.01.2018	31.01.2018	-17	61	31
71910100772018	1010077	6022008	60		124,652	28-Feb-18	20-Sep-18	20-Sep-18	20.09.2018	21.09.2018	-18	204	174
113010100772018	1010077	6027400	60		1,140,328	4-Jul-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	168	138
72110100772018	1010077	6022008	60		153,418	30-Apr-18	20-Sep-18	20-Sep-18	20.09.2018	21.09.2018	-18	143	113
120910100772018	1010077	6029001	60		24,000	25-Jul-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	07.01.2019	-18	155	125
119810100772018	1010077	6027401	60		77,400	30-Jul-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	07.01.2019	-18	150	120
16110100772018	1010077	6022004	60		6,842	11-Dec-17	5-Mar-18	5-Mar-18	05.03.2018	06.03.2018	-18	84	54
100510100772018	1010077	6020200	60		84,991	1-Jul-18	4-Dec-18	4-Dec-18	04.12.2018	06.12.2018	-18	156	126
1128110100772010	1010077	6022003	60		10,764	6-Dec-17	30-Jan-18	29-Dec-17	30.01.2018	31.01.2018	-17	55	25
85510100772018	1010077	2314130	23		2,520,000	19-Jul-18	25-Oct-18	25-Oct-18	25.10.2018	26.10.2018	-18	98	68
104810100772018	1010077	6022003	60		3,588	19-Feb-18	11-Dec-18	11-Dec-18	11.12.2018	12.12.2018	-18	295	265
85610100772018	1010077	2314130	23		2,484,000	20-Aug-18	25-Oct-18	25-Oct-18	25.10.2018	26.10.2018	-18	66	36
121510100772018	1010077	6027400	60		500,895	15-Oct-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	07.01.2019	-18	73	43
17010100772018	1010077	2318700	23		3,559,410	26-Dec-17	9-Mar-18	9-Mar-18	09.03.2018	13.03.2018	-18	73	43
31810100772018	1010077	2318700	23		5,497,620	7-Feb-18	8-May-18	8-May-18	08.05.2018	09.05.2018	-18	90	60
76510100772018	1010077	6022001	60		425,476	31-Oct-16	2-Oct-18	2-Oct-18	02.10.2018	03.10.2018	-18	701	671
112710100772018	1010077	6027400	60		917,398	4-Jul-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	168	138
113510100772018	1010077	6027401	60		11,348,321	9-Jul-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	163	133
120410100772018	1010077	6027400	60		1,014,351	19-Sep-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	28.12.2018	-18	99	69
31710100772018	1010077	2318700	23		4,526,284	30-Jan-18	8-May-18	8-May-18	08.05.2018	09.05.2018	-18	98	68
72210100772018	1010077	6022008	60		138,133	30-Apr-18	21-Sep-18	21-Sep-18	21.09.2018	24.09.2018	-18	144	114
80510100772018	1010077	6022008	60		203,616	30-Jul-18	17-Oct-18	17-Oct-18	17.10.2018	18.10.2018	-18	79	49
121910100772018	1010077	6027401	60		365,655	23-Oct-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	07.01.2019	-18	65	35
112910100772018	1010077	6027400	60		527,600	6-Jul-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	166	136
115810100772018	1010077	6020500	60		630,000	22-Oct-18	24-Dec-18	24-Dec-18	24.12.2018	26.12.2018	-18	63	33
119910100772018	1010077	6027401	60		6,211,050	28-Aug-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	28.12.2018	-18	121	91
104710100772018	1010077	6020500	60		18,840	8-May-18	11-Dec-18	11-Dec-18	11.12.2018	12.12.2018	-18	217	187

120010100772018	1010077	6027401	60		20,000	18-Sep-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	07.01.2019	-18	100	70
76910100772018	1010077	6024100	60		5,633,500	29-Jul-18	4-Oct-18	4-Oct-18	04.10.2018	05.10.2018	-18	67	37
112810100772018	1010077	6027400	60		1,271,994	4-Jul-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	168	138
100710100772018	1010077	6020200	60		84,991	3-Sep-18	4-Dec-18	4-Dec-18	04.12.2018	06.12.2018	-18	92	62
120310100772018	1010077	6027400	60		148,000	28-Aug-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	28.12.2018	-18	121	91
13710100772018	1010077	6022003	60		28,800	1-Jan-18	26-Feb-18	26-Feb-18	26.02.2018	28.02.2018	-18	56	26
121410100772018	1010077	6027400	60		1,135,475	19-Sep-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	28.12.2018	-18	99	69
72010100772018	1010077	6022008	60		297,246	31-Mar-18	20-Sep-18	20-Sep-18	20.09.2018	21.09.2018	-18	173	143
1114110100772010	1010077	6021009	60		4,425,698	24-Nov-17	30-Jan-18	29-Dec-17	30.01.2018	31.01.2018	-17	67	37
115310100772018	1010077	6020100	60		951,000	6-Aug-18	24-Dec-18	24-Dec-18	24.12.2018	26.12.2018	-18	140	110
71810100772018	1010077	6022008	60		93,556	28-Feb-18	20-Sep-18	20-Sep-18	20.09.2018	21.09.2018	-18	204	174
100610100772018	1010077	6020200	60		84,991	1-Aug-18	4-Dec-18	4-Dec-18	04.12.2018	06.12.2018	-18	125	95
112510100772018	1010077	6027400	60		2,394,341	22-Jun-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	180	150
113110100772018	1010077	6027400	60		1,441,944	19-Jul-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	153	123
100310100772018	1010077	6020200	60		38,632	30-Apr-18	4-Dec-18	4-Dec-18	04.12.2018	06.12.2018	-18	218	188
72310100772018	1010077	6022008	60		305,865	1-Jun-18	21-Sep-18	21-Sep-18	21.09.2018	24.09.2018	-18	112	82
109510100772017	1010077	2312101	23		382,073	1-Feb-17	18-Jan-18	28-Dec-17	18.01.2018	23.01.2018	-17	351	321
113210100772018	1010077	6027400	60		362,988	24-Jul-18	19-Dec-18	19-Dec-18	19.12.2018	20.12.2018	-18	148	118
72410100772018	1010077	6022008	60		287,454	1-Jul-18	21-Sep-18	21-Sep-18	21.09.2018	24.09.2018	-18	82	52
71710100772018	1010077	6022008	60		290,048	31-Jan-18	20-Sep-18	20-Sep-18	20.09.2018	21.09.2018	-18	232	202
17510100772018	1010077	6022003	60		96	31-Dec-17	12-Mar-18	12-Mar-18	12.03.2018	13.03.2018	-18	71	41
76510100772018	1010077	6022001	60		270	31-Oct-16	2-Oct-18	2-Oct-18	02.10.2018	03.10.2018	-18	701	671
85410100772018	1010077	2314130	23		2,268,000	18-Jul-18	25-Oct-18	25-Oct-18	25.10.2018	26.10.2018	-18	99	69
103710100772018	1010077	6020200	60		84,991	2-Oct-18	7-Dec-18	7-Dec-18	07.12.2018	11.12.2018	-18	66	36
1217101007720180	1010077	6027401	60		1,394,948	24-Sep-18	27-Dec-18	27-Dec-18	27.12.2018	07.01.2019	-18	94	64
107210100772018	1010077	2314140	23		527,184	9-Oct-18	14-Dec-18	14-Dec-18	14.12.2018	17.12.2018	-18	66	36
					67,759,304								

(Të dhënat: Dega e Thesarit-SIFQ Punoi:KLSH)

Nga kontrolli konstatoj se, ka dokumenta të palotësuara me të gjithë elementet e saj formale që duhet të kenë shkresat zyrtare. Duke mos garantuar plotësinë e dokumentacioneve të rregullta shkresore.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se: *Dega e financës në disa raste, ka vepruar në mosnjohje të legjislacionit ekonomiko-financiar.*

- duke kryer pagesa diferencë pagash me lekë në dorë (CASH) nga arka, mbi limitin e arkë.
- duke kryer pagesa pa dokumentacionin justifikues, shoqërues dhe verifikues
- duke kryer pagesa pa procedure prokurimi për blerjet e vogla

-likujdim z. M..... P..... për urdhër shërbime e dieta jashtë shtetit, për shpenzime trasporti, pasi biletat e trasportit me avion shoqëruar urdhër shërbimit mungojnë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

-Udhëzimin e Ministrisë Financavë nr. 30 datë 27.12.2011 "për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 64.

- *Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 22, datë 10.07.2013, Mbi "Zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të keshillit të ministrave "për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit"pika 5 dhe 22.*

-Udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar ndryshuar me Udhëzimin Nr. 5 datë 11.1.2018, neni 18.
-Udhëzimin Nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", pika 184;
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Znj. B..... I..... me detyrë Drejtore e Përgjithëshme e Doganave, (për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2018), Z. A..... S....., me detyrë Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ (i autorizuar si Nëpunës Autorizues i Deleguar me shkresën nr.11186 prot, datë 09.05.2018 dhe miratuar nga Ministria e Financës me shkresën nr.6586/1 prot, datë 12.05.2017), Znj. F..... M..... me detyrë Drejtore e Sektorit të Financës (për periudhën 01.01.2018 deri më 01.05.2018), Znj. A..... K....., Drejtore e Sektorit të Financës (për periudhën 01.05.2018 deri më 31.12.2018) dhe Z. I..... B..... me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

3. Për auditimin pagave, shpërblimeve sigurimeve shoqërore e të tjera të DPD
Nga auditimi, lidhur me dukumentacionin e* pagave, shpërblimeve sigurimeve shoqërore e të tjera, *gjatë periudhës së auditimit konstatohet që:

Janë likujduar **CASH për diferencë page** 7 punonjës në vlerën 59,512 lekë**,** kjo në kundërshtim me udhëzimin e ministrisë së financave nr. 30 datë 27.12.2011 "për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 64 ku citohet *"Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë".*

Nga auditimi, lidhur me pagat, shpërblimeve sigurimeve shoqërore e të tjera të DPD, gjatë periudhës së auditimit konstatohet që:
Me shkresën nr. 2450, datë 31.01.2018 të DPD drejtuar MEF, bazuar në Ligjin Ligjit nr.109/2017 *"Për buxhetin e vitit 2018*", VKM nr.921, datë 29.12.2014 "Për personelin e administratës doganore" si dhe në zbatim të udhëzimit nr. 02, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" është bërë detajimi i numrit të punonjësve për 17 Degët Doganore dhe për Aparatin e DPD-së në total për 1,102 punonjës të miratuar. Detajimi i numrit të punonjësve me kontratë të përkohëshme pune, në mbështetje të VKM nr. 60, datë 31.01.2018, është bërë me shkresën drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 17053 prot, datë 17.07.2018
Çelja e buxhetit për zërin 600-601 "Paga dhe Sigurime" si niveli e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.
Referuar Ligjit të Buxhetit 2018 dhe akteve ligjore në zbatim të tij, për vitin 2018, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka pasur të planifikuar vlerën për 1,068,070 mijë lekë për zërin 600-601 "Paga dhe Sigurime". Ka pësuar ndryshime duke zbritur vlerën fillestare të miratuar me 170,930 mijë lekë dhe është miratuar përfundimisht me vlerën 1,061,737 mijë lekë. Pra shpenzime të personelit, janë realizuar në masën 1,061,737 mijë lekë ose 86% e buxhetit fillestar dhe 99 % e buxhetit përfundimtar, me një diferencë të pa realizuar për 177,263 mijë lekë nga buxheti fillestar dhe 6,333 mijë lekë nga plani i buxhetit përfundimtar.
Tabela në vijim paraqet Situacionin e Shpenzimeve në zërin 600-601 "Paga dhe Sigurime " për vitin 2018.

në mijë lekë

Njësitë ekonomike	*Nr. Punonjësish*				*Plani Vjetor 2018*			*Shpenzime Faktike 2018*			*Difer.*
	Miratuar		*Faktik*								
	Struk turë	*Me kontratë*	*Struk turë*	*Me kontratë*	*Paga*	*Sigurime*	*Totali*	*Paga*	*Sigurime*	*Totali*	
					1	*2*	*3=1+2*	*4*	*5*	*6=4+5*	*7=3-6*
Aparati	464	**41**	**412**	**41**	421,475	69,378	490,853	420,539	69,093	489,632	1,221
Rinas	39	**5**	**37**	**5**	36,868	6,118	42,986	36,598	5,980	42,578	408
Tiranë	67	**12**	**47**	**10**	43,859	7,334	51,193	43,621	7,252	50,873	320
Durrës	124	**11**	**100**	**8**	95,188	16,079	111,267	94,863	15,871	110,734	533
Shkodër	49	**13**	**40**	**13**	38,980	6,507	45,487	38,931	6,497	45,428	59
Pogradec	37	**12**	**32**	**10**	31,798	5,324	37,122	31,774	5,303	37,077	45
Korçë	23	**2**	**19**	**2**	19,059	3,192	22,251	18,859	3,153	22,011	240
Kapshticë	28	**6**	**22**	**6**	24,690	4,113	28,803	24,613	4,103	28,716	87
Gjirokastër	36	**6**	**31**	**6**	27,263	4,699	31,962	27,174	4,489	31,663	299

Vlorë	31	**7**	**26**	**7**	25,700	4,234	29,934	25,452	4,229	29,681	253
Elbasan	30	**3**	**23**	**3**	23,501	3,658	27,159	21,924	3,630	25,554	1,605
Berat	16	**3**	**13**	**3**	10,959	1,879	12,838	10,737	1,785	12,523	315
Fier	43	**3**	**31**	**3**	27,532	4,657	32,189	27,421	4,598	32,019	170
Sarandë	27	**12**	**20**	**10**	19,750	3,304	23,054	19,729	3,290	23,019	35
Peshkopi	14	**2**	**11**	**2**	12,451	2,087	14,538	12,122	2,027	14,149	389
Kukës	46	**10**	**33**	**10**	32,895	5,545	38,440	32,833	5,468	38,301	139
Lezhë	15	**3**	**13**	**3**	14,473	2,477	16,950	14,443	2,412	16,855	95
Tre - urat	13	**2**	**9**	**2**	9,337	1,707	11,044	9,287	1,636	10,923	121
TOTALI	**1102**	**153**	**919**	144	**915,778**	**152,292**	**1,068,070**	**910,920**	**150,817**	**1,061,737**	**6,333**

- Nga auditimi u konstatua se numri i miratuar punjonjësve me kontratë për vitin 2018 ka qënë 153, ndërsa numri faktik është 144, të cilët janë të shpërndarë në strukturën e degëve të doganave. Krahasuar me strukturën nga kjo kategori punonjësish nuk ka tejkalim të numrit të miratuar.
- Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se në muajin korrik me mandat pagesat e arkës nr. 3, 4, 5, 6, 7, janë likujduar **CASH për diferencë page 5 punonjës me vlerë 38,061 lekë ndërsa në muajin** gusht me mandat pagesat e ark**ë**s, nr 8 dhe 9, janë likujduar **CASH për diferencë page 2 punonjës me vlerë 21,451 lekë. Pra në total janë paguar** 7 punonjës në vlerën 59,512 lekë**,** kjo në kundërshtim me udhëzimin e ministrise financave nr. 30 datë 27.12.2011 "për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" ***Veprimet që kryhen me arkë dhe bankë. Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:*** *Dega e financës, ka vepruar në mosnjohje të legjislacionit ekonomiko-financiar,* duke kryer likujdime diferencë pagash me lekë në dorë (CASH) nga arka.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" *"Veprimet me arkë dhe bankë".*Llogaritja e ndalesave për sigurime shoqërore dhe tatim mbi pagat është bërë konform legjislacionit në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Znj. F..... M..... me detyrë Drejtore e Sektorit te Financës, Z. I... B..... me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, dhe Z. N..... Gj..... me detyrë Specialist Finance.

4. Auditimi për përputhshmërinë e procedurave për inventarizimin e pasurisë së institucionit

Në zbatim të pikës nr. 2, të programit të auditimit për **Inventarizimin e pasurisë për vitin 2018**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Regjistri i aktiveve të DPD-së.
-Dokumentacioni mbi kryerjen e inventarizimit.
-Dokumentacioni shoqërues i inventarizimit.

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për inventarizimin e pasurisë së institucionit konstatua se inventarizimi i aktiveve në DPD është kryer duke u bazuar në urdhrin e titullarit nr. 28556 datë 04.12.2018, për invertarizimin e përgjithshëm fizik të pasurisë në sistemin doganor, urdhërit nr. 28556/1 datë 31.12.2018 për ngritjen e komisionit për inventarizimin e pasurisë dhe inventarizimin fizik në datë 31.12.2018, në aparatin e DPD, sipas të cilit janë ngritur komisionet përkatëse për inventarizimin fizik, në zbatim të nenit 12, pika 2 b dhe nenit 15 pika 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pikat 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet.

a. Komisioni i posaçëm për inventarin e Magazinës Qendrorë është i përbërë nga 3 punonjës, z.S..... A...../kryetar, z. Sh..... V...../anetar, z. V..... M...../anetar.) në përputhje me kërkesat e pikës 82 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Përgjegjësi material, magazinieri z. B..... Sh..... dhe sp/Financës përgjegjëse për kontabilitetin e magazinave znj. L..... Z..... Në përfundim të inventarizimit komisioni ka arritur në përfundimin se inventari fizik i magazinës qendrore është i kuadruar me kontabilitetin dhe nuk ka diferenca si në tepri ashtu edhe në mungesa. Nga komisioni është konstatuar gjendja fizike për magazinë qendrore si në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Nr	***Emërtimi***	***Gjendja kontable Viti 2018***	***Gjendja fizike Viti 2018***
1	Materiale	67.798.581.00	67.798.581.00

2	Materiale rikupero	401.000.00	401.000.00
3	Objekte inventari	6.099.581.00	6.099.581.00
4	Materiale veshmbathje	15.352.340.00	15.352.340.00
5	Pajisje të radiondërlidhjes	32.019.318.00	32.019.318.00
6	Pajisje inventar ekonomik	51.616.611.00	51.616.611.00
7	Pajisje kompjuterike	184.309.737.00	184.309.737.00
8	Pajisje elektrike & elektronike	115.551.813.00	115.551.813.00
	Shuma	**473,148,981**	**473,148,981**

b. Komisioni i posaçëm për inventarin e Laboratorit Doganor është i përbërë nga 3 punonjës, znj. E..... I...../kryetare, znj. J..... T...../anëtare dhe z. Dh..... J...../anëtar, në përputhje me kërkesat e pikës 82 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Përgjegjësi material, magazinierja z. L..... C..... dhe sp/Financës përgjegjëse për kontabilitetin e magazinave znj. L.... Z..... Në përfundim të inventarizimit komisioni ka arritur në përfundimin se inventari fizik i magazinës së laboratorit doganor është i kuadruar me kontabilitetin dhe nuk ka diferenca si në tepri ashtu edhe në mungesa. Nga komisioni është konstatuar, gjendja fizike për magazinën e laboratorit qendror si në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Nr	*Emërtimi*	*Gjendja kontable Viti 2018*	*Gjendja fizike Viti 2018*
1	Materiale	20,254,470	20,254,470
2	Objekte inventari	453,872	453,872
3	Pajise laboratori	284,371,138	284,371,138
4	Pajisje orendi	7,615,011	7,615,011
5	Pajisje kompjuterike	6,001,691	6,001,691
6	Pajisje elektrike dhe elektronike	42,387,007	42,387,007
	Shuma	**361,083,189**	**361,083,189**

c. Komisioni i posaçëm për inventarin e Magazinës A/K Detare është i përbërë nga 3 punonjës, z. A..... K...../kryetar, E..... P...../anëtar dhe A..... Z...../anëtar, në përputhje me kërkesat e pikës 82 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Përgjegjësi material, magazinieri z. Sh..... C..... dhe sp/Financës përgjegjëse për kontabilitetin e magazinave znj. L..... Z..... (të vërë në dispozicion të komisionit të inventarizimit dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim. Në përfundim të inventarizimit komisioni ka arritur në përfundimin se inventari fizik i magazinës së A/K detare është i kuadruar me kontabilitetin dhe nuk ka diferenca si në tepri ashtu edhe në mungesa. Nga komisioni është konstatuar, gjendja fizike për magazinën e A/K Detare si në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Nr	*Emërtimi*	*Gjendja kontable Viti 2018*	*Gjendja fizike Viti 2018*
1	Objekte inventari	1,783,519	1,783,519
2	Materiale rikupero	190,717	190,717
3	Karburant për motovedeta	583,551	583,551
4	Pjesë këmbimi për autovedeta	1,783,519	1,783,519
5	Mjete detare "motovedeta"	96,313,131	96,313,131
6	Pajisje të radiondërlidhjes	2,776,770	2,776,770
7	Pajisje inventar ekonomik	4,633,427	4,633,427
8	Pajisje kompjuterike	9,122,541	9,122,541
	Shuma	**117,187,175**	**117,187,175**

d. Komisioni i posaçëm për inventarin e magazinës së parkut të automjeteve është i përbërë nga 3 punonjës, z.P..... T...../kryetar, z. S..... I...../anëtar z. A... A..../anëtar, në përputhje me kërkesat e pikës 82 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Përgjegjësi material, magazinieri z. A..... H..... dhe sp/Financës përgjegjëse për kontabilitetin e magazinave znj. L..... Z..... Në përfundim të inventarizimit komisioni ka arritur në përfundimin se inventari fizik i magazinës së A/K detare është i kuadruar me kontabilitetin dhe nuk ka diferenca si në tepri ashtu edhe në mungesa. Gjendja fizike e magazinës së parkut të automjeteve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Nr	*Emërtimi*	*Gjendja kontable Viti 2018*	*Gjendja fizike Viti 2018*
1	Pjesë për automjete	23,875,659	23,875,659

2	Karburant	2,414,764	2,414,764
3	Karburant (depozita)- DPD gjenerator	204,790	204,790
4	Materiale rikupero	0	0
5	Objekte inventari	2,908,863	2,908,863
6	Autovetura	201,830,402	201,830,402
7	Inventar ekonomik	829,361	829,361
8	Pajisje elektrike & elektronike	56,817,838	56,817,838
	Shuma	**288.881.677**	**288.881.677**

Me urdhërin nr.28556/1 datë 31.12.2018 të tutillarit të institucionit janë krijuar grupet e komisionit të caktuara prej tij për inventarizimi fizik i pasurisë dhe inventarizimi fizik në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, inventarizimi duhej të fillonte me datë 03.01.2019 dhe të mbaronte brenda datës 19.01.2019. Në relacionin e mbajtur pas mbarimit të inventarizimit shënohet data 14.01.2019 si datë përmbyllëse e këtij procesi, i pa protokolluar. Inventarizimi rezulton të jetë bërë brenda afatit të kërkuar nga titullari.

-Relacioni mbajtur nga komisioni i inventarizimit pas përfundimit të procesit të inventarizimit për vitin 2018, datë 14.01.2018, ***nuk ka nr. protokolli***. ***Është i pa protokolluar*.**

- Është mbajtur një relacion i përbashkët për të gjitha magazinat. Jo i ndarë për çdo magazinë në vehte. Relacioni është firmosur nga 8 anëtarë gjithsej. Ndërkohë duhej të firmosej nga 12 anëtarë, pasi janë inventarizuar 4 magazina me nje grup prej 3 anëtarësh të ndryshëm për çdo magazinë. Nga verifikimi i bërë rezulton që jo të gjithë anëtarët e komisionit kanë firmosur në mbarim të verifikimit të inventarizimit fizik të magazinave. Në listën e anëtarëve në relacionin përmblëdhës përfundimtar rezulton që asnjë anëtar i inventarizimit të magazinës A/K Detare nuk ka firmosur, për magazinën e Laboratorit Doganor nuk është firmosur nga 2 anëtarë të komisionit si dhe në magazinën e parkut nga një anëtar i komisionit. *në kundërshtim me kërkesat e pikës nr. 85, gërma c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ku citohet se: Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë përH: Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.*

- Nga auditimi me zgjedhje i dokumentave të magazinës rezultoi se me FH nr. 09 datë 14.08.2018, nr.10 datë 15.02.2018, nr.12.datë 24.02.2018, nr 14 datë 26.02.2018 (dhurata, pjata dekorative) është bërë shënim përsipër për anullim, dhe për këtë nuk ka asnjë urdhër apo shkresë për kryerjen e kësaj procedure, në *kundërshtim me kërkesat e pikës nr. 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ku citohet se: "Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasior dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore dhe administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime të lexueshëm dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve*

Me FH nr 11 datë 08.05.2018 (karburant), nr 14 datë 06.06.2018 (Karburant), nr.21 date 20.07.2018 (Karburant) procesverbali i marrjes së mallit në dorëzim, mungon firma e njërit nga anëtarët e komisionit, në kundërshtim *me me kërkesat e pikës nr. 43, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ku citohet se: Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.si* dhe pikën *35, gërma a, ku citohet: Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:*

a Dokumenta vërtetues *- vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, proçesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi*

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:

-**Nga komisionet e posaçme nuk është mbajtur procesverbal me përgjegjësin material, para fillimit të inventarit me qëllim fiksim e numrit rendor të fletë hyrjeve dhe të fletë daljeve por është hartuar vetëm një shkresë (deklaratë) nga përgjegjësi material drejtuar komisionit të inventarizimit ku i bën me dije numrin rendor të FH dhe FD,** kjo kundërshtim me kërkesat e pikës 83 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ku citohet se: "*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behët mbyllja dhe dyllosja e magazinës."*

-**Në përfundim të inventarizimit nga komisionet e posaçme nuk është përpiluar një raport për Nëpunësin Autorizues lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre dhe gjendjen fizike të aktiveve,** në kundërshtim me kërkesat e pikës 85 germa "c" e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ku citohet se: Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësi të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nga nëpunësi autorizues."*

-**Nga auditimi me zgjedhje i fletë hyrjeve për magazinat rezultoi se në disa fletë hyrje është bërë shënim përsipër për anullim, dhe për këtë nuk ka asnjë urdhër apo shkresë për kryerjen e kësaj procedure si dhe në disa raste proces-verbali i marrjes në dorëzim është i pa protokolluar. Ka mungesa firmash të anëtarëve të komisionit në proces-verbale** në kundërshtim me kërkesat e pikës nr. 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ku citohet se: "*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasior dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore dhe administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime të lexueshëm dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve" dhe me kërkesat e pikës nr. 43, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ku citohet se: Komisioni përbëhet nga specialistë të fushë s sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.*

Nxjerrja jashtë përdorimit i aktiveve.

-Nga auditimi rezultoi se sipas urdhrit të brendshëm nr.56 datë 31.07.2018, është ngritur komisioni për vlerësimin e inventarit dhe përdorimit të mjeteve të transportit për aparatin e DPD. Komisioni pasi ka bërë vlerësimet e automjeteve dhe më datë 13.10.2015 ka mbajtur procesverbalin ku ka vlerësuar për të nxjerrë jashtë përdorimi 7 automjete.

Sipas shkresës nr. 25135, datë 25.10.2018 nga titullari i institucionit është miratuar nxjerrja jashtë përdorimi e 7 automjeteve, me vlerë 20,540,798 lekë.

Nga kontrolli i mëtejshëm, konstatoj që deri në mbajtjen e këtij akt/konstatimi nuk janë kryer veprime për eleminin fizik të automjeteve pas vlerësimit të tyre nga komisioni i vlerësimit dhe miratimit të Titullarit për nxjerrjen jashtë përdorimit te 7 automjeteve me vlerë 20,540,798 lekë.

-Me procesverbalet nr.1 – nr. 46 mbajtur në datë 18.10.2018 nga komisioni i vlerësimit të nxjerrjes jashtë përdorimit të paisjeve nga inventari ekonomik, janë vlerësuar se janë jashtë përdorimit paisjet

me kod, (kodi MP.218.702, me vlerë 471.782 lekë, kodi MP 2018.102, me vlerë 65.080 lekë, kodi MP 327, me vlerë 1,241.600 lekë,).
Me Proces verbalin nr 4331/1 datë 25.02.2019 komisioni ka bërë asgjësimin fizik në prani të komisionit të përbërë nga, Z. P..... T...../Kryetar, Z. I..... B...../Anëtar, Z. S..... A...../Anëtar, Z. F...../K..../Anëtar, Z. A..... H...../Anëtar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:
-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ndryshuar .

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Për mosmarrje pjesë hartimin e relacionit përfundimtar të procesit të inventarizimit.
Z. A..... K....., Komandant Motovedeta, A/K Detare. Z. E..... P....., Komandant Motovedeta, A/K Detare. Z. A..... Z....., Motorist. Z. Dh..... J..... Përgjegjës sektori. Znj. J..... T....., Laborante. Z. A... A..., Teknik.
Znj. K.... B....., për mosfirmosje të procesverbali i marrjes së mallit në dorëzim.
Z. B..... Sh....., magazinier.

3. Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Vlerësimit në Qendër.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit "Nr. 242/1 Prot., datë 06.06.2019", për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni elektronik si më poshtë:
1. Sistemi elektronik ORACLE i të dhënave për deklaratat doganore IM4 të përpunuara në sistemin doganor në bazë të përzgjedhjes si kriter vlerësimi: artikujt plastikë të deklaruar dhe klasifikuar ne kapitullin 39 për efekt të taksës së amablazhit (TAM); mallrat që importohen më shpesh dhe me ndikim në të ardhurat; mallrat që kuotohen në bursë; artikujt e importuar nga NEU (kryesisht Kina), si dhe mallrat e përdorur, duke synuar që të mbulohej e gjithë periudha e programuar, pa krijuar mbivendosje me strukturat e tjera kontrolluese;
2. Dokumentacioni tregtar elektronik i praktikave doganore sa më sipër, nëpërmjet sistemit Asycuda World, të vlerësuara dhe përzgjedhura me rrisk;
3. Dokumentacioni tregtar dhe elektronik i praktikave doganore të artikujve të njëjtë nga e njëjta origjinë deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme, për të cilët nga SVQ apo SKAO nuk është ndjekur i njëjti kriter apo standard vlerësimi.

Nga auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore u konstatua:

I. Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave, përpunuar nga zyra operacionale pranë DDE, si dhe Sektori i Vlerësimit në Qendër (SVQ), si dhe Sektori i Kontrollit Aposterior Operativ (SKAO), pranë DPD.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të praktikave doganore në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave, gjatë proçedurave të zhdoganimit të cilat janë vlerësuar me rrisk në bazë të metodave të ekzaminimit kryq, rishikimit analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim teknikash: si shqyrtimi i dokumentave justifikuese, krahasimi me dokumentat bazë dhe ekzaminimi analitik (auditimi i vërtetësisë, rakordimet, krahasimet), konstatohet që:

Nga ana e: z. A.... H..... me detyrë përgjegjës sektori SKAO; z. H..... E..... me detyrë përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë; z. F..... Gj..... me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i sektorit regjime në DD. Durrës; z. A.... V..... dhe z. I.... P..... me me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Durrës; z. H..... L.... dhe z. M.... B..... me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i terminalit të kontenierëve në DD. Durrës; z. E.... Sh....., z. D..... M.... dhe z. A..... Zh..... me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Kakavie; z. N.... H.... me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Shkodër, z. K.... V.... me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Vlorë; zj. E..... Sh..... me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Korçë; z. A..... L.....; z. A..... B..... dhe z. P..... T....., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës zyre në SVQ, pranë DPD; z. V..... N..... me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Korçë; zj. A..... A..... me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Kakavie; z. J..... M....., zj. O..... H.....; z. J..... K.....; zj. A..... Ç....., me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Durrës; z. N..... H..... me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Tiranë; zj. A..... D..... me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/përjashtime, pranë DD. Shkodër; zj. R..... K....., zj. L..... K....., z. D..... P..... me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/përjashtime, pranë DD. Durrës; z. A..... Sh....., z. A..... Sh....., zj. L..... B....., z. E..... D....., zj. M..... Z....., zj. O.... V....., zj. E..... B....., zj. E..... Ç....., z. A..... K....., z. A..... N....., z. K..... B....., z. A..... B., zj. K. X., zj. L. D., z. A. V., z. F. S., z. E. S., z. Sh. S., z. A. D., z. E. N., zj. S. D., z. R. D., zj. A. H., z. B. N., z. G. U., z. E. P., z. R. B., z. I. M., z. E. H., zj. G. G., z. E. B., zj. E. G., z. R. M. dhe z. I. R., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ), pranë DPD, si dhe z. E. Th., z. I. M., z. P. R., zj. E. K., z. D. B., z. A. S., z. B. D., zj. M. Z., z. S. T., z. E. I., z. R. Sh., zj. I. B., z. E. Gj., z. R. M., zj. E. Sh., z. I. Ç. dhe z. A. D. me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra legjislacionin doganor lidhur me vlerësimin doganor të mallrave referuar kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..",* ndryshuar me pikën 7 dhe 8 të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* nxjerrë për këtë qëllim.

Referuar nenit 171, pika 2, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

Për qëllime të pikës 1, kur një deklaratë doganore mbulon dy ose më shumë artikuj, të dhënat për secilin artikull konsiderohen sikur përbëjnë deklarata të veçanta doganore.

Referuar nenit 70, pika 2, shkronja "a" dhe "b", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

Vlera doganore, sipas pikës 1, është: *a) vlera e transaktuar e mallrave identike te shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;* *b) vlera e transaktuar e mallrave të ngjashme, të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;*

Referuar nenit 70, pika 3 të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1, të këtij neni, ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë

Referuar pikës 7, të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore"*, në të përcaktohet qartë që:

Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor Indikatorët që mund të evidentojnë një shqyrtim më të thelluar të vlerës doganore, mund të jenë:
- Ekziston një ndryshim i dukshëm midis vlerës së deklaruar dhe çmimeve të Database-it Kombëtar të Vlerësimit apo të të dhënave të disponueshme për artikujt që përditësohen nga bursat apo agjenci ndërkombëtare.
- Ka çmime të ndryshme të deklaruara për të njëjtin produkt, nga furnizues/origjina të njëjta/ ngjashme.
- Vendi i origjinës/lëvrimit me risk: Azisë, Lindjes së Largët, vendeve arabe, zonave të lira (zona off-shore), Amerika Latine.
- Vendi i origjinës ndryshon nga vendi nga ku transportohet/lëvrohet malli.
- Përmbajtja e faturave nga i njëjti furnizues paraqet luhatje jo të zakonshme.
- Përfshihen shitjet e njëpasnjëshme (zinxhir shitjesh).
- Ekziston një tregtar ose një kompani e tretë (agjenti blerës) i përfshirë në transaksione.
- Mallrat vijnë nga një vend pa marrëveshje të asistencës reciproke me vendin tonë ose nga ku është e vështirë për të marrë informacion.
- Vendi i ngarkimit nuk korrespondon me vendin e adresën e eksportuesit.
- Ekziston një ndryshim i dukshëm midis çmimit të deklaruar me çmimet nga publikime në tregje të ndryshme.
- Vlera e produktit nuk mund të jetë më e ulët se vlera e lëndës së parë me të cilën është prodhuar.
- Indikatorë të tjerë të paspecifikuar më lart etj.

Referuar pikës 10, shkronja "h" të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore"*, në të përcaktohet qartë që:

Kur importohen mallra të përdorura dhe transaksioni i paraqitur nuk justifikon gjendjen e tyre, nga dega doganore apo strukturat e posaçme, ngrihet "grup vlerësimi", që merr në konsideratë sipas rastit, vitin e prodhimit, shkallën e amortizimit, gjendjen reale të tyre etj., por jo më pak se 40% të vlerës të mallit të ri

Referuar Urdhërit nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që:

Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore ***të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme****, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave* ***dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.***

Për kryerjen e auditimit u përdorën teknika të ndryshme të ekzaminimeve nëpërmjet sistemit IDEA të raporteve të përpunuara në sistemin ORACLE, si dhe Asycuda ŴORLD. Nga auditimi u konstatua që është pranuar transaksioni dhe për raste kur vlerat e artikujve kanë qenë nën referencë, por dokumentacioni bashkëngjitur praktikave doganore nuk justifikonte metodën e përdorur. U konstatua që është bërë ndërhyrje duke mos e pranuar transaksionin por masa e ndërhyrjes nuk ka qenë në nivelet e operatorëve të tjerë për të njëjtin artikull nga e njëjta origjinë. Gjatë auditimit janë përdorur metodat e ekzaminimit kryq, rishikimit analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim

teknikash: si shqyrtimi i dokumentave justifikuese dhe krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimi analitik (auditimi i vërtetësisë, rakordimet, krahasimet).
Nga auditimi me zgjedhje i praktikave doganore IM4, kryesisht me origjinë NEU, por edhe EU për mallra të deklaruar, çmimi për njësi i të cilave rezulton dukshëm më i ulët krahasuar me çmimin: e mallrave të njëjtë apo identik të importuar të deklaruar dhe transaktuar; e publikuar në tregje; të publikuar në bursë; si dhe të dhënat e miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të publikuara në faqen zyrtare të DPD, rezultoi se nga ana e sektorit operacional pranë degeve doganore, Sektorit të Vlerësimit Doganor në Qendër (SQV), si dhe nga ana e sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), për importet e mallrave nga disa subjekte, pranimi i transaksionit nuk ka qënë i justifikuar pasi referuar:
1. Indikatorëve të përcaktuar në pikën 2 të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme...",* me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, nuk është bërë një **analizë** e thelluar, sepse:
- së pari, në pikën 2.1 të Udhëzimit citohet "*Vlerat e mallrave identike apo të ngjashme të pranuara me transaksionin në sistemin doganor brenda 3 muajve të fundit*", ku nga verifikimi në sistemin ORACLE, rezulton se çmimi për të njëjtin artikull, nga e njëjta origjinë, nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues paraqitet i ndryshëm, dhe se, çmimi për të njëjtin artikull nga NEU *(në rastet e importit të artikullit "Mishi dhe nënproduktet e tij")*, paraqitet shumë më i lartë se çmimi i po të njëjtëve artikuj të importuar nga EU;
- së dyti, në pikën 2.3 të Udhëzimit citohet *"Vlerat e mallrave te derguara zyrtarisht nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave si te dhena te disponueshrne etj",* ku nga verifikimi rezulton se çmimet e deklaruara dhe transaktuara të artikujve në sistemin ORACLE, krahasuar me çmimet e publikuara në faqen zyrtare të DPD dhe të miratuara nga komisioni Add-Hoc pranë Ministrisë së Financave, janë shumë të ulëta;
- së treti, në pikën 2.4 të Udhëzimit citohet *"Vlera e produktit nuk mund te jete me e ulet se vlera e lendes se pare me te,cilen eshte prodhuar",* ku nga verifikimi rezulton se çmimet e deklaruara dhe transaktuara të artikujve në sistemin ORACLE, në disa raste janë nën çmimin e lëndës së parë, *(në rastin e importit të artikujve të kapitullit *39* dhe kapitullit *84* të NKM)*, si dhe vlera doganore/kg në inkotermin CIF e produkteve të mishit rezulton më e ulët se vlera CIF/kg e plehut organik *(në rastet e importit të artikullit "Mishi dhe nënproduktet e tij")*;
- së katërti, në pikën 2.4 të Udhëzimit citohet *"Vendi i origjines me risk: Azise, Lindjes se Larget, Vendeve Arabe, Zonave te Lira (zona off-shore), Amerika Latine",* ku nga verifikimi rezulton se janë trajtuar me transaksion mallrat e importuar nga këto vende, të cilat përcaktohen me rrisk të lartë me të cilat administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi, si dhe në shumë raste transaksionet janë kryer në zonat e lira ose off-shore;
- së pesti, në pikën 2.8 të Udhëzimit citohet *"fatura nuk është lëshuar nga prodhuesi",* rezulton se nga verifikimi, transaksioni është kryer në "zona të lira ose off-shore". Dokumentacioni shoqërues i mallit është lëshuar nga kompania ose vendi prodhues (çertifikatë veterinare, deklaratë eksporti ose EUR.1, CMR), ndërsa fatura është lëshuar nga kompani me seli të ndryshme nga vendi i origjinës dhe dërgues i mallit;
- së gjashti, në pikën 2.9 të Udhëzimit citohet *"Vendi i origjines ndryshon nga vendi nga ku transportohet malli",* rezulton se, nga verifikimi, vend i origjinës së mallrave të importuara ndryshon nga vend i transportit apo firma shitëse;

- së shtati, në pikën 2.10 të Udhëzimit citohet *"Marresi i mallit ka historik shkeljesh",* rezulton se, nga verifikimi, shumë subjekte për të njëjtën natyrë malli, nga autoriteti doganor janë penalizuar me vendime administrative për detyrimet doganore shtesë;
- së teti, në pikën 2.22 të Udhëzimit citohet *"Kontrata me firmën shitëse",* rezulton se, nga verifikimi, për importet nuk rezulton kontratë bashkëngjitur praktikave doganore me firmën shitëse;
- së nënti, në pikën 2.24 të Udhëzimit citohet *"faturë e sigurimit të mallit",* rezulton se, nga verifikimi, bashkëlidhur praktikave doganore nuk rezulton fatura e pagesës së sigurimit të mallit apo dokument shtesë për të treguar kushtet e lëvrimit të mallit;
- së dhjeti, në pikën 2.25 të Udhëzimit citohet *"Dokumentacione të tjera shtesë që lidhen me sasinë, vlerën, origjinën, transportin, magazinimin, transitimin, mënyrën e pagesës, dokumente justifikuese të kushteve të livrimit të mallit. Për shembull në rastet e deklarimit të kushtit CIF, mund të kërkohen faturat e pagesave për transport dhe siguracion malli",* rezulton se, nga verifikimi, nuk rezulton të kemi bashkëlidhur praktikave doganore fatura për transport në rastin e kushtit CPT, CIF, apo fatura mbi siguracionin e mallit;
- së njëmbëdhjeti, në asnjë rast nuk është bërë asnjë investigim lidhur me verifikimin e faturave të deklaruara apo verifikim aposterior nga grup i përbashkët lidhur me cmimin e produkteve në treg;

2. Indikatorëve të përcaktuar në pikën 7 të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, **nuk është bërë një profilizimim i riskut** në vlerësimin doganor për të evidentuar një shqyrtim më të thelluar të vlerës doganore, sepse:
- së pari, Konstatohet një ndryshim i dukshëm midis vlerës së deklaruar dhe çmimeve të Database-it Kombëtar të Vlerësimit apo të të dhënave të disponueshme për artikujt që përditësohen nga bursat apo agjenci ndërkombëtare;
- së dyti, Konstatohen çmime të ndryshme të deklaruara për të njëjtin produkt, nga furnizues/origjina të njëjta/ ngjashme;
- së treti, Konstatohen si vend i origjinës/lëvrimit me risk: Azisë, Lindjes së Largët, vendeve arabe, zonave të lira (zona off-shore), Amerika Latine;
- së katërti, Vendi i origjinës ndryshon nga vendi nga ku transportohet/lëvrohet malli;
- së pesti, Konstatohet se përmbajtja e faturave nga i njëjti furnizues paraqet luhatje jo të zakonshme;
- së gjashti, Konstatohet se mallrat vijnë nga një vend pa marrëveshje të asistencës reciproke me vendin tonë ose nga ku është e vështirë për të marrë informacion;
- së shtati, Konstatohet se ekziston një ndryshim i dukshëm midis çmimit të deklaruar me çmimet nga publikime në tregje të ndryshme;
- së teti, Konstatohet se vlera e produktit është më e ulët se vlera e lëndës së parë me të cilën është prodhuar *(në rastin e importit të artikujve të kapitullit *39* dhe kapitullit *84* të NKM)*, si dhe vlera doganore/kg në inkotermin CIF e produkteve të mishit rezulton më e ulët se vlera CIF/kg e plehut organik *(në rastet e importit të artikullit "Mishi dhe nënproduktet e tij")*.
Pra, **si konkluzion**, lidhur me vlerësimin doganor, nga **Sektori i Vlerësimit në Qendër, si dhe Sektori i Kontrollit Aposterior Operativ (SKAO),** pranë DPD, nuk janë ndjekur hapa pas hapi metodat e vlerësimit doganor lidhur me mallrat e importuar në Republikën e Shqipërisë sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi lidhur me vlerësimin e mallrave në zbatim të neneve 65-71 të Kodit të ri Doganor.

Konkretisht:

♦ Në lidhje me importin dhe deklarimin e artikullit *"Patate"*, deklaruar në kodin tarifor *07019050* të NKM, me origjinë Egjipt, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në

përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit të Ri Doganor pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëjti artikull nga e njëjta origjinë në sistemin doganor është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me çmimin 0.42 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-8506, datë 18.06.2018).* Referuar deklarimeve, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëti artikull nga e njëjta origjinë është deklaruar dhe transaktuar me çmimin 0.42 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-8531, datë 19.06.2018).*

♦ Në lidhje me importin dhe deklarimin e artikullit *"Fasule e bardhë"*, deklaruar në kodin tarifor *07133390* të NKM, me origjinë NEU (Argjentinë), në kushtet e lëvrimit CIF, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit të Ri Doganor pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëjti artikull nga e njëjta origjinë në sistemin doganor është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me çmimin 1.1 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB, ndërsa transporti me 2200 $, *(mjaft të citojmë DAV me R-715, datë 05.01.2018; R-3015, datë 16.01.2018 etj).* Referuar deklarimeve, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëti artikull nga e njëjta origjinë është deklaruar dhe transaktuar me çmimin mbi 1.1 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-57216, datë 20.06.2018; R-104408, datë 31.10.2018).* Gjithashtu për të njëjtin artikull me origjinë NEU (Egjipt), është bërë rivlerësim sipas metodës 6 të vlerësimit.

♦ Në lidhje me importin dhe deklarimin e artikullit *"Thjerza"*, deklaruar në kodin tarifor *07134000* të NKM, me origjinë NEU (Kanada), në kushtet e lëvrimit CIF, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit të Ri Doganor pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëjti artikull nga e njëjta origjinë në sistemin doganor është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me çmimin 0.8 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB, ndërsa transporti me 1950 $, *(mjaft të citojmë DAV me R-1402, datë 03.02.2018; R-4120, datë 19.06.2018; R-11700, datë 23.08.2018, etj).* Referuar deklarimeve, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëti artikull nga e njëjta origjinë është deklaruar dhe transaktuar me çmimin mbi 1.1 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-8569, datë 02.02.2018; R-16449, datë 22.11.2018).*

♦ Në lidhje me importin dhe deklarimin e artikullit *"Gështenja"*, deklaruar në kodin tarifor *08024100* të NKM, me origjinë NEU (Kinë), në kushtet e lëvrimit FOB, praktika doganore me R-16651, datë 08.11.2018, është trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit të Ri Doganor pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëjti artikull nga e njëjta origjinë në sistemin doganor është rivlerësuar sipas metodës 2 të vlerësimit me çmimin 0.5 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-1199, datë 30.01.2018; R-14580, datë 15.12.2018; R-15026, datë 22.12.2018, etj).* Referuar deklarimeve, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëti artikull nga e njëjta origjinë është deklaruar dhe transaktuar me çmimin 0.5 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-11097, datë 16.11.2018; R-18045, datë 05.12.2018).*

♦ Në lidhje me importin dhe deklarimin e artikullit *"Piper i zi/bardhë"*, deklaruar në kodin tarifor *09041200* të NKM, me origjinë NEU *(Vietnam, Brazil, Ekuador, Kinë & Indonezi, vende me të cilat administrata doganore nuk ka marëveshje bashkëpunimi)*, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit të Ri Doganor pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëjti artikull nga e njëjta origjinë në sistemin doganor është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me çmimin 6.5 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-8845, datë 25.06.2018; R-79821, datë 22.08.2018; R-14269, datë 28.09.2018, etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Peshk ton i konservuar"*, deklaruar në kodin tarifor *16041421* të NKM, me origjinë NEU *(Tajlandë, Kinë dhe Vietnam)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SVQ, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull me origjinë nga NEU *(vende me të cilat administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO & SVQ, artikulli është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 3.6 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë praktikat e përpunuara për vitin 2018, citojmë DAV me: R-52254, datë 07.06.2018; R-71280, datë 27.07.2018; R-82156, datë 30.08.2018; R-108484, datë 12.11.2018; R-79863, datë 22.08.2018, etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Gaz ftohës R134A"*, deklaruar në kodin tarifor *29033919* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë dhe Emiratet Arabe)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull me origjinë nga NEU *(vende me të cilat administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO & SVQ, artikulli është rivlerësuar sipas metodës 3 të vlerësimit me 470 lekë/kg (vlerë statistikore CIF, referuar vendimit administrativ nr. nr. 1322, datë 01.11.2018 ku artikullit i shtohen detyrime doganore në masën 264,416 lekë, *(mjaft të citojmë praktikat e përpunuara për vitin 2018, citojmë DAV me: R-84836, datë 08.09.2018; R-833, datë 02.02.2018; R-81850, datë 29.08.2018, etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Pastë dhëmbësh"*, deklaruar në kodin tarifor *33061000* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë)*, me nivel të taksës doganore 6 % konstatohet se disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull me origjinë nga NEU *(vend me të cilin administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO & SVQ, artikulli është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 4.6 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-1324, datë 20.02.2018).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Tub uji plastik"*, deklaruar në kodin tarifor *39173900* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë)*, me nivel të taksës doganore 6 % konstatohet se disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull me origjinë nga NEU *(vend me të cilin administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SVQ, artikulli është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 1.9 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-4159, datë 11.04.2018; R-5232, datë 22.06.2018).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Mbulesa dyshemeje (lionoleum) PVC"*, deklaruar në kodin tarifor *39181090* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë & Indi)*, me nivel të taksës doganore 6 % konstatohet se disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion edhe pse ***artikulli i importuar dhe deklaruar në këto praktika doganore është transaktuar nën nivelin e çmimit të lëndës së parë ku PVC është 730 $/ton,*** veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor. Veprimet e sipërcituara janë jo në përputhje të përcaktimeve të kërkesave të pikës 2.4 të Udhëzimit 25, datë

30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme...",* ku **citohet** se: *"Vlera e produktit nuk mund te jete me e ulet se vlera e lendes se pare me te,cilen eshte prodhuar",* ndryshuar me pikën 7 të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* ku **citohet** se: *"Vlera e produktit është më e ulët se vlera e lëndës së parë me të cilën është prodhuar"*, ndaj artikulli duhej rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me minimumin 730 $/ton në kushtet e lëvrimit FOB.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikujve plastikë ku si njësi kanë deklarimin në copë*"Kapak ŴC, pjata dushi, mekanizma shkarkimi, kuti, kanistra, etj"*, deklaruar në kodin tarifor me kre *3922*, *3923*, *3924*, *3925* & *3926* të NKM *(në njësinë copë)*, me origjinë NEU (Kinë), me nivel të taksës doganore 6 %, konstatohet se disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit të Ri Doganor, pasi referuar importeve të artikujve nga e njëjta origjinë, rezultojnë të rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 2.3 $/kg, në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me R-5421, datë 24.01.2018, R-11856, datë 13.02.2018, R-65979, datë 13.07.2018, R-81427, datë 28.08.2018, R-125030, datë 24.12.2018, etj.).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Dyer të brendshme komplet"*, deklaruar në kodin tarifor me kre *4418* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe i rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 100 $/copë në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-15668, datë 23.10.2018; R-82615, datë 31.08.2018, etj.).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Fletore shkrimi"*, deklaruar në kodin tarifor me kre *4820* të NKM, me origjinë NEU *(Indonezi & Kinë, vende me të cilat administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe i rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 0.85 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-8445, datë 02.02.2018, etj.).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Tapet leshi i bërë me dorë"*, deklaruar në kodin tarifor *57011090* të NKM, me origjinë NEU *(Indi)*, me nivel të taksës doganore 10 %, praktika doganore me R-110107, datë 16.11.2018, është trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, me origjinë NEU, rezulton i deklaruar me çmim mbi 10 €/m^2, ndaj artikulli duhej rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 10 €/m^2 në kushtet e lëvrimit FOB.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Tapet i thurur"*, deklaruar në kodin tarifor *57024200* të NKM, me origjinë NEU *(Egjypt)*, me nivel të taksës doganore 10 %, praktika doganore me R-19957, datë 09.03.2018, është trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, me origjinë NEU, rezulton i rivlerësuar sipas metodës 6 të

vlerësimit me 4.5 €/m^2 në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me R-68249, datë 19.07.2018; R-104919, datë 02.11.2018, etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Kanavacë për printim"*, deklaruar në kodin tarifor *59011000* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, praktika doganore me R-81002, datë 27.08.2018, është trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 2.96 \$/m^2 në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-57628, datë 21.06.2018, përpunuar në të njëjtën degë doganore).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Inkelit"*, deklaruar në kodin tarifor *59032090* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, praktika doganore me R-3248, datë 29.05.2018, është trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 1.5 €/ml në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-5420, datë 24.01.2018, etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Pëlhurë mikrofibër"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor të kapitullit *60* të NKM, me origjinë NEU, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në Urdhërin nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që *"Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore* ***të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme****, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave* ***dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.****"* Për sa më sipër, nga SVQ dhe SKAO, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit përkatësisht me 450 lekë/kg në kushtet e lëvrimit CIF, sipas urdhrit të sipërcituar.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Veshmbathje"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor të kapitujve *61* dhe *62* të NKM, me origjinë NEU, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në Urdhërin nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që *"Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore* ***të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme****, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave* ***dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.****"* Për sa më sipër, nga SVQ dhe SKAO, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga

sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit përkatësisht me 1350 lekë/kg në kushtet e lëvrimit CIF, sipas urdhrit të sipërcituar.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Batanije"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *6301* të NKM, me origjinë NEU, *(Kinë & Indi, vende me të cilat administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 10 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në Urdhërin nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që *"Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore **të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme**, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave **dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.**"* Për sa më sipër, nga SVQ dhe SKAO, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit përkatësisht me 550 lekë/kg në kushtet e lëvrimit CIF, sipas urdhrit të sipërcituar.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Perde"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *6303* të NKM, me origjinë NEU, *(Kinë, vend me të cilin administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 10 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në Urdhërin nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që *"Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore **të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme**, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave **dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.**"* Për sa më sipër, nga SVQ dhe SKAO, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit përkatësisht me 1000 lekë/kg në kushtet e lëvrimit CIF, sipas urdhrit të sipërcituar.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Hidrosanitare"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor *69109000* të NKM, me origjinë NEU, Kinë, Indi dhe Tunizi *(vende me të cilat administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 15 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në Urdhërin nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që *"Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore **të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme**, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave **dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.**"* Për sa më sipër, nga SVQ dhe SKAO, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a

dhe 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit përkatësisht me 125 lekë/kg (nga Kina) dhe 150 lekë/kg (nga India dhe Tunizia) në kushtet e lëvrimit CIF, sipas urdhrit të sipërcituar.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Imitacione bizhuterish"*, deklaruar në kodin tarifor *71179000* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 15 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe i rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 12 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me R-31347, datë 12.04.2018; R-27914, datë 31.03.2018; R-51555, datë 05.06.2018; R-117963, datë 06.12.2018, etj.).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Lëndë e parë për prodhim duralumini"*, deklaruar në kodin tarifor *76012020* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme, ndaj duhej rivlerësuar sipas metodës 2 dhe 3 të vlerësimit me 2.5 $/kg në kushtet e lëvrimit CIF *(citojmë DAV me R-8051 & R-8099, datë 01.02.2018; R-7579 & R-7759, datë 31.01.2018, në D.D. Tiranë, ku subjekti importues ka aktivitetin kryesor, si dhe gjithë praktikat e tjera).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Profile duralumini të lyera"*, deklaruar në kodin tarifor *76041090* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe i rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 3 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Krisaf alumini"*, deklaruar në kodin tarifor *76071119* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 3 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB *(citojmë DAV me: R-26489, datë 28.03.2018; R-63229, datë 06.07.2018; R-101013, datë 23.10.2018; R-39545, datë 05.05.2018; etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Artikuj kuzhine prej alumini"*, deklaruar në kodin tarifor *76151080* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të

vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 3.7 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Makina qepëse industriale"*, deklaruar në kodin tarifor *84522900* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, praktika doganore me R-6771, datë 29.01.2018, është trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 480 €/copë në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-6677, datë 29.01.2018 të përpunuar në të njëjtën degë doganore).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Kuzhineta të ndryshme"*, deklaruar në kodin tarifor me kre *8482* dhe *8483* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 6 $/kg në kushtet e lëvrimit FOB.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Mobilje"*, deklaruar dhe klasifikuar në kapitullin *94* deri në kreun *9403* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në Urdhërin nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që *"Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore* ***të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme****, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave* ***dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.****"* Për sa më sipër, nga SVQ dhe SKAO, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a dhe 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 180 lekë/kg në kushtet e lëvrimit CIF sipas urdhrit të sipërcituar.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Skelete syzesh"*, deklaruar në kodin tarifor *90031900* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 2 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 13 $/copë në kushtet e lëvrimit FOB *(citojmë DAV me: R-7437, datë 29.03.2018; R-8019, datë 05.04.2018; R-6297, datë 27.01.2018; R-91784, datë 03.09.2018; R-81417, datë 28.08.2018; etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Veshje këmbe"*, deklaruar në kapitullin *64* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 10 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në Urdhërin nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që *"Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore **të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme**, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave **dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.**"* Për sa më sipër, nga SVQ dhe SKAO, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a dhe 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 1000 lekë/kg në kushtet e lëvrimit CIF sipas urdhrit të sipërcituar.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Veshje këmbe plastike dhe gome"*, deklaruar në kapitullin *64* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 15 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, si dhe jo në përputhje me përcaktimet në Urdhërin nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që *"Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore **të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme**, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave **dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.**"* Për sa më sipër, nga SVQ dhe SKAO, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a dhe 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 600 lekë/kg në kushtet e lëvrimit CIF sipas urdhrit të sipërcituar.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Doreza pune"*, deklaruar në kodin tarifor *61169900* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a dhe 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 2 dhe 3 të vlerësimit me 650 lekë/kg në kushtet e lëvrimit CIF *(citojmë DAV me: R-4951, datë 16.01.2018; R-16572, datë 27.02.2018; R-27418, datë 30.03.2018; R-62249, datë 04.07.2018; R-125727, datë 26.12.2018; etj. Gjithashtu nga verifikimet rezulton se po i njëjti artikull është rivlerësuar me 0.8 €/palë në kushtet e lëvrimit FOB, citojmë DAV me R-99005, datë 17.10.2018; R-100222, datë 20.10.2018).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Lëndë druri e sharruar"*, deklaruar në kodin tarifor *44071190* të NKM, me origjinë NEU *(Ukrainë)*, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a

dhe 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 120 €/m^3 në kushtet e lëvrimit FOB ndërsa transporti është rivlerësuar me 2570 € *(citojmë DAV me R-114092, datë 27.11.2018; R-100011, datë 20.10.2018; R-22876, datë 01.10.2018; R-23507, datë 08.10.2018; etj.).* Referuar importeve të të njëjtit produkt po me origjinë nga NEU *(Rusia),* nga verifikimi në sistemin ORACLE, produkti është deklaruar dhe transaktuar me 230 – 240 €/m^3, në kushtet e lëvrimit CIF.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Ndriçuesa & abazhurë"*, deklaruar në kodin tarifor me kre *9405* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi),* me nivel të taksës doganore 15 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 2.9 €/kg nga NEU në kushtet e lëvrimit FOB.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Zbukurime festive"*, deklaruar në kodin tarifor me kre *9505* të NKM, me origjinë NEU *(Kinë, vend me të cilin administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi),* me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 4.5 €/kg nga NEU në kushtet e lëvrimit FOB.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Tubo bakri"*, deklaruar në kodin tarifor *74111090* të NKM, me origjinë EU & NEU, me nivel të taksës doganore 0 %, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion pa u kryer një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a dhe 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull, nga e njëjta origjinë, nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues rezulton i deklaruar me çmime të ndryshme dhe se nga sektori i vlerës është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 8.4 €/kg nga EU, ndërsa nga NEU është rivlerësuar me 7.8 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB dhe 3300 $/kontenier 40' *(citojmë DAV me R-556, datë 05.01.2018; R-20633, datë 12.03.2018; R-40068, datë 07.05.2018; R-63175, datë 06.07.2018; R-77321, datë 13.08.2018, e shumë të tjera.)*

♦ ***Në lidhje me deklarimet e artikullit*** *"Sheqer i bardhë",* deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor *17019910* të NKM me origjinë EU, trajtuar me MSABE me nivel të taksës doganore 0 %, rezultoi se nga sektori i operacioneve doganore, si dhe SVQ, lidhur me vlerësimin doganor me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e pikave 6, 7, 8 dhe 15.1 shkronja "c", të Udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të Ministrit të Financave "*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*" në shkelje të neneve 70.3 të KD, pasi artikulli është i kuotuar në bursën ***"Thomson Reuters"***. Pothuajse gjithë praktikat doganore të deklaruara për vitin 2018 janë trajtuar sipas të dhënave të kësaj burse ndërsa ato që pasqyrohen në material janë trajtuar me transaksion.

♦ ***Në lidhje me deklarimet e artikullit*** *"Grurë",* deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *1001* të NKM me origjinë EU dhe NEU, rezultoi se nga sektori i operacioneve doganore, si dhe SVQ, lidhur me vlerësimin doganor me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së

mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e pikave 6, 7, 8 dhe 15.1 shkronja "c", të Udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të Ministrit të Financave "*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*" në shkelje të neneve 70.3 të KD, pasi artikulli është i kuotuar në bursën ***"Reuters"***. Pothuajse gjithë praktikat doganore të deklaruara për vitin 2018 janë trajtuar sipas të dhënave të kësaj burse ndërsa ato që pasqyrohen në material janë trajtuar me transaksion ose me ndërhyrje por jo në masën e duhur sipas të dhënave të publikuara në bursë.

♦ ***Në lidhje me deklarimet e artikullit*** *"Misër",* deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *1005* të NKM me origjinë NEU, rezultoi se nga sektori i operacioneve doganore, si dhe SVQ, lidhur me vlerësimin doganor me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e pikave 6, 7, 8 dhe 15.1 shkronja "c", të Udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të Ministrit të Financave "*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*" në shkelje të neneve 70.3 të KD, pasi artikulli është i kuotuar në bursën ***"Reuters"***. Pothuajse gjithë praktikat doganore të deklaruara për vitin 2018 janë trajtuar sipas të dhënave të kësaj burse ndërsa ato që pasqyrohen në material janë trajtuar me transaksion ose me ndërhyrje por jo në masën e duhur sipas të dhënave të publikuara në bursë.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Patate të prera, të ngrira",* deklaruar në kodin tarifor *20041010* të NKM, nga SVQ disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, ndërsa për disa të tjera është bërë ndërhyrje po jo në masën e duhur, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi:

- ***së pari,*** rezultojnë praktika doganore ku artikulli i importuar nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues është deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme, ku rezultojnë me çmim të deklaruar dhe transaktuar mbi çmimete e publikuara në dosjen e të dhënave të disponueshme në kushtet e lëvrimit EXŴ, *(citojmë DAV me: R-25096, datë 24.03.2018; R-5984, datë 26.01.2018, etj)*;
- ***së dyti,*** artikulli nga e njëjta origjinë nga EU, eksportuar nga i njëjti subjekt eksportues, për të njëjtin subjekt importues është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 0.6 €/kg, ndërsa transporti me 2600 €, *(vendimi administrativ nr. 126, datë 15.11.2018, për DAV me R-10982, datë 07.08.2018 dhe R-15106, datë 15.10.2018 DD Elbasan);*
- ***së treti,*** referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull me origjinë EU, eksportuar nga i njëjti subjekt eksportues, për të njëjtin subjekt importues është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 0.6 €/kg, në kushtet e lëvrimit FOB *(citojmë DAV me: R-3292, datë 30.10.2018; R-178, datë 19.01.2018; R-11664, datë 19.11.2018; etj.).*

♦ ***Në lidhje me deklarimet e artikullit*** *"Oriz",* deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *1006* të NKM me origjinë EU dhe NEU, trajtuar me MSABE me nivel të taksës doganore përkatësisht 0 % dhe 2 %, lidhur me vlerësimin doganor me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e pikave 6, 7, 8 dhe 15.1 shkronja "c", të Udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të Ministrit të Financave "*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*" në shkelje të neneve 70.3 të KD, pasi artikulli është i kuotuar në bursën ***"Thomson Reuters"***. Pothuajse gjithë praktikat doganore të deklaruara për vitin 2018 janë trajtuar sipas të dhënave të kësaj burse, ndërsa ato që pasqyrohen në material janë trajtuar me transaksion.

♦ ***Në lidhje me importet e artikujve të deklaruar sipas kodeve tarifore të kapitullit *02* të NKM "****Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit",* me origjinë EU dhe NEU, rezultoi se pranimi i transaksionit nuk ka qënë i justifikuar sepse nuk janë ndjekur hapa pas hapi metodat e vlerësimit

doganor lidhur me mallrat e importuar në Republikën e Shqipërisë sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi lidhur me vlerësimin e mallrave dhe transportin sipas kërkesave të neneve 65-71 të Kodit të ri Doganor, ***pasi:***

- *së pari,* nga verifikimi në sistemin ORACLE, rezulton se çmimi për të njëjtin produkt, nga e njëjta origjinë, nga i njëjti eksportues (furnizues), për të njëjtin importues paraqitet i ndryshëm, dhe se, çmimi për të njëjtin artikull nga NEU *(Turqi, Brazil, Uruguaj),* paraqitet shumë më i lartë se çmimi i po të njëjtëve artikuj me origjinë nga EU, si dhe NEU *(Amerikë & Kanada)*;

- *së dyti,* nga verifikimi konstatohet një ndryshim i dukshëm *(çmime shumë të ulëta)* midis çmimit të deklaruar dhe transaktuar, *(citojmë DAV me: R-24457, datë 23.03.2018; R-82255, datë 30.08.2018; R-106818, datë 07.11.2018; R-78054, datë 15.08.2018; R-93575, datë 02.10.2018; etj, ku çmimi i transaktuar është 0.22 – 0.41 €/kg),* si dhe çmimeve të të dhënave të disponueshme të publikuara në faqen zyrtare të DPD dhe të miratuara nga komisioni Add-Hoc pranë Ministrisë së Financave, madje nga verifikimi rezulton se çmimet e deklaruara dhe transaktuara të artikujve në sistemin ORACLE, rezultojnë edhe nën çmimin e plehut organik *(citojmë DAV me: R-1662, datë 08.01.2018; R-2982, datë 25.05.2018; R-16061, datë 30.10.2018; R-76072, datë 09.08.2018; R-13345, datë 22.11.2018; R-25698, datë 27.03.2018; R-74981, datë 09.07.2018, etj, ku çmimi i transaktuar është 0.3 – 0.41 €/kg).* Gjithashtu nga verifikimi në sistemin ORACLE rezulton se në vlerë statistikore (vlerë doganore, CIF) artikulli pastë pule, krahë pule dhe kofsha pule, tremix derri *(citojmë DAV me: R-24457, datë 23.03.2018; R-57178, datë 20.06.2018; R-82255, datë 30.08.2018; R-81445, datë 28.08.2018; R-15545, datë 23.02.2018, etj, ku vlera doganore e transaktuar është 42-66 lekë/kg),* vlera doganore e artikujve paraqitet shumë më ulët se vlera doganore e plehut organik, *(citojmë DAV me: R-25698, datë 27.03.2018; R-74981, datë 09.07.2018, etj, ku vlera doganore e transaktuar është 72-73 lekë/kg);*

- *së treti,* nga verifikimi në sistemin ORACLE, rezulton se çmimi për të njëjtin produkt *(mallrat identike apo të njëjtë),* nga e njëjta origjinë, nga i njëjti eksportues (furnizues), për të njëjtin importues paraqitet i ndryshëm, madje në shumë raste, konstatohet mbi në/mbi çmimin e të dhënave të disponueshme *(citojmë DAV me: R-12652, datë 09.11.2018; R-6736, datë 26.07.2018; R-10491, datë 31.07.2018; R-76006, datë 09.08.2018; R-13252, datë 22.12.2018; R-62589, datë 05.07.2018; R-85861, datë 12.09.2018; R-2806, datë 16.01.2018, R-24539, datë 23.03.2018, por jo vetëm, për çdo artikull të pasqyruar në material verifikuar nga sistemi ORACLE, rezultojnë çmime të deklaruara dhe të transaktuara mbi çmimin e publikuar në dosjen e të dhënave të disponueshme).*

- *së katërti,* nga verifikimi në sistemin ORACLE, rezulton se kemi import të artikujve nga vende të cilësuara me risk *(zonat e lira off-shore)* në të cilat është kryer edhe transaksioni, për mallrat me origjinë nga Amerika ose Kanada;

- *së pesti,* nga verifikimi në sistemin ORACLE, rezulton se kemi import të artikujve ku fatura nuk është lëshuar nga prodhuesi dhe se vendi i origjinës ndryshon nga vendi ku eksportohet produkti.

Si konkluzion, praktikat doganore me deklarimet e artikujve të kapitullit *02* të NKM, janë trajtuar me transaksion, apo në shumë pak raste me ndërhyrje sipas metodës 2 apo 3 të vlerësimit por jo në masën e duhur, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave 65-71 të Kodit Doganor pasi për artikujt e importuar nuk është bërë një **analizë** e thelluar, referuar pikës 1, sipas indikatorëve të përcaktuar në pikën 2 të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme...",* ndryshuar me pikën 7 të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, ku ka rezultuar se **nuk është bërë një profilizimin i riskut** në vlerësimin doganor mbi të cilën duhej të mbështetej kjo **analizë**.

♦ ***Lidhur me importet dhe deklarimet e artikujve:*** "*Pirun, ekskavator & makineri të ndryshme të përdorura*" deklaruar në kapitullin *84* të NKM me nivel të taksës doganore 0 %, nga sektori i vlerës nuk është bërë një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikujve sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a, të Kodit të Ri Doganor, pasi, referuar importeve dhe deklarimeve të këtyre artikujve, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se ato janë rivlerësuar sipas metodës 2 & 5 të vlerësimit me mbi 0.7 €/kg - 0.85 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-2501, datë 20.03.2017; R-13147, datë 18.10.2017; R-2889, datë 27.03.2017; R-7325, datë 23.06.2017; R- 2025, datë 22.02.2018; R-3974, datë 07.04.2018; R-3249, datë 03.04.2017; R-815, datë 12.02.2018; R-20984, datë 13.03.2018; R-4446, datë 16.04.2018; R-5845, datë 11.05.2018, R-9482, datë 13.07.2018; R-9909, datë 20.07.2018; R-108406, datë 18.10.2018; 132053, datë 17.12.2018, por jo vetëm, si dhe për rivlerësim të së njëjtës natyrë të konstatuar, Autoriteti Doganor i DD. Elbasan ka dalë me vendim administrativ nr. 81, datë 14.06.2017 për praktika doganore të përpunuara më parë).* Nisur nga sa më sipër, artikujt e përdorur të kapitujve të sipërcituar të pasqyruar në material duheshin rivlerësuar jo më pak se 0.7 €/kg. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore të këtyre artikujve konstatohet se edhe pse artikujt janë deklaruar nën çmimin e skrapit të publikuar te bursa "Metal Buletin", janë trajtuar me transaksion *(citojmë DAV me R-4003, datë 07.04.2018, etj).* Konstatohet se nuk është ngritur komisioni vlere për rivlerësimin e artikujve të cilët nuk gjenden te *"Dosja e të dhënave të disponueshme"*, veprim ky, jo në përputhje të kërkesave të pikës 5.2 të Sesionit I, të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007, *"Mbi procedurat e shqyrtimit te Vleres Doganore",* ndryshuar me pikën 10, shkronja "h" të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018, *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga sektorët e sipërcituar është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a, të Kodit të Ri Doganor**.**

♦ ***Në lidhje me deklarimet e artikujve****, "Hekur ndërtimi, llamarinë inox 304, llamarinë e galvanizuar etj"* të deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor të kapitujeve *72* të NKM rezultoi se, lidhur me vlerësimin doganor, me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, nuk është bërë një analizë e thelluar, referuar pikës 1, sipas indikatorëve të përcaktuar në pikën 2 të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme...",* ndryshuar me pikat 6, 7, 8 dhe 15.1 shkronja "c", të Udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të Ministrit të Financave "*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*".mbi të cilën duhej të mbështetej kjo analizë, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 66-70 të KD, pasi:

- *së pari,* artikujt e klasifikuara në këtë kapitull të NKM janë artikuj ose të kuotuar në bursën "Metal Bulletin", ose artikuj që rrjedhin nga përpunimi i mëtejshëm i artikujve (metaleve) të kuotuar në bursën e sipërcituar;

- *së dyti,* për artikujt që nuk kanë çmime të publikuara në bursë, nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e shënimeve referuar shkresave të publikimit të të dhënave, ku citojmë: *"Për artikujt që në tabelën e mësipërme nuk publikohen çmime, të ruhen raporte në % -je që kanë pasur ndaj zërit "hekur ndërtimi" në publikimin më të fundit të tyre"*.

Konstatimet e mësipërme, ***për 3503 raste, me vlerë 283,263,967 lekë të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit,*** *evidentohet më konkretisht në aneksin nr. 3 të Projektraportit të Auditimit.*

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga ana e nëpunësve: z. A. H. me detyrë përgjegjës sektori SKAO; z. H. E. me detyrë përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë; z. F. Gj. me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i sektorit regjime në DD. Durrës; z. A. V. dhe z. I. P. me me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Durrës; z. H. L. dhe z. M. B. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i terminalit të kontenierëve në

DD. Durrës; z. E. Sh., z. D. M. dhe z. A. Zhupa me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Kakavie; z. N. H. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Shkodër, z. K. V. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Vlorë; zj. E. Sh. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Korçë; z. A. L.; z. A. Bicprendi dhe z. P. T., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës zyre në SVQ, pranë DPD; z. V. N. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Korçë; zj. A. A. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Korçë; z. J. M., zj. O. H.; z. J. K.; zj. A. Ç., me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Durrës; z. N. H. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Tiranë; zj. A. D. me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/përjashtime, pranë DD. Shkodër; zj. R. K., zj. L. K., z. D. P. me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/përjashtime, pranë DD. Durrës; z. A. Sh., z. A. Sh., zj. L. B., z. E. D., zj. M. Z., zj. O. V., zj. E. B., zj. E. Ç., z. A. K., z. A. N., z. K. B., z. A. B., zj. K. Xh., zj. L. D., z. A. V., z. F. S., z. E. S., z. Sh. S., z. A. D., z. E. N., zj. S. D., z. R. D., zj. A. H., z. B. N., z. G. U., z. E. P., z. R. B., z. I. M., z. E. H., zj. G. G., z. E. B., zj. E. G., z. R. M. dhe z. I. R., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ), pranë DPD, si dhe z. E. Th., z. I. M., z. P. R., zj. E. K., z. D. B., z. A. S., z. B. D., zj. M. Z., z. S. T., z. E. I., z. R. Sh., zj. I. B., z. E. Gj., z. R. M., zj. E. Sh., z. I. Ç. dhe z. A. D. me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD, është vepruar jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012; seksionit III, pika 1.5, shkronja "d" si dhe seksionit IV, pika 1.9, shkronja "d" të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD *"Mbi funksionimin e seksioneve të vlerës në qendër dhe aposteriorit operativ në DPD",* përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për zbatimin e kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me zhdoganimin e mallrave.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",* neni 67, pika 1, shkronja "d/i"; neni 70, pika 2, shkronja "a" dhe pika 3;

Udhëzimin 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..",* Sesioni I, pika 1, pika 2.

Udhëzimin nr. 3 datë 23.01.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "*Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore*", pika 6, 7, 8, 10 dhe 11.

Për 3503 raste, vlera prej 283,119,190 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. H. me detyrë përgjegjës sektori SKAO;
2. Z. H. E. me detyrë përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë;
3. Z. F. Gj. me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i sektorit regjime në DD. Durrës;
4. Z. A. V. dhe z. I. P. me me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës në terminalin e trageteve në DD. Durrës;
5. Z. H. L. dhe z. M. B. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i terminalit të kontenierëve në DD. Durrës;
6. Z. E. Sh., z. D. M. dhe z. A. Zh. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Kakavie;
7. Z. N. H. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Shkodër;
8. Z. K. V. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Vlorë;
9. Zj. E. Sh. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Korçë;

10. Z. A. L.; z. A. B. dhe z. P. T., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës zyre në SVQ, pranë DPD;
11. Z. V. N. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Korçë;
12. Zj. A. A. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Kakavie;
13. Z. J. M., zj. O. H.; z. J. K.; zj. A. Ç., me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Durrës;
14. Z. N. H. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Tiranë;
15. Zj. A. D. me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/përjashtime, pranë DD. Shkodër;
16. Zj. R. K., zj. L. K., z. D. P. me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/përjashtime, pranë DD. Durrës;
17. Z. A. Sh., z. A. Sh., zj. L. B., z. E. D., zj. M. Z., zj. O. V., zj. E. B., zj. E. Ç., z. A. K., z. A. N., z. K. B., z. A. B., zj. K. Xh., zj. L. D., z. A. V., z. F. S., z. E. S., z. Sh. S., z. A. D., z. E. N., zj. S. D., z. R. D., zj. A. H., z. B. N., z. G. U., z. E. P., z. R. B., z. I. M., z. E. H., zj. G. G., z. E. B., zj. E. G., z. R. M. dhe z. I. R., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ), pranë DPD;
18. Z. E. Th., z. I. M., z. P. R., zj. E. K., z. D. B., z. A. S., z. B. D., zj. M. Z., z. S. T., z. E. I., z. R. Sh., zj. I. B., z. E. Gj., z. R. M., zj. E. Sh., z. I. Ç. dhe z. A. D. me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD; nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra legjislacionin doganor lidhur me vlerësimin doganor të mallrave referuar kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..",* ndryshuar me pikën 7 dhe 8 të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* nxjerrë për këtë qëllim.

Shënim: *Lidhur me përgjegjësitë e punonjësve në përpunimin e deklaratave doganore të pasqyruara në material, të cilat rezultojnë me probleme, nga ana e strukturave përkatëse në DPD apo DD, të dalin përgjegjësitë pasi nga grupi i auditimit nuk u mundësua dot nxjerrja e gjithë personave përgjegjës për arsye kohe e cila ishte e limituar në raport me konstatimet.*

II. Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me klasifikimin tarifor të mallrave, përpunuar nga SVQ dhe SKAO pranë DPD.

Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit në lidhje me klasifikimin tarifor të mallrave gjatë proçedurave të zhdoganimit të cilat janë vlerësuar me rrisk në bazë të metodave të ekzaminimit kryq, rishikimit analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim teknikash: si shqyrtimi i dokumentave justifikuese dhe krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimi analitik (auditimi i vërtetësisë, rakordimet, krahasimet), konstatohet që:

Nga ana e: zj. G. G., z. I. R., zj. L. B., z. K. B., z. A. V., z. E. D., z. E. B., z. E. S., z. A. N., z. E. N., zj. O. V., zj. E. Ç., z. R. B., zj. L. D., zj. A. H., zj. S. D., z. A. Sh., zj. M. Z., z. A. Sh.i, z. A. K., z. A. D., z. I. M., z. F. S., zj. E. B., z. B. N., zj. E. G., z. Sh. S., zj. K. Xh., z. A. B., z. G. U., dhe, me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ); z. E. Th., z. R. Sh., z. A. S., zj. E. Sh., z. E. I., z. D. B., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në legjislacionin doganor lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave referuar kërkesave të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Referuar nenit 251, pika 2, shkronja "a", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

2. Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje me përgjegjësi objektive: a) mosrespektimi nga personi, që depoziton deklaratën doganore, ..., i detyrimit për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e informacioneve të dhëna në deklaratë, ..., në përputhje me shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 23

Referuar nenit 256, pika 1, shkronja "a", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

*a. kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, **lloj**) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 1-fish të detyrimit të munguar;*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 të artikujve të ndryshëm në kodet përkatëse tarifore të NKM u konstatua se: bazuar në të dhënat e sistemit ORACLE; në dokumentacionin bashkëlidhur praktikave doganore, në notat spjeguese të NKM, si dhe shfrytëzimit të të dhënave të internetit lidhur me mallrat e deklaruara, disa praktika doganore rezultojnë me keqklasifikim të kodit tarifor të artikujve të importuar me pasojë shamngien e detyrimeve doganore. Nga agjensitë doganore, SVQ, por dhe SKAO, artikujt janë keqklasifikuar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, në shkelje të nenit 250.1/a, 251.1 dhe 256.1/a të KD.

Konkretisht:

♦ ***Në lidhje me importin e artikullit*** *"Çadra për lokale me logo & çadra plazhi për ambiente publike"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor *66011000*, deklaruar dhe trajtuar me nivel të taksës doganore 10 %, rezultoi se artikulli është keqklasifikuar në kodin tarifor të sipërcituar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej deklaruar në kodin tarifor *66019100* të NKM me nivel të taksës doganore 15 % pasi referuar zhdoganimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, në gjithë degët e tjera doganore *(citojmë: DAV me R-44238, datë 26.04.2017; R-56676, datë 23.05.2017; R-65785, datë 12.06.2017 të D. D. Durrës, DAV me R-63151, datë 06.07.2018 të D.D. Tiranë)*, si dhe notave spjeguese të NKM, artikulli klasifikohet në KT *6601 91 00*, ***"– – Qe kane nje shtize teleskopike"*** me nivel të taksës doganore 15 %. Për rast analog Autoriteti Doganor i D. D. Durrës ka dalë me vendim administrativ nr. 456, datë 03.11.2017, nr. 17391 prot., datë 09.11.2017, por jo vetëm. Gjithashtu referuar çertifikatës së origjinës nr. 0507690, datë 11.05.2018 *(R-46988)*, apo faturës nr. 17GN1130-2, datë 12.12.2017 *(R-5276)*, bashkëlidhur praktikave doganore artikulli përshkruhet përkatësisht *"Parasol 3.5x3.5 m with logo..."* dhe *"Beach umbrellas for public places"*, ku referuar të dhënave të artikullit të nxjerrë në rrugë elektronike nga intërneti, artikulli paraqitet me nje shtizë teleskopike. Si rezultat i keqdeklarimit dhe keqklasifikimit nga agjencia doganore rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a dhe 256.1/a të Kodit të Ri Doganor.

♦ ***Në lidhje me importin e artikullit*** *"Lule dekorative plastike"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor *39264000* të NKM, deklaruar dhe trajtuar me nivel të taksës doganore 6 % *(DAV me R-4365, datë 22.06.2018 në DD. Durrës)*, rezultoi se artikulli është keqklasifikuar në kodin tarifor të sipërcituar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej të deklarohej në kodin tarifor me kre *67021000* të NKM me nivel të taksës doganore 15 % pasi referuar deklarimeve dhe zhdoganimeve të artikujve të sipërcituar, nxjerrë nga sistemi ORACLE, si dhe notave spjeguese të NKM, artikulli klasifikohen në kodin tarifor me kre *67021000* ku citohen artikujt *"**Lulet, kurorat dhe frutat artificial dhe pjeset e tyre; artikuj te bere nga lulet, kurorat apo frutat artificiale: – Prej plastike**"*, me nivel të taksës doganore 15 %. Si rezultat i keqdeklarimit dhe keqklasifikimit nga agjencia doganore rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a dhe 256.1/a të Kodit Doganor.

♦ ***Në lidhje me importin e artikullit*** *"Vizore & set vizore"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *9017* të NKM, trajtuar me nivel të taksës doganore 2 %, rezultoi se artikulli është keqklasifikuar në kodin tarifor të sipërcituar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej të deklaroheshin në kodin tarifor *39261000* të NKM me nivel të taksës doganore 6 % pasi: referuar deklarimeve dhe zhdoganimeve të artikujve të sipërcituar *(mjafton të citojmë në DD. Tiranë DAV me R-24778, datë 24.03.2018; R-76541, datë 10.08.2018; R-77047, datë 13.08.2018, etj)*; dokumentacionit elektronik të përshkrimit në faturë nxjerrë nga sistemi ORACLE dhe kërkimit në internet sipas përshkrimit në faturë të artikullit dhe kodit të tij, artikulli është prej plastike; si dhe notave spjeguese të NKM, artikulli për DAV-et e pasqyruara në material duhej të klasifikohej në kodin tarifor *392610000* të NKM me nivel të taksës doganore 6 %. Për rast analog të keqklasifikimit të artikullit, Autoriteti Doganor i DD. Durrës ka dalë me Vendim Administrativ nr. 635, datë 22.11.2017. Si rezultat i keqdeklarimit dhe keqklasifikimit nga agjencia doganore rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a dhe 256.1/a të Kodit Doganor.

♦ ***Në lidhje me importin e artikullit*** *"Letër depilimi"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor të kapitujve *48* dhe *56* të NKM, trajtuar me nivel të taksës doganore 0 %, rezultoi se artikulli është keqklasifikuar në kodin tarifor të sipërcituar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej deklaruar në kodin tarifor *39191012* të NKM me nivel të taksës doganore 6 % pasi: referuar zhdoganimeve të artikullit nxjerrë nga sistemi ORACLE artikulli është deklaruar në kodin e sipërcituar me nivel të taksës doganore 6 %, *(citojmë DAV me R-66024, datë 13.07.2018; R-84814, datë 08.09.2018)*, si dhe notave spjeguese të NKM, artikulli nuk është thjesht letër por i ngopur me adeziv ngjitës ndaj referuar notave spjeguese të NKM rezulton i deklaruar në KT *39191012* të NKM, me nivel të taksës doganore 6 %. Si rezultat i keqdeklarimit dhe keqklasifikimit nga agjencia doganore rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a dhe 256.1/a të Kodit të Ri Doganor.

♦ ***Në lidhje me importin e artikullit*** *"Monitorë LED & LCD"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor *85285210* të NKM, trajtuar me nivel të taksës doganore 0 %, rezultoi se artikujt janë keqklasifikuar në kodin tarifor të sipërcituar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej të deklaroheshin në kodin tarifor *85285291* të NKM me nivel të taksës doganore 2 % pasi: referuar deklarimeve dhe zhdoganimeve të artikujve të sipërcituar *(mjafton të citojmë: në D.D.Rinas DAV me R-30808, datë 06.12.2018; në DD. Tiranë R-81369, datë 28.08.2018; R-98031, datë 15.10.2018; R-107124, datë 08.11.2018, etj)*; dokumentacionit elektronik të përshkrimit në faturë nxjerrë nga sistemi ORACLE dhe kërkimit në internet sipas përshkrimit në faturë të artikullit dhe kodit të tij; si dhe notave spjeguese të NKM, artikujt e pasqyruar në material janë të teknologjisë LED & LCD, dhe si të tillë duhej të klasifikoheshin në kodin tarifor *85285291* të NKM me nivel të taksës doganore 2 %. Në DAV me R-99266, datë 24.09.2018, artikulli është klasifikuar saktë në kodin tarifor *85285291* të NKM, por është trajtuar me MSABE me nivel të taksës doganore 0 %. Referuar Invoice nr. 3018611512, datë 19.09.2018 (faqe 12), artikulli citohet ne emërtim "SAMSUNG LED MONITOR 49", 60 Hz E-LED BLU", country of origin Slovakia - **NO PREFERENTIAL ORIGIN**, pra si i tillë nuk duhej trajtuar me MSABE. Si rezultat i keqdeklarimit dhe keqklasifikimit nga agjencia doganore rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a dhe 256.1/a të Kodit Doganor.

♦ ***Në lidhje me importin e artikujve*** *"Shirit LED; ndricues dhe spote"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *8539*; *8541* dhe *8543* të NKM, deklaruar dhe trajtuar me nivel të taksës doganore 0 %, rezultoi se artikujt janë keqklasifikuar në kodin tarifor të sipërcituar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej të deklaroheshin në kodin tarifor me kre *9405* të NKM me nivel të taksës doganore 15 % pasi referuar deklarimeve dhe zhdoganimeve të artikujve të

sipërcituar, nxjerrë nga sistemi ORACLE, *(mjafton të citojmë: në D.D.Durrës DAV me R-7974, datë 23.01.2018; në DD. Tiranë R-48053, datë 26.05.2018; R-102963, datë 29.10.2018; R-121323, datë 15.12.2018, etj),* si dhe notave spjeguese të NKM, artikujt klasifikohen në kodin tarifor me kre *9405* me nivel të taksës doganore 15 %. Si rezultat i keqdeklarimit dhe keqklasifikimit nga agjencia doganore rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a dhe 256.1/a të Kodit Doganor.

♦ ***Në lidhje me importin e artikullit*** *"Komerdare plazhi"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *9503* të NKM, deklaruar dhe trajtuar me nivel të taksës doganore 0 % *(DAV me R-2222, datë 27.03.2018 në DD. Fier),* rezultoi se artikulli është keqklasifikuar në kodin tarifor të sipërcituar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej të deklarohej në kodin tarifor *95061900* të NKM me nivel të taksës doganore 15 % pasi referuar deklarimeve dhe zhdoganimeve të artikujve të sipërcituar, nxjerrë nga sistemi ORACLE, *(mjafton të citojmë në DD. Tiranë DAV me R-43400, datë 16.05.2018, etj),* si dhe notave spjeguese të NKM, artikujt klasifikohen në kodin tarifor me kre *9506*, ku futen artikujt për praktikimin e sporteve ujore, me nivel të taksës doganore 15 %. Si rezultat i keqdeklarimit dhe keqklasifikimit nga agjencia doganore rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a dhe 256.1/a të Kodit Doganor.

♦ ***Në lidhje me importin e artikullit*** *"Zinxhir me pllaka për ekskavatorë"*, deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *8431* të NKM, deklaruar dhe trajtuar me nivel të taksës doganore 0 %, rezultoi se artikulli është keqklasifikuar në kodin tarifor të sipërcituar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej deklaruar në kodin tarifor me kre *7315* të NKM me nivel të taksës doganore 15 % pasi referuar historikut të deklarimeve dhe zhdoganimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, *(mjafton të citojmë: në D.D.Durrës DAV me R-123708, datë 03.12.2016; R-151942, datë 18.12.2017; R-34875, datë 22.03.2018, në DD. Tiranë R-89124, datë 01.11.2016; R-89116, datë 21.09.2018; R-112554, datë 22.11.2018, etj),* si dhe notave spjeguese të NKM, artikulli klasifikohet në KT *73158100*, ***"– – Zinxhir me hallka pete ne terheqje"*** me nivel të taksës doganore 15 %. Si rezultat i keqdeklarimit dhe keqklasifikimit nga agjencia doganore rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a dhe 256.1/a të Kodit Doganor.

Konstatimi i mësipërm, ***për 190 raste, me vlerë 12,869,486 lekë efekt financiar në Buxhetin e Shtetit,*** *(nga të cilat 6,434,743 lekë detyrim doganor dhe 6,434,743 lekë penalitet), evidentohet më konkretisht në aneksin nr. 3.1 të Projektraportit të Auditimit.*

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësve: zj. G. G., z. I. R., zj. L. B., z. K. B., z. A. V., z. E. D., z. E. B., z. E. S., z. A. N., z. E. N., zj. O. V., zj. E. Ç., z. R. B., zj. L. D., zj. A. H., zj. S. D., z. A. Sh., zj. M. Z., z. A. Sh.i, z. A. K., z. A. D., z. I. M., z. F. S., zj. E. B., z. B. N., zj. E. G., z. Sh. S., zj. K. Xh., z. A. B., z. G. U., dhe, me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/ vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ); z. E. Th., z. R. Sh., z. A. S., zj. E. Sh., z. E. I., z. D. B., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në seksionin III, pika 1.5, shkronja "a", si dhe seksionin IV, pika 1.9, shkronja "a",të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD *"Mbi funksionimin e seksioneve të vlerës në qendër dhe aposteriorit operativ në DPD",* përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për zbatimin e kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*; neni 251, pika 2, shkronja "a"; neni 256, pika 1, shkronja "a".

Për 190 raste, vlera prej 12,869,486 lekë, e cila përfaqëson 6,434,743 lekë detyrim doganor të munguar dhe 6,434,743 lekë penalitet, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. zj. G. G., z. I. R., zj. L. B., z. K. B., z. A. V., z. E. D., z. E. B., z. E. S., z. A. N., z. E. N., zj. O. V., zj. E. Ç., z. R. B., zj. L. D., zj. A. H., zj. S. D., z. A. Sh., zj. M. Z., z. A. Sh.i, z. A. K., z. A. D., z. I. M., z. F. S., zj. E. B., z. B. N., zj. E. G., z. Sh. S., zj. K. Xh., z. A. B., z. G. U., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/ vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ);
2. z. E. Th., z. R. Sh., z. A. S., zj. E. Sh., z. E. I., z. D. B., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO);

III. Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me deklarimin e taksës së ambalazhit (TAM).

Nga ana e: z. A. H. me detyrë përgjegjës sektori SKAO; z. A. T. me detyrë përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë; z. F. K. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit regjimeve në DD. Vlorë; z. I. P. me me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Durrës; z. E. Sh., z. D. M. dhe z. A. Zh. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Kakavie; z. K. V. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Vlorë; zj. E. Sh. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Korçë; z. A. L.; z. A. B. dhe z. P. T., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës zyre në SVQ, pranë DPD; zj. A. A. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Kakavie; z. F. F. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Vlorë; z. J. S., z. A. V. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Durrës; zj. J. M. me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/përjashtime, pranë DD. Vlorë; z. A. Sh., z. A. Sh., zj. L. B., z. E. Dervishi, zj. M. Z., zj. O. V., zj. E. B., zj. E. Ç., z. A. K., z. A. N., z. K. B., z. A. B., zj. K. Xh., zj. L. D., z. A. V., z. F. S., z. E. S., z. Sh. S., z. A. D., z. E. N., zj. S. D., z. R. D., zj. A. H., z. B. N., z. G. U., z. E. P., z. R. B., z. I. M., z. E. H., zj. G. G., z. ., zj. E. G., z. R. M. dhe z. I. R., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ), pranë DPD, si dhe z. E. Th.; z. P. R.; zj. E. K.; z. A. S.; z. E. I. dhe z. A. D. me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra legjislacionin doganor lidhur me klasifikimin tarifor *(në kuadratin 31 të DAV nuk është vendosur kodit 74)* të mallrave referuar NKM, për gjenerimin e taksës së amablazhit dhe legjislacionit lidhur me taksën e ambalazhit (TAM).

Referuar nenit 251, pika 2, shkronja "a", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

2. Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje me përgjegjësi objektive: a) mosrespektimi nga personi, që depoziton deklaratën doganore, ..., i detyrimit për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e informacioneve të dhëna në deklaratë, ..., në përputhje me shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 23

Referuar nenit 256, pika 1, shkronja "a", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

*a. kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, **lloj**) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, **zbatohet sanksion** në masën **1-fish** të detyrimit të munguar;*

Referuar nenit 3, pika 8, të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare",* i ndryshuar, në të përcaktohet qartë që:

Taksat kombëtare janë: 8. Taksa e ambalazheve njëpërdorimshe të plastikës dhe të qelqit.

Referuar nenit 4, pika 8, shkronja "a", të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare",* i ndryshuar, në të përcaktohet qartë që:

Taksa e ambalazheve njëpërdorimshe të plastikës caktohet në masën 100 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas.

Referuar nenit 5, shkronja "ë/i", të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare",* i ndryshuar, në të përcaktohet qartë që:

Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e tyre janë: ë) për taksën e ambalazheve njëpërdorimshme të plastikës dhe qelqit ngarkohen: i) ***Drejtoria e Përgjithshme e Doganave****, nëpërmjet degëve të saj doganore, për vjeljen e kësaj takse në import;*

Referuar pikës 2.8.5, të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014 të MF, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 'Për Taksat Kombëtare', të ndryshuar*", në të përcaktohet qartë që:

Në rastet e ***importeve të produkteve gjysëm të gatshme****...të cilat janë të destinuara për prodhimin e ambalazheve të plastikës apo të qelqit, ...****TAM paguhet në momentin e importimit****, pavarësisht nëse importuesi është prodhues vendas dhe i importon këto produkte në funksion të aktivitetit të vet prodhues apo është importues i këtyre produkteve për qëllime tregtare*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore u konstatua se për artikujt plastikë të importuar të cilët shërbejnë për ambalazhimin e produkteve të ndryshme, i cili e mbulon tërësisht produktin dhe e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim, nga ana e agjencive doganore, SVQ dhe SKAO nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të legjislacionit doganor lidhur me vjeljen e taksës së ambalazhit (TAM), pasi në kuadratin 31 të DAV në momentin e deklarimit, por jo vetëm, nuk është vendosur kodi 74 për të gjeneruar këtë taksë. ***Nga ana e grupit të auditimit janë shqyrtuar dhe krahasuar deklarimet e operatorëve edhe në tatime ku rezulton se shumica e operatorëve nuk e kanë deklaruar TAM.***

Konkretisht:

III.1. Për artikujt *"Qese; thasë plehrash; kuti plastike paketimi; gota dhe shishe plastike për ambalazh",* deklaruar në kodin tarifor me kre *3923* dhe *3925* të NKM rezultoi se në kuadratin 31 të DAV nuk është vendosur kodi 74 *"Ambalazh njëpërdorimësh plastik bosh"*, për të gjeneruar pagesën e taksës së ambalazhit, pasi artikulli nuk specifikohet në nenin 7 shkronja "ç" të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare në RSH"*. Sa më sipër referuar përcaktimeve në pikën 2.8.5, të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014 të MF, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 'Për Taksat Kombëtare ', të ndryshuar*", artikulli duhej të paguante TAM 100 lekë/kg. Referuar zhdoganimeve të artikujve të sipërcituar nxjerrë nga sistemi ORACLE *(citojmë DAV me: R-39399, datë 04.05.2018, i njëjti artikull nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues është trajtuar me TAM; R-100602, date 22.10.2018 i njëjti artikull është trajtuar me TAM)*, si dhe notave spjeguese të NKM, artikulli shërben për ambalazhimin e produkteve të ndryshme i cili e mbulon tërësisht dhe e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim.

Konstatimi i mësipërm, ***për 16 raste, me vlerë 1,945,440 lekë efekt financiar në Buxhetin e Shtetit,*** *(nga të cilat 972,720 lekë detyrim doganor dhe 972,720 lekë penalitet), evidentohet më konkretisht në aneksin nr. 3.2 të Projektraportit të Auditimit.*

III.2. Në lidhje me importet dhe deklarimin e artikujve *"Film polietileni i stampuar në bobinë (edhe me konfeksionet përkatëse) për ambalazhim: kafeje; mielli; orizi; ëmbëlsirash të ndryshme; ureje; panolinash; kroasani; sallam; kripe; patatinash, ure, etj",* deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *3919*, *3920*, *3921* dhe *3923* të NKM u konstatua se:

a. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore si dhe referuar notave shpjeguese të NKM rezulton se artikulli, *(artikull i përbërë prej polimerëve të etilenit në rastet e ambalazhit të kafes, patatinave, kroasanëve),* është i përbërë prej polimerëve të etilenit i veshur me alumin ndaj duhej klasifikuar në kodin tarifor *3923* Referuar DAV me R-9138, datë 30.01.2017 *(DD. Durrës),* artikulli është deklaruar në KT *39129090* dhe në kuadratin 31 të DAV është vendosur kodi 74 për TAM, *(për të njëjtën shkelje autoriteti doganor DDD ka dalë me vendimin administrativ nr. 562, datë 07.11.2017, nr. 17823 prot., datë 15.11.2017)*. Po për të njëjtën problematikë, AD i D.D. Fier ka dalë me VA nr. 108 – 111, datë 30.06.2017.

b. Referuar zhdoganimeve të artikullit nxjerrë nga sistemi ORACLE, si dhe notave spjeguese të NKM, si dhe faturave, artikulli rezulton film polietileni i stampuar në bobinë për amabalazhimin e produkteve të sipërcituara, ndaj në kuadratin 31 duhej vendosur kodi 74 *"Ambalazh njëpërdorimësh plastik bosh"*, për të gjeneruar pagesën e taksës së ambalazhit, pasi artikulli nuk specifikohet në nenin 7 shkronja "ç" të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare në RSH"*. Sa më sipër referuar përcaktimeve në pikën 2.8.5, të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014 të MF, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 'Për Taksat Kombëtare ', të ndryshuar*", ndaj duhej të paguante TAM 100 lekë/kg. Nga sa më sipër referuar përshkrimit në faturat e emetuara, artikulli është produkt i cili shërben për ambalazhimin e produkteve të ndryshme i cili e mbulon tërësisht dhe e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Vlen për tu theksuar se në asnjë rast nuk janë marrë mostrat për verifikimin e klasifikimit tarifor në Laboratorin Doganor. Gjithashtu nga grupi i auditimit u verifikuan procedurat e ndjekura në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve lidhur me deklarimin e taksës së ambalazhit (TAM), në tatime ku nëpërmjet email-it zyrtar datë 29.07.2019 ora 09:55, rezulton se subjektet e pasqyruara në material nuk figurojnë të kenë paguar TAM. Si rezultat i mosdeklarimit dhe keqklasifikimit rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a dhe 256.1/a të Kodit Doganor.

Konstatimi i mësipërm, ***për 319 raste, me vlerë 201,212,540 lekë efekt financiar në Buxhetin e Shtetit,*** *(nga të cilat 100,606,270 lekë detyrim doganor dhe 100,606,270 lekë penalitet), evidentohet më konkretisht në aneksin nr. 3.3 të Projektraportit të Auditimit.*

III.3. Në lidhje me importet dhe deklarimin e artikujve *"Film në bobinë për ambalazhim produktesh ushqimore si dhe film i ambalazhuar në bobinë për prodhim qesesh vakumi",* deklaruar dhe klasifikuar në kodin tarifor me kre *3919*, *3920* dhe *3921* të NKM u konstatua se nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore si dhe referuar notave shpjeguese të NKM rezulton se artikulli i importuar dhe deklaruar shërben për ambalazhimin e produkteve të ndryshme i cili e mbulon tërësisht dhe e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim, ndaj në kuadratin 31 duhej vendosur kodi 74 *"Ambalazh njëpërdorimësh plastik bosh"*, për të gjeneruar pagesën e taksës së ambalazhit, pasi artikulli nuk specifikohet në nenin 7 shkronja "ç" të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare në RSH"*. Sa më sipër referuar përcaktimeve në pikën 2.8.5, të Udhëzimit nr. 2, datë 17.01.2014 të MF, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 'Për Taksat Kombëtare ', të ndryshuar*", ndaj duhej të paguante TAM 100 lekë/kg. Referuar importeve të subjektit INTER TRADE DISTRIBUTION me nipt K91524002L, artikulli është klasifikuar në kodin tarifor me kre *3923*, dhe në kuadratin 31 të DAV është vendosur kodi 74, klasifikim i cili ka gjeneruar taksën e ambalazhit. Nga sa më sipër referuar përshkrimit në faturat e emetuara, artikulli është produkt i cili shërben për ambalazhimin e produkteve të ndryshme. Vlen për tu theksuar se në asnjë rast nuk janë marrë mostrat për verifikimin e klasifikimit tarifor në Laboratorin Doganor. Gjithashtu nga grupi i auditimit u verifikuan procedurat e ndjekura në Drejtorinë e

Përgjithshme të Tatimeve lidhur me deklarimin e taksës së ambalazhit (TAM), në tatime ku nëpërmjet email-it zyrtar datë 29.07.2019 ora 09:55, rezulton se subjektet e pasqyruara në material nuk figurojnë të kenë paguar TAM. Figurojnë vetëm 4 subjekte që kanë kryer deklarimin në tatime përkatësisht ato me NIPT: J61826508M; K51705007E; J61924010K; K63521608M. Si rezultat i mosdeklarimit dhe keqklasifikimit rezulton shmangie e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 251.2/a të Kodit Doganor.

*Konstatimi i mësipërm, **për 462 raste, me vlerë 385,533,268 lekë efekt financiar në Buxhetin e Shtetit,** (e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar), evidentohet më konkretisht në aneksin nr. 3.4 të Projektraportit të Auditimit.*

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga ana e nëpunësve: z. A. H. me detyrë përgjegjës sektori SKAO; z. A. T. me detyrë përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë; z. F. K. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit regjimeve në DD. Vlorë; z. I. P. me me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Durrës; z. E. Sh., z. D. M. dhe z. A. Zh. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Kakavie; z. K. V. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Vlorë; zj. E. Sh. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Korçë; z. A. L.; z. A. B. dhe z. P. T., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës zyre në SVQ, pranë DPD; zj. A. A. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Kakavie; z. F. F. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Vlorë; z. J. S., z. A. V. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Durrës; zj. J. M. me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/përjashtime, pranë DD. Vlorë; z. A. Sh., z. A. Sh., zj. L. B., z. E. Dervishi, zj. M. Z., zj. O. V., zj. E. B., zj. E. Ç., z. A. K., z. A. N., z. K. B., z. A. B., zj. K. Xh., zj. L. D., z. A. V., z. F. S., z. E. S., z. Sh. S., z. A. D., z. E. N., zj. S. D., z. R. D., zj. A. H., z. B. N., z. G. U., z. E. P., z. R. B., z. I. M., z. E. H., zj. G. G., z. ., zj. E. G., z. R. M. dhe z. I. R., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ), pranë DPD, si dhe z. E. Th.; z. P. R.; zj. E. K.; z. A. S.; z. E. I. dhe z. A. D. me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.12 dhe 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012 si dhe seksionit III, pika 1.5, shkronja "a" si dhe seksionit IV, pika 1.9, shkronja "a", të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD *"Mbi funksionimin e seksioneve të vlerës në qendër dhe aposteriorit operativ në DPD",* përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për zbatimin e kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me pagesën e taksës së ambalazhit për mallrat e importuar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

- Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*; neni 251, pika 2, shkronja "a"; neni 256, pika 1, shkronja "a";
- Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare",* i ndryshuar; neni 3, pika 8; neni 4, pika 8, shkronja "a"; neni 5, shkronja "ë/i";
- Udhëzimin nr. 2, datë 17.02.2014 të Ministrisë së Financave "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 'Për Taksat Kombëtare ', të ndryshuar*", pika 2.8.5.

Për 797 raste, vlera prej 588,691,248 lekë, e cila përfaqëson 487,112,258 lekë detyrim doganor të munguar dhe 101,578,990 lekë penalitet, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. H. me detyrë përgjegjës sektori SKAO;
2. Z. A. T. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë;

3. Z. I. P. me me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Durrës;
4. Z. F. K. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit regjimeve në DD. Vlorë;
5. Z. E. Sh., z. D. M. dhe z. A. Zh. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Kakavie;
6. Z. K. V. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Vlorë;
7. Zj. E. Sh. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Korçë;
8. Z. A. L.; z. A. B. dhe z. P. T., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës zyre në SVQ, pranë DPD;
9. Zj. A. A. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Kakavie;
10. Z. F. F. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Vlorë;
11. Z. J. S., z. A. V. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/ vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Durrës;
12. Zj. J. M. me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/përjashtime, pranë DD. Vlorë;
13. z. A. Sh., z. A. Sh., zj. L. B., z. E. Dervishi, zj. M. Z., zj. O. V., zj. E. B., zj. E. Ç., z. A. K., z. A. N., z. K. B., z. A. B., zj. K. Xh., zj. L. D., z. A. V., z. F. S., z. E. S., z. Sh. S., z. A. D., z. E. N., zj. S. D., z. R. D., zj. A. H., z. B. N., z. G. U., z. E. P., z. R. B., z. I. M., z. E. H., zj. G. G., z. ., zj. E. G., z. R. M. dhe z. I. R., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ), pranë DPD;
14. z. E. Th.; z. P. R.; zj. E. K.; z. A. S.; z. E. I. dhe z. A. D. me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD.

4. Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit si dhe Drejtorisë së Politikave të Vlerësimit Doganor. Rimbursimi i akcizës në përputhje me afatet dhe procedurat e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit "Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave", u konsiderua si e nevojshme zhvillimi, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i një verifikimi nga audituesit e KLSH-së Z. Agron Opari dhe Z. Xhein Xhindoli, në prezencë të përfaqësuesve të subjektit të auditimit Znj. A. K. me detyrë dhe në cilësinë e Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, Znj. E. K. me detyrë dhe në cilësinë e Përgjegjës Sektori në Sektorin e Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave dhe Znj. E. V. me detyrë dhe në cilësinë e specialist në Sektorin e Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave.

Objekti i këtij akt verifikimi është:

Auditimi i procedurave të ndjekura nga Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, pranë DPD, në lidhje me rimbursimin e akcizës në përputhje me afatet dhe kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për periudhën objekt auditimi.

Nga verifikimi rezultoi që:

Për periudhën objekt auditimi, në DPD janë adresuar kërkesa për rimbursim gjithsej **187 raste** në vlerën **1,642,944,411 lekë**, nga të cilat, *129 raste në vlerën 11,931,057 lekë* për Ambasadat dhe Selitë Diplomatike *(pasqyruar në Aneksin nr.1),* dhe *58 raste në vlerën 1,631,013,354 lekë* për operatorët e ekonomik *(pasqyruar në Aneksin nr. 2).*

Respektivisht sa më sipër të gjitha rastet e rimbursimeve paraqiten në pasqyrat si më poshtë:

Tabela në të cilën pasqyrohen Ambasadat dhe Trupat Diplomatike që kanë përfituar nga skema e rimbursimit/përjashtimit;

Aneksi nr. 1

NR	NIPTI	KËRKESA	DEGA	MIRATIMI	SHUMA

		NR	*DATË*		*NR*	*DATË*	
1		28776	19.12.17.	TIRANE	28776/2	29.12.17.	41,070
2		28235	13.12.17	TIRANE	28235/2	28.12.17	33,300
3		28237	13.12.17	TIRANE	28237/2	28.12.17	27,750
4		28236	13.12.17	TIRANE	28236/2	28.12.17	111,000
5		28107	12.12.17.	TIRANE	28107/2	28.12.17	18,500
6		27820	7.12.17.	TIRANE	27820/2	28.12.17	37,000
7		26397	16.11.17.	TIRANE	26397/2	17.1.18.	18,500
8		153	4.1.18.	TIRANE	153/2	26.1.18.	18,500
9		465	9.1.18	TIRANE	465/2	26.1.18.	37,000
10		707	11.1.18	TIRANE	707/2	26.1.18.	66,600
11		158	4.1.18.	TIRANE	158/2	26.1.18.	9,990
12		157	4.1.18.	TIRANE	157/2	26.1.18.	249,750
13		958	15.1.18.	TIRANE	958/2	26.1.18.	11,100
14		1344	18.1.18.	TIRANE	1344/2	1.2.18.	19,610
15		1345	18.1.18.	TIRANE	1345/2	1.2.18.	37,000
16		2505	31.1.18.	TIRANE	2505/2	13.2.18.	46,250
17		1341	18.1.18.	TIRANE	1341/1	6.2.18.	255,300
18		2503	31.1.18.	TIRANE	2503/2	13.2.18.	74,000
19		2504	31.1.18.	TIRANE	2504/2	13.2.18.	91,390
20		3857/2	8.3.18.	TIRANE	3857/1	2.3.18.	148,000
21		1343	18.1.18.	TIRANE	13431/2	21.2.18.	18,870
22		3861/2	8.3.18.	TIRANE	3861/1	2.3.18.	25,900
23		3855	14.2.18.	TIRANE	3855/1	2.3.18.	37,000
24		4441	20.2.18.	TIRANE	4441/1	5.3.18.	1,706,810
25		3856	14.2.18.	TIRANE	3856/1	28.2.18.	45,140
26		4440	20.2.18.	TIRANE	4440/1	28.2.18.	171,902
27		2920	5.2.18.	TIRANE	2920/1	16.2.18.	44,400
28		2325	29.1.18.	TIRANE	2325/1	16.2.18.	370,000
29		2326	29.1.18.	TIRANE	2326/1	16.2.18.	22,200
30		3153	7.2.18.	TIRANE	3153/2	21.2.18.	74,000
31		5554	5.3.18.	TIRANE	5554/1	26.3.18.	33,300
32		6044	9.3.18.	TIRANE	6044/1	28.3.18.	31,450
33		5981	8.3.18.	TIRANE	5981/1	28.3.18.	18,500
34		5982	8.3.18.	TIRANE	5982/1	28.3.18.	70,300
35		7068	20.3.18.	TIRANE	7068/1	28.3.18.	55,500
36		6351	13.3.18.	TIRANE	6351/1	28.3.18.	101,750
37		6487	28.3.18.	TIRANE	6487/1	28.3.18.	8,880
38		6471	15.3.18	TIRANE	6471/1	28.3.18.	173,382
39		7085	20.3.18	TIRANE	7085/1	28.3.18.	2,590
40		8422	6.4.18	TIRANE	5480/1	6.4.18	24,420
41		8087	3.4.18	TIRANE	5057/1	30.3.18.	33,300
42		8413	6.4.18	TIRANE	5386/1	5.4.18	25,900
43		8114	6.4.18.	TIRANE	5484/1	.04.18.	331,150
44		7722	28.3.18.	TIRANE	4711/1	27.3.18.	101,010
45		10539	3.5.18.	TIRANE	7297/1	3.5.18.	11,100
46		10096	27.4.18.	TIRANE	6774/1	27.4.18.	12,950
47		10097	27.4.18.	TIRANE	6772/1	21.4.18.	111,000
48		10098	27.4.18.	TIRANE	6816/1	27.4.18.	64,750
49		9789	24.4.18.	TIRANE	6622/1	23.4.18.	55,500
50		9790	24.4.18.	TIRANE	6649/1	23.4.18.	37,000
51		10535	3.5.18.	TIRANE	7118/1	3.5.18.	140,230
52		10534	3.5.18.	TIRANE	7192/1	3.5.18.	37,740
53		10538	3.5.18.	TIRANE	7237/1	3.5.18.	22,200
54		11224	11.5.18.	TIRANE	7793	10.5.18.	37,000
55		10963	9.5.18.	TIRANE	7415/1	8.5.18.	21,090
56		10523	3.5.18.	TIRANE	7027/1	30.4.18.	37,000
57		10522	3.5.18.	TIRANE	6923/1	30.4.18.	61,790
58		10536	3.5.18.	TIRANE	7243/1	3.5.18.	44,400
59		10533	3.5.18.	TIRANE	7052/1	3.5.18.	20,350
60		12015/2	01.06.18.	TIRANE	12015/1	24.5.18.	364,080
61		11721/2	22.6.18.	TIRANE	11721/1	25.5.18.	44,400
62		13345/2	10.7.18.	TIRANE	13345/1	29.6.18.	23,680
63		12823/2	10.7.18.	TIRANE	12823/1	19.6.18.	55,500
64		13069/2	10.7.18.	TIRANE	1369/1	19.6.183.	298,960
65		12822/2	10.7.18.	TIRANE	12822/1	19.6.18.	49,950

66		8278/2	10.7.18.	TIRANE	8278/1	26.6.18.	99,900
67		13762/1	10.7.18.	TIRANE	13762/1	25.6.18.	44,400
68		12616/2	10.7.16	TIRANE	12616/1	19.6.18.	44,400
69		14394/2	10.7.18.	TIRANE	14394/1	25.6.18.	48,100
70		13761/2	10.7.18.	TIRANE	13761/1	29.6.18.	81,400
71		8279/3	10.7.18.	TIRANE	8279/2	26.6.2	125,060
72		8280/2	10.7.18.	TIRANE	8280/1	26.6.18.	37,000
73		15652/2	18.7.18.	TIRANE	15652/1	11.7.18.	25,530
74		16053/2	17.7.18.	TIRANE	16053/1	12.7.18.	37,740
75		14081/2	26.7.18.	TIRANE	14081/1	13.7.18.	78,440
76		16054/2	26.7.18.	TIRANE	16054/1	13.7.18.	25,900
77		16054/2	26.7.18.	TIRANE	16054/1	20.7.18.	70,300
78		15794/2	26.7.18.	TIRANE	15794/1	13.7.18.	59,200
79		15793/2	26.7.18.	TIRANE	15793/1	13.7.18.	55,500
80		17732/2	15.8.18.	TIRANE	17732/1	6.8.18.	22,200
81		16395/2	15.8.18.	TIRANE	16395/1	27.7.18.	18,500
82		17191/2	15.8.18.	TIRANE	17191/1	27.7.18.	11,100
83		17190/2	15.8.18.	TIRANE	17190/1	27.7.18.	12,950
84		17189/2	15.8.18.	TIRANE	17189/1	27.7.18.	37,000
85		16396/2	15.8.18.	TIRANE	16396/1	27.7.18.	11,100
86		18512/3	30.8.18.	TIRANE	18512/2	24.8.18.	1,295,370
87		18509/2	17.9.18.	TIRANE	18509/1	6.9.18.	109,890
88		19123/2	17.9.18.	TIRANE	19123/1	28.8.18.	17,760
89		19126/2	17.9.18.	TIRANE	19126/1	28.8.18.	40,700
90		18187/2	17.9.18.	TIRANE	18187/1	0.2018	16,650
91		18512/5	17.9.18.	TIRANE	18512/4	30.8.18.	47,360
92		19124/2	17.9.18.	TIRANE	19124/1	18.8.18.	55,500
93		19125/2	2.10.18.	TIRANE	19125	20.8.18.	58,830
94		22092/2	2.10.18	TIRANE	21092	17.9.18	222,000
95		20070/2	2.10.18.	TIRANE	20070	4.9.18.	35,150
96		19127/2	2.10.18	TIRANE	19127	20.8.18.	24,050
97		18510/2	2.10.18.	TIRANE	18510	7.8.18.	66,600
98		18508/2	2.9.18.	TIRANE	18508	7.8.18.	83,990
99		20073/2	18.10.18.	TIRANE	20073	4.9.18.	51,800
100		20819/2	18.9.18.	TIRANE	20819/1	3.10.18.	37,000
101		22468/2	18.10.18.	TIRANE	22468/1	8.10.18.	14,800
102		22854/2	19.10.18.	TIRANE	22854/1	15.10.18.	7,400
103		22856/2	19.10.18.	TIRANE	22856/1	15.10.18.	22,200
104		21314/2	18.10.18.	TIRANE	21314/1	8.10.18.	55,500
105		20821/2	18.10.18.	TIRANE	20821	3.10.18.	11,100
106		19126/2	17.9.18.	TIRANE	19126/1	28.8.18.	46,250
107		24426/2	07.11.18.	TIRANE	24426/1	30.10.18.	222,000
108		21932/2	13.11.18	TIRANE	21932/1	31.10.18.	66,600
109		23707/2	13.11.18	TIRANE	23707/1	2.11.18.	18,500
110		23879/2	13.11.18.	TIRANE	23879/1	21.11.18.	74,000
111		17623/3	13.11.18.	TIRANE	17632/2	02.11.18.	159,100
112		23874/2	13.11.18.	TIRANE	23874/1	02.11.18.	11,100
113		22055/2	13.11.18.	TIRANE	22055/1	19.10.18.	10,730
114		22056/2	13.11.18.	TIRANE	22056/1	21.10.18.	3,700
115		22852/2	13.11.18.	TIRANE	22852/1	19.10.18.	7,400
116		25016/2	13.11.18.	TIRANE	25016/1	05.11.18.	18,500
117		22580/1	13.11.18.	TIRANE	22580/1	18.10.18.	148,000
118		25014/2	13.11.18	TIRANE	25014/1	05.11.18.	81,400
119		24425/2	13.11.18.	TIRANE	24425/1	5.11.18.	18,500
120		24423/2	22.11.18.	TIRANE	24423/1	06.11.18.	204,943
121		24716/2	22.11.18.	TIRANE	24716/1	12.11.18.	61,050
122		25910/1	16.11.18.	TIRANE	25910	5.11.18.	81,400
123		25907/2	5.11.18.	TIRANE	25907/1	16.11.18.	34,780
124		25580/2	13.12.18.	TIRANE	25580/1	16.11.18.	51,430
125		26294/2	13.12.18.	TIRANE	26294/1	16.11.18.	166,500
126		25908/2	13.12.18.	TIRANE	25908/1	16.11.18.	18,500
127		26539/2	13.12.18.	TIRANE	26539	16.11.18.	27,750
128		26023/2	13.12.18.	TIRANE	26023/1	5.11.18.	62,900
129		26293/2	13.12.18.	TIRANE	26293/1	16.11.18.	686,720
SHUMA LEKË							***11,931,057***

Tabela në të cilën pasqyrohen subjektet që kanë përfituar nga skema e rimbursimit

Aneksi nr. 2

NR	NIPTI	KËRKESA		DEGA	MIRATIMI		SHUMA
		NR	DATË		NR	DATË	
1		18762	14.8.17.	ELBASAN	18762/1	20.2.18.	9,254,255
2		22868	9.10.17.	ELBASAN	22868/1	20.2.18.	6,644,423
3		22867	9010.17.	ELBASAN	22867/1	20.2.18.	2,929,549
4		28278/1	13.12.17.	ELBASAN	28278/1	20.2.18.	12,216,697
5		28278	13.12.17	ELBASAN	28278/2	20.2.18.	4,766,229
6		3223	7.2.18.	ELBASAN	3223/1	20.2.18.	3,295,220
7		3444/2	23.2.18.	FIER	3444/2	23.2.18.	55,500,377
8		22543	4.10.17.	DURRES	22543/1	20.2.18.	13,650,182
9		2752	13.9.17.	DURRES	20752/1	20.2.18.	3,508,918
10		4749	22.2.18	DURRES	156/3	19.2.18.	27,339,599
11		7139	21.3.18.	DURRES	3376/3	21.3.18.	56,003,497
12		4141	16.2.18.	ELBASAN	373/2	15.2.18.	18,788,082
13		4140	16.2.18.	ELBASAN	374/2	15.2.18.	7,540,970
14		8177	4.4.18.	ELBASAN	742/2	28.3.18.	4,690,897
15		4748/1	19.6.18.	DURRES	1041	19.2.18.	1,858,520
16		5011/1	20.6.18.	DURRES	2310/2	22.2.18.	1,235,926
17		4747/1	20.6.18	DURRES	13756/7	19.2.18.	11,608,381
18		9233/1	20.6.18.	DURRES	4813/2	10.4.18.	12,834,402
19		1281/1	20.6.18.	DURRES	4812/2	18.5.18.	5,397,602
20		14905/1	25.6.18	FIER	1772/8	21.06.18.	83,416,241
21		10805/1	12.7.18.	DURRES	5078/3	3.5.18.	30,708,916
22		10805/1	12.7.18.	DURRES	6804/3	4.7.18.	38,948,552
23		15853/1	18.7.18.	DURRES	15853	4.7.18.	39,691,083
24		13796/1	18.7.18.	DURRES	8912/2	11.6.18.	12,319,667
25		13796/1	18.7.18.	DURRES	6583/4	7.6.18	529,289
26		13796/1	18.7.18.	DURRES	8796	7.6.18.	8,295,802
27		16826/1	18.7.18.	FIER	16826	13.7.18.	155,923,920
28		13797/1	27.7.18.	DURRES	13797	11.6.18.	19,415,683
29		29820/1	30.8.18.	FIER	19820	30.8.18.	169,481,645
30		12661/1	12.9.18.	TIRANE	12661	29.5.18.	28,484,172
31		9905/1	12.9.18.	ELBASAN	9905	25.4.18.	658,600
32		12290/1	12.9.18.	TIRANE	12290	23.5.18.	4,394,675
33		21134/1	28.9.18.	FIER	21134	17.9.18	150,022,272
34		15908/1	8.10.18.	DURRES	15908	4.7.18.	7,039,608
35		13798/1	8.10.18.	DURRES	13798	11.6.18.	3,800,323
36		19280/1	8.10.18.	DURRES	19280	23.8.18.	37,801,914
37		17245/1	8.10.18.	ELBASAN	17245	19.7.18.	3,624,520
38		16778/1	8.10.18	ELBASAN	16778	13.7.18.	10,571,307
39		21311/1	22.10.18.	ELBASAN	21311	19.9.18.	7,764,857
40		21307/1	22.10.18.	ELBASAN	21307	19.9.18.	11,137,888
41		20354/1	22.10.18.	ELBASAN	20354	7.9.18.	4,130,310
42		21390/1	22.10.18.	DURRES	21390	20.9.18.	15,395,573
43		19279/1	22.10.18.	DURRES	19279	23.8.18.	6,526,643
44		24749/1	31.10.18.	FIER	24749	22.10.18.	123,416,460
45		27022/1	23.11.18.	DURRES	27022	14.11.18.	33,825,937
46		27007/1	23.11.18.	DURRES	27007	14.11.18.	27,371,749
47		22397	27.11.18.	DURRES	22397	01.10.18.	33,044,808
48		25211/1	26.10.18.	DURRES	25211	26.10.18.	23,044,768
49		28078/1	5.12.18.	FIER	28078	23.11.18.	83,868,603
50		19283/1	6.12.18.	DURRES	19283	23.8.18.	1,269,059
51		27006/1	6.12.18.	DURRES	27006	14.11.18.	510,847
52		26890/1	6.12.18.	DURRES	26890	14.11.18.	8,133,266
53		26214/1	6.12.18.	DURRES	26214	26.10.18.	4,006,460
54		25210/1	6.12.18.	DURRES	25210	7.11.18.	9,028,414
55		26408/1	6.12.18.	TIRANE	26408	9.11.18.	5,239,082
56		26437/1	7.12.18	FIER	26437	9.11.18.	4,227,028
57		30004/1	21.12.18.	DURRES	30004	19.12.18.	19,663,160
58		29929/1	27.12.18.	FIER	29929	18.12.18.	145,216,527
SHUMA LEKË							***1,631,013,354***

Nga shqyrtimi dokumentacionit elektronik *(regjistrit elektronik të rimbursimeve),* spjegimeve dhe materialeve, të vëna në dispozicion për auditim rezultoi:

1. Lidhur me bazat ligjore ku mbështeten procedurat e rimbursimit

- Ligji 102/2014 datë 31.07.2014, *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, nenet 109-114 dhe neni 184;
- VKM nr.651/2017 datë 10.11.2017, *"Për dispozitat zbatuese të Ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar, nenet referuese;
- Ligji 61/2012 datë 24.05.2012 *"Për akcizat në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, nenet 108 dhe 109;
- VKM nr.612/2012 datë 05.09.2012 *"Për dispozitat zbatuese të Ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, nenet referuese;
- Ligji 92/2014 *datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, neni 60;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.17 datë 26.07.2016 *"Për procedurat e përjashtimit nga detyrimet e importit dhe detyrimet e tjera tatimore të lëndëve djegëse për përdorim për nevoja zyrtare dhe personale, në kuadër të misioneve diplomatike dhe konsullore, misionet speciale të akredituara në Shqipëri si dhe të organizmave ndërkombëtarë, të njohur si të tillë nga Republika e Shqipërisë", bashkalidhur Aneksi 1."Aplikimi për përjashtim për lëndët djegëse për misionet diplomatike dhe konsullore, misionet speciale të akredituara në Shqipëri si dhe të organizmave ndërkombëtarë" dhe Aneksi 2. "Autorizim nr..... për përjashtim të lëndëve djegëse për misionet diplomatike dhe konsullore, misionet speciale të akredituara në Shqipëri si dhe të organizmave ndërkombëtarë";*

2. Lidhur me procedurat që ndiqen për rimbursim

Subjektet përfituese që plotësojnë kushtet për rimbursim, aplikojnë pranë degëve doganore sipas kërkesave të pikës 1, të shkresës nr. 7100/4 prot., datë 12.06.2013 të DPD *"Mbi procedurat për autorizimin e pagesës, për rimbursimin e akcizës nga të ardhurat nga degët doganore, në zbatim të Ligjit 61/2012 datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM 612 datë 05.09.2012 dhe Urdhrit nr.29 datë 07.06.2013 të Ministrit të Financave"*, ku përcaktohet se degët doganore shqyrtojnë kërkesën, miratojnë dhe dërgojnë në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës në DPD kërkesën për shumën e miratuar për rimbursim për çdo operator ekonomik ku, bashkangjitur saj gjendet miratimi i shumës sipas formularit bashkëlidhur "MIRATIM I SHUMËS PËR RIMBURSIM".
Pas këtij veprimi, vijon procedura nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në DPD *(mbështetur në pikën 2 të shkresë së sipërcituar),* pasi mbledh kërkesat e degëve, rast pas rasti urdhëron kalimin e shumave përkatëse në llogarinë bankare (7031500), "Pagesë për rimbursim akcize", e çelur sipas urdhrit nr. 29 datë 07.06.2013 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë duke pakësuar llogarinë qëndrore të të ardhurave të DPD-së.
Pagesa për rimbursim autorizohet nga dega doganore konform formularit tip (model nr.1) sipas pikës 1, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 21 datë 17.11.2014 *"Për procedurën e pagesave të detyrimeve doganore të paguara tepër nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave",* për xhirim në çdo BND. Transferta kryhet nga gjendja e llogarisë bankare *"Pagesë për rimbursim akcize"*, në favor të subjektit përfitues. Dokumentacioni dhe dosjet e subjekteve të cilët kanë aplikuar dhe u është miratuar kërkesa për rimbursim ndodhet pranë degeve doganore.

3. Lidhur me afatet e parashikuara të rimbursimit.

Për Trupat Diplomatike, në pikën 3, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 17, datë 26.07.2016, *"Mbi procedurat e përjashtimit nga detyrimet e importit dhe detyrimet e tjera tatimore të lëndëve djegëse për përdorim për nevoja zyrtare dhe personale, në kuadër të misioneve diplomatike dhe konsullore...",* (pas aplikimit për përjashtim pranë DPD-së sipas pikës 2),

parashikohet afati 3 ditor i pranimit/refuzimit të autorizimit për përjashtim nga detyrimet doganore, rast pas rasti, në varësi të konfirmimit të Drejtorisë së Protokollit pranë Ministrisë së Punëve të jashtme dhe Integrimit Europian. Në varësi të autorizimit sipas aneksit 2, DPD transferon periodikisht, pranë ministrisë respektive, vlerat e akcizës për tu rimbursuar, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Integrimit Europian në këtë proces. Bazuar në autorizimin sipas aneksit 2, rimbursimi bëhet një herë në muaj. DPD komunikon me MPJIE në këtë proces duke i bashkëlidhur kërkesës gjithë dokumentacionin e nevojshëm në respektim të pikave a, b dhe c të kësaj pike. Në përmbushje të kushteve të sipërcituara, DPD, referuar pikës 1, të Udhëzimit nr.21, datë 17.11.2014, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë *"Për procedurën e pagesave të detyrimeve doganore të paguara tepër nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave",* procedon me kthimin e detyrimeve doganore të paguara tepër kundrejt paraqitjes, në degën përkatëse të thesarit, të Urdhër Pagesës për rimbursim sipas modelit 1, bashkëlidhur udhëzimit.

Në Udhëzimin nr.21, datë 17.11.2014, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë *"Për procedurën e pagesave të detyrimeve doganore të paguara tepër nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave",* apo në legjislacionin doganor, nuk parashikohen afate të rimbursimit të shumave të paguara tepër.

4. Lidhur me respektimin e rradhës së rimbursimeve

Nga DBF pranë DPD, pasi merret praktika e konfirmuar nga Dega Doganore që ka miratuar rimbursimin, si edhe nga Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Integrimit Europian (e cila përcillet nga Departamenti Teknik i Akcizës), menjëherë përgatitet Urdhëri për rimbursim, i cili dërgohet për nënshkrim nga Drejtori i Përgjithshëm dhe pasi del i nënshkruar nga DBF përgatitet menjëherë Urdhër xhirimi për në Thesar. Nga verifikimi nuk konstatohen probleme lidhur me respektimin e radhës së rimbursimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe ballafaqimi nuk konstatohen probleme lidhur me rimbursimet nese subjekti përfitues është me detyrime të pa paguara në doganë.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 4, datë 16/08/2019 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë *komente dhe shpjegime*, dhe konkretisht:
Me shkresën nr. 8878/13 prot., datë 20.08.2019, të D.P.D, ku **citohet** se: ***"...dëshirojmë t'u sqarojmë se nr. prot., dhe data e shënuar në tabelën e vënë në dispozicion nga ana jonë nuk është ai i kërkesës së operatorit ekonomik për rimbursim (pasi ajo depozitohet në DD përkatëse), por nr. prot., dhe data e kërkesës së ardhur nga DD për çeljen e fondit për rimbursim...."***.
Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH":
Në lidhje me komentet e bëra nga ***zj. Karapinjalli; zj. Kaja dhe zj. Vjero,*** *sqarojmë se pretendimet e mësipërme qëndrojnë, merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

Shënim: Auditimi i kësaj pike të programit nuk është audituar plotësisht për shkak të mos angazhimit të plotë të stafit në auditim si dhe ngarkesës dhe volumit të madh, ndaj mbetet për tu audituar në auditimin pasardhes.

5. Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit Operativ Hetimor lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Antikontrabandës si dhe Drejtorisë së Kontrolleve të Paszhdoganimit (Aposterior operativ 5 ditor SKAO)

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit "Nr. 242/1 Prot., datë 06.06.2019", për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni elektronik si më poshtë:

1. Sistemi elektronik ORACLE i të dhënave për deklaratat doganore IM4 të përpunuara në sistemin doganor në bazë të përzgjedhjes si kriter vlerësimi: deklaratat doganore të profilizuara në kanalin BLU; mallrat që importohen më shpesh dhe me ndikim në të ardhurat; mallrat që kuotohen në bursë; artikujt e importuar nga NEU (kryesisht Kina), si dhe mallrat e përdorur, duke synuar që të mbulohej e gjithë periudha e programuar, pa krijuar mbivendosje me strukturat e tjera kontrolluese;
2. Dokumentacioni tregtar elektronik i praktikave doganore sa më sipër, nëpërmjet sistemit Asycuda Ŵorld, të vlerësuara dhe përzgjedhura me rrisk;
3. Dokumentacioni tregtar dhe elektronik i praktikave doganore të artikujve të njëjtë nga e njëjta origjinë deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme, për të cilët nga SVQ apo SKAO nuk është ndjekur i njëjti kriter apo standard vlerësimi.

Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të profilizuara në kanalin "BLU", *(si dhe SVQ për veprimet jo në përputhje me legjislacionin doganor për artikujt të të njëjtës natyrë),* ***gjatë proçedurave të zhdoganimit konstatohet që:***

Nga ana e: z. A. H. me detyrë përgjegjës sektori SKAO; z. H. E. me detyrë përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë; K. Ç. me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/ kontroll fizik në DD. Sarandë; z. A. T. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë; z. A. V. dhe z. I. P. me me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Durrës; z. H. B. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Berat; z. E. Sh., z. D. M. dhe z. A. Zh. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Kakavie; zj. A. H. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Shkodër, z. K. V. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Vlorë; zj. E. Sh. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Korçë; z. A. L.; z. A. B. dhe z. P. T., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës zyre në SVQ, pranë DPD; z. K. N. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Sarandë; z. Dh. Xh. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Berat; z. A. Sh., z. A. Sh., zj. L. B., z. E. D., z. M. Z., zj. O. V., zj. E. B., zj. E. Ç., z. A. K., z. A. N., z. K. B., z. A. B., zj. K. Xh., zj. L. D., z. A.V., z. F. S., z. E. S., z. Sh. S., z. A. D., z. E. N., zj. S. D., z. R. D., zj. A. H., z. B. N., z. G. U., z. E. P., z. R. B. dhe z. I. R., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ), pranë DPD, si dhe z. E. Th., z. I. M., z. P. R., zj. E. K., z. D. B., z. A. S., z. B. D., zj. M. Z., z. S. T., z. E. I., z. R. Sh., zj. I. B., z. E. Gj., z. R. M., zj. E. Sh., z. I. Ç. dhe z. A. D. me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra legjislacionin doganor lidhur me vlerësimin doganor të mallrave referuar kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..",* ndryshuar me pikën 7 dhe 8 të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* nxjerrë për këtë qëllim.

Referuar nenit 171, pika 2, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

Për qëllime të pikës 1, kur një deklaratë doganore mbulon dy ose më shumë artikuj, të dhënat për secilin artikull konsiderohen sikur përbëjnë deklarata të veçanta doganore.

Referuar nenit 70, pika 2, shkronja "a" dhe "b", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

Vlera doganore, sipas pikës 1, është: *a) vlera e transaktuar e mallrave identike te shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;*

b) vlera e transaktuar e mallrave të ngjashme, të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

Referuar nenit 70, pika 3 të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, në të përcaktohet qartë që:

Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1, të këtij neni, ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë

Referuar pikës 7, të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore"*, në të përcaktohet qartë që:

Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor Indikatorët që mund të evidentojnë një shqyrtim më të thelluar të vlerës doganore, mund të jenë:
- Ekziston një ndryshim i dukshëm midis vlerës së deklaruar dhe çmimeve të Database-it Kombëtar të Vlerësimit apo të të dhënave të disponueshme për artikujt që përditësohen nga bursat apo agjenci ndërkombëtare.
- Ka çmime të ndryshme të deklaruara për të njëjtin produkt, nga furnizues/origjina të njëjta/ ngjashme.
- Vendi i origjinës/lëvrimit me risk: Azisë, Lindjes së Largët, vendeve arabe, zonave të lira (zona off-shore), Amerika Latine.
- Vendi i origjinës ndryshon nga vendi nga ku transportohet/lëvrohet malli.
- Përmbajtja e faturave nga i njëjti furnizues paraqet luhatje jo të zakonshme.
- Përfshihen shitjet e njëpasnjëshme (zinxhir shitjesh).
- Ekziston një tregtar ose një kompani e tretë (agjenti blerës) i përfshirë në transaksione.
- Mallrat vijnë nga një vend pa marrëveshje të asistencës reciproke me vendin tonë ose nga ku është e vështirë për të marrë informacion.
- Vendi i ngarkimit nuk korrespondon me vendin e adresën e eksportuesit.
- Ekziston një ndryshim i dukshëm midis çmimit të deklaruar me çmimet nga publikime në tregje të ndryshme.
- Vlera e produktit nuk mund të jetë më e ulët se vlera e lëndës së parë me të cilën është prodhuar.
- Indikatorë të tjerë të paspecifikuar më lart etj.

Referuar pikës 10, shkronja "h" të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore"*, në të përcaktohet qartë që:

Kur importohen mallra të përdorura dhe transaksioni i paraqitur nuk justifikon gjendjen e tyre, nga dega doganore apo strukturat e posaçme, ngrihet "grup vlerësimi", që merr në konsideratë sipas rastit, vitin e prodhimit, shkallën e amortizimit, gjendjen reale të tyre etj., por jo më pak se 40% të vlerës të mallit të ri

Referuar Urdhërit nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*, në të përcaktohet qartë që:

Në rast se gjatë deklarimit të këtyre mallrave në doganë konstatohen raporte më të ulëta se sa indikatorët e kontrollit shtesë sipas tabelës së mësipërme, strukturat e degës doganore ***të kryejnë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme****, përfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave* ***dhe sidomos të vlerës së mallrave me peshën e tyre.***

Për auditimin e përputhshmërisë lidhur me procedurat e ndjekura nga sektori SKAO, u përzgjodhën praktikat e përpunuara në kanalin BLU, për të cilat u përdorën teknika të ndryshme të ekzaminimeve nëpërmjet sistemit IDEA të raporteve të përpunuara në sistemin ORACLE, si dhe Asycuda ŴORLD.

Nga auditimi u konstatua që është pranuar transaksioni dhe për raste kur vlerat e artikujve kanë qenë nën referencë, por dokumentacioni bashkëngjitur praktikave doganore nuk justifikonte metodën e përdorur. U konstatua që është bërë ndërhyrje duke mos e pranuar transaksionin por masa e ndërhyrjes nuk ka qenë në nivelet e operatorëve të tjerë për të njëjtin artikull nga e njëjta origjinë. Gjatë auditimit janë përdorur metodat e ekzaminimit kryq, rishikimit analitik, shqyrtimit të dokumentacionit, metodën e krahasimit të mallrave të njëjtë të deklaruar brenda të njëjtës degë doganore por jo vetëm, si dhe një kombinim teknikash: si shqyrtimi i dokumentave justifikuese dhe krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimi analitik *(auditimi i vërtetësisë, rakordimet, krahasimet)*. Për artikujt sensitiv të cilët rezultuan me probleme në vlerësimin doganor nga ky sektor, auditimi u shtri edhe për të njëjtët artikuj të përpunuar nga SVQ. Nga auditimi u konstatuan veprime jo në përputhje të kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..",* ndryshuar me pikën 7 dhe 8 të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* nxjerrë për këtë qëllim.

Konkretisht:

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikujve *"Kafe kokërr e pjekur; kafe kokërr e papjekur; kafe e pjekur e bluar; kafe në bustina; kafe në tableta"*, deklaruar në kodin tarifor *0901* të NKM, me origjinë EU & NEU, me nivel të taksës doganore 0 %, nga SVQ dhe SKAO disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion , veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve për vitin 2018, të përpunuar në sistemin doganor, nga këta sektorë, artikulli nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit sipas të dhënave të miratuara nga Komisioni "AD-HOC" i MFE sipas të dhënave të burimit "Reuters". Për të gjitha DAV-et e pasqyruara në material është bërë rivlerësim sipas metodës 6 të vlerësimit sipas të dhënave të miratuara në fuqi në datën importit të artikullit.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Qingja të gjallë"*, deklaruar në kodin tarifor *01041030* të NKM, me origjinë EU *(Rumani)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, praktika doganore me R-17360, datë 11.12.2018, është trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull nga i njëjti eksportues, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me 2 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë praktikat e përpunuara për vitin 2018, citojmë DAV me: R-13552, datë 27.09.2018; R-15158, datë 26.10.2018; R-16844, datë 30.11.2018, etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Qumësht në konfeksione 1 litër me 1.5 % - 3.8 % yndyrnë"*, deklaruar në kodin tarifor *04012011* të NKM, me origjinë NEU *(Bosnjë Hercegovina)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull nga i njëjti eksportues me origjinë nga NEU, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, përkatësisht me 0.49; 0.51 & 0.53 €/litër në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë praktikat e përpunuara për vitin 2018, citojmë DAV me: R-17659, datë 02.03.2018; R-86129, datë 12.09.2018; R-81573, datë 28.08.2018 etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Fidanë ulliri"*, deklaruar në kodin tarifor *06022080* të NKM, me origjinë EU *(Greqi)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, praktika doganore me R-1248, datë 28.11.2018, është trajtuar me transaksion, veprim ky jo në

përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull nga i njëjti eksportues, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me me 5 €/copë në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-1244, datë 27.11.2018, përpunuar një ditë më parë nga ky sektor).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Malto për birrë jo e pjekur"*, deklaruar në kodin tarifor *11071099* të NKM, me origjinë EU *(Kroaci)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO dhe SVQ, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull nga i njëjti eksportues, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO apo SQV, është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, përkatësisht me 400 €/ton në kushtet e lëvrimit FOB, ndërsa transporti me 1600 €, *(mjaft të citojmë praktikat e përpunuara për vitin 2018, citojmë DAV me: R-44099, datë 17.05.2018; R-53702, datë 11.06.2018; R-63453, datë 07.07.2018; R-100562, datë 22.10.2018, etj; ndërsa në DAV me R-30466, datë 10.04.2018, në aktin e inspektimit citohet se: "U krye kontrolli dokumentar, u derguan formularet e rivleresimit, si axhensis edhe apostoriorit te deges. U be amendimi i davit ne baze te vendimit 461 dt. 25.05.2018 te deges doganore Tirane").*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Dhjam industrial"*, deklaruar në kodin tarifor *15180091* të NKM, me origjinë EU *(Itali)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull nga i njëjti eksportues me origjinë nga EU, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 507.69 €/ton në kushtet e lëvrimit CIF, *(mjaft të citojmë praktikat e përpunuara për vitin 2018, citojmë DAV me: R-4134, datë 24.05.2018; R-2974, datë 23.04.2018; R-6535, datë 18.07.2018; R-7240, datë 04.08.2018; R-9288, datë 26.09.2018; R-10460, datë 24.10.2018 etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Peshk ton i konservuar"*, deklaruar në kodin tarifor *16041421* të NKM, me origjinë NEU *(Tajlandë, Indonezi dhe Vietnam)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull me origjinë nga NEU *(vende me të cilat administrata doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi)*, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 3.6 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë praktikat e përpunuara për vitin 2018, citojmë DAV me: R-71280, datë 27.07.2018; R-82156, datë 30.08.2018; R-108484, datë 12.11.2018; R-79863, datë 22.08.2018, etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Pure patate"*, deklaruar në kodin tarifor *20052010* të NKM, me origjinë EU *(Gjermani)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull me origjinë nga EU, nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO është rivlerësuar sipas metodës 3 të vlerësimit me 3.1 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB,

(mjaft të citojmë praktikat e përpunuara për vitin 2018, citojmë DAV me: R-26614, datë 28.03.2018, në bazë të Vendimit të DD. Tiranë nr. 459, datë 25.05.2018; R-49125, datë 29.05.2018, etj).

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Ushqim i përgatitur nga yndyrnat vegjetale"*, deklaruar në kodin tarifor *21069092* të NKM, me origjinë EU *(Poloni)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull me origjinë nga EU, nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO është rivlerësuar sipas metodës 2 të vlerësimit me 1.24 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, ndërsa transporti 2960 €, *(mjaft të citojmë praktikat e përpunuara për vitin 2018, citojmë DAV me: R-55276, datë 14.06.2018; R-69473, datë 23.07.2018; R-115768, datë 01.12.2018; R-122449, datë 18.12.2018, ndërsa në DAV me R-106826, datë 07.11.2018 i njëjti artikull është deklaruar dhe transaktuar me 2.34 €/kg).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Përgatitje ushqimore (djath i bardhë danez)"*, deklaruar në kodin tarifor *21069092* të NKM, me origjinë EU *(Danimarkë)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, praktika doganore me R-125203, datë 24.12.2018, është trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se i njëjti artikull i deklaruar në të njëjtin kod tarifor *(ndërkohë që ky është djath dhe jo thjesht përgatitje ushqimore)*, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore është deklaruar me mbi 1.6 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, ndërsa për rastin e deklaruar nën 1.6 €/kg, është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me me 1.6 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-116069, datë 03.12.2018).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikujve *"Pije freskuese & pije freskuese energjike"*, deklaruar në kodin tarifor *22021000* të NKM, me origjinë NEU *(Kosovë & Sërbi)*, me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikujve të njëjtë, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikujt nga i nëjti eksportues, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqiten të deklaruar dhe transaktuar me çmime të ndryshme dhe se nga SKAO janë rivlerësuar sipas metodës 3 të vlerësimit përkatësisht me 0.32 €/litër dhe 0.83 €/litër në kushtet e lëvrimit FOB, *(thuajse shumica e praktikave të përpunuara për vitin 2018, ku mjaft të citojmë DAV me: R-47191, datë 25.05.2018; R-78622, datë 17.08.2018; R-88407, datë 19.09.2018; R-99806, datë 09.10.2018, etj).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Birrë nga malti PEJA, ambalazhi në qelq dhe kanaçe alumini"*, deklaruar përkatësisht në kodin tarifor *22030001* dhe *22030009* të NKM, me origjinë NEU *(Kosovë)*, me nivel të taksës doganore 0 %, në kushtet e lëvrimit DAP *(me vlerë transporti 0 lekë)*, konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga i nëjti eksportues, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore nga SKAO janë rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit përkatësisht me 0.48 €/litër dhe 0.52 €/litër në kushtet e lëvrimit FOB, ndërsa transporti është rivlerësuar me 314 €, *(thuajse shumica e praktikave të përpunuara për vitin 2018, ku mjaft të citojmë DAV me: R-6724, datë 29.01.2018; R-23474, datë 20.03.2018; dhe shumë të tjera).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Gëlqere e pashuar & e shuar"*, deklaruar përkatësisht në kodin tarifor *25221000* dhe *25222000* të NKM, me origjinë EU *(Greqi & Kroaci)*,

me nivel të taksës doganore 0 %, konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga i njëjti eksportues, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore nga SKAO janë rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit përkatësisht me 0.06 €/kg dhe 0.075 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, ndërsa transporti është rivlerësuar me 1000 € nga Kroacia dhe 600 € nga Greqia, *(thuajse shumica e praktikave të përpunuara për vitin 2018, ku mjaft të citojmë DAV me: R-16333, datë 27.02.2018; R-833, datë 01.08.2018; R-81, datë 24.01.2018; R-1267, datë 04.12.2018; R-26565, datë 08.11.2018; R-5162, datë 24.03.2018; R-25024, datë 23.10.2018; dhe shumë të tjera).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Torfe (pleh për lulet)"*, deklaruar në kodin tarifor *27030000* të NKM, me origjinë EU, me nivel të taksës doganore 0 %, konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga i njëjti eksportues, importuar nga i njëjti importues, në këtë degë doganore paraqitet i deklaruar dhe transaktuar me çmimin mbi 0.2 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB *(mjaft të citojmë DAV me R-19329, datë 16.02.2018; R-80011, datë 23.08.2018; etj)*, ndërsa nga SKAO, artikulli është rivlerësuar sipas metodës 3 të vlerësimit me 0.2 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(mjaft të citojmë DAV me R-50044, datë 31.05.2018).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Ngjitës të ndryshëm"*, deklaruar në kodin tarifor *35051050* të NKM, me origjinë EU, trajtuar me MSABE me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se nga i njëjti eksportues, për të njëjtin importues, në këtë degë doganore, paraqitet me çmime të ndryshme dhe se dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Gjithashtu nga SKAO, i njëjti artikull është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me me 1.7 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-63473, datë 07.07.2018).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Diluent"*, deklaruar në kodin tarifor *38140090* të NKM, me origjinë EU, trajtuar me MSABE me nivel të taksës doganore 0 % konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se nga i njëjti eksportues, për të njëjtin importues, në këtë degë doganore, paraqitet me çmime të ndryshme dhe se dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Nga SKAO, artikulli duhej rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me me 1.1 €/litër në kushtet e lëvrimit FOB

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Profile PVC për dyer dhe dritare & shkopinj e shufra të profilizuara prej PVC për perde"*, deklaruar në kodin tarifor *39162000* të NKM, me origjinë EU, trajtuar me MSABE me nivel të taksës doganore 0 %, konstatohet se nga SKAO, shumë praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga i njëjti eksportues, për të njëjtin importues, në këtë degë doganore, paraqitet me çmime të ndryshme, shumë i ulët krahasuar me vlerat e deklaruara dhe transaktuara nga subjektet e tjerë si dhe të dhënat e disponueshme, dhe se dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Gjithashtu nga SKAO, i njëjti artikull është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me me 2.6 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-5660, datë 18.09.2018; R-3719, datë 18.06.2018),* ndërsa për DAV me R-102491, datë 26.10.2018 dhe R-

123759, datë 21.12.2018 artikulli është rivlerësuar me 1.9 €/kg në kushtet e levrimit FOB. Citojmë faktin se artikulli është lëvruar në inkotermin CIP dhe se vlera e transportit është deklaruar 0 lekë.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Zorrë artificiale për sallam"*, deklaruar në kodin tarifor *39171010* të NKM, me origjinë EU & NEU, trajtuar me origjinë preferenciale, konstatohet se nga SKAO, shumë praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga i njëjti eksportues, për të njëjtin importues, në këtë degë doganore, paraqitet me çmime të ndryshme, dhe i ulët krahasuar me vlerat e deklaruara dhe transaktuara nga subjektet e tjerë, *(citojmë DAV me R-8333, datë 02.02.2018; R-59588, datë 27.06.2018; R-68658, datë 20.07.2018; R-88912, datë 20.09.2018, de shumë të tjerë me cmim mbi 12 €/kg),* si dhe të dhënat e disponueshme, dhe se dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Gjithashtu nga SKAO, i njëjti artikull është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me 12 €/kg nga EU dhe 12 $/kg nga NEU në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-964, datë 29.03.2018; R-712, datë 08.03.2018; R-1889, datë 18.06.2018; etj.).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Tuba plastike për vaditje"*, deklaruar në kodin tarifor *39173100* të NKM, me origjinë EU *(Greqi)*, trajtuar me origjinë preferenciale, konstatohet se nga SKAO, rezultojnë praktika doganore të trajtuara me çmim të transaktuar nën çmimin e lëndës së parë, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli paraqitet mbi vlerën e të dhënave të disponueshme, mbi 1.75 €/kg.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Tubo plastike (fleksibël) për instalime elektrike"*, deklaruar në kodin tarifor *39173100* të NKM, me origjinë EU, trajtuar me origjinë preferenciale, konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga i njëjti eksportues, për të njëjtin importues, në këtë degë doganore, paraqitet me çmime të ndryshme, dhe se dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Gjithashtu nga SKAO, artikulli në shumë DAV-e është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me vlerën më të lartë (1.74 €/kg) dhe vlerën më të ulët (1.73 €/kg), të publikuar në dosjen e të dhënave të dipsonueshme nga EU në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-3840, datë 03.04.2018; R-1951, datë 17.02.2019; R-6797, datë 07.06.2018; R-12724, datë 28.10.2018; etj.).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Granulat gome për shtrim fusha minifutbolli"*, deklaruar në kodin tarifor *40040000* të NKM, me origjinë EU, trajtuar me origjinë preferenciale, konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli paraqitet me çmime të ndryshme, dhe se dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Gjithashtu nga SKAO, artikulli në shumë DAV-e është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me 0.25 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-47032, datë 24.05.2018; R-81083, datë 27.08.2019; R-102544, datë 27.10.2018; etj.).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Karton i veshur me plastik (duplex i stampuar)"*, deklaruar në kodin tarifor *48115900* të NKM, me origjinë NEU, trajtuar me origjinë preferenciale, konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga i njëjti eksportues, për të njëjtin

importues, në këtë degë doganore, paraqitet me çmime të ndryshme, mbi atë referues të publikuar në dosjen e të dhënave të disponueshme, *(citojmë DAV me R-2324, datë 23.02.2018; R-5308, datë 25.04.2018; R-7600, datë 09.06.2018; R-12537, datë 07.09.2018, dhe shumë të tjera me cmim mbi 4 €/kg),* si dhe të dhënat e disponueshme, dhe se dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Gjithashtu nga SKAO, i njëjti artikull është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me 4 €/kg nga NEU në kushtet e lëvrimit CIF, *(citojmë DAV me: R-1301, datë 27.04.2018; etj.).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Pllaka qeramike"*, deklaruar në kodin tarifor *69072200* të NKM, me origjinë nga EU & NEU, konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga e njëjta origjinë (madje nga i njëjti eksportues), për të njëjtin importues, paraqitet me çmime të ndryshme, dhe se dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Gjithashtu nga SKAO, i njëjti artikull është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me 4 €/m^2 nga EU dhe 3.3 €/m^2 nga NEU në kushtet e lëvrimit FOB.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Membranë bituminoze për hidroizolim (katrama)"*, deklaruar në kodin tarifor *68071000* të NKM, me origjinë EU & NEU, trajtuar me origjinë preferenciale, konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga i njëjti eksportues, për të njëjtin importues, në këtë degë doganore, paraqitet me çmime të ndryshme, si dhe shumë ulët krahasuar me të dhënat e disponueshme dhe çmimin e deklaruar për të njëjtin artikull nga subjekte të tjerë, dhe se dokumentacioni bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Gjithashtu nga SKAO, i njëjti artikull është rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me 1 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-23866, datë 26.02.2018; R-73344, datë 02.08.2018; R-15499, datë 23.02.2018; R-68540, datë 20.07.2018; R-97665, datë 15.10.2018; R-12718, datë 07.09.2018 etj.).*

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Hidrosanitare"*, deklaruar në kodin tarifor *68071000* të NKM, me origjinë NEU, konstatohet se nga SVQ & SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion apo ndërhyrje (rivlerësim) por jo në përputhje me kërkesat e Urdhër nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatoreve kontrolli shtese ne vleresimin doganor te mallrave me origjine nga vendet jashte BE/NEU"*, i cili thekson se, ***citojmë:*** *"Ne rast se gjate deklarimit te ketyre mallrave ne dogane konstatohen raporte me te uleta se sa indikatoret e kontrollit shtese sipas tabeles se mesiperme, strukturat e deges doganore* ***te kryejne te gjitha nderhyrjet e nevojshme****, perfshi edhe kontrollin e detajuar fizik me qellim qe te shmangen anomalite e mundshme ne vleresimin doganor te mallrave dhe sidomos te vleres se mallrave me peshen e tyre.".* Dokumentacioni tregtar bashkëlidhur praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Nga SVQ & SKAO, artikulli duhej rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me 150 lekë/kg nga NEU dhe 125 lekë/kg nga Kina në kushtet e lëvrimit CIF.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit *"Gota pije qelqi të thjeshta"*, deklaruar në kodin tarifor *70132890* të NKM, me origjinë EU, trajtuar me origjinë preferenciale, konstatohet se nga SKAO, disa praktika doganore janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor, pasi referuar importeve dhe deklarimeve të artikullit, nxjerrë nga sistemi ORACLE, rezulton se artikulli nga i njëjti eksportues, për të njëjtin importues, paraqitet me çmime të ndryshme, mbi atë referues të publikuar në dosjen e të dhënave të disponueshme, *(citojmë DAV me R-115059, datë 30.11.2018, etj),* si dhe të dhënat e disponueshme, dhe se dokumentacioni bashkëlidhur

praktikave doganore nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion. Nga SKAO, artikulli duhej rivlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit, me 0.45 €/copë nga EU në kushtet e lëvrimit FOB.

♦ Lidhur me importet dhe deklarimet e artikullit "*Rimorkio dhe gjysëmrimorkio*" deklaruar në kapitullin *87* të NKM me nivel të taksës doganore 2 %, nga sektori i vlerës nuk është bërë një analizë e thelluar lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a, të Kodit të Ri Doganor, pasi, referuar importeve dhe deklarimeve të këtyre artikujve, nxjerrë nga sistemi ORACLE rezulton se ato janë rivlerësuar sipas metodës 2 të vlerësimit me 0.7 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB, *(citojmë DAV me: R-3301, datë 23.03.2018; R-3493, datë 07.05.2018; R-42785, datë 14.05.2018; R-9051, datë 20.09.2018; R-88040, datë 18.09.2018; R-16904, datë 12.11.2018, por jo vetëm.).* Nisur nga sa më sipër artikujt e përdorur të kapitujve të sipërcituar të pasqyruar në material duheshin rivlerësuar jo më pak se 0.7 €/kg. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore të këtyre artikujve konstatohet se edhe pse artikujt janë deklaruar nën çmimin e skrapit të publikuar te bursa "Metal Buletin", janë trajtuar me transaksion *(citojmë DAV me R-4003, datë 07.04.2018, etj).* Nga sektorët e sipërcituar është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a, të Kodit të Ri Doganor**.**

*Konstatimi i mësipërm, **për 513 raste, me vlerë 34,638,400 lekë të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit,** (e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar), evidentohet më konkretisht në Aneksin nr. 5 të Projektraportit të Auditimit.*

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësve: z. A. H. me detyrë përgjegjës sektori SKAO; z. H. E. me detyrë përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë; K. Ç. me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/ kontroll fizik në DD. Sarandë; z. A. T. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë; z. A. V. dhe z. I. P. me me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Durrës; z. H. B. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Berat; z. E. Sh., z. D. M. dhe z. A. Zh. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Kakavie; zj. A. H. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Shkodër, z. K. V. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Vlorë; zj. E. Sh. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Korçë; z. A. L.; z. A. B. dhe z. P. T., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës zyre në SVQ, pranë DPD; z. K. N. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Sarandë; z. Dh. Xh. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Berat; z. A. Sh., z. A. Sh., zj. L. B., z. E. D., z. M. Z., zj. O. V., zj. E. B., zj. E. Ç., z. A. K., z. A. N., z. K. B., z. A. B., zj. K. Xh., zj. L. D., z. A.V., z. F. S., z. E. S., z. Sh. S., z. A. D., z. E. N., zj. S. D., z. R. D., zj. A. H., z. B. N., z. G. U., z. E. P., z. R. B. dhe z. I. R., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ), pranë DPD, si dhe z. E. Th., z. I. M., z. P. R., zj. E. K., z. D. B., z. A. S., z. B. D., zj. M. Z., z. S. T., z. E. I., z. R. Sh., zj. I. B., z. E. Gj., z. R. M., zj. E. Sh., z. I. Ç. dhe z. A. D., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO), pranë DPD, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra përkatësisht: në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012; seksionit III, pika 1.5, shkronja "d" si dhe seksionit IV, pika 1.9, shkronja "d"të Udhëzimit nr. 5, datë 26.01.2018 të DPD *"Mbi funksionimin e seksioneve të vlerës në qendër dhe aposteriorit operativ në DPD",* përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për zbatimin e kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me vlerësimin doganor të mallrave.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

- Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",* neni: 171, pika 2; 70, pika 2, shkronja "a" dhe "b"; 70, pika 3;
Udhëzimin nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore"*, pika7, pika 10, pika 11;

- Urdhërin nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*.

Për 513 raste, vlera prej 34,638,400 lekë, efekt financiar në Buxhetin e Shtetit *(e cila është e ardhur e munguar),* ***do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. A. H. me detyrë përgjegjës sektori SKAO;
2. Z. H. E. me detyrë përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë;
3. Z. K. Ç. me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/ kontroll fizik në DD. Sarandë;
4. Z. A. T. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Tiranë;
5. Z. A. V. dhe z. I. P. me me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Durrës;
6. Z. H. B. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Berat;
7. Z. E. Sh., z. D. M. dhe z. A. Zh. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Kakavie;
8. Zj. A. H. me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i sektorit operacional në DD. Shkodër;
9. Z. K. V. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Vlorë;
10. Zj. E. Sh. me detyrë dhe në cilësinë e specialist i kontrollit aposterior në DD. Korçë;
11. Z. A. L.; z. A. B. dhe z. P. T., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës zyre në SVQ, pranë DPD;
12. Z. K. N. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Sarandë;
13. Z. Dh. Xh. me detyrë dhe në cilësinë e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, pranë DD. Berat;
14. z. A. Sh., z. A. Sh., zj. L. B., z. E. D., z. M. Z., zj. O. V., zj. E. B., zj. E. Ç., z. A. K., z. A. N., z. K. B., z. A. B., zj. K. Xh., zj. L. D., z. A.V., z. F. S., z. E. S., z. Sh. S., z. A. D., z. E. N., zj. S. D., z. R. D., zj. A. H., z. B. N., z. G. U., z. E. P., z. R. B. dhe z. I. R., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në sektorin e vlerës në qendër (SVQ), pranë DPD;
15. z. E. Th., z. I. M., z. P. R., zj. E. K., z. D. B., z. A. S., z. B. D., zj. M. Z., z. S. T., z. E. I., z. R. Sh., zj. I. B., z. E. Gj., z. R. M., zj. E. Sh., z. I. Ç. dhe z. A. D., me detyrë dhe në cilësinë e doganier i sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO).

Shënim:
1. Auditimi i kësaj pike të programit nuk është audituar plotësisht për shkak të mos angazhimit të plotë të stafit në auditim si dhe ngarkesës dhe volumit të madh, ndaj mbetet për tu audituar në auditimin pasardhes.
2. *Lidhur me përgjegjësitë e punonjësve në përpunimin e deklaratave doganore të pasqyruara në material, të cilat rezultojnë me probleme, nga ana e strukturave përkatëse në DPD apo DD, të dalin përgjegjësitë pasi nga grupi i auditimit nuk u mundësua dot nxjerrja e masës së shkeljeve për secilin personat përgjegjës për arsye kohe, e cila ishte e limituar në raport me konstatimet.*

6. Përputhshmëria ligjore në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime si dhe ankande të realizuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë e shërbime nga subjekti i audituar. Zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike. Argumentimi dhe përllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra, punë e shërbime.

- Përputhshmëria ligjore në realizimin e prokurimeve të fondeve publike dhe zbatimi i kontratave

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit "Nr.242/1 datë 06/06/2019", lidhur me zbatimin e procedurave të prokurimit të kryera nga ky subjekt, bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik si dhe në aktet ligjore e nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit, ku për vitin ushtrimor janë zhvilluar gjithsej 26 procedura prokurimi me fond limit 133,720,121 lekë, sipas çështjeve të trajtuara, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistri realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2018.
2. Dosjet e procedurave të prokurimeve.
3. Aksesi në sistemin e prokurimeve publike në faqen e APP (.http://www.app.gov.al/).
4. Planifikimi buxhetor i prokurimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

1. Mbi Planifikim Buxhetor dhe mbështetjen në fonde buxhetore të investimeve

Nga informacioni i vënë në dispozicion mbi planifikimin buxhetor të investimeve kapitale në DPD, u audituan me përzgjedhje procedurat e prokurimit në zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", dhe Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2 datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", ku rezulton si më poshtë:

Planifikimi buxhetor për Investimet 2018 në DPD *Tabela nr. 1:*

Nr	*Emri i projektit*	*Kodi projektit*	*Planifikimi PBA 2018-2020*	*Planifikimi Ligj buxheti*	*Urdhër prokurim*			*Organi që ka zhvilluar procedurë*
					Data	*Miratim thesari*	*Fondi limit*	
1	Ruajtja me roje private			25,300,000	28.12.2017	Jo	2,379,030	DPD
2	Ruajtja me roje private				26.02.2018	Po	5,185,082	DPD
3	Ruajtja me roje private		24,310,000		16.01.2018	Po	18,493,461	DPD
4	Blerje plumbçe metalike, plumbçe plastike dhe tel lidhës		10,000,000	24,000,000	10.11.2017	Po	23,558,287	DPD
5	Reagente Kimik		6,000,000	6,000,000	12.03.2018	Po	4,994,720	DPD
6	Mirëmbajtje sisteme peshimi		3,000,000	2,000,000	06.04.2018	Po	1,660,000	DPD
7	Blerje dhe montim stabilizator tensioni	M100493	6,000,000	6,000,000	19.03.2018	Po	1,660,000	DPD
8	Blerje dhe montim Gjeneratorë	M100454	12,000,000	12,000,000	19.03.2018	Po	9,600,000	DPD
9	Projekt për rikonceptimin e Doganës Kapshtice	M100449	6,695,000	6,695,000	20.03.2018	Po	4,493,213	DPD
10	Mirëmbajtje/Riparim - automjete të DPD-së dhe furnizim vendosje të pjesëve të këmbimit të tyre		6,200,000	3,500,000	07.05.2018	Po	2,914,800	DPD
11	Blerje dhe instalim të aksesorëve për linjën e gazeve në LD		0	0	23.05.2018	Po	1,609,000	DPD
12	Blerje peshore rruge portative (aksiale) për mjetet e transportit	M100457	4,500,000	4,500,000	26.04.2018	Po	3,742,000	DPD
13	Shërbim Interneti		7,000,000	4,000,000				AKSHI
14	Blerje Tonera `		5,532,000	4,702,205				ABP
15	Vaj Lubrifikant			1,500,000				ABP
16	Goma për Automjete		2,595,000					ABP
17	Blerje Kabina Zyre	M100451	1,300,000	3,000,000	14.08.2018	Po	2,110,000	DPD
18	Blerje Fotokopje	M100538	20,000,000	21,476,095				AKSHI
19	Blerje Kompjutera	M100498						AKSHI

20	Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim	M100177	4,981,000	6,336,000				ABP
21	Rivënie në funksion të sistemit të mbrojtjes nga zjarri për DPD	M100524	0	0	18.10.2018	Po	1,125,800	DPD
22	Blerje e aparatit për analizimin e tensionit të shpimit për DPD	M100455	5,400,000	5,400,000				ABP
23	Blerje bango laboratorike, kapa laboratorike	M100327	7,000,000	7,000,000				ABP
24	Blerje e dy kabineteve për mbajtjen e solventeve dhe reagenteve kimik	M100456	1,300,000	1,300,000				ABP
25	Blerje Aparatit GC për analizimin e gazeve	M100494	8,400,000	8,400,000				ABP
26	Studim projektimi për rikonceptimin e hapësirave të Degës së Doganës Vlorë	M100268	1,000,000					DPD

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPD – Punoi: KLSH

Sa më sipër, rezultoi se:

a- Për një projekt investimi planifikimi buxhetor nuk është bërë në përputhje me legjislacionin dhe nuk ka ndjekur me përpikmëri hapat për planifikim të parashikuara në legjislacion, mungon planifikimi edhe në Programin Buxhetor Afatmesëm edhe në Ligj Buxheti, konkretisht për procedurën "Blerje Kompjutera" me kod M100498, në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 40, në të cilin përcaktohet se: "Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga MFE që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direkt në sistemin informatikë financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë sistem angazhimin, brenda pesë ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij, kundrejt urdhrit të prokurimit". Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor A. S. me detyrë ish-Zv/Drejtor i Përgjithshëm Administrativ.

2. Procedura prokurimit publik me objekt "Blerje dhe instalim të aksesorëve për linjën e gazeve në Laboratorin Doganor", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 33, me nr. 12215 prot., date 23.05.2018	NJHDT K. V. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 12215/2 prot., datë 23.05.2018 P. D. – kryetar A. Z. – anëtar L. M.- anëtar
Fondi limit 1,609,000 lekë		
Procedura e prokurimit – Kërkesë për propozim		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: O. "G." shpk	Vlera fituese 1,609,000 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 04.06.2018	Diferenca nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr. 12215/5 prot., datë 23.07.2018
Marrin pjesë 1 OE S`kualifikuar 0 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 12215/3 prot., datë 19.06.2018	Vlera e kontratës 1,609,000 lekë pa tvsh dhe 1,930,800 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës 60 ditë nga data e nëshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit nuk u konstatuan mangësi pasi ishin në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

B. Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje dhe instalim të aksesorëve për linjën e gazeve në Laboratorin Doganor", rezultoi se në tender ka marrë pjesë 1 operator, për të cilin KVO ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	***Operatori ekonomik pjesëmarrës***	***Oferta ekonomike (pa tvsh)***	***Vlerësimi i KVO-së***
1	"G....." shpk	1,609,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga O. "G....." shpk, me vlerë 1,609,000 lekë, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues këtë operator pasi ka plotësuar kriteret e dst.

3. Procedura prokurimit publik me objekt "Blerje kabina zyre me një dhe disa poste pune për DD Durrës", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 42, me nr. 18807 prot., datë 14.08.2018	NJHDT K. V. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 18807/2 prot., datë 14.08.2018 N. T. – kryetar E. L. – anëtar S. A.- anëtar
Fondi limit 2,110,000 lekë		
Procedura e prokurimit – Kërkesë për propozim		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: O. "A." shpk	Vlera fituese 1,874,800 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 27.08.2018	Diferenca nga fondi limit 235,200 lekë.	Kontrata nr. 20072/5 prot., datë 07.10.2018
Marrin pjesë 4 OE S`kualifikuar 1 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 20072/3 prot., datë 18.09.2018	Vlera e kontratës 1,874,800 lekë pa tvsh dhe 2,249,760 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - po Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës 25 ditë nga data e nëshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – B. I.; A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit nuk u konstatuan mangësi pasi ishin në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

B. Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje kabina zyre me një dhe disa poste pune për DD Durrës", rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 4 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	***Operatori ekonomik pjesëmarrës***	***Oferta ekonomike (pa tvsh)***	***Vlerësimi i KVO-së***
1	"A." shpk	1,874,800	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"Sh." shpk	1,890,000	Kualifikuar
3	"P." shpk	2,070,000	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: - Vërtetimi i paraqitur për shlyerjen e energjisë elektrike nuk përputhet me afatin e zhvillimit të procedurës
4	"B." shpk	2,108,000	Kualifikuar

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga OE "A." shpk, me vlerë 1,874,800 lekë, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues këtë operator pasi ka plotësuar kriteret e dst.

Ankesa për vlerësimin e ofertave:

1. ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik "Sh." shpk

- me shkresën e protokolluar në DPD me nr. 20072 prot., datë 04.09.2018 ky OE paraqet kundërshtimet e tij në lidhje me arsyet e kualifikimit të OE "A." shpk, i cili sipas ankimuesit nuk ka pltësuar kriteret e dst në lidhje me punët e ngjashme dhe mos shlyerjen e energjisë elektrike.
- Me urdhërin nr. 20072/1, datë 04.09.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar të pezullohet vazhdimi i procedurës prokurimit dhe është ngarkohet drejtoria juridike për shqyrtimin e ankesës.
- Me shkresën nr. 20072/2, prot., datë 07.09.2018 drejtuar subjektit ankimues është vendosur mos pranimi ankesës.

4. Procedura prokurimit publik me objekt "Mirëmbajtje/Riparim mjete transporti-automjete të DPD-së dhe furnizim vendosje të pjesëve të këmbimit të tyre", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 30, me nr. 6944/2 prot., datë 7.5.2018	NJHDT K. V. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 6944/4 prot., datë 07.05.2018; urdhrit nr. 6944/6 datë 18.05.2018. I. M. – kryetar N. D. – anëtar A. H.- anëtar
Fondi limit 2,914,800 lekë		
Procedura e prokurimit – Kërkesë për propozim		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "S...." shpk	Vlera fituese 2,584,620 lekë pa tvsh

Datë e hapjes së tenderit 21.05.2018 ora 10:00; shtyrë për në 6.6.2018	Diferenca nga fondi limit 330,180 lekë.	Kontrata nr. 15436 prot., datë 29.06.2018
Marrin pjesë 1 OE S`kualifikuar 0 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 6944/7 prot., datë 19.06.2018	Vlera e kontratës 2,584,620 lekë pa tvsh dhe 3,101,544 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - po Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 31.12.2018	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.

Në bazë të urdhrit nr. 6944 prot., datë 20.03.2018 është ngritur grupi i posaçëm i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret teknike e profesionale kualifikuese të operatorëve ekonomik pjesëmarrës dhe llogaritjen e vlerës limit i përbërë nga I. B., N. H. dhe S. I..

Sipas urdhrit të mësipërm është hartuar procesverbali nr. 6944/1 prot., datë 04.05.2018 nga grupi i posaçëm i punës ku përcaktohen specifikimet teknike, fondi limit dhe kriteret teknike për kualifikim.

Njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbalin datë 10.05.2018 mbi zhvillimin e mbledhjes me objekt hartimin e DST dhe kritereve të kualifikimit, ne të cilën theksohet u përdorën specifikimet teknike, analiza e fondit limit dhe kriteret e kualifikimit të paraqitura me shkresën nr. 6944/1 prot., datë 04.05.2018 nga grupi i posaçëm i punës.

Nga auditimi i DST rezultoi se:

a- Titullari i autoritetit kontraktor nuk ka nxjerrë urdhër për përcaktimin e personit/personave përgjegjës për prokurim, duke vepruar në kundërshtim me nenin VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, neni 56 "Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar" dhe neni 57 "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit" pika 1, në të cilën thuhet se: "1.Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik", çka ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor A. S. me detyrë ish-Zv/Drejtor i Përgjithshëm Administrativ.

b- Në procesverbalin e njësisë së prokurimit datë 10.05.2018 ora 11:00 janë përdorur kritere kualifikuese të ndryshme nga ato të përcaktuara shkresën nr. 6944/1 prot., datë 04.05.2018 të grupit të posaçëm të punës, të cilat janë reflektuar edhe ne DST e publikuara, konkretisht kriteret e më poshtme:

- është shtuar kriteri për lejen mjedisore sipas Kodit III.1.B,
- distanca e servisit nga 10 km është bërë 15 km,
- është shtuar kriteri për certifikatën ISO, etj.

Sa më sipër, njësia e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, neni 57 "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit" pika 4, paragrafi fundit në të cilin thuhet se "Në rast se detyrat e sipërpërmendura nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit për objektin që prokurohet", pasi jemi në rastin kur këto kritere janë kryer nga një grup i posaçëm.

b/1- Gjithashtu nga auditimi u konstatua se kriteri për lejen mjedisore sipas "Kodit III.1.B" nuk është i argumentuar dhe aspak i lidhur ngushtë e në përpjestim me objektin e kontratës, për arsye se objekti i prokurimit është mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, ndërsa sipas ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, shtojca 1, pika 10.5 dhe 10.6, kapaciteti kufi për lejet, nuk përfshin lejet e mjedisit të tipit B.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (c), (ç), (d), (dh) dhe Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c, neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 28 "Kontratat e shërbimeve", pika 2, në të cilën thuhet se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në

përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve", neni 30 "Kërkesat e cilësisë" pika 2, neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2 paragrafi 2, dhe ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, shtojca 1, pika 10.5 dhe 10.6. Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e njësisë prokurimit të pëbërë nga K. V., S. R. dhe R. H..

Observacioni nr. 8878/12 prot., datë 20.08.2019, për akt-konstatimin nr. 3 datë 16.08.2019, paraqitur nga anëtarët e njësisë prokurimit K. V., S. R. dhe R. H., në lidhje me kriteret kualifikuese në procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje/Riparim mjete transporti-automjete të DPD-së dhe furnizim vendosje të pjesëve të këmbimit të tyre", në të cilën pretendohet se:
- vendosja e kriterit për certifikaten ISO 9001:2008 është në përputhje me nenin 30 të VKM 914.
- distanca e servisit është bërë nga 10 km në 15 km me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në tender duke rritur kështu rrezen e largësisë në përputhje me nenin 46/3 të LPP.
- në specifikimet teknike sipas shkresës me nr. 6944/1 prot., datë 04.05.2018 kishte zëra punimesh stukime lyerje me bojë pjekje në një masë të konsiderueshme, vendosja e këtij kriteri është në përputhje me ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", shtojca1, pika 7.9 dhe 7.12.

Përgjigja e grupit të auditimit: Në lidhje me kriterin për ISO 9001:2008 dhe distancën e servisit, për të cilat ju pretendoni se janë vendosur konform legjislacionit në fuqi, ju bëjmë me dije se pretendimi i grupit të ka qenë në lidhje me ndryshimin nga ana juaj e kritereve të vendosura nga grupi i posaçëm pasi nuk jeni ju personat përjegjës për hartimi e kritereve kualifikuese. Ndërsa në lidhje me kriterin për lejen mjedisore Kodi III.1.B për të cilën ju pretendoni se ka punime për lyerje dhe stukime të konsiderueshme ju bëjme me dije se në asnjë rast këto sasi nuk justifikojn volumet e përcaktuara në ligjin për lejet mjedisore, duke bërë që kjo kërkesë të mos jetë e lidhur ngushtë me objektin e kontratës objekt prokurimi, në kundërshtim me neni 46/1 të LPP. Sa më sipër, observacioni juaj nuk merret parasysh pasi ju nuk keni sjell fakte dhe argumenta të reja.

Ankesa për dst.

1. Paraqitur nga subjekti "P....." shpk,.
- Me shkresën e protokolluar në DPD me nr. 11572 prot., datë 16.05.2018, ka paraqitur ankesë për kriteret të vendosura në dst, konkretisht për kriterin e lejes mjedisore sipas Kodit III.1.B.
- Me urdhrin nr. 11572/1, datë 16.05.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar të pezullohet vazhdimi i procedurës prokurimit dhe është ngarkuar drejtoria juridike për shqyrtimin e ankesës.
- Me shkresën nr 11572/2 prot., datë 18.05.2018 drejtuar subjektit ankimues ku informohet për mospranimin e ankesës së tij.

2. Paraqitur nga subjekti "Kadiu Sh.a" shpk,.
- Me shkresën e protokolluar në DPD me nr. 11469 prot., datë 18.05.2018, ka paraqitur ankesë për kriteret të vendosura në dst, konkretisht për kriterin e lejes mjedisore sipas Kodit III.1.B.
- Me shkresën nr 11469/2 prot., datë 18.05.2018 drejtuar subjektit ankimues ku informohet për mospranimin e ankesës së tij.

Sa më sipër, titullari i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ka nxjerr urdhrin nr. 11572/1, datë 16.05.2018 ku ngarkon drejtorinë juridike për shqyrtimin e ankesës. Nga verifikimi rezultoi se në urdhër nuk është përcaktuar me emra konkret se cilët persona do të shqyrtojnë ankesën, të cilët me vonë duhet të dalin me vendimin për pranimin ose jo të ankesës së operatorëve ekonomik, duke mos siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të nëpunësve të përfshirë në procesin e në hartimin e dokumenteve të tenderit. Veprime në kundërshtim me VKM nr.

914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, Neni 56 "Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar" neni 78 "Ankesat në autoritetin kontraktor" pika 6, shkronja (a) dhe (ç), çka ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor z. A. S., me detyrë ish-Zv/Drejtor i Përgjithshëm Administrativ.

B. Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje/Riparim mjete transporti-automjete të DPD-së dhe furnizim vendosje të pjesëve të këmbimit të tyre", rezultoi se në tender ka marrë pjesë 1 operator, për të cilin KVO ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	*Operatori ekonomik pjesëmarrës*	*Oferta ekonomike (pa tvsh)*	*Vlerësimi i KVO-së*
1	"S....." shpk	2,584,620	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga OE "S....." shpk, me vlerë 2,584,620 lekë, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues këtë operator pasi ka plotësuar kriteret e dst.

5. Procedura prokurimit publik me objekt "Blerje dhe montim stabilizator tensioni", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 16, me nr. 6834 prot., datë 19.03.2018	NJHDT E. Xh. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 7056 prot., datë 20.03.2018; urdhrit nr. 7884 datë 30.03.2018. A. K. – kryetar E. D. – anëtar E. K.- anëtar
Fondi limit 1,666,000 lekë		
Procedura e prokurimit – Kërkesë për propozim		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "E....." shpk	Vlera fituese 745,000 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 03.04.2018 ora 10:00	Diferenca nga fondi limit 921,000 lekë.	Kontrata nr. 13122 prot., datë 04.06.2018
Marrin pjesë 6 OE S`kualifikuar 2 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 10834 prot., datë 08.05.2018	Vlera e kontratës 745,000 lekë pa tvsh dhe 894,000 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës: 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit nuk u konstatuan mangësi pasi ishin në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

B. Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje dhe montim stabilizator tensioni", rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 6 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	*Operatori ekonomik pjesëmarrës*	*Oferta ekonomike (pa tvsh)*	*Vlerësimi i KVO-së*
1	"E....." shpk	745,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"A....." shpk	880,000	Kualifikuar
3	"F....." shpk	1,120,000	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: - Kontrata e paraqitur nuk është e ngjashme me procedurën që zhvillohet. - Në katalogun e paraqitur specifikimet teknike nuk përputhen me specifikimet teknike te kërkuara. Mungon Faktori i Fuqisë. Zeri Lagështira në specifikimet teknike kërkohet 0-95 %, në katalog është paraqitur <90%.
4	"P....." shpk	1,527,200	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: - Nuk ka paraqitur katalog të pajisjes së kërkuar të përkthyer të noterizuar. Janë paraqitur specifikimet e ngarkuara në DST dhe fotografi e një stabilizatori me specifikime në gjuhën angleze ku nuk janë të përfshira të gjitha zërat e kërkuar. - Vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve të energjisë elektrike është i muajit Shkurt datë 27.02.2018, duhet të paraqitej vërtetim i muajit Mars.
5	"R....." shpk	1,300,000	Kualifikuar
6	"R....." shpk	1,610,000	Kualifikuar

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga OE "Eurocol Service" shpk, me vlerë 745,000 lekë, me vlerë më të ulët, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues këtë operator pasi ka plotësuar kriteret e dst.

6. Procedura prokurimit publik me objekt "Mirëmbajtje e Sistemeve të Peshimit", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 24, me nr. 8324/1 prot., datë 06.04.2018	NJHDT K. V. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 8324 prot., datë 06.04.2018; N.D. – kryetar L. Z. – anëtar E. K.- anëtar
Fondi limit 1,660,000 lekë		
Procedura e prokurimit – Kërkesë për propozim		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "T....." shpk	Vlera fituese 1,658,000 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 23.04.2018	Diferenca nga fondi limit 2,000 lekë.	Kontrata nr. 10477/2 prot., datë 14.05.2018
Marrin pjesë 1 OE S`kualifikuar 0 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 10477/1 prot., datë 03.05.2018	Vlera e kontratës 1,658,000 lekë pa tvsh dhe 1,989,600 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës: nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 31.12.2018	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e Sistemeve të Peshimit", rezultoi se në tender ka marrë pjesë 1 operator, për të cilin KVO ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"T...." shpk	1,658,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga OE "T....." shpk, me vlerë 1,658,000 lekë, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues këtë operator pasi ka plotësuar kriteret e dst.

7. Procedura prokurimit publik me objekt "Blerje plumbçe metalike, plumbçe plastike dhe tel lidhës", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 87, me nr. 25927 prot., datë 10.11.2017	NJHDT K. V. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 25927 /2 prot., datë 10.11.2017 P. K. – kryetar B. T. – anëtar L. Z.- anëtar
Fondi limit 23,558,287 lekë		
Procedura e prokurimit – E hapur		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "Agimi B" shpk	Vlera fituese 14,387,000 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 04.01.2018	Diferenca nga fondi limit 9,171,287 lekë.	Kontrata nr. 10293 prot., datë 02.05.2018
Marrin pjesë 8 OE S`kualifikuar 5 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 6028/2 prot., datë 20.04.2018	Vlera e kontratës 14,387,000 lekë pa tvsh dhe 17,264,400 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - po Ankimime në KPP - po	Afati kontratës 60 ditë nga data e nëshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit nuk u konstatuan mangësi pasi ishin në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

Ankesa për DST

1. Paraqitur nga subjekti "F....." shpk,.

- Me shkresën e protokolluar në DPD me nr.28512 prot., datë 18.12.2017, ka paraqitur ankesë për dy kritere të vendosura në dst.
- Me urdhrin nr. 28729, datë 19.12.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar të pezullohet vazhdimi i procedurës prokurimit dhe është ngarkuar drejtoria juridike, njësia prokurimit dhe drejtoria e teknologjisë së informacionit për shqyrtimin e ankesës.
- Me shkresën nr 28612/1 prot., datë 21.12.2017 drejtuar subjektit ankimues ka pranuar pjesërisht ankesa e shoqërisë "F....." shpk.

2. Paraqitur nga subjekti "A....." shpk" shpk, për vlerësimin e ofertave.

- Me shkresën e protokolluar në DPD me nr.26898 prot., datë 23.11.2018, është paraqitur ankesë në lidhje me specifikimet teknike të plumbçeve.
- Me urdhrin nr. 26898/1, datë 24.11.2017 të titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar të pezullohet vazhdimi i procedurës prokurimit dhe është ngarkuar drejtoria juridike, njësia prokurimit dhe drejtoria e teknologjisë së informacionit për shqyrtimin e ankesës.
- Me shkresën nr. 26898/2, prot., datë 30.11.2017 drejtuar subjektit ankimues ka pranuar ankesën e shoqërisë "A....." shpk.

B. Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje plumbçe metalike, plumbçe plastike dhe tel lidhës", rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 8 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"A...." shpk	14,387,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"F....." shpk	14,630,000	Kualifikuar
3	A....." shpk	16,600,000	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- anjë nga kontratat e paraqitura për punë të ngjashme nuk u konsideruan të ngjashme me ato të përcaktuara në objektin e tenderit.
4	"R....." shpk	16,610,000	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme pasi ka paraqitur 3 kontrata: Kontratë me OSHEE, për "Blerje pajisje dhe mjete mbrojtese individuale"; Kontratë me OSHEE, për "Blerje kabëll, TU, ABC dhe aksesore"; dhe Fatura Tatimore Shitje me operatorë ekonomik të ndryshëm; nga të cilat asnjë nga këto nuk u konsideruan të ngjashme me ato të përcaktuara në objektin e tenderit.
5	"M....." shpk	22.791,000	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- Operatori ka paraqitur 5 copë mostra plumbçe metalike që nuk përmbushin kriterin e specifikimeve teknike (diametri i telit që lidhet te koka e plumbçes te jetë jo më pak se Ø = 3.5 mm).Nga matjet rezultoi se mostrat e paraqitura kanë diameter Ø = 2 mm. 2-Subjekti ka paraqitur si furnizime të ngjashme Fatura Tatimore Shitje me operatorë ekonomik të ndryshëm.Nga KVO-ja, këto furnizime nuk u konsideruan të ngjashme me ato të percaktuara në objektin e tenderit
6	"T....." shpk	22,765,000	Kualifikuar
7	"W....." shpk	0	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
8	"E....." shpk	0	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokument për përmbushjen e kritereve të dst.

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga OE "A...." shpk, me vlerë 14,387,000 lekë, me vlerë më të ulët, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues këtë operator pasi ka plotësuar kriteret e dst.

Ankesa për Vlerësimin e ofertave:

Paraqitur nga subjekti "T....." shpk, për vlerësimin e ofertave.

- Me shkresën e protokolluar në DPD me nr.3717 prot., datë 13.02.2018, është paraqitur ankesë me pretendimin se dy operatorët ekonomikë të renditur të parët nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit, konkretisht për shoqëritë "A....." shpk dhe "F....." shpk.
- Me urdhërin nr. 3717/1, datë 13.02.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar të pezullohet vazhdimi i procedurës prokurimit dhe është ngarkuar drejtoria juridike për shqyrtimin e ankesës.
- Me urdhërin nr. 3717/2, datë 16.02.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesave i përbërë nga A. G., S. H. dhe R. F.. Gjithashtu është anuluar pika 2 e urdhrit nr. 3717/1, datë 13.02.2018.
- Me shkresën nr. 3717/3 prot., Datë 20.02.2018 autoriteti kontraktor refuzon ofertën e këtij subjekti.
- Më datë 28.02.2018 operatori ekonomik i drejtohet Komisionit të Prokurimit Publik.

- Në datën 20.04.2018 KPP del me vendimin 228/2018 vendos të refuzojë ankesën e paraqitur nga OE.

C. Marrja në dorëzim

- Afati i kontratës nr. 10293 prot., datë 02.05.2018 ka qenë 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës ose deri më 01.07.2018 sipas.
- Fatura tatimore e lëshuar nga OE "A....." shpk me nr. 411, datë 18.06.2018 dhe nr serial 60960147. Flethyrja me nr. 27, datë 29.06.2018.
- Me shkresën nr 15427 prot., datë 29.06.2018 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim nga A. Gj., S. Ç. dhe A. A., të cilët shprehen se sasia është e njëjtë me atë të kërkuar dhe plotëson kushtet e kontratës

8. Procedura prokurimit publik me objekt "Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagente kimik", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 13, me nr. 6161 prot., datë 12.03.2018 Fondi limit 4,994,720 lekë Procedura e prokurimit – kërkesë për propozim	NJHDT K. V. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 6161/1 prot., datë 12.03.2018 Dh. J. – kryetar L. D. – anëtar B. K.- anëtar
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "A....." shpk	Vlera fituese 3,890,816 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 23.03.2018	Diferenca nga fondi limit 1,103,904 lekë.	Kontrata nr. 6161/5 prot., datë 19.04.2018
Marrin pjesë 4 OE S`kualifikuar 2 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 6161/3 prot., datë 05.04.2018	Vlera e kontratës 3,890,816 lekë pa tvsh dhe 4,668,979 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit nuk u konstatuan mangësi pasi ishin në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

B. Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagente kimik", rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 4 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	*Operatori ekonomik pjesëmarrës*	*Oferta ekonomike (pa tvsh)*	*Vlerësimi i KVO-së*
1	"A....." shpk	3,890,816	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"K....." shpk	4,338,110	Kualifikuar
3	"P....." shpk	0	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokument për përmbushjen e kritereve të dst.
4	"G....." shpk	0	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokument për përmbushjen e kritereve të dst.

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga OE "A....." shpk, me vlerë 3,890,816 lekë, me vlerë më të ulët, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues këtë operator pasi ka plotësuar kriteret e dst.

C. Marrja në dorëzim

- Me urdhrin e brendshëm nr. 6161/7 prot., datë 23.04.2018 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të mallit dhe monitorimin e zbatimit të kontratës i përbërë nga E. Y., L. M. dhe Xh. B..
- Me shkresën nr. 20612/1 prot., datë 14.09.2018 është mbajtur procesverbali (pjesa e tretë) i marrjes në dorëzim, në të cilin shpjegohet situata lëvrimit të mallit sipas kontratës së furnizimit.
- Me shkresën nr. 17055/3 prot., datë 07.08.2018 është vendosur penalitet shoqërisë "A....." shpk në shumën 156,565 lekë pasi nga grupi i marrjes në dorëzim nuk i janë pranuar mallrat (materiale apo

pajisje laboratorike) për mos përmbushje të specifikimeve teknike apo për shkak se nuk janë të disponueshme brenda afatit të lëvrimit të kontratës.
- Kontrata me nr. 6161/5 prot., datë 19.04.2018, me afat 90 ditë nga nënshkrimi kontratës ose data 18.07.2018.

9. Procedura prokurimit publik me objekt "Blerje dhe montim gjeneratorë", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 19, me nr. 6832 prot., datë 19.03.2018 Fondi limit 9,600,000 lekë Procedura e prokurimit – E hapur	NJHDT E. Xh. S. R. R. H.	KVO me urdhrin nr. 7057 prot., datë 20.03.2018; nr. 7884 prot., datë 30.03.2018; nr. 9283 prot., datë 18.04.2018 B. F. – kryetar A. K. – anëtar E. M. - anëtar
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "E....." shpk	Vlera fituese 6,060,000 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 21.04.2018	Diferenca nga fondi limit 3,540,000 lekë.	Kontrata nr. 13121 prot., datë 04.06.2018
Marrin pjesë 13 OE S`kualifikuar 1 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 6832/3 prot., datë 21.05.2018	Vlera e kontratës 6,060,000 lekë pa tvsh dhe 7,272,000 lekë me tvsh. Dhe nr. 13121/3 prot., datë 18.09.2018
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.
Nga auditimi i dokumenteve të tenderit nuk u konstatuan mangësi pasi ishin në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

B. Zhvillimi i procedurës:
Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje dhe montim gjeneratorë", rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 13 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"E....." shpk	6,060,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"F....." shpk	6,510,000	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: - Nuk ka paraqitur kontratë të ngjashme. - Fuqia e Gjeneratorit është 196 KËA
3	"A....." shpk	6,750,000	Kualifikuar
4	"R....." shpk	7,305,000	Kualifikuar
5	"I....." Sha	7,591,035	Kualifikuar
6	"R....." shpk	7,899,000	Kualifikuar
7	"F....." shpk	8,310,000	Kualifikuar
8	"R....." shpk	8,374,000	Kualifikuar
9	"A....." shpk	8,550,000	Kualifikuar
10	"A....." shpk	9,090,000	Kualifikuar
11	"A....." shpk	9,200,000	Kualifikuar
12	"E....." shpk	9,368,190	Kualifikuar
13	"N....." shpk	9,450,000	Kualifikuar

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga OE "E....." shpk, me vlerë 6,060,000 lekë, me vlerë më të ulët, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues këtë operator pasi ka plotësuar kriteret e dst.

C. Marrja në dorëzim
- Me urdhrin e brendshëm nr. 13539 prot., datë 04.06.2018 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të mallit i përbërë nga S. G., I. Z. dhe O. Ç..
- Në vijim grupi i punës për marrjen në dorëzim i përbërë nga S. G., I. Z. dhe O. Ç. ka hartuar raportin përmbledhës me nr. 24120 prot., datë 16.10.2018 mbi zbatimin e kontratës nr. 13121 prot., datë 04.06.2018 në të cilën shprehen se: ka pasur vonesë në instalimin e njërit prej gjeneratorëve jo për shkak të kontraktuesit por sepse në Degën e Doganës Morinë ka qenë duke u zhvilluar punime në vendin e instalimit të gjeneratorit (emaili DD Morinë bashkangjitur dt 19.07.2018) dhe për këtë arsye

ka qenë e pamundur të instalohej gjeneratori. Kontrata është zbatuar me korrektësi, brenda afateve dhe me cilësi sipas detyrimeve të përcaktuara në dst.

- Me shkresën nr. 21835 prot., datë 25.09.2018 janë dërguar procesverbalet e marrjes në dorëzim për secilën degë doganore, për të cilat nga grupi i marrjes ne dorëzim nuk konstatohen probleme.

10. Procedura prokurimit publik me objekt "Projekt për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 19, me nr. 6940 prot., date 20.03.2018 Fondi limit 4,493,213 lekë Procedura e prokurimit – Kërkesë për propozim	NJHDT L. Z. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 6940/2 prot., datë 20.03.2018 O. K. – kryetar R. J. – anëtar L. B.- anëtar
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "GJ....." shpk	Vlera fituese 4,080,000 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 10.04.2018	Diferenca nga fondi limit 413,213 lekë.	Kontrata nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018
Marrin pjesë 6 OE S`kualifikuar 5 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 6940/3 prot., datë 08.06.2018	Vlera e kontratës 4,080,000 lekë pa tvsh dhe 4,896,000 lekë me tvsh. Shtesë afati me nr 19094 prot., datë 17.08.2018
Ankimime në AK - po Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.

Në përcaktimet e kritereve të veçanta të kualifikimit të hartuara me shkresën me nr. 5177 prot., datë 28.02.2018, u konstatuan mangësi, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, nuk janë të argumentuara me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, konkretisht kriteret e mëposhtëme:

1- Në dokumentet e tenderit është kërkuar që "Operatori ekonomik duhet të disponojë liçensën për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me kategoritë e mëposhtme (sipas VKM-së nr. 943 datë 28.12.2016) ku ndër të tjera edhe kategoritë (2/ç; 4/dh;11/ç)", të cilat nga auditimi rezultuan se nuk ishin pjesë e rregullores së re sipas përcaktimeve të VKM 943 datë 28.12.2016. Kërkesë e vendosur në mënyrë të paargumentuar dhe të pa justifikuar, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 28 "Kontratat e shërbimeve", pika 2, Neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2, çka ngarkon me përgjegjësi grupin e posaçëm të punës i përbërë nga E. K., E. Xh. dhe E. Gj. (në bazë të shkresës nr. 1839 prot., datë 24.01.2018).

B. Zhvillimi i procedurës:

- Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Projekt për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë", rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 6 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"N....." shpk	3,302,512	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- Për inxhinier hidroteknik K. N. dhe inxhinier mjedisi S. H. nuk janë paraqitur licenca, - Për arkitekt E. G. është paraqitur licencë e skaduar, nuk rezulton në listëpagesa për periudhën e kërkuar, nuk është paraqitur diploma, 2- për licencën e ushtrimit të aktivitetit ky OE nuk zotëron kategoritë: 2 në tersi; 4/dh; 11/ç; 12 në tersi, 3- Nuk është paraqitur metodologji e propozuar për realizimin e objektit të prokurimit.
2	"B....." shpk	3,867,687	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- ka paraqitur xhiro vjetore vetëm për vitin 2017, 2- nuk plotëson kriterin për kapacitetin teknik për stafin e kërkuar pasi: - inxhinieri ndërtimi E. S. s'ka paraqitur kontratë, nuk rezulton në listëpagesa për muajt shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2017 - inxh mjedisi K. B. nuk ka paraqitur licencë dhe diplomë, nuk rezulton në listëpagesa për muajt shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2017 - Arkitekt D. M. nuk rezulton në listëpagesa për të gjithë periudhën e kërkuar (shtator, tetor 2017) - Inxh elektrik B. D. nuk figuron në listëpagesa për të gjithë periudhën e kërkuar 3- OE nuk ka paraqitur licencë të shoqërisë

			4- nuk ka dorëzuar deklaratën për inxhinierët që do të angazhojë
3	BOE "S...." shpk & "A....." shpk	3,909,000	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- nuk plotëson kriterin për kapacitetin teknik pasi dokumentacioni i stafit të kërkuar ka mangësi në diploma, licenca si edhe mungojnë në listëpagesa për periudhën e kërkuar në dst. 2- të dy operatorët ekonomik në licencat e paraqitura u mungojn kategoritë 2/ç; 4/dh;11/ç
4	BOE "C....." shpk & N....." shpk	3,954,000	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- nuk plotëson kriterin për kapacitetin teknik pasi dokumentacioni i stafit të kërkuar ka mangësi në diploma, licenca si edhe mungojnë në listëpagesa për periudhën e kërkuar në dst. 2- të dy operatorët ekonomik në licencat e paraqitura u mungojn kategoritë 2/ç; 4/dh;11/ç
5	"GJ....." shpk	4,080,000	(në procesverbalin e datës 16.04.2018 është skualifikuar pasi në licencën e paraqitur mungojnë kategoritë 2/ç; 4/dh;11/ç;)
6	BOE "D....." shpk; & "I....." shpk	4,100,000	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- nuk plotëson kriterin për kapacitetin teknik pasi dokumentacioni i stafit të kërkuar ka mangësi në diploma, licenca si edhe mungojnë në listëpagesa për periudhën e kërkuar në dst. 2- të dy operatorët ekonomik në licencat e paraqitura u mungojn kategoritë 2/ç; 4/dh;11/ç

KVO me procesverbalin e datës 16.04.2018 ka skualifikuar të gjitha ofertat pjesëmarrëse në procedurë pasi asnjë prej tyre nuk kishte plotësuar kriteret e kërkuara në dst.

Lidhur me pretendimet e KVO kanë paraqitur ankesë dy operatorë ekonomik:

a- BOE "S....." shpk & "A....." shpk protokolluar në DPD me nr. 9312 prot., datë 18.04.2018.

Me shkresën nr. 9312/1 prot., titullari autoritetit kontraktor ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ka ngarkuar drejtorinë juridike për shqyrtimin e ankesës dhe daljen me një vendim drejtuar shoqërisë ankimuese.

b- OE "GJ....." shpk protokolluar në DPD me nr. 9573 prot., datë 20.04.2018.

Me shkresën nr. 9573/1 prot., titullari autoritetit kontraktor ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ka ngarkuar drejtorinë juridike për shqyrtimin e ankesës dhe daljen me një vendim drejtuar shoqërisë ankimuese.

Për sa më sipër, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 9724 prot., datë 24.04.2018 i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për asistencë në lidhje me përcaktimet e kategorive të licencave (2/ç; 4/dh;11/ç) në fushën e studim projektimit sipas VKM-së nr. 943 datë 28.12.2016. Në mungesë të një përgjigje nga MIE, AK me shkresën nr. 9724/1 prot., datë 02.05.2018 ka ri-kërkuar asistencën e kësaj ministrie.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6698/1 prot., datë 11.05.2018 protokolluar në DPD nr. 9724/2 datë 14.05.2018 me lëndë kthim përgjigje sqaron për ndryshimet e VKM-së nr. 943 datë 28.12.2016 ku thekson se shkronjat "ç", "dh", "ë" janë përjashtuar nga rregullorja e re.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 9312/2 prot., datë 18.05.2018 mbi shqyrtimin e ankesës së BOE "S....." shpk & "A....." shpk vendos pranimin e ankesës së tij lidhur me numerizimin e licencave të studim projektimit dhe refuzimin për pjesën tjetër. Gjithashtu, AK me shkresën nr. 9573/2 datë 18.05.2018 mbi shqyrtimin e ankesës së OE "GJ....." shpk vendos pranimin e ankesës së këtij OE, si rrjedhojë, kjo ofertë kualifikohet e shpallet fituese.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave me Procesverbalin e datës 22.05.2018 për rivlerësim të procedurës reflekton korrigjimet sipas shkresës nr. 9573/2 datë 18.05.2018 dhe shpall fitues OE i renditur i pesti "GJ....." shpk me vlerë të ofertës 4,080,000 lekë.

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së dhe plotësimit të kritereve të kërkuara në dst nga OE pjesëmarrës rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës së OE "N....." shpk, me vlerë 3,302,512 lekë, me vlerë më të ulët, rezultoi se KVO e ka s'kualifikuar me të drejtë ofertën e paraqitur nga ky OE pasi nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara në dst.
Nga auditimi i ofertës së OE "B....." shpk, me vlerë 3,867,687 lekë, rezultoi se KVO e ka s'kualifikuar me të drejtë ofertën e paraqitur nga ky OE pasi nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara në dst.
Nga auditimi i ofertës së BOE "S...." shpk & "A....." shpk, me vlerë 3,909,000 lekë, rezultoi se KVO e ka s'kualifikuar me të drejtë ofertën e paraqitur nga ky BOE pasi nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara në dst.
Nga auditimi i ofertës së BOE "C..." shpk & N....." shpk, me vlerë 3,954,000 lekë, rezultoi se KVO e ka s'kualifikuar me të drejtë ofertën e paraqitur nga ky BOE pasi nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara në dst.
Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga OE "GJ....." shpk, me vlerë 4,080,000 lekë, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues këtë operator pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në dst, konkretisht si më poshtë:
- Për plotësimin e kriterit për inxhinier mjedisi rezulton se D. P. nuk figuron në listëpagesa për muajin janar 2017) si edhe nuk ka paraqitur licencë, në kundërshtim me kriteret e kërkuara në dst.
- Për plotësimin e kriterit për inxhinier gjeodet rezulton se E. I. nuk figuron në listëpagesa për muajin prill 2017, në kundërshtim me kriteret e kërkuara në dst.

Sa më sipër, KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "GJ....." sh.p.k, me vlerë 4,080,000 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në dst. Si pasojë, tenderi duhej anulluar dhe duhej zhvilluar proçedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 "Anulimi i një procedure prokurimi" dhe nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve" e nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se "Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit", çka ngarkojnë me përgjegjësi KVO e përbërë nga O. K., R. J., L. B., pasi me veprimet e tyre kanë shkaktuar mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën 777,488 lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e shpallur padrejtësisht fituese të OE "GJ....." sh.p.k minus (-) ofertën e s'kualifikuar të OE "T....." sh.p.k, me vlerë më të ulët, (4,080,000 – 3,302,512) = 777,488 lekë. Veprime në kundërshtim me me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c dhe me Nenet 46, 53 pika 4, dhe 55.

C. Marrja në dorëzim
- Me urdhrin e brendshëm nr. 6940/8 prot., datë 06.07.2018 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të mallit i përbërë nga E. Xh., M. H. dhe E. Gj..
- Në vijim grupi i punës ka hartuar raportin përmbledhës me nr. 27929 prot., datë 22.11.2018 mbi zbatimin e kontratës bazë nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018 dhe amendimit të kontratës nr. 19094 prot., datë 17.08.2018, në të cilën shprehen se kontratat janë zbatuar sipas detyrimeve të përcaktuara në dst (M. H. nuk ka firmosur).
- Me shkresën nr. 26315 prot., datë 08.11.2018 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim, në të cilin shprehen se: operatori ekonomik ka dorëzuar pranë DPD projektin e zbatimit në 4 kopje sipas shkresës me nr. 19988 prot., datë 03.09.2018 ku rezulton se projekti është në përputhje me kontratën dhe specifikimet teknike.

- Afati i kontratës ka qenë deri më 18.08.2018 sipas kontratës fillestare, ndërsa me amendimin e saj (nr 19094 prot., datë 17.08.2018) afati shtyhet me 15 ditë nga nënshkrimi mendimit ose data 01.09.2018 si afat përfundimtar i dorëzimit të projektit.
- Fatura tatimore e lëshuar nga OE "GJ....." shpk me nr. 57, datë 17.09.2018.
- Flethyrja me nr. 53, datë 20.11.2018

Nga auditimi konstatohet se nuk është respektuar kontrata nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018 dhe amendimi i saj me nr. 19094 prot., datë 17.08.2018, pasi dorëzimi i projektit nuk është bërë në kohën e përcaktuar në kontratë, çka nuk është konstatuar nga grupi i punës për marrjen në dorëzim në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe në raportin përmbledhës për ecurinë e zbatimit të kontratës. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, neni 77 "Mbikëqyrja e kontratës" pika 1, në të cilën thuhet: "1."Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuara me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi" dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, "Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara", çka ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e ngritur sipas urdhrit nr. 6940/8 prot., datë 06.07.2018 i përbërë nga E. Xh., M. H. dhe E. Gj..

D. Likuidimi i kontratës me objekt "Projekt për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë", me kontratës bazë nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018 dhe amendimit të kontratës nr. 19094 prot., datë 17.08.2018, vlera 4,896,000 lekë me tvsh, kontraktues: OE "GJ....." shpk, afati përfundimtar i kontratës (përfshirë shtesën) 01.09.2018

Kontrata është likuiduar me urdhër shpenzimet sa vijon:

Urdhër shpenzimi	*Shuma e likuiduar*	*Fatura tatimore nr/ datë/ Përshkrimi i fat*
1035/ 07.12.2018	4,896,000	Nr. 57, datë 17.09.2018 "Projekti për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë"
Shuma	4,896,000	

Sipas kontratës bazë nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018 dhe amendimit të kontratës nr. 19094 prot., datë 17.08.2018, afati i ekzekutimit të kontratës (furnizimi projektit) është 01.09.2018, ndërkohë që fatura tatimore mban datën 17.09.2018 (me nr serial 60987757).
Bazuar në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" neni 99, "Momenti i lëshimit të faturës" pika 1, në të cilën thuhet se: "Fatura lëshohet në momentin e furnizimit të mallit ose shërbimit, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe", fatura tatimore nr. 57, datë 17.09.2018 është paraqitur tej afatit kohor të dorëzimit të punës së kryer në një kohë që furnizimi quhet i kryer në momentin kur është e detyrueshme të lëshohet fatura, pavarësisht se në kontratën e nënshkruar është përcaktuar si datë e dorëzimit të projektit data 01.09.2018, ose 16 ditë më vonë (01.09.2018 – 17.09.2018).
Sa më sipër, duhet të ishin mbajtur sanksione sipas kushteve të përcaktuara në kontratën bazë nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018 dhe amendimit të kontratës nr. 19094 prot., datë 17.08.2018, neni 12, "Sanksionet", në të cilën thuhet: "Në rast të mos lëvrimit të mallit brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë dhe në aneksin e saj, Kontraktuesi detyrohet të paguaj 4/1000 në ditë të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht 25% të vlerës së kontratës.....".
Vlera e kontratës 4,896,000 lekë x 4/1000 në ditë x 25% x 16 ditë = 78,336 lekë sanksione të pambajtura dëm ekonomik për buxhetin e shtetit të arkëtueshëm nga subjekti "GJ....." shpk, çka ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e ngritur sipas urdhrit nr. 6940/8 prot., datë 06.07.2018 i përbërë nga E. Xh., M. H. dhe E. Gj. për mos veprim sipas parashikimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014,

"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, neni 77 "Mbikëqyrja e kontratës" pikat 1,2,3 dhe 4.

11. Procedura prokurimit publik me objekt "Blerje peshore rruge portative (aksiale) për mjete transporti", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 29, me nr. 8934/2 prot., date 26.04.2018 Fondi limit 3,742,000 lekë Procedura e prokurimit – Kërkesë për propozim	NJHDT K. V. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 8934/5 prot., datë 26.04.2018 H. B. – kryetar (dr. antitrafik) B. T. – anëtar (dr. Hetimit) L. Z.- anëtar (dr. brimeve mbështetëse)
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "M....." shpk	Vlera fituese 3,192,000 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 16.05.2018	Diferenca nga fondi limit 550,000 lekë.	Kontrata nr. 19838 prot., datë 31.08.2018
Marrin pjesë 4 OE S`kualifikuar 2 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 19268 prot., datë 23.08.2018	Vlera e kontratës 3,192,000 lekë pa tvsh dhe 3,830,400 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - po Ankimime në KPP - po	Afati kontratës 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit nuk u konstatuan mangësi pasi ishin në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

B. Zhvillimi i procedurës:

- Njësia e prokurimit ka ftuar në garë operatorë ekonomikë të cilët nuk kanë objekt të aktivitetit të tyre objektin e kontratës në fjalë pavarësisht se në procesverbal theksohet se përzgjedhja e kandidatëve do të jetë përputhja e aktivitetit të tyre me objektin e kontratës, konkretisht operatorët sa vijon: "M..." shpk, "G..." shpk, "N....." shpk. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, neni 39 "Kërkesë për propozime" pika 4, për mos argumentimin e saktë të kandidatëve të përzgjedhur, çka nga ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e pëbrë nga K. V., S. R., R. H..
- Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje peshore rruge portative (aksiale) për mjete transporti", rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 8 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	***Operatori ekonomik pjesëmarrës***	***Oferta ekonomike (pa tvsh)***	***Vlerësimi i KVO-së***
1	"T....." shpk	2,873,600	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-U konstatua se gjatë verifikimit të dokumentacionit në QKB për përputhshmërinë e fushës së veprimtarisë së kërkuar dhe ofruar nga OE se operatori ekonomik pjesëmarrës nuk e përmbush ketë kriter. 2- Kontratat e ngjashme të ngarkuara në sistem nga Operatori Ekonomik i sipërcituar nuk përputhen me objektin e prokurimit të kërkuar sipas pikës 2.3 të DST-ve.
2	"M....." shpk	3,192,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
3	"T....." shpk	3,280,000	Kualifikuar
4	"M....." shpk	0	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- s'kualifikohet pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument bashkëldhur.

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi i ofertës së OE "T....." shpk, me vlerë 2,873,600 lekë, me vlerë më të ulët, rezultoi se KVO e ka s'kualifikuar me të drejtë ofertën e paraqitur nga ky OE pasi nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara në dst.

Nga auditimi i ofertës fituese të OE "M....." sh.p.k, me vlerë 3,192,000 lekë, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues këtë ofertë pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas DST, konkretisht si më poshtë:

a- Nuk ka paraqitur Manual përdorimi në gjuhën shqipe.

b- Nuk ka paraqitur certifikatën e prodhuesit.

c- Në dst është kërkuar "Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun teknik të aparaturës së kërkuar të prodhuesit, të përkthyer të noterizuar, në të cilin të jenë të përfshira të gjitha të dhënat

teknike sipas specifimimeve teknike të kërkuara", nga auditimi u konstatua se: shoqëria "M....." sh.p.k ka paraqitur katalogun pjesërisht të përkthyer në gjuhën shqipe. Pra, mungon përkthimi në gjuhën shqipe të karakteristikave të peshores, çka e bënë të pamundur krahasim e mallit të ofruar nga operatori ekonomik me atë të kërkuar ne specifikimet teknike pjesë e dst.

Sa më sipër, KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "M....." sh.p.k, me vlerë 3,192,000 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në dst. Si pasojë, tenderi duhej anulluar dhe duhej zhvilluar proçedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 "Anulimi i një procedure prokurimi" dhe nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve" e nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se "Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit", çka ngarkojnë me përgjegjësi KVO e përbërë nga H. B., B. T. dhe L. Z., pasi me veprimet e tyre kanë shkaktuar mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën 318,400 lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e shpallur padrejtësisht fituese të OE "M...." sh.p.k minus (-) ofertën e s'kualifikuar të OE "T....." sh.p.k, me vlerë më të ulët, (3,192,000 – 2,873,600) = 318,400 lekë. Veprime në kundërshtim me me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c dhe me Nenet 46, 53 pika 4, dhe 55.

Ankesa:

1. Paraqitur nga subjekti "T....." shpk, për vlerësimin e ofertave.

- Me shkresën e protokolluar në DPD me nr.12239 prot., datë 23.05.2018, është paraqitur ankesë me pretendimin se është subjekti i vetëm që plotëson kriteret e kualifikimit.
- Me urdhërin nr. 12239/1, datë 25.05.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar të pezullohet vazhdimi i procedurës prokurimit dhe është ngarkuar drejtoria juridike për shqyrtimin e ankesës.
- Me shkresën nr 12239/2 prot., datë 30.05.2018 është refuzuar ankesa e paraqitur nga ky OE me pretendimin se dokumentacioni i paraqitur nga OE "M....." sh.p.k është sipas përcaktimeve të kërkuara në dst.

2. Paraqitur nga subjekti "T....." shpk, për vlerësimin e ofertave.

- Me shkresën e protokolluar në DPD me nr.12391 prot., datë 24.05.2018, është paraqitur ankesë me pretendimin se arsyet e skualifikimit të përdorura nga KVO nuk qëndrojnë.
- Me urdhërin nr. 12239/1, datë 25.05.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar të pezullohet vazhdimi i procedurës prokurimit dhe është ngarkuar drejtoria juridike për shqyrtimin e ankesës.
- Me shkresën nr 12391/2 prot., datë 30.05.2018 është refuzuar ankesa e paraqitur nga ky OE duke i dhënë të drejtë KVO.
- Me vendimin nr. 1061/1 të Komisionit të Prokurimit Publik vendoset pezullimi procedurës deri në shqyrtimin e ankesës së "T...." shpk.

Me vendimin nr. 547/2018 datë 16.08.2018 KPP vendos refuzimin e ankesës së paraqitur nga kjo shoqëri.

C. Marrja në dorëzim

- Me urdhrin e brendshëm nr. 19838/2 prot., datë 31.08.2018 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të mallit i përbërë nga E. H., F. P. dhe M. L..
- Me shkresën nr. 25268 prot., datë 29.10.2018 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim, në të cilin shprehen se: pajisjet e furnizuara janë në përputhje me me sasinë dhe specifikimet teknike, gjithashtu kompania ka kryer trajnimin e punonjësve sipas përcaktimeve të kontratës.

- Kontrata nr. 19838 prot., datë 31.08.2018, me afat 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës ose data 15.10.2018
- Fatura tatimore e lëshuar nga OE "M....." shpk me nr. 44, datë 15.10.2018 dhe nr serial 57697644.
- Flethyrja me nr. 45, datë 29.10.2018

12. Procedura prokurimit publik me objekt "Ruajtja e godinës me roje private, rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 7, me nr. 4945 prot., datë 26.02.2018 Fondi limit 5,185,082 lekë Procedura e prokurimit – me negocim pa shpallje paraprake	NJHDT K. V. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 4945/1 prot., datë 26.02.2018; A. K. – kryetar E. K. – anëtar L. Z.- anëtar
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "A...." shpk	Vlera fituese 5.102.871,29 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 28.02.2018		Kontrata nr. 4945/4 prot., datë 01.03.2018
Marrin pjesë 2 OE S`kualifikuar 0 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 4945/2 prot., datë 01.03.2018	Vlera e kontratës 5.102.871,29 lekë pa tvsh dhe 6,123,445 lekë me tvsh.
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës: 3 muaj ose deri në lidhjen e kontratës me fituesin e procedurës së hapur marrëveshje kuadër e cila është në proces	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

Në urdhrin e prokurimit numër 7 është bërë argumentimi i arsyes së përzgjedhjes së llojit të procedurës prokurimi në të cilin thuhet se: "Autoriteti Kontraktor në bazë të LPP neni 33 pika 2/c dhe VKM 914 neni 36 pika 2/c, për nevoja të fillim vitit ka nënshkruar shtesën e kontratës nr. 29536/1 prot., datë 28.12.2017 në masën 20% të kontratës të vitit të kaluar, me afat deri më 13.02.2018. Ndërkohë AK ka shpallur procedurën e hapur marrëveshje kuadër në datën 17.01.2018. Sa më sipër, nisur edhe nga eksperienca e vitit të kaluar procedura e përzgjedhjes së fituesi për procedurën e hapur parashikohet të zgjasë deri në 3 muaj. Si rrjedhojë, AK ndodhet në kushtet e emergjencës për realizimin e procedurës negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës pasi shërbimi me roje civile është i domosdoshëm për ruajtjen e vlerave materiale".

A. Dokumentet e tenderit.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit nuk u konstatuan mangësi pasi ishin në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

B. Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Ruajtja e godinës me roje private", rezultoi se në tender ka marrë pjesë 2 operator nga 3 të ftuar, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	*Operatori ekonomik pjesëmarrës*	*Oferta ekonomike (pa tvsh)*	*Vlerësimi i KVO-së*
1	"A....." shpk	5.102.871,29	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	M.....	5.123.787,29	Kualifikuar

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave u konstatua se komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar të dyja ofertat pjesëmarrëse dhe ka shpallur fitues shoqërinë "A-2000" shpk në bazë të dokumenteve të tenderit në të cilën përcaktohet se kriteri për përzgjedhjen e fituesit do të jetë çmimi më i ulët.

13. Procedura prokurimit publik me objekt "Shërbimi i ruajtjes me roje civile në DPD", rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi Nr. 2, me nr. 1151 prot., datë 16.01.2018 Fondi limit 18,493,461 lekë Procedura e prokurimit – e hapur – marrëveshje kuader	NJHDT K. V. R. H. S. R.	KVO me urdhrin nr. 1151/2 prot., datë 16.01.2018; dhe nr. 11837 prot., datë 18.05.2018 A. M. – kryetar A. K. – anëtar E. GJ- anëtar
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE "O....." shpk	Vlera fituese 11,743,711 lekë pa tvsh në total (ose 55,92.72 në ditë për 3 turne/7 vende roje)
Datë e hapjes së tenderit 09.02.2018 ora 10:00		Kontrata nr. 13319 prot., datë 06.06.2018
Marrin pjesë 13 OE S`kualifikuar 10 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 13022 prot., datë 01.06.2018	Vlera e kontratës 11,687,848 lekë pa tvsh dhe 14,025,418 lekë me tvsh

Ankimime në AK - po Ankimime në KPP - po	Afati kontratës: 321 ditë ose nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 31.12.2018	Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ)

A. Dokumentet e tenderit.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit nuk u konstatuan mangësi pasi ishin në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar dhe rekomandimeve të APP dhe KPP datë 20.12.2017.

Ankesa për dst.

1. Paraqitur nga subjekti "I....." shpk,.

- Me shkresën e protokolluar në DPD me nr. 1824 prot., datë 24.01.2018, ka paraqitur ankesë për kriteret të vendosura në dst, konkretisht për fondin limit dhe për përzgjedhjen e procedurës.
- Me urdhërin nr. 1824/1, datë 24.01.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar të pezullohet vazhdimi i procedurës prokurimit dhe është ngarkuar drejtoria juridike për shqyrtimin e ankesës.
- Me shkresën nr 1824/3 prot., datë 26.01.2018 drejtuar subjektit ankimues ku informohet për mospranimin e ankesës së tij.

2. Paraqitur nga subjekti "S....." shpk,.

- Me shkresën e protokolluar në DPD me nr. 1825 prot., datë 24.01.2018, ka paraqitur ankesë për kriteret të vendosura në dst, konkretisht për fondin limit dhe për përzgjedhjen e procedurës.
- Me urdhërin nr. 1824/2, datë 24.01.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar të pezullohet vazhdimi i procedurës prokurimit dhe është ngarkuar drejtoria juridike për shqyrtimin e ankesës.
- Me shkresën nr 1825/1 prot., datë 26.01.2018 drejtuar subjektit ankimues ku informohet për mospranimin e ankesës së tij.

B. Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt "Shërbimi i ruajtjes me roje civile në DPD", rezultoi se në tender ka marrë pjesë 13 operator, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet sipas procseverbalit datë 27.02.2018, konkretisht si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"A....." shpk	17.951.148,18	Kualifikuar
2	"S...." shpk	17.951.148,18	Kualifikuar
3	"A..... " shpk	0	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
4	"A..... " shpk	7.988,96	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- ka paraqitur formularin e ofertës vetëm me çmimin për njësi. Formulari i ofertësi i paraqitur, nuk është plotësuar sipas shtojcës nr.1 , pasi në shtojcën nr. 1 është përcaktuar që operatori ekonomik të paraqesë vlerën në total për 321 ditë për 7 vend roje.
5	"S....." shpk, & "A....." shpk	55.934,13	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- Bashkimi i operatorëve ka paraqitur vetdeklarim, vetëm për OE 'Start 2000", dhe nuk është paraqitur vetëdeklarim nga OE tjeter në këtë BOE "A....." sh.p.k. 2- Formulari i ofertësi i paraqitur nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë, nuk është plotësuar sipas kërkesave të shtojcës nr.1 , pasi në shtojcën nr. 1 ku është përcaktuar që operatori ekonomik të paraqesë vlerën në total për 321 ditë për 7 vend roje.
6	"I....." shpk	7.988,94 lekë/24 ore	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- ka paraqitur formularin e ofertës vetëm me çmimin për njësi. Formulari i ofertësi i paraqitur, nuk është plotësuar sipas shtojcës nr.1 , pasi në shtojcën nr. 1 është përcaktuar që operatori ekonomik të paraqesë vlerën në total për 321 ditë për 7 vend roje.
7	"L....." shpk	17.954.855,73	Kualifikuar
8	"M....." shpk	17.951.148,18	Kualifikuar
9	"O....." shpk	17.951.530,17	Kualifikuar
10	"O....." shpk	17.951.193 12	Kualifikuar
11	"S....." shpk	17.951.148,18	Kualifikuar

12	"S....." shpk	17.951.148,18	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-Operatori ekonomik ka paraqitur çertifikata për 31 punonjësh shërbimi (licensat për 7 prej tyre, janë të përsëritura 2 herë) dhe konkretish liçensat me nr. 2148; nr.5060; nr.2174; nr.2153; nr.3495; nr.4338; nr.4892.
13	"M....." shpk	17.946.159,84	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, pasi bazuar në përllogaritjet e bëra nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, ofera dysheme duhet të ishte 17.951.14818. Ndërsa OE "M....."sh.p.k. ka ofertuar në vlerën 17.946.15984, nën koston minimale dhe çmimin dysheme të parashikuar nga kuadri ligjor.

Lidhur me pretendimet e KVO kanë paraqitur ankesë operatorët ekonomik si më poshtë:
a- OE "O....." shpk protokolluar në DPD me nr. 5577 prot., datë 05.03.2018 në lidhje me pagën minimale bazë të lejuar.
- Me shkresën nr. 5665 prot., datë 06.03.2018 titullari autoritetit kontraktor ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ka ngarkuar drejtorinë juridike për shqyrtimin e ankesës dhe daljen me një vendim drejtuar shoqërisë ankimuese.
- Me shkresën nr. 5577/1 prot., datë 12.03.2018, autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e paraqitur nga kjo shoqëri.
b- OE "L....." shpk protokolluar në DPD me nr. 5565 prot., datë 05.03.2018 në lidhje me pagën minimale bazë të lejuar.
- Me shkresën nr. 5665 prot., datë 06.03.2018 titullari autoritetit kontraktor ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ka ngarkuar drejtorinë juridike për shqyrtimin e ankesës dhe daljen me një vendim drejtuar shoqërisë ankimuese.
- Me shkresën nr. 5498/1 prot., datë 12.03.2018, autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e paraqitur nga kjo shoqëri.
c- OE "A....." shpk protokolluar në DPD me nr. 5433 prot., datë 02.03.2018 në lidhje me arsyen e skualifikimit të tij dhe për pagën minimale bazë të lejuar.
- Me shkresën nr. 5433/1 prot., datë 06.03.2018 titullari autoritetit kontraktor ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ka ngarkuar drejtorinë juridike për shqyrtimin e ankesës dhe daljen me një vendim drejtuar shoqërisë ankimuese.
- Me shkresën nr. 5433/2 prot., datë 08.03.2018, autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e paraqitur nga kjo shoqëri.

Sa më sipër, nisur nga mos pranimi i ankesës së tyre në DPD, operatorët e ekonomik i janë drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).

KPP me vendimin 305/2018 datë 11.05.2018 vendos:
- të pranojë anesën e paraqitur nga OE "O....." shpk,
- të mos pranojë ankesë e OE "L....." shpk,
- Autoritetit Kontraktor të anulojë vendimin e KVO për kualifikimin e OE "S....." shpk, "A..." shpk, "M....." shpk dhe "S....." shpk

Si rrjedhojë autoriteti kontraktor ka nxjerr shkresën nr. 12409 prot., datë 24.05.2018 drejtuar KVO për rivlerësimin të procedurës.
Më datë 24.05.2018 KVO ka kryer rivlerësimin sipas vendimit të KPP, konkretisht si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"A....." shpk	17.951.148,18	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, pasi oferta është nën koston ligjore sipas arsyetimit të vendimit nr.305/2018 prot, date 11.05.2018, të Komisionit të Prokurimit Publik.
2	"S..... " shpk	17.951.148,18	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, pasi oferta është nën koston ligjore sipas arsyetimit të vendimit nr.305/2018 prot, date 11.05.2018, të Komisionit të Prokurimit Publik.

3	"A..... " shpk	0	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
4	"A..... " shpk	7.988,96	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- ka paraqitur formularin e ofertës vetëm me çmimin për njësi. Formulari i ofertësi i paraqitur, nuk është plotësuar sipas shtojcës nr.1 , pasi në shtojcën nr. 1 është përcaktuar që operatori ekonomik të paraqesë vlerën në total për 321 ditë për 7 vend roje.
5	"S....." shpk, & "A....." shpk	55.934,13	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- Bashkimi i operatorëve ka paraqitur vetdeklarim, vetëm për OE S....", dhe nuk është paraqitur vetëdeklarim nga OE tjeter në këtë BOE "A....." sh.p.k. 2- Formulari i ofertësi i paraqitur nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë, nuk është plotësuar sipas kërkesave të shtojcës nr.1 , pasi në shtojcën nr. 1 ku është përcaktuar që operatori ekonomik të paraqesë vlerën në total për 321 ditë për 7 vend roje.
6	"I....." shpk	7.988,94 lekë/24 ore	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- ka paraqitur formularin e ofertës vetëm me çmimin për njësi. Formulari i ofertësi i paraqitur, nuk është plotësuar sipas shtojcës nr.1 , pasi në shtojcën nr. 1 është përcaktuar që operatori ekonomik të paraqesë vlerën në total për 321 ditë për 7 vend roje.
7	"L....." shpk	17.954.855,73	Kualifikuar
8	"M....." shpk	17.951.148,18	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, pasi oferta është nën koston ligjore sipas arsyetimit të vendimit nr.305/2018 prot, date 11.05.2018, të Komisionit të Prokurimit Publik.
9	"O....." shpk	17.951.530,17	Kualifikuar
10	"O....." shpk	17.951.193 12	Kualifikuar
11	"S....." shpk	17.951.148,18	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, pasi oferta është nën koston ligjore sipas arsyetimit të vendimit nr.305/2018 prot, date 11.05.2018, të Komisionit të Prokurimit Publik.
12	"S....." shpk	17.951.148,18	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-Operatori ekonomik ka paraqitur çertifikata për 31 punonjësh shërbimi (licensat për 7 prej tyre, janë të përsëritura 2 herë) dhe konkretish liçensat me nr. 2148; nr.5060; nr.2174; nr.2153; nr.3495; nr.4338; nr.4892.
13	"M....." shpk	17.946.159,84	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, pasi bazuar në përllogaritjet e bëra nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, oferta dysheme duhet të ishte 17.951.14818. Ndërsa OE "M....."sh.p.k. ka ofertuar në vlerën 17.946.15984, nën koston minimale dhe çmimin dysheme të parashikuar nga kuadri ligjor.

7. Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerezore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Rekrutimet, transferimet dhe largimet për periudhën nën auditim, si dhe impakti i tyre në Buxhetin e Shtetit. Procedurat e ndjekura në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike për plotësimin e vendeve vakante të organikës. Radha e ndjekur e rekrutimeve për punonjësit që kanë fituar konkurimin.
- Mënyra dhe radha e ndjekur për pagesën e punonjësve gjyqfitues me vendim gjykate të formës së prerë

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit "Nr 242/1 Prot. Datë 06.06.2019", për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Listë pagesat (borderotë) e DPD për punonjësit për gjithë periudhën objekt auditimit;
2. Dosjet, lidhur me rekrutimet, largimet dhe transferimet për gjithë punonjësit për periudhën objekt auditimi;
3. Dokumentacioni bashkëlidhur në dosjet personale të punonjësve të rekrutuar, larguar dhe transferuar në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë DPD.
4. Veprimtaria e Komisionit Disiplinor.
5. Databaza e Vendimeve Gjyqësore.
6. Dosja e Komisionit të Ristrukturimit, urdhëra, vendime, relacione, korrespondenca me DAP

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Referuar Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar përfshin dispozitat bazë për organizimin e administratës doganore, të veprimtarisë doganore, kompetencat, bashkëpunimin, punësimin dhe marrëdhëniet e punës së personelit të administratës doganore. Këto dispozita rregullohen me VKM Nr.921, datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore".

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 3, 8, 11, pika 4 dhe 15, pikat 11 dhe 12, të Ligjit Nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës, i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr.9 datë 11.01.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.921 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Personelin e Administratës Doganore", për vitin 2017 miratoi nr total i punonjësve të Administratës Doganore në 1052, nga të cilët 652 janë punonjës të Degëve Doganore dhe 400 punonjës të DPD, sipas strukturës së mëposhtme.

Këshilli i Ministrave me shkresën Nr.87 Prot, datë 09.01.2018, prot në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me Nr.436 Prot, datë 09.01.2018, përcolli në DPD Vendimin Nr.2 datë 08.01.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.921 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Personelin e Administratës Doganore", të ndryshuar.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, pika 3, 8, 11, pika 4, 15, pikat 11 e 12, të Ligjit Nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e MFE, Këshilli i Ministrave vendosi miratimin e organikës së DPD me 1102 punonjës, të shpërndarë në nivel qëndror dhe vendor, nga të cilët 464 punonjës janë të DPD dhe 638 punonjës të Degëve Doganore.

Struktura organike e administratës doganore është sipas aneksit të mëposhtëm:

	Kabineti	Departamenti Teknik I Akcizes dhe Procedurave	Departmenti i Analizave dhe Aposteriorit	DOH		shuma Aparatit	Shuma e Degeve	Totali Administrata
Emërtimi	shuma	shuma	shuma	shuma	shuma			
Drejtor i Përgjithshëm	1	0	0	0	0	1		1
Drejtor Kabineti, A	1	0	0	0	0	1		1
N/Drejt i Përgjithshëm	0	1	1	1	1	4		4
SECI, A	0	0	0	1	0	1		1
Këshilltare, A	4	0	0	0	0	4		4
Drejtor Drejtorie, A	4	5	3	6	3	21		21
Kryetar Dogane, A	0	0	0	0	0	0	7	7
Kryetar Dogane, B	0	0	0	0	0	0	10	10
Pergjegjes Sektori, B	3	11	10	17	8	49		49
Pergjegjes i Administrates dhe Sherbimit, B	0	0	0	0	0	0	16	16
Specialist, C1	19	33	37	66	31	186	56	242
Specialist, C1 QNOD	0	0	0	5	0	5		5
Oficer i OPGj, C1	0	0	0	7	0	7		7
Përgjegjës Operacional/Turni, C1	0	0	0	0	0	0	81	81
Auditues, C1	7	0	0	0	0	7		7
Kordinator per Skanimet	0	0	0	1	0	1	4	5
Komandant	0	0	0	22	0	22		22
Doganier kategoria C2	0	35	0	20	0	55	329	384
Specialist GFI	0	0	5	0	0	5		5
Inspektor Antikontrabande, C2	0	0	0	49	0	49		49
Asistent Laborant C2	0	6	0	0	0	6		6
Sekretar/Përpunues Informacioni/Arkiv	1	2	1	2	6	12	22	34
Doganier Peshore/ Pike Kontrolli	0	0	0	8	0	8	111	119
Magazinjer/Teknik Mirëmbajtje/Shofer D1	2	0	0	2	11	15	2	17

Sanitar/Punonjes Pastimi D3	0	1	0	0	4	5		5
Shuma	42	94	57	207	64	464	638	1102

Ndryshimet në strukturën organike të DPD paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	***Totali Administrates 2018***	***Totali Administrates 2017***	***Diferenca ne Strukture***
Drejtor i Përgjithshëm	1	1	0
Drejtor Kabineti, A	1	1	0
N/Drejt i Përgjithshëm	4	4	0
SECI, A	1	1	0
Këshilltare, A	4	0	+4
Drejtor Drejtorie, A	21	32	-11
Kryetar Dogane, A	7	0	+7
Kryetar Dogane, B	10	0	+10
Pergjegjes Sektori, B	49	53	-4
Pergjegjes i Administrates dhe Sherbimit, B	16	0	+16
Specialist, C1	242	327	-85
Specialist, C1 QNOD	5	0	+5
Oficer i OPGj, C1	7	8	-1
Përgjegjës Operacional/Turni, C1	81	0	+81
Auditues, C1	7	7	0
Kordinator per Skanimet	5	17	-12
Komandant	22	0	+22
Doganier kategoria C2	384	409	-25
Specialist GFI	5	0	+5
Inspektor Antikontrabande, C2	49	0	+49
Asistent Laborant C2	6	0	+6
Sekretar/Përpunues Informacioni/Arkivist	34	0	+34
Doganier Peshore/ Pike Kontrolli	119	141	-22
Magazinjer/Teknik Mirëmbajtje/Shofer D1	17	26	-9
Punetor mirembajtje D2	0	1	-1
Sanitar/Punonjes Pastimi D3	5	24	-19
Shuma	1102	1052	+50

Ndryshimet kryesore që ka sjell miratimi i strukturës së re:

Drejtoria e Anti-Korrupsionit dhe Standarteve Profesionale është shtuar me 1 specialist

Drejtoria e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave ka kaluar në varësi të Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit dhe është shkurtuar me 1 specialist

Departamenti Teknik ka ndryshuar emërtesë në Departamenti Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore dhe ristrukturohet në 5 Drejtori: Drejtoria Teknike e Akcizës, Drejtoria e Procedurave Doganore, Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, Drejtoria e Laboratorit Doganor, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër. Departamenti ndryshon numrin total të punonjësve dhe nga 52 punonjës shkoj në 94.

Departamenti Operativ Hetimor ristrukturohet, nga 2 sektorë bëhet me 3 me një numër total prej 89 punonjësish. Është shtuar Sektori i Koordinimit dhe Operativitetit në Terren me 3 punonjës. Në sektorin e Antikontrabandës Detare është shtuar një 1 specialist dhe është reduktuar numri I punonjësve administrativë Teknik Marine/Motorrist nga 5 në 1.

Drejtoria Antitrafik ristrukturohet dhe ndahet në 3 sektorë dhe numri i punonjësve dyfishohet nga 8 në 16.

Drejtoria e Hetimit ristrukturohet dhe krijohen 4 sektorë. Nga 24 punonjës kalon me 25.

Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit ristrukturohet në 2 sektorë dhe nga 11 punonjës kalon në 26.

Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit ristrukturohet duke u shtuar 1 sektor i ri. Numri total i punonjësve shkon në 44 nga 45 që ishte.

Departamenti Administrativ ristrukturohet dhe ka në përbërje Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Burimeve Mbështetëse, Drejtorinë Juridike dhe numri i punonjësve rritet nga 15 në 18. Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit (Help Desk) kalon në Drejtorinë e Burimeve Mbështetëse dhe 2 sektorët e tjerë, Sektori i Sistemeve dhe Sigurisë dhe Sektori i Zhvillimit kalojnë në varësi të AKSH-it.

Departamenti i Analizave dhe Aposteriorit krijohet si department i ri nga bashkimi I Drejtorisë së Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të ardhurave dhe Drejtorisë së Vlerës Doganore. Përbëhet nga 3 drejtori: Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave. Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor. Në total ka 52 punonjës.
Departamenti i Akcizës është ristrukturuar dhe suprimohet. Dy drejtoritë kalojnë në Departamente të tjerë.
Dega Doganore Shkodër ristrukturohet dhe numri i punonjësve rritet nga 47 në 50.
Dega Doganore Lezhë. Nga 19 punonjës bëhet me 15.
Dega Doganore Bllatë. Numri i punonjësve ndryshon nga 18 në 14.
Dega Doganore Kukës. Numri i punonjësve ndryshon nga 49 në 47. Pakësohet një sanitare dhe 1 doganier regjim/akcize.
Dega Doganore Tiranë. Numri i punonjësve shtohet nga 65 në 69.
Dega Doganore Durrës. Numri i punonjësve rritet nga 119 në 125.
Dega Doganore Rinas. Numri i punonjësve nga 42 kalon në 40. Pakësohet një 1 sanitare dhe 1 doganier Cargo.
Dega Doganore Elbasan. Numri total i punonjësve mbetet i njëjtë. Pakësohet 1 sanitare, 1 doganier dhe shtohen 2 doganier.
Dega Doganore Qafë Thanë organizohet në 5 zyra. Pakësohet 1 sanitare. Nr total i punonjësve kalon nga 37 në 38.
Dega Doganore Korcë. Administrata pakësohet me 1 sanitare, shtohet 1 specialist. Nga 24 punonjës kalon me 23.
Dega Doganore Kapshticë organizohet me 4 zyra. Nga 32 punonjës kalon me 30.
Dega Doganore Vlorë pas organizimit kalon me 32 punonjës nga 35.
Dega Doganore Fier pas organizimit shtohet me 5 punonjës dhe kalon në 44.
Dega Doganore Berat pas organizimit nga 13 punonjës kalon me 16.
Dega Doganore Kakavijë pas organizimit të sektorëve pakësohet me 3 punonjës dhe kalon në 37.
Dega Doganore Sarandë organizohet në 4 zyra dhe numri total i punonjësve rritet me 1. Nga 27 shkon në 28.
Dega Doganore 3-Urat (Përmet) organizohet me 3 zyra dhe numri total i punonjësve kalon nga 15 në 13.

Ristrukturimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Me shkresën Nr.769 Prot. Datë 12.01.2018 Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Znj.Belinda Ikonomi, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike për vënien në dijeni që DPD është në kushtet e ristrukturimit të Institucionit dhe për krijimin e Komisionit, në përputhje me Udhëzimin Nr.1 datë 01.03.2016 Kreu II "Krijimi dhe funksionimi i komisionit të ristrukturimit" pika 1 e cila citon- Jo më vonë se dy ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar mbylljen apo ristrukturimin e Institucionit, nëpunësi më i lartë civil në institucionin në të cilin është/janë nëpunësi/t i/të emëruar në pritje për transferim, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit.

Me shkresën kthim përgjigje Nr.Prot. 265/1 datë 24.01.2018 DAP dërgon Urdhërin Nr.04 datë 24.01.2018, 10 ditë më vonë se përcaktimet në Udhëzimin Nr.1 datë 01.03.2016, kreu II, pika 2 e cila citon se "Njësia përgjegjëse (DAP), brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës krijon Komisionin".
Në zbatim të Vendimit Nr.921 datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", të ndryshuar, Ligjit Nr.152/2013 "Për Nënpunësin Civil", i ndryshuar; VKM Nr.125, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave "Për Transferimin e Përkohshëm dhe të Përhershëm të Nënpunësve Civilë";

Udhëzimit Nr.1, datë 01.03.2016 të Departamentit të Administratës Publike "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të Institucionit", si dhe në bazë të Urdhërit Nr.04 datë 24.01.2018 të Departamentit të Administratës Publike "Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit" të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, u ngrit Komisioni i Ristrukturimit, i përbërë nga:

Znj. I. V. - specialist në Sektorin e Sekretariatit Teknik për TND, në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit në Fushën e Menaxhimit të Shërbimit Civil, në Departamentin e Administratës Publike, Kryetar;

Znj. G. P. - Sekretar i Përgjithshëm në MFE, Anëtar;

Z. A. S. - Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ, në DPD, Anëtar;

Ky komision është ngritur në përputhje me kreun II pika b. Rasti i dytë: Ristrukturimi i Institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës, Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga: Nëpunësi më i lartë civil i institucionit mëmë nga varet institucioni që po ristrukturohet (Kryeministrisë në rastin e varësisë së Kryeministrit apo ministrisë në rastin e institucioneve në varësi të ministrave); Nëpunësi më i lartë civil i institucionit që po ristrukturohet; Një përfaqësues nga njësia përgjegjëse (DAP);

Referuar pikës 15, Kreut II, të VKM Nr.125 datë 17.02.2016 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të përhershëm të nënpunësve civil" në të përcaktohet qartë që:

"*Nëpunësit e Institucionit të ristrukturuar apo të mbyllur njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, në momentin e miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së Institucionit*"

Referuar Nenit 50, pika 7, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në të përcaktohet qartë që:

"*Nëpunësit që i përkasin Institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e këtij neni, nëpunësi civil që largohet ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë*"

Nga auditimi u konstatua se nuk është bërë njoftimi individual i punonjësve për ristrukturimin e Institucionit dhe as nuk janë zhvilluara takime.

E vetmja shkresë njoftimi është shkresa nr.463/1 Prot datë 11.01.2018 nga Zv. Drejtor i Përgjithshëm drejtuar: Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, Departamenteve, Drejtorive, Degëve Doganore, nëpërmjet së cilës u është përcjellë Vendimi Nr.02 datë 08.01.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.921 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për personelin e Administratës Doganore". Sipas kësaj shkrese ngarkohen Drejtorët e Drejtorive dhe Kryetarët e Degëve Doganore të marrin masa për njohjen dhe zbatimin e këtij vendimi për të gjithë punonjësit e administratës doganore.

Referuar pikës 17, VKM Nr. 125 Datë 17.02.2016 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të përhershëm të nënpunësve civil", në të përcaktohet qartë që:

"*Komisioni, brenda 15 ditësh nga momenti i krijimit të tij i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira sipas procedurave më sipër; i dërgon njësisë së burimeve njerëzore të institucionit vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit sipas procedurave më sipër*"

Nga auditimi u konstatua se propozimet nga ana e Komisionit dhe konfirmimet nga DAP janë bërë jashtë afateve ligjore të përcaktuara duke e tejzgjatur procesin e Ristrkturimit deri në mars të vitit 2019.

Propozimi i parë është bërë në datën 25.01.2018 për 57 punonjës në përputhje me VKM.

DAP në datën 26.01.2018 i ka miratuar propozimet me shkresën nr.2118 prot datë 26.01.2018 në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, 37 akte emërimi janë për Drejtorinë e Vlerës në Qendër dhe 20 akte emërimi për Drejtorinë e Kontrolleve Paszhdoganimit (apostreriori operativ 5 ditor)

Me shkresën Nr.2022 Prot datë 24.01.2018 Komisioni i Ristrukturimit ka bërë 21 propozime për sistemim punonjësish të Degës Doganore Kukës, Morinë të cilat janë miratuar nga DAP më shkresën Nr.529/1 Prot datë 24.01.2019, 1 vit me vonesë. (Nr.2022/1 datë 24.01.2019 DPD).

Me shkresën Nr.561 Prot datë 26.01.2018 Komisioni i Ristrukturimit ka vijuar me propozime për Departamentin Teknik të Akcizës dhe Procedurës Doganore dhe Departamentit Operativ Hetimor. Konstatohen mangësi në shkresë pasi nuk është përfshirë numri total i gjithë punonjësve pavarësisht se përmendet që gjithë Departamenti është prekur nga Ristrukturimi duke kaluar si Drejtori Vlerësimi në Qendër. Shkresa e propozimit është e pafirmosur nga një prej anëtareve të Komisionit Znj.G. P..

Propozimi nga Komisioni i Ristrukturimit është bërë në datën 01.11.2018, pra 9 muaj me vonesë, nisur nga përcaktimet ligjore të VKM Nr.125 datë 17.02.2016. Janë propozuar për sistemim 189 punonjës, të cilët janë miratuar nga DAP po në datën 01.11.2018, me shkresën nr 7792/1 prot datë 01.11.2018.

Në datë 25.01.2019 me shkresat si më poshtë janë bërë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit për degët doganore si më poshtë:

Me shkresën Nr.2173/3 Prot datë 25.0l.2019 për DD Kakavijë (Gjirokastër) janë propozuar në ristrukturim 17 punonjës. Kjo degë doganore do të ketë një nr total prej 36 punonjësish.

Përgjatë vitit 2018, në DPD, numri i personave të larguar ka qenë 89 nëpunës nga të cilët:
Me komision disiplinor – 7 punonjës
Me kërkesë të nëpunësve - 17 punonjës
Pension Pleqërie - 10 punonjës
Transferim ndërinstitucional - 1 punonjës
Pezullime të përkohshme – 17 punonjës
Lirim për shkak të ligjit të dekriminalizimit - 2 punonjës
Ndërprerje kontrate me Kod Pune - 8 punonjës
Nga Ristrukturimi – 25 punonjës
Vdekje – 1 punonjës
Kemp – 1 punonjës
Largimet nga Ristrukturimi janë bërë referuar aneksit nr. 1 të VKM nenit 921, datë 29.12.2014, i ndryshuar me VKM nr. 2, datë 08.01.2018, *"Për disa ndryshime në VKM nr. 921, datë 29.12.2014 'Për personelin e administratës doganore'"*, si dhe nenit 141, 143 pika 1 dhe 145 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i punës", i ndryshuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, që ndodhet në dosjen individuale të personelit, nuk u konstatuan problematika në lidhje me respektimin e afateve ligjore dhe dhënien e shpërblimit për vjetërsi.

Komisioni Disiplinor për vitin 2018
Komisioni Disiplinor në DPD funksionon në zbatim të procedurave të përcaktuara në Ligjin Nr.152/2013 "Për Nënpunësin Civil", Vendim nr.115, datë 5.3.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor", VKM Nr.921 datë 29.12.2014 "Për personelin e Administratës Doganore".
Komisioni Disiplinor është ngritur me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm në DPD sipas kërkesave të Kreut VI "Procedura disiplinore" me përbërje: një prej nënpunësve civilë të kategorisë së mesme drejtuese, DMBNJ dhe nënpunësin civil më të vjetër në detyrë.

Nga veprimtaria e Komisionit Disiplinor për vitin 2018 u konstatua se ky komision ka shqyrtuar 37 raste në total nga të cilat:
Ndërprerje të ecurisë disiplinore – 18 raste
Mbajtje e pagës deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj – 4 raste
Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për 1 periudhë deri në 2 vjet – 3 raste
Largim nga shërbimi civil – 2 raste
Në proces – 3 raste
Për kompetencë te eprori direkt – 3 raste
Pezullimi nga shërbimi civil me vendim të ndërmjetëm të Komisionit Disiplinore – 4 raste

Referuar pikës 7, Kreu II "Komisioni Disiplinor i Vendimit Nr.115 Datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil" në të përcaktohet qartë që:

"Eprori direkt, në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore nëpërmjet ankesave nga publiku, e vlerëson paraprakisht atë"

Referuar pikës 13/c të Kreut II "Komisioni Disiplinor" i Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil" në të përcaktohet qartë që:

"Për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe Jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësi"

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve konstatohet se:
Në dosjen e G..... G..... mungon aryetimi i eprorit direkt për fillimin ose jo të ecurisë disiplinore. Nuk është mbajtur procesverbal për datën e shqyrtimit të cështjes, personat që marrin pjesë dhe vendin e seancës. Data e shqyrtimit është më vonë se 16 ditë nga marrja e njoftimit të nënpunësit.
Në dosjen e K..... B..... nuk ka procesverbal për zhvillimin e mbledhjes. DAP si anëtar i Komisionit Disiplinor nuk ka qënë i pranishëm. Data e shqyrtimit është më vonë se 16 ditë nga marrja e njoftimit të nënpunësit.
Në dosjen e I..... M..... nuk disponohet raport i mbajtur nga Komisioni për moszhvillimin e seancave dëgjimore në datat e përcaktuara. Data e shqyrtimit është më vonë se 16 ditë nga marrja e njoftimit të nënpunësit.
Në dosjen e A..... N..... nuk ndodhen deklaratat për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të KD.
Në dosjen e S.... D.....ndodhet deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të KD së A.....V..... Anëtarët e tjerë kanë firmosur deklarat pa plotësuar për cilin punonjës janë.
Në dosjen e A.... M..... rezulton se njoftimi për ecurinë disiplinore është bërë rreth 6 muaj me vonesë dhe nuk ka material/procesverbal për zhvillimin e seancës. Në dosje mungon deklarata e pavarësisë dhe gjatë shqyrtimit të ecurisë disiplinore të punonjësit ka munguar përfaqësuesi i DAP.
Në dosjen e E..... K... mungon shkresa se kush e ka inicuar ecurinë disiplinore dhe mungon arsyetimi i eprorit direkt. Mungon dokumentacioni për zhvillimin e seancës dëgjimore. Në dosje mungon deklarata e pavarësisë dhe gjatë shqyrtimit të cështjes nuk ka qënë prezent përfaqësuesi i DAP.
Në dosjen e D..... C..... mungon dokumentacioni për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe deklarata e pavarësisë dhe gjatë shqyrtimit të cështjes nuk ka qënë prezent përfaqësuesi i DAP.
Në dosjen e M..... Z..... procesverbali i mbajtur për zhvillimin e seancës dëgjimore është pa datë dhe i pafirmosur nga anëtaret e KD.
Në dosjen e A..... F..... nuk ka qënë prezent përfaqësuesi i DAP. Procesverbali i mbajtur për zhvillimin e seancës dëgjimore është i pafirmosur nga anëtaret e KD.
Në mënyrë të përmbledhur konstatohen këto problematika:
Në dosjen e punonjësit për të cilën ka filluar ecuria disiplinore, mungon arsyetimi i eprorit direkt për fillimin e ecurisë disiplinore të punonjësve në kundërshtim me Pikën 7, kreu II "Komisioni Disiplinor".
Në disa raste data e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore është më vonë se 16 ditë nga dita e marrjes së njoftimit nga nënpunësi, në kundërshtim me pikën 13/c të Kreut II "Komisioni Disiplinor" i Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil".
Në disa raste, deklaratat për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të KD janë të nënshkruara nga anëtarët, por nuk tregohet se për cilin/cilën punonjës bëhet kjo deklaratë.

Nuk disponohen shkresa për shtyrje të seancës dëgjimore.
Konstatohet se janë 8 punonjës të larguar përgjatë vitit 2018 që kanë ngritur padi mbi largimin nga puna si në vijim:

Nr	*Emer*	*Mbiemer*	*Objekti padise*	*Faza e gjykimit*
1			Rikthim ne Detyre/ /Larguar me Kom.Disipl	Humbur nga DPD ne Gj.A. - Proces Gjykata Administrative Apel Tirane
2			Demshperblim Page/ Larguar me Kod Pune	Proces ne Gjykaten e Rrethit Elbasan
3			Demshperblim Page/ Larguar me Kod Pune	Pushuar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane
4			Demshperblim Page/ Larguar me Kod Pune	Proces ne Gjykaten e Rrethit Pogradec
5			Anullim Vendimi/ Larguar me Kod Pune	Pushuar ne Gjykaten Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster
6			Shfuqizim akti/Ristrukturim	Proces ne Gjykaten e Rrethit Shkoder
7			Anullim Vendimi//Larguar me Kom.Disipl	Humbur ne Gjykaten Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster. Proces ne Gjykaten e Apelit
8			Shfuqizim vendimi//Larguar me Kom.Disipl	Humbur ne Gj.Ad. Shk.1. Proces ne Gjykaten Administrative Apel Tirane

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Znj. B..... I..... ish-Drejtoreshë e Përgjithshme e DPD, Z. A..... S..... në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Disiplinor, Znj. A..... V..... në cilësinë e Antares së Komisionit Disiplinor dhe cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, dhe si anëtar të KD sipas rasteve përkatëse ku me Urdhër të DP janë caktuar: Z. Zh..... D....., Z. S..... S....., Z. A..... S....., Z. D..... Sh....., Z. B.....D....., Z. I..... B....., Z. V..... V.....

Vlerësimi vjetor i punonjësve

Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit që administrohet në dosjen e vlerësimit vjetor për punonjësit e DPD rezulton se është hartuar formulari i vlerësimit vjetor.
Me shkresën Nr.15339 Prot datë 27.06.2018 është urdhëruar kryerja e procesit të vlerësimit për 6-mujorin e parë të vitit 2018, periudha 01.01.2018-30.06.2018. Ndërsa me shkresën Nr.15339 Prot datë 27.06.2018 është urdhëruar kryerja e procesit të vlerësimit për 6-mujorin e dytë. Sipas kësaj shkrese ky proces do të konkludohet me nënshkrimin e formularëve të vlerësimit nga Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për shkak të angazhimeve të vazhdueshme të Titullarit, në mënyrë që të realizohet brenda afateve ligjore. Nga auditimi i dokumentacionit që administrohet në dosjen e vlerësimit vjetor konstatohet se në përgjithësi vlerësimi i punonjësve është realizuar por konstatohen disa mangësi të tilla si mungesa firmash nga zytari kundërfirmues apo autorizues, datat e vlerësimit etj. Vlerësimet e punës janë të paprotokolluara.

Dosjet e personelit

Nga kontrolli i dosjeve personale të punonjësve, konstatohet se ka disa rasteve me mungesa të pjesshme në dokumentacion, konkretisht: Në disa raste nuk administrohet në dosje raporti mjeko ligjor, vërtetim nga prokuroria (dosja D Sh.....), auotrizimi i konfliktit të interesit, dokumenta të kurseve kualifikuese apo gjuhëve të huaja, vërtetim nga tatim-taksat (A..... H....., D..... Sh.....) si dhe në disa raste nuk është plotësuar fletë inventari i dosjes (E..... D.....). Kjo në kundërshtim me Lidhjen Nr.1 dhe Lidhjen Nr.2 të Vendimit Nr.117 datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Znj.A..... V..... në pozicionin Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore.

Vendimet gjyqësore

Nga auditimi u konstatua se: Gjatë vitit 2018, janë likuiduar me Vendime Gjyqësore të formës së prerë ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën 51,418,190 lekë, nga të cilat vlera prej 2,080,446 lekë është kthim me memo kredi e vitit 2017, pra në total likudiuar nga buxheti i shtetit 49,337,744 lekë. Drejtoria e Financës, për ndjekjen e këtyre vendimeve gjyqësore ka mbajtur një databaze me të dhëna

si, numri dhe data e vendimit gjyqësor, gjendja e detyrimit të mbartur në çelje të periudhës ushtrimore si dhe likuidimet mujore për çdo person të regjistruar në këtë databazë.

Vendimet gjyqësore për - ish punonjës viti 2018

Nr	*Ish - Punonjësi*	*Nr. dhe data vendimit gjykatës*	*Apelit / Gjykatës së Lartë*	*SHUMA Detyrimit*	*SHUMA likujduar në 2018*	*Detyrimi i mbartur për vitin 2019*	*Urdhër Pagesa*	*Urdhëri i Titullarit Nr….datë……*
							Nr.	*Data likujdimit*
1		nr.2175 datë 13.07.2016	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	415,015	415,015	-	71	09.02.2018
2		nr.828 dt.31.10.2017	Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë	1,665,431	1,665,431	-	162	05.03.2018
3		nr.3601 , datë 02.11.2016	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	7,500	7,500	0	105	20.02.2018
4		Nr.4, datë 14.01.2009	Gjykatës së Apelit Korçë	39,552	39,552	0	104	20.02.2018
5		nr.171, dt.25.01.2017	Gjykatës Administrative të Apelit	119,622	119,622	0	81	13.02.2018
6		nr.4707(80-2017-4799) dt 06.12.2017	Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë , Tiranë	86,400	86,400	0	288	24.04.2018
7		nr.1153,date 20.03.2017	Gjykatës Administrative të Apelit	3,500	3,500	0	176	12.03.2018
				56,445	56,445	0	79	13.02.2018
8		nr.2002(2028), dt.14.06.2017	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	75,232	75,232	0	77	13.02.2018
9		nr.4383, dt.07.12.2016	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	64,010	64,010	0	80	13.02.2018
10		nr.325 datë 31.01.2018	Gjykatës Administrative së Apelit	1,543,872	771,936	0	320	10.05.2018
					300,000		530	26.07.2018
					471,936		1,083	17.12.2018
11		nr.2624,nr.301 akti , datë 03.0.2005 ,	Gjykatës së Rrethit Gjyqësor , Tiranë	632,563	200,000	0	562	30.07.2018
					432,563		1,133	19.12.2018
12		nr.1430 dt.05.04.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	145,375	145,375	0	333	15.05.2018
13		nr.310 dt.31.01.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	2,989,800	2,989,800	0	1153 1202	21.12.2018
				503,736	0	503,736	-	-
14		nr.232 datë 21.01.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	3,486,800	250,000	0	547	27.07.2018
					3,236,800		1,095	17.12.2018
				460,800	0	460,800	-	-
15		0	Gjykatës së Apelit Tiranë	6,259,680	1,000,000	0	537	26.07.2018
					5,259,680		1,089	17.12.2018
				405,860	0	405,860	-	-
16		Nr.392, datë 02.03.2016	Gjykatës Administrative së Apelit Tiranë	1,240,800	1,240,800	0	1,205	27.12.2018
17		nr.2273, datë 24.05.2017	Gjykatës Administrative të Apelit	22,001	22,001	0	82	13.02.2018
18		nr.5030, datë 30.11.2017	Gjykatës Adminisrative së Apelit Tiranë	603,844	182,320	0	178	12.03.2018
					182,320		321	10.05.2018
					182,320		541	26.07.2018
					56,884		591	03.08.2018
19		nr.5196(5552), datë	Gjykatës Administrative së	841,614	200,000	0	529	26.07.2018
					420,807		204	30.03.2018

		12.12.2017	Apelit		220,807		1,082	17.12.2018
20		Nr.1835, datë 15.05.2014	Gjykatës së Apelit Tiranë	14,426	14,426	0	106	20.02.2018
21		Nr.1345, datë 30.03.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	2,997,100	300,000	0	533	26.07.2018
					200,000		812	16.10.2018
					2,497,100		1,086	17.12.2018
				418,355	0	418,355	-	-
22		nr.2624,nr.301 akti , datë 03.0.2005 ,	Gjykatës së Rrethit Gjyqësor , Tiranë	562,988	200,000	0	561	30.07.2018
					362,988		1,132	19.12.2018
23		nr.2329, datë 19.07.2016	Gjykatës Administrative së Apelit	86,960	86,960	0	182	13.03.2018
				43,480	43,480	0	551	30.07.2018
24		nr.5328 datë 14.12.2017	Gjykatës Administrative së Apelit	296,590	296,590	0	1,220	27.12.2018
25		nr.1026 datë 12.03.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	1,217,398	300,000	0	552	27.07.2018
					917,398		1,127	19.12.2018
26		nr.778 dt.27.02.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	2,644,341	250,000	0	548	27.07.2018
					2,394,341		1,125	19.12.2018
27		nr.2027 datë 16.05.2016	Gjykatës Administrative së Apelit Tiranë	500,895	500,895	0	1,215	27.12.2018
28		nr.1156, dt.12.05.2016	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	589,500	589,500	0	76	13.02.2018
29		nr.1531 dt.12.04.2018	Gjykates Administrative te Apelit	1,106,128	250,000	0	563	30.07.2018
					856,128		1,134	19.12.2018
30		nr.11522(86-2018-1738), datë 12.04.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë,	2,463,399	250,000	0	546	27.07.2018
					2,213,399		1,092	17.12.2018
31		nr.712 dt.21.02.2018	Gjykates Administrative te Apeli	384,068	236,068	0	539	26.07.2018
					148,000		1,203	27.12.2018
32		nr.29 date 26.04.2018	Gjykates Administrative te shk.I-rë Tiranë	89,400	26,400	0	90	14.02.2018
					63,000		538	26.07.2018
33		nr.1617 datë 13.04.2017	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	671,443	671,443	0	535	26.07.2018
34		nr.2087, datë 16.05.2017	Gjykatës Administrative shk.I-rë , Tiranë	115,576	115,576	0	107	20.02.2018
35		nr.3723, dt.09.11.2016	Gjykatës Administrative të Apelit	1,471,994	200,000	0	559	30.07.2018
					1,271,994		1,128	19.12.2018
				455,984	0	455,984	-	-
36		Nr.310 datë 31.01.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	2,977,126	250,000	0	550	27.07.2018
					2,727,126		1,126	19.12.2018
				517,518	0	517,518	-	-
37		nr.2431 datë 14.06.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	1,293,382	1,293,382	0	1,229	27.12.2018
38		nr.2589 datë 26.06.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	2,149,826	2,149,826	0	1214 1204	27.12.2018
39		nr.343 datë 30.05.2016	Gjykatës Administrative shk.I-rë , Gjirokastër	504,290	250,000	0	542	26.07.2018
					254,290		1,090	17.12.2018
				389,760	0	389,760	-	-
40		nr.1551 datë 16.04.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	1,641,944	200,000	0	560	30.07.2018
					1,441,944		1,131	19.12.2018

41		nr.3463(3610) datë 14.07.2017	Gjykatës Administrative te Apelit Tiranë	376,769	176,769 200,000	0	1,084 531	17.12.2018 26.07.2018
42		nr.594, datë 15.02.2017	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	400,100	200,000 200,100	0	534 1,087	26.07.2018 17.12.2018
43		nr.1834 datë 03.05.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	1,340,328	200,000 1,140,328	0	558 1,130	30.07.2018 19.12.2018
44		nr.1964, datë 15.05.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	228,095	228,095	0	620	27.08.2018
45		nr.3275 986-2017-3403, datë 10.07.2017	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	462,246	462,246	0	108	20.02.2018
46		nr.3094, datë 13.09.2018	Gjykatës Administrative së Apelit Tiranë	2,935,662	2,935,662	0	1,230	27.12.2018
47		nr.4263, dt.06.12.2016	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	389,280	200,000 189,280	0	536 1,088	26.07.2018 17.12.2018
48		nr.1401, datë 04.04.2018	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	727,600	200,000 527,600	0	557 1,129	30.07.2018 19.12.2018
49		nr.5167, datë 07.12.2017	Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	436,800	200,000 236,800	0	532 1,085	26.07.2018 17.12.2018
TOTALI				54,570,203	51,418,190	3,152,013		
kthim me memo kredi v.2017				-	2,080,446			
Likuiduar nga Buxheti				-	49,337,744			

Nga auditimi u konstatua se nga DPD, janë ekzekutuar dhe likudiuar përgjatë vitit 2018, vendime të Gjykatës së formës së prerë të viteve të mëparshme (viti 2005, 2009, 2015, 2016, 2017).

Referuar pikës 3, të Udhëzimit e KM nr. 1, datë 4.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga llogaria e thesarit" në të përcaktohet qartë që:

"Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore realizohet nga njësia shpenzuese përgjegjëse: a. me fondet buxhetore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit pasardhës për njësinë shpenzuese për shlyerjen e detyrimeve të vitit paraardhës, duke respektuar rradhën e paraqitjes në njësinë shpenzuese"

Referuar pikës 5, të Udhëzimit e KM nr. 1, datë 4.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga llogaria e thesarit" në të përcaktohet qartë që:

"Ekzekutimi i vendimeve gjyqesore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shyerjes së detyrimit të publikuar"

Referuar pikës 9, të Udhëzimit e KM nr. 1, datë 4.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga llogaria e thesarit" në të përcaktohet qartë që:

"Në rastin kur njësia shpenzuese nuk ka ndjekur vullnetarisht asnjë nga procedurat e parashikuara në pikat 5 ose 6 të këtij Udhëzimi, atëhere përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyruar nga llogaria e thesarit. Llogari e thesarit, sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", konsiderohet llogaria e unifikuar e thesarit në Bankën e Shqipërisë"

Nga analiza e bazës së të dhënave u konstatua se nuk është bërë shlyerja e vendimeve gjyqësore sipas precedencës së përcaktuar në Udhëzimin e KM nr. 1, datë 4.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga llogaria e thesarit", pika 3, pika 5, pika 9.
Nga auditimi u konstatua se:
Pagesa e detyrimeve gjyqësore për 2018 është bërë duke përzgjedhur vendimet gjyqësore përkatëse dhe jo në respektim të udhëzimit të mësipërm.
Grupi i auditimit konstatoi se shumica e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore janë kryer me përmbarues privat, duke e kaluar afatin për likuidimin vullnetar.
Llogaria 602/7400 "Shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna" është një shpenzim jo efektiv duke pasur parasysh përdorimin e këtyre fondeve buxhetore për paga të punonjësve që nuk kanë punuar për periudhën që janë paguar dhe në mbivlerësim të shpenzimeve të vitit 2018. Mosrespektimi i radhës së pagesës dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore me përmbarues privat rëndon në buxhetin e shtetit, për vlerat e ndërmjetësimit të cilat indeksohen në bazë të vlerës së padisë, shumës që përfiton kreditori gjyqfitues.

Konstatohet gjithashtu se:
Për të gjithë periudhën objekt auditimi, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", ndryshuar me Udhëzimin Nr. 23, datë 30.7.2013, përsa i përket tatimit të të ardhurave personale.
Referuar nenit 8, pika 1, shkronja "g", të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar", në të përcaktohet qartë që:

"Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë"

Referuar nenit 9, "Tarifat tatimore", pika 2, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar", në të përcaktohet qartë që:

"……të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera, që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, tatohen me 15 për qind"

Referuar pikës 8, Kapitullit 2.4 "Të ardhurat e përjashtuara" të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 23, datë 30.7.2013, në të përcaktohet qartë që:

*….**Përfitimet për punonjësit e larguar nga puna** për të cilët Gjykata ka vendosur kthimin në vendet e punës dhe përfitimin e pagës deri në momentin e kthimit në punë, **nuk janë objekt përjashtimi**.*

Vlera totale për punonjësit gjyqfitues për rikthim në punë, të cilëve nuk i'u është mbajtur 15% është **6,351,011** lekë, konstatuar gjatë auditimit në terren, për të cilën është mbajtur Akt Konstatim nr. 6, datë 16.08.2019. Pas konstatimeve të kësaj problematike gjatë auditimit në DD. Elbasan, DPD ka dalë me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD për rikuperimin e vlerës së konstatuar, ndaj pasqyrohet në material heqja si dëm ekonomik ndërsa përgjegjësia mbetet.
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Znj. B..... I..... ish-Drejtoreshë e Përgjithshme e DPDP, zj. F..... M....., me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit & Financës, zj. A..... K....., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit & Financës dhe z. I..... B....., me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të financës dhe kontabilitetit në Drejtorinë e Buxhetit & Financës dhe anëtar i Komisionit të Posaçëm pranë DPD.

Nga auditimi u konstatua se:

Referuar pikës 3, të Kreut IV të urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil", në të përcaktohet qartë që:

"...Shqyrtimi administrative përfundon jo më vonë se 15 ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës/ lajmërimit me shkrim për ekzekutim vullnetar"

Referuar pikës 3, Kreu II, të Urdhërit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike *"Për zbatimin e vendimeve gjyqsore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil "*, në të përcaktohet qartë që:

***Të dhënat e përditësuara**, sipas pikës 2 të këtij kreu, **i vihen në dispozicion DAP-it** nga njësia e burimeve njërëzore të njësisë debitore, në formën e kërkuar prej tij **brenda 2-ditëve** punë, nga momenti i përditësimit të çdo të dhëne*

Referuar pikës 5, Kreu III, të Urdhërit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike *"Për zbatimin e vendimeve gjyqsore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil "*, në të përcaktohet qartë që:

***Njësia e burimeve njerëzore**, në njësinë debitore, informon **brenda ditës**, nga depozitimi i kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit/përfaqësuesit ligjor të tij/përmbaruesit gjyqësor, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpunësin më të lartë civil të njësisë debitore/titullarin e institucioneve të varësisë dhe **vë në dijeni Departamentin e Administratës Publike**.*

Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil", në të përcaktohet qartë që:

Komisioni i Posacëm, në përfundim të shqyrtimit të rasteve konkrete, nxjerr akt rekomandimin me zgjidhjet konkrete për sistemimin e gjyqfituesit në një pozicion të rregullt të shërbimit civil

Gjatë kësaj periudhe nuk ka funksionuar Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave, pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, për të gjithë gjyqfituesit, referuar urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike. Mos funksionimi i këtij komisioni ka sjellë dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura përgjatë vitit 2018, pasi në kundërshtim me pikën 3, 4, 5 të Kreut IV "Shqyrtimi i fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë", nuk ka mbaruar shqyrtimi administrativ për sistemimin e gjyqfituesve në kohë.

Komisioni i Posacëm është ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr.20133 Prot datë 07.09.2017 me përbërje si në vijim:

a) Z. A..... S..... me detyrë Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ në cilësinë - Kryetar
b) Znj. A..... V..... përfaqësues që mbulon cështjet e burimeve njerëzore – anëtar
c) Z. I... B.....– përfaqësues që mbulon cështjet financiare/buxhetore
d) Znj. O..... B..... – përfaqësuese që mbulon cështjet juridike – anëtare

Nga auditimi konsatojmë se nuk kemi asnjë procesverbale të dokumentuar mbi takimet dhe mbledhjet e zhvilluara nga Komsioni i Posacëm për trajtimin dhe sistemimin në punë të gjyqfituesve.

Të punësuarit me Vendim Gjykate përgjatë Vitit 2018

Nga auditimi u konstatua se janë rikthyer në punë 11 ish-punonjës që kanë fituar me Vendim Gjykate të formës së prerë për rikthim në punë.

PUNONJES ME VENDIM GJYKATE	*Emër*	*Mbiemër*	*Data e emërimit në punë*	*Vendimi i Gjykatës*
1			11.01.2018	Rikthim Vendim Gjykate dt 04.01.2018 prot., 6915/2
2			26.02.2018	Rikthim Vendim Gjykate Apelit Tirane dt 14.07.2017 prot., 3610
3			20.07.2018	Rikthim Vendim Gjykate Apelit Tirane dt 14.07.2017 prot., 15041
4			22.10.2018	Rikthim Vendim Gjykate Apelit Tirane Nr.1345 datë 30.03.2018
5			20.11.2018	Rikthim Vendim Gjykate Apelit Tirane Nr.3723 datë 09.11.2016
6			21.11.2018	Rikthim Vendim Gjykate Apelit Tirane Nr.310 date 31.01.2018
7			21.11.2018	Rikthim Vendim Gjykate Apelit Tirane Nr.778 date 27.02.2018
8			01.12.2018	Rikthim Vendim Gjykate Apelit Tirane Nr.232 datë 26.01.2018
9			26.01.2018	Rikthim Vendim Gjykate Apelit Tirane dt 20.01.2012 prot., 115
10			18.12.2018	Rikthim Vendim Gjykate Apelit Tirane Nr 705 date 21.02.2018
11			26.12.2018	Rikthim Vendim Gjykate Administrative te Shkalles se Pare 972 dt 19.03.2017 Tirane

Gjithashtu ish-punonjësi A.... R.... rezulton ende i pa sistemuar në punë, pavarësisht se vendimi Nr.1300 Datë 1.05.2017 i gjykatës së Apelit Tiranë, i formës së prerë është me "kthim në shërbimin civil dhe pagim page për kohën e qëndrimit pa punë".

Konstatojmë së marëdhëniet financiare janë ndërprerë në 08.12.1999 dhe për periudhën 08.12.1999-08.12.2017 është paguar në vlerën 6,259,680 lekë.

Konstatohet se dhe për rikthimin e punonjësve në punë Komisioni i Posacëm nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për t'i rikthyer të gjithë, në kohë, dhe sipas radhës së daljes së vendimit të formës së prerë të Gjykatës.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Znj. B..... I..... ish Drejtoreshë e Përgjithshme e DPD dhe Komisioni i Posacëm Z. A..... S..... me detyrë Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ në cilësinë – Kryetar, Znj. A..... V..... përfaqësues që mbulon cështjet e burimeve njerëzore – anëtar, Z. I..... B..... – përfaqësues që mbulon cështjet financiare/buxhetore, Znj. O..... B..... – përfaqësuese që mbulon cështjet juridike – anëtare

Referuar pikës 3, të Kreut II "Krijimi i bazës së të dhënave gjyqësore", të Urdhërit Nr 5151, Datë 28.10.2018 të Ministrit të Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike, "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil", në databazën e paraqitur nga DPD nuk u raportuan 4 raste gjyqfituesish që kanë marr Vendim të formës së prerë për rikthim në punë dhe ende nuk janë rikthyer, si më poshtë:

1. Sh..... C..... me Vendimin Nr. nr. 4707(80-2017-4799) datë 06.12.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
2. V..... K..... me Vendimin nr.4263, dt.06.12.2016 të Gjykatës Administrative Tiranë
3. O..... C..... me Vendimin nr.343 datë 30.05.2016 të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Gjirokastër
4. S..... K..... me Vendimin nr.3094, datë 13.09.2018 të Gjykatës Administrative Tiranë

U konstatua gjithashtu se sipas databazës së vendimeve gjyqësore janë 3 punonjës të rikthyer në punë me Vendim Gjykate por që ende nuk kanë dorëzuar kërkesë për likuidim. Në mungesë të një regjistri me të dhëna të mjaftueshme dhe me raportim të saktë të ish-gjyqfituesve nuk mund të shprehemi për detyrimet e mundshme në vazhdim dhe efektin që do të kenë në buxhetin e shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Znj. A.... V..... në cilësinë Drejtor Drejtorisë së Burimeve Njerëzore

8. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Në zbatim të pikës 8 të programit të auditimit "Nr 242/1 Prot., datë 06.06.2019", për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Raporti Përfundimar i KLSH me objekt auditimi 01.01.2017-31.12.2017.

2. Urdhëri i Grupit të Punës të DPD për vlerësimin e Rekomandimeve të KLSH.
3. Shkresa, materiale, evidenca mbi marrjen e masave për zbatimin e Rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Me shkresën nr.280/11 prot., datë 05.10.2018 (nr.22995 prot, datë 08.10.2018 të DPD), KLSH ka dërguar: *"Raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet"* (këtu e në vazhdim RPA), mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të ushtruar në DPD për periudhën 01.01.2017-31.12.2017. Nga KLSH është kërkuar zbatimi i rekomandimeve për 24 "Masa organizative", 1 masë për eleminimin e efekteve negative në Buxhetin e Shtetit, 7 "Masa për shpërblim dëmi" dhe i është rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave fillimi i procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e "Masave Disiplinore", në vlerësim të shkeljeve të trajtuara në Raportin përfundimtar të auditimit dhe klasifikimi tyre sipas nenit 57, pika1, shkronja "b"; "c"; "ç " të ligjit nr. 152/2013"Për nëpunësin civil".

I. Hartimi i programit (Planit të veprimit), si dhe respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (shkronja "j"e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014,datë 27.11.2014).
- Nga auditimi rezultoi se, DPD me shkresën nr. 22995/4, datë 25.10.2018, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës të ndarë sipas sektorëve përkatës për vlerësimin e rekomandimeve dhe klasifikimin e shkeljeve të trajtuara në RPA i cili do të paraqes para Drejtorit të Përgjithshëm qëndrimin e Institucionit mbi rekomandimet e lëna dhe masat që propozohen ndaj personave përgjegjës. Së bashku me Programin e punës (Plan Veprimi), në lidhje me rekomandimet e KLSH-së sipas RPA ku janë përcaktuar detyrat dhe afatet sipas sektorëve përkatëse. Me shkresën nr. 22995/5 prot, datë. 29.10.2018 DPD ka bërë raportimin në KLSH, brenda afatit 20 ditor. *Rekomandimi është zbatuar plotësisht.*

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014,datë 27.11.2014).
- Nga auditimi rezultoi se, DPD me shkresën nr. 8559 prot, datë 04.04.2019 "Dërgim të relacionit të grupit të punës mbi RPA ardhur sipas shkresës nr. 22995/11 prot dt 08/10/2018", (nr. 280/11 prot.datë 05.10.2018 tonën), informon në mënyrë të detajuar lidhur me zbatimin e rekomandimeve, para afatit 6/mujor i cili përfundon më datë 05.04.2019. *Rekomandimi është zbatuar plotësisht.*

III. Realizimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se KLSH për përmirësimin e gjendjes ka rekomanduar për zbatim:
24 masa organizative (masa 11-12-13 janë me nga 2 rekomandime/total 27 rekomandime), nga të cilat 1 rekomandim është zbatuar plotësisht, 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 14 rekomandime janë në proces zbatimi,
6 rekomandime janë pranuar po nuk janë zbatuar dhe 3 rekomandime nuk janë pranuar as zbatuar.
1 rekomandime për eleminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, i cili konsiderohet i pazbatuar.
7 rekomandime për shpërblim dëmi në vlerën **105,141,938 lekë**, nga të cilat asnjë nuk është zbatuar. (3 masa konsiderohen të paparanuara dhe 4 të tjera nuk janë zbatuar).
16 masa disiplinore punonjës, 6 prej të cilëve me masën "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", sipas nenit 58, shkronja "c" dhe

10 me masën "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj" sipas nenit 58, shkronja "b", të cilat rezultojnë të pazbatuara në lidhje me masat e propozuara nga KLSH.

Konkretisht:

MASA ORGANIZATIVE.

1.1.Rekomandimi: Strukturat e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave të DPD në bashkëpunim me strukturat përkatëse të MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, të riorganizojnë dhe mundësojnë programimin e të ardhurave në të gjitha fazat edhe me strukturat e DPD, duke shtuar kështu bashkëpunimin për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese që mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhurave të mos vijnë të gatshëm në DPD, si dhe të programohen drejt e pa rezerva. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: DPD ka një metodologji specifike lidhur me parashikimin e të Ardhurave bazuar në Analizën e 60 produkteve kryesore bazuar në trendin e volumit, cmimit për njësi si dhe objektivat kryesore kryesisht për produktet e akcizës. Këto raporte si dhe ecuria e treguesve dorëzohen cdo muaj pranë MFE.

Koment i grupit të auditimit: Plan i të ardhurave i DPD është përcaktuar nga Drejtoria e Analizës dhe Politikave Fiskale në MFE, si rrjedhojë DPD punon me tregues të gatshëm për të ardhurat, duke mos u bërë programimi i tyre në të gjitha fazat dhe në strukturat e DPD. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.*

2.1 Rekomandimi: Në institucion të merren masa që të rishikohet:

a- Kontrata e lidhur me "P..... Sh....." SHA me nr. 30425, datë 15.12.2014, e cila ka rolin e agjentit doganor në marrëveshje me DPD, duke vendosur penalitetet për mosderdhjen në kohë të të ardhurave në DPD.

b- Të caktohen personat e kontaktit në marrëdhëniet me "P..... Sh....." SHA dhe në marrëdhëniet sipas kontratave të lidhura me bankat e nivelit të dytë dhe me DPD për kryerjen e aktrakordimeve javore me "P..... Sh....." SHA dhe mujore me bankat e nivelit të dytë, duke raportuar në kohë reale të dhëna për diferencat që rezultojnë të cilat detyrimisht të evidentohen në raportin mujor të evidencës fiskale të doganës.

c- Në institucion të merren masa që të arkëtohet nga Posta Shqiptare sha shuma prej 62,861,303 lekë, e pa derdhur në DPD në fund të vitit 2017, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse administrative dhe ligjore, për mosarkëtimin në kohë në llogarinë e të ardhurave doganore të DPD nga Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilizimit të të Ardhurave Doganore. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Aktualisht është në fuqi Marrëveshja e re e Bashkëpunimit me P..... Sh..... Sh.a prot 3049/2 i DPD-së datë 08.04.2019 dhe nr.995 prot i Postës Shqiptare Sh.a datë 09.04.2019 e cila shfuqizoi marrëveshjen e vjetër të bashkëpunimit nr.4522 prot i Postës Shqiptare Sh.a datë 15.02.2014 dhe nr 30435 prot DPD-së datë 15.12.2014. Ndryshimet përkatëse konsistojnë edhe në parashikimin e penaliteteve përkatëse për cdo shumë të munguar në llogarinë e DPD-s. Krahas shumës së munguar posta detyrohet të kalojë edhe interes mbi vonesën, i përllogaritur për cdo ditë vonesë, sipas normës mesatare të interesit të Bankës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 5 të Marrëveshjes "Penalitete në rast vonese pagesash". Në zbatim të nenit 6 "Afati dhe zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit", pika 5 parashikon "zgjidhjen e marrëveshjes" në mënyrë të njëanshme. Marëdhënia e postës funksionon nëpërmjet personave të kontaktit për secilin Institucion.

Lidhur me detyrimin e P.... situata paraqitet si më poshtë:

Detyrimi i P..... Sh..... Sh.a në fund të vitit 2017 ishte 62,861,303 lekë.

Në fund të vitit 2018 ky detyrim ishte 29,522,813 lekë si më poshtë:

NR	Periudha	Detyrimi sipas sist. A.Ŵ	Derdhjet e postës në Banka	Diferenca mujore	Diferenca progresive
	Trashëguar Viti 2018				-62,861,303
1	Janar	50,253,983	47,746,462	-2,507,521	-65,368,824
2	Shkurt	55,058,790	45,597,133	-9,461,657	-74,830,481
3	Mars	52,777,054	35,782,428	-16,994,626	-91,825,107
4	Prill	55,824,355	66,594,943	10,770,588	-81,054,519
5	Maj	56,210,695	94,278,582	38,067,887	-42,986,632
+	Derdhje shtesë nga dublimet		1,971,301	1,971,301	-41,015,331
+	Anullimet 2017+Janar & Shkurt 2018		937,257	937,257	-40,078,074
6	Qershor	54,777,520	39,669,414	-15,108,106	-55,186,180
7	Korrik	64,971,572	74,326,372	9,354,800	-45,831,380
8	Gusht	62,688,135	58,873,041	-3,815,094	-49,646,474
9	Shtator	61,915,280	98,018,866	36,103,586	-13,542,888
10	Tetor	57,825,620	55,711,845	-2,113,775	-15,656,663
11	Nëntor	112,221,270	89,665,350	-22,555,920	-38,212,583
12	Dhjetor	74,377,670	83,067,440	8,689,770	-29,522,813
	Shuma Viti 2018	758,901,944	792,240,434	33,338,490	

Deri në momentin e auditimit, situata për 2019 paraqitet si më poshtë:

NR	Periudha	Detyrimi sipas sist. A.Ŵ	Derdhjet e postës në Banka	Diferenca mujore	Diferenca progresive
	Trashëguar Viti 2019				-29,522,813
1	Janar	31,119,629	46,879,543	15,759,914	-13,762,889
2	Shkurt	43,355,510	27,759,421	-15,596,089	-29,358,988
3	Mars	73,501,340	47,826,148	-25,675,192	-55,034,180
4	Prill	73,006,027	61,814,304	-11,191,723	-66,225,903
5	Maj	48,438,322	80,273,659	31,835,337	-34,390,566
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
	Shuma viti 2019	269,420,828	264,553,075		

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

3.1. Rekomandimi: Institucioni të marrë masat që të përfundojë implementimin e plotë të programit financiar Alpha Ëeb (faza e dytë e prokurimit), program i cili duhet të bëjë të mundur migrimin e të dhënave nga sistemi Asycuda Ŵord për çdo lloj deklaratë, sipas çdo subjekti fizik apo juridik dhe duke kryer njëkohësisht rakordimin me të dhënat e migruara nga bankat e nivelit të dytë ku kryhen pagesat për veprimet me doganën dhe veprimet me "Postën Shqiptare" SHA, me qëllim evidentimin, regjistrimin dhe kontabilizimin e të ardhurave për çdo deklaratë (DAV, DSHA, IND) nga sektori i pagesave, garancive dhe kontabilitetit të të ardhurave, në kohën e kryerjes së çdo veprimi on-line.
Gjatë vitit 2019

Zbatimi i këtij rekomandimi: Puna për implementimin e sistemit të qendërzuar financiar Alpha Ŵeb është planifikuar në dy faza. Në fazën e parë (2018) janë implementuar këto module pilot: moduli i kontabilitetit, moduli arka/banka, moduli blerje/shitje, moduli i të ardhurave, moduli i raporteve. Në këtë fazë janë realizuar gjithashtu: instalimi i sistemit në serverin e DPD, konfigurimi dhe personalizimi i sistemit në DPD dhe Njësitë Vartëse, Trajnim i përdoruesve, migrimi i të dhënave për fillimin e punës, migrimi i sistemit të kreditimit sipas Nipt-eve nga llogaria parapaguese. Njësitë vartëse janë në punë me sistemin Alpha Ŵeb. Në fazën e dytë të 2019 janë në pritje implementimi: moduli i listëpagesave, aseteve, urdhër-shpenzimeve/buxhetit, inventarit, amoritizimit, raportet për këto module. Procesi në vitin buxhetor 2019 po vazhdon me implementimin e plotë të programit Alpha Ŵeb dhe është kërkuar trajnimi i punonjësve të DBF për programin Alpha Ŵeb. *Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.*

4.1.Rekomandimi: Në institucion të merren masa që të mbyllen deklaratat e thjeshtuara për pagesat e kryera nga subjekte private për zhdoganim mallrash personale me natyrë jo tregtare e të kryera në 17 Degë Doganore, të rezultuara të pa debituara në sistemin Asycuda Ŵorld nga periudha Maj 2013 e në vazhdim në shumën prej 27,500,650 lekë, sipas dokumenteve përkatëse. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Referuar deklaratave të thjeshtuara të viteve 2017 dhe 2018 janë debituar në total 16.012 deklarata të thjeshtuara. Paralelisht në këtë proces janë rikontrolluar deklaratat për vitet 2014-2016. Për shkak të një numri të madh deklaratash dhe problematikës së tyre ka hyr në fuqi Urdhëri Nr.23 datë 23.04.2019 "Për përfundimin e procesit të debitimit manual të Deklaratave të Thjeshtuara për periudhën 2013-2018". Sipas Urdhërit është parashikuar përfundimi i procesit në dy faza përkatësisht data 31.07.2019 dhe 31.12.2019. Me memo-n Nr.15820 datë 13.06.2019 është bërë me dije se deri në datën 09.06.2019 janë debituar në total 4664 deklarata të thjeshtuara në vlerë 27,398,167 lekë. *Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.*

5.1.Rekomandimi: Nga institucioni të merren masa që të rishikohet Udhëzimi nr. 5, datë 16.07.2013 i DPD "Mbi procedurën e pagesave (e-payment) të operatorëve ekonomikë (shoqëri apo persona fizikë), në kuadër të implementimit të Sistemit të pagesave elektronike on-line, në një llogari bankare të centralizuar arkëtimesh, të çelur në bankat e nivelit të dytë me emërtimin "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave", për të ardhurat Doganore, të Akcizës dhe detyrime të tjera të pagueshme në doganë", në lidhje me përcaktimin e strukturës përkatëse si rezultat i ndryshimeve të reflektuara nga zbatimi i VKM nr. 9, datë 11.01.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 921, datë 29.12.2014 "Për personelin e administratës doganore", si në Degë Doganore dhe në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës në DPD, me qëllim evidentimin, regjistrimin, kontabilizimin e të ardhurave fiskale doganore në mënyrë analitike sipas llojit të deklaratës(DAV DSHA apo IND) dhe subjekteve juridike apo fizike. Dhjetor 2018

Zbatimi i këtij rekomandimi: Është në proces Drafti i Udhëzimit "Mbi procedurën e pagaesave nëpërmjet Sistemit të Pagesave Elektronike Online, për të Ardhurat Doganore, të Akcizës dhe detyrime të tjera të pagueshme në doganë, mbi menaxhimin e llogarisë parapaguese dhe mbi kontabilizimin dhe raportimin e të ardhurave doganore si rishikim i Udhëzimit Nr.5 datë 16.07.2013 me qëllim përcaktimin e strukturës përkatëse si rezultat i ndryshimeve të reflektuara nga zbatimi i VKM Nr.9 datë 11.07.2017 "Për disa ndryshime në VKM Nr.921 datë 29.12.2014. Për shkak të specifikave të tij nuk ka mundur të realizohet brenda 2018. Udhëzimi do të përfundojë brenda 9-mujorit 2019. *Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar por i pazbatuar deri në momentin e mbajtjes së këtij akt-konstatimi.*

6.1 Rekomandimi: Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD në bashkëpunim me Degët Doganore, të bëjë një analizë të thelluar të rasteve të shtuara të mosarkëtimit të borxhit dhe rrugëve të zgjidhjes për rikuperimin e këtyre detyrimeve. Borxhi i lindur si rezultat i shkeljeve të legjislacionit të akcizës të analizohet sipas natyrës së lindjes së detyrimeve më qëllim parandalimin në të ardhmen. ***Afati: Në vazhdimësi***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Është miratuar Udhëzimi Nr. 15 datë 03.12.2018 i cili përcakton procedurat e ndjekjes dhe raportimit, duke futur elementin e bllokimit të procedurave të import exportit në momentin e daljes së Urdhërit për mbledhjen me forcë të detyrimit dhe jo në momentin e daljes së Vendimit të Ekzekutimit nga ana e Gjykatës. (dok 8) + Plani Financiar për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin me shkresën Nr.5105 datë 28.02.2019 pika 3.3 është lënë detyrë për Drejtorinë e Buxhetit të marrin masa për ndryshimet në Asycuda. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces.*

7.1.Rekomandimi: DPD të marrë masa që gatë rishikimit të Udhëzimit nr. 4, datë 07.04.2016 të DPD, për një monitorim më efektiv dhe ndjekje të borxhit doganor nga DPD duhet më përpara se të

hartohen në Degët Doganore evidencat e detyrimeve të papaguara nga subjektet (borxhi) sipas burimeve të krijimit, duhen përcaktuar strukturat përkatëse si (jurist /apo specialist i borxhit) dhe specialisti në zyrat e financës, të cilët duhet të kryejnë çdo muaj rakordimet përkatëse të borxhit sipas subjekteve në vlerë dhe sipas arkëtimeve të kryera, bazuar në të dhënat nga sektori i financës. Këto evidenca të hartuara sipas të dhënave të rakordimeve të mbajtura të dërgohen çdo muaj në Sektorin e Monitorimit të Borxhit në DPD, e cila bën të mundur evidentimin në kohë të detyrimeve duke monitoruar procesin në tërësi të borxhit doganor me efektivitet. ***Afati: Në vazhdimësi***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Me shkresën Nr.22995/1 datë 18.10.2018 drejtuar Degëve Doganore, u është kërkuar kryerja e analizave të hollësishme. Është miratuar dhe ka hyr në fuqi Udhëzimi Nr.15 datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës, i cili mundëson një monitorim më efektiv dhe ndjekje të borxhit doganor nga DPD. Këto evidenca dërgohen cdo muaj në Sektorin e Monitorimit të Borxhit në DPD. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces.*

8.1.Rekomandimi: Në institucion të merren masa që të evidentohet dhe kontabilizohet borxhi doganor sipas burimeve të krijimit, duke mundësuar ndjekjen dhe rikuperimin me forcë sipas subjekteve të detyrimeve sipas dispozitave ligjore në fuqi. ***Afati: Në vazhdimësi***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Me shkresën Nr.22995/1 datë 18.10.2018 drejtuar Degëve Doganore, u është kërkuar kryerja e analizave të hollësishme. Është miratuar dhe ka hyr në fuqi Udhëzimi Nr.15 datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës, i cili mundëson një monitorim më efektiv dhe ndjekje të borxhit doganor nga DPD. Po punohet për rishikimin e manualit të shkeljeve dhe ndjekjes së debisë sipas D.Doganore. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces.*

9.1.Rekomandimi: Në institucion të merren masa që të bëhen ndryshime në sistemet informatike e konkretisht, në sistemin doganor Asycuda Ëord dhe atë financiar Alpha Ëeb, me qëllim hartimin e një programi për detyrimet doganore, si dhe përllogaritjen e penaliteteve dhe kamatëvonesave sipas subjekteve,e cila aktualisht mbahet në mënyrë manuale me dorë, si nga 17 Degët Doganore dhe në DPD, me qëllim administrimin sa më efikas së këtij programi. ***Afati: Në vazhdimësi***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Me shkresën Nr.22995/2 datë 18.10.2018 i është kërkuar Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit të përfshijë në projektet e zhvillimit të sistemit kërkesat e rekomandimit. Në vazhdim për shkak të ndryshimeve strukturore është bërë shkresa Nr.22995/10 datë 25.01.2019 drejtuar Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse dhe kjo e fundit me shkresën Nr.3406 datë 08.02.2019 i është drejtuar Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe me shkresën Nr.3406/1 datë 26.02.2019, 3406/2 datë 19.03.2019, është krijuar grupi i punës i cili do të punojë për zbatimin e rekomandimin. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

10.1.Rekomandimi: Në institucion të merren masa që në evidencat mujore të borxhit doganor të jepen të dhëna për shkallën e ndjekjes me forcë të borxhit doganor, ecurinë e ekzekutimeve të borxhit nga Përmbarimi Gjyqësor në bazë të kontratave të lidhura, duke e bërë procesin e monitorimit efikas dhe të kontrolluar nga Sektori i Monitorimit të Borxhit. ***Afati: Në vazhdimësi***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Në vazhdim si të zbatimit të shkresës Nr.22995/1 datë 18.10.2018, kërkohet që të plotësohen të gjitha fushat e evidencave mujore sipas modelit të evidencave të dërguara bashkëngjitur Urdhërit të Brendshëm Nr.8790 datë 04.06.12.

Koment i grupit të auditimit: Në evidencat mujore plotësohen si fusha monitorimi informacione në lidhje me situatën e ekzekutimeve nga përmbarimi gjyqësor, në se janë në banka të nivelit të dytë , në ZRPP, në DPSHTRR, QKB etj. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

11.1. Rekomandimi. DPD të kryejë një analizë të plotë të faktorëve dhe shkaqeve që kanë sjellë si pasojë uljen e vlerës së deklarimeve të transaksioneve të kryera deri në nivelin 60%, krahasuar kjo me të dhënat statistikore të viteve 2015 dhe 2016 për mallra identikë dhe të ngjashëm, për deklarime të mallrave të Kapitullit "Mishi dhe të Brendshmet e ngrënshme të Mishit" nga vende të EU, kryesisht Italia, Greqia, Polonia, Gjermania dhe të tjerë. Bazuar në nenin 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nga Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit në DPD, nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në DPD dhe Drejtoria e Hetimit, si struktura kontrolli dhe verifikimi që monitorojnë dhe kontrollojnë edhe zbatimin e sistemeve të kontrollit në praktikë, të ndërmerren Programe Kontrolli me qëllim analizimin korrekt të konstatimeve të arritura sa më sipër, si dhe të kërkohet në vijimësi arkëtimi dhe vjelja e detyrimeve doganore për rastet e praktikave doganore që do të evidentohen gjatë ushtrimit të program kontrolleve, për periudhën 01.01.2017 deri 31.12.2017 dhe në vijim. Nga DPD të nxirren përgjegjësitë konkrete të inspektorëve të Kontrollit pas Zhdoganimit, specifikisht në DD Tiranë dhe të personelit përpunues doganor që ka trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë vlerësimin doganor të këtyre mallrave, ku problematika e këtij fenomeni është shumë e dukshme dhe me pasoja të rënda financiare në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, të cilët nuk kanë ushtruar atributet ligjore sipas nenit 102 të ligjit nr. 8449, datë 24.01.1999 "Kodi Doganor në RSH" i shfuqizuar dhe bazuar në nenet 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm janë organizuar programe kontrolli, gjithashtu është kërkuar dhe ndihma e administratës tatimore për këtë qëllim. Lidhur me këtë çështje kemi organizuar një plan hetimi proaktiv në se jemi në rastet e mashtrimeve fiskale, plan ky që do të analizojë problematikën e deritanishme të zhdoganimeve të këtij produkti nga të gjitha origjinat duke kërkuar shkëmbim informacioni me struktura homologe, duke organizuar hetime proaktive me hetimin tatimor për cmimet e shitjes, duke krahasuar zhdoganimet e të njëjtit mall në doganat homologe për eksportues të njëjtë. Në bazë të shqyrtimit të observacioneve rezulton se DPD ka ndërrmarë veprimet për:

-marrjen e masave për Degët kryesore si Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier për zhdoganimin e mishit si dhe ndaj Drejtorisë së vlerësimit në qendër. (dok 11)
-kërkesën për rregulla të shtuara kodifikimi ndaj Departamentit Teknik...(dok 12)
-kërkesë për verifikim vlerësimi me aposteriro për 6-mujorin e parë 2018 (dok 13)
-shkresa Nr.7536 datë 26.03.2019 e DPD drejtuar DPT (dok 14)
-shkresa Nr.536 Prot datë 10.01.2018 e DPD drejtiar DPT (DOK 14/1)
-shkresa Nr.607/1 datë 29.06.2018 e DPT drejtuar DPD kthim përgjigjë (14/2). *Për sa më sipër duhet të konsiderohet në proces*

*11.2. Rekomandimi: I rikërkojmë DPD të shfuqizojë shkresat nr. 1945prot.datë 25.01.2016 dhe nr. 2344 prot.datë 28.01.2016, të DPD, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave të kapitullit *02* të NKM, të cilat bien ndesh me kërkesat e Seksionit I të Udhëzimit të MF nr. 25, datë 30.11.2007 "Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit...".* ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Nuk kemi asnjë material për shfuqizimin e shkresave sipas rekomandimit 11.2. *Për sa më sipër rekomandim konsiderohet i pazbatuar.*

12.1. Rekomandimi: DPD nëpërmjet Drejtorisë së Hetimit pranë Departamentit Operativ-Hetimor, në bashkëpunim me AD, si struktura të varësisë, si dhe struktura e organe të tjera hetimore dhe ligjzbatuese në RSH, të ndjekë në të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor dhe në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal në RSH", i ndryshuar, që lidhet me këto vepra penale, të

kërkojë sekuestrimin e mjeteve motorrike me të cilin është kryer kontrabanda për 5 raste shkeljesh doganore në shumën 2,410,459 lekë.

12.2. Rekomandimi. DPD të referojë në Organin e Prokurorisë Durrës, shumën e detyrimeve doganore të akcizës në vlerën 335,500,000 lekë, referuar dosjes hetimore nr. 24673/3prot.datë 07.11.2017, për sasinë prej 3,050,000 paketa cigare, ose 61,000,000 fije cigare të faturuara për llogari të shoqërisë "R..... G..... T..... LTD" me NIPT L....., si dhe të gjykojë mbi referimet penale të patrajtuara në përputhje me shkeljet doganore të kontrabandës, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aneksin nr. 3, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" dhe Udhëzimit nr. 6, datë 23.07.2013 "Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës". ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: *Rekomandimi 12.1 nuk është pranuar nga Drejtoria e Hetimit. Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.*

Zbatimi i këtij rekomandimi:12.2 - Ende nuk është referuar shuma e detyrimeve të akcizës në vlerën 335,500,000 lekë në Organin e Prokurorisë Durrës. Nuk disponojmë gjykime/evidenca mbi referimet penale të patrajtuara në përputhje me shkeljet doganore të kontrabandës, trajtuar në RPA dhe aneksin nr. 3. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.*

*13.1. Rekomandimi: DPD, Departamenti Teknik nëpërmjet Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës, të ndjekë përputhshmërinë ligjore të deklarimeve të kryera sipas autorizimeve respektive me status përjashtimi nga pagesa e TVSH-së, sipas praktikave doganore të cituara në RPA, që lidhen më artikuj të natyrës "Makineri dhe pajisje", deklaruar në kreun *8705*, me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor të deklarimeve të kryera në përputhje të plotë midis VKM nr. 953, datë 29.12.2014, neni 8, pika 1/a dhe 4.1 dhe VKM nr. 13, datë 14.01.2015, Aneksi 1/ 1, si dhe kërkesave të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005 "Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore", deri në arkëtimin e plotë të detyrime doganore të TVSH-së në shumën 7,541,446 lekë.*

13.2. Rekomandimi. DPD, Departamenti Teknik nëpërmjet Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës, në bashkëpunim dhe me strukturat e DPT, të analizojnë vlerat dhe sasitë e mallrave në praktikat doganore të trajtuara në RPA, me qëllim "verifikimin e destinacionit" të këtyre mallrave në investimin e kryer, me status përjashtimi nga pagesa e TVSH-së, sipas deklarimeve në autorizimet respektive që lidhen me praktikat doganore, sipas aneksit nr. 19 të RPA, si dhe të veprojë për mospërputhjet e konstatuara në zbatim të ligjit nr. 125/2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar", neni 4, shkronja "g", VKM nr. 180, datë 13.02.2013, pika 1, shkronja "a", pika 3.1, dhe ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH", neni 56, pika 38/a, VKM nr. 953, datë 29.12.2014, neni 8, pika 1/a dhe 4.1, VKM nr. 13, datë 14.01.2015, Aneksi 1/1, si dhe legjislacionit doganor në fuqi. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Rekomandimi 13.1 nuk është pranuar. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pa pranuar dhe i pazbatuar.*

Në lidhje me Rekomandimin 13.2 Nga DT, Sektori i tarifës i është dërguar shkresë DOH, Drejtorisë së Kontrollit pas zhdoganimit me qëllim "verifikimin e destinacionit" të këtyre mallrave në investimin e kryer. Gjithashtu i është dërguar DPT-s, lista e të gjithë subjekteve që kanë përfituar nga përjashtimi i TVSH.

Koment i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së këtij akt-konstatimi nuk kemi ansjë informacion shtesë në lidhje me veprimet/masat e DPD për mospërputhjet e konstatuara. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.*

14.1 Rekomandimi DPD, të ndjekë të gjithë procedurat e sekuestrimit për vlera mallrash, në shumën 2,849,454 lekë, parashikuar nga legjislacioni doganor dhe kontabilizimin e vendimeve administrative, sipas rasteve të trajtuara në RPA, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 "Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës". ***Afati: Deri më 31.12.2018***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Ky rekomandim nuk është pranuar. *Për sa më sipër konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.*

15.1. Rekomandimi: DPD, si struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare të mbikëqyrë transitet e pambyllura në sistem duke kërkuar nga:

-"Zyrat doganore të destinacionit" në rastin kur konfirmohet paraqitja në destinacion, në shkelje të afatit kohor për kryerjen e transitit, vendosjen e penalitetit për shkelje të afatit të mbylljes së transitit sipas legjislacionit në fuqi.

-" Zyra doganore e nisjes", në rastin kur konfirmohet mosparaqitja në destinacion, të identifikohet debitorin, të rillogariten detyrimet doganore të munguara dhe të njoftohet menjëherë mbajtësi i regjimit/garantuesi për shlyerjen e regjimit brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj.

-Në rast mospagese brenda afatit ligjor nga zyra doganore e nisjes, të njoftohet DPD për të vazhduar procedurën për prekjen e garancisë bankare të depozituar nga garantuesi në shumën 12,776,322 lekë, për 66 transitet e pambyllura.

-DPD, nëpërmjet strukturave të saj, të konfirmojë vlefshmërinë e garancisë për pagesë të datës 09.01.2017 lëshuar nga BKT për aplikantin "Albadian D 2013" me kod J085, në përputhje me dispozitat në fuqi. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Gjatë periudhës 01.08.2018 e në vijim deri në vënien në eficencë të Sektorit të lehtësirave Doganore, Tranzitit dhe Informimit të Operatorëve, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, në zbatim të Urdhërit Nr.18719 datë 13.08.2018 me lëndë "Struktura monitoruese në DPD për të gjitha problematikat e shfaqura nga regjimi i tranzitit do të jetë Sektori i Pagesave dhe Garancive pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës; ka monitoruar mbylljen e tranziteve në sistemin Asycuda. Është mbajtur korrespondencë me DD nisëse dhe pritëse të regjimit të tranzitit. Me shkresën nr 14059/1 datë 18.10.2018 i jemi drejtuar BKT e cila me shkresën ne 5577/1 datë 02.11.2018 ka rikonfirmuar se garancia është autentike dhe e vlefshme. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.*

16.1. Rekomandimi: DPD, si struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare, që bashkërendon e mbikëqyr veprimtarinë e administratës doganore të nxjerrë rregullore të brendshme, urdhër apo udhëzim, me qëllim adresimin e përgjegjësive për administrimin e regjimeve transit. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Është nxjerr Udhëzimi dhe Manuali Nr.17 datë 31.12.2018 "Mbi zbatimin praktik të deklarimit elektronik të përkohshëm të mallrave në deklarimin e përkohshëm DEMP në sistemin ASYCUDA Ŵorld. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar.*

17.1. Rekomandimi: DPD, si struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare, të përmirësojë Manualin nr. 4349/4, datë 22.04.2016 "Mbi kryerjen e kontrollit paszhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore", për të siguruar procedura që krijojnë sisteme të kontrollit të brendshëm që minimizojnë rrezikun e korrupsionit, sigurojnë trajtim të paanshëm për të gjithë kontrollet aposterior, reduktojnë subjektivitetin e punonjësve të administratës doganore, duke bërë të mundur mbajtjen e përgjegjësisë për të gjitha veprimet e kryera.

DPD, si struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare të sigurojë procedura që krijojnë sisteme të kontrollit te brendshëm me qëllim zbatim e trajtim të unifikuar të zbatimit të legjislacionit doganor në përputhje me dispozitat e KD dhe legjislacionin në fuqi. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe paszhdoganimit në Departamentin e Analizave dhe Aposteriorit ka dërguar pranë Drejtorisë Juridike në Departamentin Administrativ shkresën Nr.4751 prot datë 25.02.2019 me lëndë "Shkresë përcjellë se e Draft Manualit mbi kryerjen e Kontrollit pas Zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

18.1. Rekomandimi: DPD, në cilësinë e organit epror dhe DD në cilësinë e "autoritetit doganor kompetent" të analizojnë në bashkëpunim të plotë rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto dy institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për kontabilizimin e shumës prej 148,456,732 lekë, rekomanduar më parë në RPA dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 424/31prot., datë 06.10.2017 dhe protokolluar në DPD me shkresën nr. 22774 prot., datë 09.10.2017. ***Afati: Menjëherë dhe në vijimësi***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Vazhdojnë procedurat për ndjekjen dhe rikuperimin e borxhit doganor.

Koment i grupit të auditimit: Deri në mbajtjen e këtij akt-konstatimi nuk kemi ende një raport mbi analizën e rekomandimeve të parealizuara dhe masave të marra mbi përgjegjësitë konkrete ligjore apo procedurat verifikuese dhe administrative për kontabilizimin e shumës prej 148,567,732 lekë. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.*

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit në DPD të marrë masa, që të bëjë rregullimet e duhura kontabile dhe pasqyrimin e saktë, si të investimeve në proces, por dhe atyre të përfunduara, kjo për një pasqyrim të saktë të aseteve të institucionit.

Nga Drejtoria e Buxhetit të merren masa për eliminimin e parregullsive të konstatuara dhe hartimin në kohë të pasqyrave financiare, me qëllim informimin në kohë të stafit menaxherial për vendimmarrjen e tyre. ***Afati: Në vazhdimësi***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Implementimi i moduleve në fazën e dytë (2019), ka parashikuar të përfshijë: modulin e aseteve, modulin e inventarit, modulin e amortizimit ku do të bëhen të mundura veprimet: raportimi i situacionit të shpenzimit për secilën njësi dhe për njësinë raportuese. Konfigurimi i dokumentave të magazinës. Evidentimi specifik i secilit aset nëpërmjet serialeve të cilat mund të gjenerohen automatikisht apo të caktohen manualisht nga përdoruesi. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

20.1. Rekomandimi: Të përfundojë rakordimi i llogarisë parapaguese të sistemit Asycuda nga Zyrat e Financës së DD për periudhën para muajit Maj 2013, si dhe rakordimi nga Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore, me qëllim nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të balancës së llogarisë parapaguese. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2018 janë debituar si më poshtë: Për llogari të DD. Tiranë 13,896 deklarata të thjeshtuara me një vlerë totale 42.3 mln lekë. Për llogari të DD Bllatë, Rinas, Qafë Thanë, dhe Tre Urat 404 deklarata të thjeshtuara me një vlerë totale prej 2 mln lekë. Po vijon puna për përfundimin e debitimit të deklaratave të thjeshtuara për degën e Doganës Tiranë për vitin 2013 dhe DD Rinas. Rakordimi i plotë i llogarisë parapaguese të sistemit Asycuda do të kryhet pas përfundimit të plotë të debitimit manual të deklaratave të thjeshtuara. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit në DPD të marrë masa, që në të ardhmen të evidentojë të gjithë të drejtat dhe detyrimet në pasqyrat financiare të institucionit, në momentin e ndodhjes së tyre,

në përputhje me kërkesat kontabël dhe me kërkesat e nenit 61 "Standardet dhe procedurat e kontabilitetit", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ku citohet se "Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me: a) njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës". ***Afati: Në vazhdimësi***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Me implementimin e moduleve të Alpha Buxhetor në fazën e dytë në vitin 2019 janë parashikuar të implementohen Moduli i Urdhër Shpenzimeve/Buxhetit që do të bëj të mundur raportimin e situacionit të shpenzimit për secilën njësi dhe për njësinë raportuese. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

22.1. Rekomandimi: Nga institucioni të merren masa për implementimin e plotë të strukturës së DPD, të miratuar me VKM nr. 2, datë 08.01.2018 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 921, datë 29.12.2014 të KM "Për personelin e administratës doganore", ndryshuar me VKM nr. 9, datë 11.01.2017, me qëllim krijimin e një strukture efiçente, që gjatë vitit 2017 nuk është arritur të realizohej plotësisht. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Nga Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe DOH do të hartohet draft Udhëzimi në përputhje me rekomandimin.

Koment i grupit të auditimit: Nuk kemi ende një produkt përfundimtar megjithatë DPD përgjatë vitit 2018 deri në mars 2019 ka qënë në proces ristrukturimi me qëllim krijimin e një strukture sa më eficente. Konstatohen ende vakanca të cilat duhet të plotësohen sipas strukturës së miratuar. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.*

23.1. Rekomandimi: Departamenti Administrativ të marrë masa për hartimin e një udhëzimi të ri të shpërblimit nga të ardhurat, që realizohen nga sanksionet e shkeljeve doganore, për ta sjellë atë në kornizën aktuale të KD, tashmë në fuqi, ku të përcaktohen qartësisht raportet e përfitimit, shpërblimi nga kamatëvonesat, si dhe nga të ardhurat e krijuara nga strukturat e jashtme të auditimit. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Është ngritur grup pune në DBF me përbërje nga tri sektorët ku do të diskutohen variantet për propozim për MFE për rishikim të Udhëzimit Nr.38 datë 08.12.2009 "Për rregullat e shpërblimit të personelit doganor nga të ardhurat që realizohen nga sanksionet e shkeljeve doganore" me qëllim që të përcaktohen raportet e përfitimit, shpërblimit nga gjobat, për përfituesit e drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë.

Koment i grupit të auditimit: Deri në mbajtjen e këtij akt-konstatimi ende nuk është hartuar një Udhëzim. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.*

24.1. Rekomandimi: Grupet e punës apo njësia e prokurimit pranë AK, në të ardhmen të tregojë vëmendjen e duhur në përcaktimin e kritereve kualifikuese në zhvillimin e procedurave të prokurimit, për të garantuar parimet mbi të cilat zhvillohen procedurat e prokurimit publik. Në hartimin e fondit limit AK të bazohet në të dhënat e vetë administratës doganore, ashtu sikurse përcaktohet dhe në nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". ***Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Elementi "të dhënat e administratës doganore" nuk vlerësohet i përshtatshëm pasi nuk është i plotë cmimi me marzhin e fitimit e shpenzime të tjera, pra është larg cmimit real me të cilët operatorët konkurojnë dhe ofertojnë në procedurën e konkurimit. Në raste të vecanta kur del e nevojshme, për shkak të mungesës së informacionit nga burimet e tjera të përcaktuara në VKM, përdoren dhe do të përdoren në vazhdimësi edhe të dhënat e administratës doganore.

Koment i grupit të auditimit: Do të rishikohet nga grupi i auditimit në auditimin e cështjes së prokurimeve në DPD. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

1.1.Rekomandimi: MFE të marrë masa që të zgjidhë përfundimisht në mënyrë institucionale kontabilizimin e detyrimeve të akcizës në shumën prej 12,029,713 mijë lekë, që i përket periudhës Janar 2011 deri më Dhjetor 2014, sipas shkresës nr. 11562/1 prot., datë 16.06.2017 të DPT dhe të refuzuar nga ana e DPD me shkresën nr. 14634/4 prot., datë 31.07.2017 drejtuar Sekretares së Përgjithshme të MFE. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Nuk kemi asnjë material për marrje masash në lidhje me rekomandimin 1.1. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.*

MASA SHPERBLIM DËMI

DPD të marrë masa që të evidentojë detyrimet në kontabilitet dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e të ardhurave doganore të munguara në Buxhetin e Shtetit në shumën 105,141,992 lekë, konkretisht:

1.1. Rekomandimi: DPD, në cilësinë e organit epror juridiksional të kërkojë nga DD Fier dhe Durrës, ndryshimin e dy vendimeve administrative në shumën 4,309,360 lekë, për rastet e trajtuara në RPA, me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve dhe gjobave doganore, bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999 "Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë", shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, referuar interpretimit të Avokaturës së Shtetit për mënyrën e evidentimit dhe nxjerrjes së përgjegjësive për shkeljet doganore të kryera para datës 01.06.2017 (në këtë datë ka hyrë plotësisht në fuqi ligji nr. 102/2014, datë 37.07.2014), si dhe VKM nr. 205, datë 13.04.1999 "Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" i ndryshuar. ***Afati: Deri më 30.10.2018***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Për të shqyrtuar rekomandimet mbi rastet specifike është ngritur grupi i punës me Urdhërin Nr.68 datë 25.10.2018. Gjithashtu me shkresën Nr.2509 Prot datë 30.01.2019 në vijim të rekomandimeve të lëna nga KLSH, iu është komunikuar dy degëve doganore marrja e masave për ndryshimin e dy vendimeve administrative dhe arkëtimin e detyrimeve dhe gjobave doganore.

Koment i grupit të auditimit: Deri në mbajtjen e këtij akt-konstatimi nuk kemi asnjë material/evidencë mbi zbatimin e rekomandimit nga degët doganore. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.*

*2.1 Rekomandimi: DPD në bashkëpunim me strukturat e varësisë dhe struktura dhe organe të tjera hetimore e ligjzbatuese në RSH, të ndjekë me të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor, arkëtimin e sanksioneve dhe gjobave doganore për shkeljet doganore të kontrabandës në shumën 416,944 lekë, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" dhe Udhëzimin nr. 6 datë 23.07.2013,"Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës".***Afati: Deri më 31.12.2018***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Ky rekomandim nuk është pranuar. *Për sa më sipër konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.*

3.1 Rekomandimi: DPD, të analizojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, me qëllim kryerjen e procedurave doganore verifikuese sipas legjislacionit doganor në fuqi për vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 49,943,089 lekë, për praktika doganore që lidhen me rekomandime rillogaritjesh të detyrimeve doganore në import, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e neneve 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i shfuqizuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014, datë

31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 "Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 të MF "Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore", Nomenklaturës së Mallrave në RSH, shkresës nr. 779 prot., datë 16.01.2013 "Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE". ***Afati: Deri më 31.01.2019***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Për të shqyrtuar rekomandimet mbi rastet specifike është ngritur grupi i punës me Urdhërin Nr.68 datë 25.10.2018.

Koment i grupit të auditimit: Deri në mbajtjen e këtij akt-konstatimi nuk kemi asnjë material/evidencë mbi zbatimin e rekomandimit. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.*

4.1 Rekomandimi: DPD të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për kontabilizimin e detyrimeve doganore të akcizës, për 4 (katër) raste, në shumën 13,255,638 lekë, konform afateve dhe përcaktimeve ligjore të shprehura në ligjin specifik të fushës, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në Udhëzimit nr. 6, datë 23.07.2013 "Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës". ***Afati: Deri më 31.01.2019***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Ky rekomandim nuk është pranuar. *Për sa më sipër konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.*

5.1 Rekomandimi: DPD në bashkëpunim me AD ku janë konstatuar shkeljet doganore, si struktura të varësisë, të ndjekë me të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor nxjerrjen e vendimeve administrative dhe kontabilizimin e detyrimeve në shumën totale 5,124,767 lekë, për 18 raste, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" dhe Udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 "Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës". ***Afati: Deri më 31.12.2018***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Deri në mbajtjen e këtij akt-konstatimi nuk kemi asnjë material/evidencë mbi zbatimin e rekomandimit. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.*

6.1 Rekomandimi: DPD në bashkëpunim me strukturat e saj të varësisë, të ndjekë me të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor nxjerrjen e vendimeve administrative dhe kontabilizimin e borxhit doganor në shumën 15,865,790 lekë, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 "Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës". ***Afati: Deri më 31.01.2019***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Në lidhje me mosfunksionimin e kuotave, Sektori i Origjinës së bashku me Drejtorinë e IT dhe përfaqësues nga UNCTAD po punojnë për sistemimin e situatës. Bazuar në këtë argumentim, shuma 4,546,265 lekë mbi detyrimet doganore në kuotën e verës nuk qëndron. Lidhur me rastet e përgjigjeve fallco, negative dhe pa veprim, për të cilat kërkohet të ndiqet arkëtimi i detyrimeve doganore, kemi informuar me observacionin e dërguar lidhur me gjetjet se Sektori i Origjinës ka kërkuar informacion të detajuar DD Tiranë, Vlorë, Sarandë dhe Durrës me shkresën Nr.16467/3 Prot, datë 25.07.2018. Në vijim të kësaj shkrese, degët doganore kanë dërguar informacion respektivisht me shkresat Nr.21436 Prot datë 20.09.2018; Nr.19263/1 Prot datë 31.08.2018 dhe Nr.21431 Prot datë 20.09.2018.

Koment i grupit të auditimit: Observacionet e dërguara janë mbi projekt-raportin për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të DPD. KLSH ka dal me raport përfundimtar dhe rekomandimin përkatës, për të cilin nuk disponojmë evidencë për zbatimin e tij. *Për sa më sipër konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.*

7.1 Rekomandimi: DPD dhe DD të ndjekin të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 16,226,404 lekë, sipas Aneksit bashkëlidhur. ***Afati: Menjëherë***

Zbatimi i këtij rekomandimi: Zbatimi i këtij rekomandimi: Për të shqyrtuar rekomandimet mbi rastet specifike është ngritur grupi i punës me Urdhërin Nr.68 datë 25.10.2018.

Koment i grupit të auditimit: Deri në mbajtjen e këtij akt-konstatimi nuk kemi asnjë material/evidencë mbi zbatimin e rekomandimit. *Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.*

MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i rekomandojmë: Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, që në vlerësim të shkeljeve të konstatuara në RPA, fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave si më poshtë:

I. "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", sipas nenit 58, germa "c", për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për znj. A..... D....., me detyrë ZV/Drejtor i Përgjithshëm i Doganave:

2. Për znj. A..... G....., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Pijeve Alkolike në Drejtorinë e Metodikave dhe Kontrollit, pranë Departamentit të Akcizës në DPD:

3. Për z. E..... D....., me detyrë Komandant Grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

4. Për z. Sh..... Y....., me detyrë Komandant i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

5. Për z. H..... Sh....., me detyrë Komandant i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

6. Për z. Sh..... H....., me detyrë Komandant i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor:

II. "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj" sipas nenit 58, germa "b", për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për z. E..... C....., me detyrë specialist hetues pranë Drejtorisë së Hetimit, në Departamentin Operativ-Hetimor:

2. Për z. A..... S....., me detyrë specialist hetues pranë Drejtorisë së Hetimit në Departamentin Operativ-Hetimor.

3. Për z. D..... Sh....., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

4. Për z. E..... L....., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

5. Për z. Y..... K....., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

6. Për z. Y.... S....., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

7. Për z. F..... O....., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

8. Për z. B..... P....., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

9. Për z. A..... U....., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor dhe
10. Për z. G..... U....., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor:

NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, DPD pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë DAP, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar
Zbatimi i këtij rekomandimi:
Për znj. A..... D....., me detyrë ZV/Drejtor i Përgjithshëm i Doganave me shkresën Nr.2528/2 datë 04/03/2019 u vendos ndërprerja e ecurisë disiplinore nga Komisioni Disiplinor.
Për z. G..... U....., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor me shkresën Nr.1015/3 datë 13.03.2019 u vendos ndërprerja e ecurisë disiplinore nga Komisioni Disiplinor.
Për punonjësit e mëposhtëm është dërguar praktika disiplinore për kompetencë te Eprori direkt:
Për D..... Sh..... është dërguar praktika disiplinore me shkresën Nr.15731 Prot datë 13.06.2019, te Z.P..... D....., Drejtor i Drejtorisë së Kontrollove të Akcizës dhe Paszhdoganimit.
Për Y..... S....., Sh..... H....., F..... O....., E..... D....., E..... L....., B..... P....., H.... Sh....., është dërguar praktika disiplinore me shkresën Nr.14310/1 Prot datë 11.06.2019, te Z.M..... L....., Drejtor i Drejtorisë së Antikontrabandës.
Për G..... K....., është dërguar praktika disiplinore me shkresën Nr.1017/3 Prot datë 13.06.2019, te Z.E..... Sh....., Kryetar i Degës Doganore Shkodër.
Për Sh..... Y....., është dërguar praktika disiplinore me shkresën Nr.15732 Prot datë 13.06.2019, te Z.G..... C....., Drejtor i Drejtorisë së Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit.
Për Znj.A..... G....., është dërguar praktika disiplinore me shkresën Nr.1006/3 Prot datë 18.06.2019, te Z.P.....D...., Drejtor i Drejtorisë së Kontrolleve dhe Akcizës dhe Paszhdoganimit.
Për A..... S....., nëpunësi është i pezulluar nga shërbimi civil me kërkesë për 2 vjet.
Për A..... U..... - Me vendim të Komisionit Disiplinor Z. A..... U..... është i pezulluar nga shërbimi civil në vijim të një shqyrtimit penal.Për të gjithë punonjësit, praktika disiplinore e të cilëve është dërguar te Eprori direkt kemi marr këtë informacion:
- Këshillim me goje - Shkresa nr.13471/6 prot., datë 08.07.2019
1. B..... P.....
2. Y.... S.....
3. E..... L.....
4. F.... O.....
5. Sh.... Y.....
6. E..... D..
7. H.... Sh....
8. Sh.... H.....
-Ndërprerje të ecurisë disiplinore / Shkresa nr. 1020/3 prot., date 20.06.2019 nuk ka shkelje disiplinore
1. G.... K.....

Për punonjësit D..... Sh....., A... G.... dhe Sh..... Y..... deri në mbajtjen e këtij akt-konstatimi nuk kemi ende një informacion në lidhje me ecurinë disiplinore/marrjen e masave.
Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar në raport me masat e rekomanduara nga KLSH.
Për sa më sipër për mozbatimin e rekomandimeve të KLSH ngarkohet me përgjegjësi Znj.B..... I..... ish-Drejtor i Përgjithshëm i DPD dhe grupi i punës i përbërë nga: Z.A..... K....., Zv.Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit të Akcizës; Z.A..... S....., Zv.Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit Administrativ; Z. Gj..... B....., Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit Operativo-Hetimor; Z. A..... R....., Zv.Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit Teknik; Znj.F..... M....., Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës; Znj.M..... D....., Drejtor i Drejtorisë së Auditit; Z.N..... C....., Këshilltar i Drejtorit të Përgjithshëm

9. Të tjera gjatë auditimit
Në lidhje me të tjera gjatë auditimit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për auditim, nuk u konstatuan probleme të papërfshira në pikat e Programit të Auditimit.

IV/1. GJETJET

<u>Drejtimi nr. 1</u>. *"Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave doganore. Borxhi doganor, ecuria dhe masat shtrënguese të marra për rikuperimin e tij. Auditimi i dokumentacionit lidhur me transferimin e akcizës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë"*

Titulli i Gjetjes 1: Mosrealizimi i planit të të ardhurave doganore**.**

Situata: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2018 rezultoi se, plani i të ardhurave për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) është përcaktuar nga Drejtoria e Analizës dhe Politikave Fiskale në MFE në vlerën 168,982 milionë lekë ndërsa realizimi nga DPD është në vlerën 162,621 milionë lekë ose në masën 96.2 %, pra 6,361 milionë lekë më pak nga planifikimi, ku për rrjedhojë DPD ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat, duke mos angazhuar strukturat e saj, sikurse është Drejtoria e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave (Sektori i Monitorimit të Ardhurave, Analizës dhe Statistikës).

Kriteri: - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4, neni 24,
- Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", kap. IV. "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave"

Ndikimi/Efekti: Mosrealizim i planit të të ardhurave në vlerën 6,361 milionë lekë.

Shkaku: Mosrespektim i dispozitave ligjore të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4, neni 24, ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", kap. IV. "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave".

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime: Strukturat e **Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave** të DPD në bashkëpunim me strukturat përkatëse të MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, të riorganizojnë dhe mundësojnë **programimin e të ardhurave** në të gjitha fazat edhe me strukturat e DPD, duke shtuar kështu bashkëpunimin për shkëmbimin e të dhënave për subjektet

kontribuese që mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhurave të mos vijnë të gatshëm në DPD, si dhe të programohen drejt e pa rezerva.

Titulli i Gjetjes 2: Probleme me procedurat e rikuperimit të borxhit doganor**.**

Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, materialeve, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, rezulton se gjendja e borxhit doganor më 01.01.2018 paraqitet me 4521 raste, 2978 subjekte debitorë në vlerën 23,946,599 mijë lekë. Gjendja e borxhit më datë 31.12.2018 paraqitet me 4520 raste, 3211 subjekte debitorë në vlerën 27,596,148 mijë lekë, pra gjatë vitit ushtrimor 2018, borxhi doganor është shtuar me 233 subjekte debitorë ose 7.8 %, ndërsa në vlerë 3,649,549 mijë lekë ose 15.2 %. Nga zyra e borxhit pranë degëve doganore nuk janë ndjekur hap pas hapi masat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin doganor si dhe udhëzimet përkatëse të nxjerra për këtë qëllim për rikuperimin e detyrimeve të papaguara nga subjektet debitoë, ku për 1203 raste, për vlerën **3,299,965,219 lekë**, nuk kanë vijuar procedurat me nxjerrjen e Urdhër Ekzekutimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, duke bërë të mundur vazhdimin e veprimtarisë doganore në sistem të subjekteve debitore.

Kriteri: Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, neni 245, pika 3; Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, neni 106; Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 *"Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, neni 103, pika 3 dhe 4; Udhëzimi DPD nr. 4, datë 07.04.2016, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* pika 2.2.1, germa "a", të pjesës IX, ndryshuar me Udhëzimin nr. 15, datë 03.12.2018, pika 2.6, të pjesës VII.

Ndikimi/Efekti: Rritje të borxhit doganor në vlerën 3,649,549 mijë lekë ose 15.2 %

Shkaku: Mosrespektim i dispozitave ligjore të legjislacionit doganor dhe të akcizës lidhur si dhe udhëzimeve të DPD, lidhur me masat shtrënguese të ndjekura nga zyrat e borxhi për rikuperimin e borxhit doganor dhe të akcizës.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime: DPD të marrë të gjitha masat për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet kryera jo në përputhje me dispozitat ligjore në lidhje me procedurat e ndjekura nga zyrat e borxhit pranë degëve doganore, si dhe të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor në vlerën 27,596,148 mijë lekë.

Drejtimi nr. 2. *"Auditimi i Buxhetit dhe pasqyrave financiare të institucionit për vitin 2018".*

Titulli i Gjetjes 3: Blerje bileta udhëtimi pa procedurë prokurimi**.**

Situata: Mandat Pagesa nr. 63, datë 25.09.2018, me përshkrimin "Shërbim në dorëzim mostrash pranë Laboratorit të Barit, Itali". në emër të z. L…. M…., është blerë pranë agjencisë " F…. T….." me numër NIPT-i L……. me vlerën duke konvertuar 208 euro konvertuar në 26, 200 lekë. Konstatohet se shpenzimet e blerjes së biletës së udhëtimit në rastin në fjalë janë bërë pa procedurë prokurimi.

Kriteri: Udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar ndryshuar me Udhëzimin Nr. 5 datë 11.1.2018, neni 18

Ndikimi/Efekti: Mosrespektim i dispozitave ligjore dhe mungesë transparence dhe favorizim të agjencisë ku është blerë bileta

Shkaku: Kjo procedurë nuk është zhvilluar në përputhje me bazën ligjore përkatësisht me Udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar ndryshuar me Udhëzimin Nr. 5 datë 11.1.2018, neni 18

Rëndësia: E Mesme

Rekomandime: DPD të marrë të gjitha masat për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet kryera jo në përputhje me dispozitat ligjore në lidhje me biletat dhe procedurat e prokurimit për blerje të vogla**.**

Titulli i Gjetjes 4: Likujdim CASH i pagave të punonjësve**.**

Situata: Në muajin korrik me mandat pagesat e arkës nr. 3, 4, 5, 6, 7 datë 09.07.2018 janë likujduar CASH për diferencë page 5 punonjës me vlerë 38,061 lekë ndërsa në muajin gusht me mandat pagesat e arkës, nr 8 dhe 9, datë 03.08.2018 janë likujduar CASH për diferencë page 2 punonjës me vlerë 21,451 lekë. Pra në total janë paguar 7 punonjës në vlerën 59,512 lekë.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 64

Ndikimi/Efekti: Pasqyrimi jo i drejtë i pagave

Shkaku: Mosrespektimi i bazës ligjore të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 64.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandime: DPD të marrë të gjitha masat për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet kryera jo në përputhje me dispozitat ligjore në lidhje me likujdimin e pagave të punonjësve vetëm nëpërmjet sektorit bankar

Titulli i Gjetjes 5: Likujdim me vonesë në tejkalim të afatit të faturave**.**

Situata: Konstatohet se 55 raste në vlerën 67,759,304 lekë, janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 9, datë 20.3.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", pika 184 ku citohet: "*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik"*.

Kriteri: Udhëzimi Nr. 9, datë 20.3.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", pika 184

Ndikimi/Efekti: Kalim i afateve te pagesave në vlerën 67,759,304 lekë. Risk potencial në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet për mos likuidim brenda afateve ligjore

Shkaku: Mosrespektim i dispozitave ligjore të Udhëzimit Nr. 9, datë 20.3.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", pika 184.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandime: DPD dhe strukturat përgjegjëse të marrin të gjitha masat për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet kryera jo në përputhje me dispozitat ligjore në lidhje me likujdimin e e detyrimeve në tejkalim të afateve të parashkruara, pasi likuidimi me vonesë i tyre përbën risk potencial ne rritjen e shpenzimeve buxhetore, si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet për mos likuidim brenda afateve ligjore

Drejtimi nr. 3. ***"Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Vlerësimit në Qendër."***

Titulli i Gjetjes 6: Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave dhe transportin.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore rezultoi se: për disa subjekte vlerat e artikujve të importuar si dhe shpenzimet e transportit janë deklaruar dhe trajtuar me transaksion edhe pse dokumentacioni bashkëlidhur nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion; i njëjti subjekt për të njëjtin artikull të importuar në shumë raste është rivlerësuar artikulli apo transporti dhe për raste të tjera jo; çmimet e deklaruara dhe transaktuara nga NEU për artikullin *"Mish",* paraqiten shumë më të larta se çmimet e deklaruara dhe transaktuara nga EU; deklarime të çmimeve të produkteve të gatshme nën çmimin e lëndës së parë; trajtimi i mallrave të kuotuar në bursë me transaksion; trajtimi i mallrave të përdorur me transaksion nën çmimin e lëndës së parë; anashkalim i indikatorit peshë për mallra me origjinë NEU, si dhe për mallra të importuar nga NEU (Kina) nën regjimin e magazinimit doganor, trajtimi i tyre është bërë me transaksion në momentin e hedhjes për qarkullim të lirë, të gjitha këto, jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor.

Kriteri:- Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",* neni: 67, pika 1, shkronja "d/i"; 70, pika 2, shkronja "a"; 70, pika 3.

- Udhëzimi 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme...",* i ndryshuar, Sesioni I dhe II.

- Udhëzimi nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* pika 7 dhe pika 10, shkronja "h".

- Urdhëri nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në **vlerën 283,263,967 lekë**.

Shkaku: Nga veprimi jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor si dhe urdhrave dhe udhëzimeve të MFE dhe DPD, nxjerrë për këtë qëllim.

Rëndësia: I lartë

Rekomandime: DPD në bashkëpunim me strukturat e varësisë dhe struktura dhe organe të tjera ligjzbatuese në RSH, të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore për 3503 raste, **në vlerën 283,119,190 lekë,** referuar: nenit 67, pika 1, shkronja "d/i"; 70, pika 2, shkronja "a"; 70, pika 3 të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".*

Titulli i Gjetjes 7: Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me klasifikimin tarifor të mallrave.

Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4, të artikujve të deklaruar në kodet përkatëse tarifore të NKM të mallrave rezultoi se nga agjencitë doganore janë keqklasifikuar mallra në kodin tarifor, (e përcaktuar kjo, në kuadratin 33 të DAV), me pasojë shmangien e detyrimeve doganore.

Kriteri: - Ligji nr. 8474 datë 14.04.1999 *"Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore"*, i ndryshuar, Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave 2017;

- Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",* neni: 250, pika 4, 251, pika 2, shkronja "a"; 256, pika 1, shkronja "a" dhe "b".

Ndikimi/Efekti: Efekti financiar në Buxhetin e Shtetit në **vlerën 12,869,486 lekë,** *(nga të cilat e ardhur e munguar në vlerën 6,434,743 lekë dhe penalitet 6,434,743 lekë).*

Shkaku: Nga veprimi jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor dhe notat shpjeguese të NKM.

Rëndësia: I lartë
Rekomandime: DPD në bashkëpunim me strukturat e varësisë dhe struktura dhe organe të tjera ligjzbatuese në RSH, të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore dhe penaliteteve për 190 raste, **në vlerën 12,869,486 lekë** referuar nenit 250, pika 4; nenit 251, pika 2, shkronja "a"; nenit 256, pika 1, shkronja "a" dhe "b", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".*

Titulli i Gjetjes 8: Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me pagesën e taksës së ambalazhit (TAM).
Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore u konstatua se për artikujt plastikë të importuar të cilët shërbejnë për ambalazhimin e produkteve të ndryshme, i cili e mbulon tërësisht produktin dhe e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim, nga ana e agjencive doganore, SVQ dhe SKAO nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të legjislacionit doganor lidhur me vjeljen e taksës së ambalazhit (TAM), pasi në kuadratin 31 të DAV në momentin e deklarimit, por jo vetëm, nuk është vendosur kodi 74 për të gjeneruar këtë taksë. Nga ana e grupit të auditimit janë shqyrtuar dhe karahasuar deklarimet e operatorëve edhe në tatime ku rezulton se shumica e operatorëve nuk e kanë deklaruar TAM.
Kriteri: - Ligji nr. 8474 datë 14.04.1999 *"Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore"*, i ndryshuar, Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave 2017;
- Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",* neni: 250, pika 4, 251, pika 2, shkronja "a"; 256, pika 1, shkronja "a" dhe "b".
- Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare",* i ndryshuar, neni 3 dhe 4, pika 8, shkronja "a"; neni 5, shkronja "ë/i".
- Udhëzimi i MF nr. 2, datë 17.01.2014, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 'Për Taksat Kombëtare', të ndryshuar*", pika 2.8.5.
Ndikimi/Efekti: Efekti financiar në Buxhetin e Shtetit në **vlerën 588,691,248 lekë,** *(nga të cilat e ardhur e munguar në vlerën 487,112,258 lekë dhe penalitet 101,578,990 lekë).*
Shkaku: Nga veprimi jo në përputhje me legjislacionin doganor dhe taksave kombëtare.
Rëndësia: I lartë
Rekomandime: DPD në bashkëpunim me strukturat e varësisë dhe struktura dhe organe të tjera ligjzbatuese në RSH, të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore dhe penaliteteve për 797 raste, **në vlerën 588,691,248 lekë** referuar: nenit 250, pika 4; nenit 251, pika 2, shkronja "a"; nenit 256, pika 1, shkronja "a" dhe "b", të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*; nenit 3 dhe 4, pika 8, shkronja "a"; nenit 5, shkronja "ë/i", të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare",* i ndryshuar.

<u>Drejtimi nr. 4</u>. *"Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit si dhe Drejtorisë së Politikave të Vlerësimit Doganor**. ***Rimbursimi i akcizës në përputhje me afatet dhe procedurat e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi****"*.
Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për auditim, nga Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, pranë DPD,

për rimbursimin e akcizës nuk u konstatuan probleme lidhur me: përputhshmërinë ligjore; procedurat; afatet; si dhe me rradhën e ndjekur për rimbursim nuk rezultuan gjetje.

Drejtimi nr. 5 ***"Mbi organizimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Departamentit Operativ Hetimor lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Antikontrabandës si dhe Drejtorisë së Kontrolleve të Paszhdoganimit (Aposterior operativ 5 ditor, SKAO)".***

Titulli i Gjetjes 9: Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave dhe transportin nga Sektori i Kontrollit Aposterior Operativ (SKAO).

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore rezultoi se: për disa subjekte vlerat e artikujve të importuar si dhe shpenzimet e transportit janë deklaruar dhe trajtuar me transaksion edhe pse dokumentacioni bashkëlidhur nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion; i njëjti subjekt për të njëjtin artikull të importuar në shumë raste është rivlerësuar artikulli apo transporti dhe për raste të tjera jo; çmimet e deklaruara dhe transaktuara nga NEU për artikullin *"Mish",* paraqiten shumë më të larta se çmimet e deklaruara dhe transaktuara nga EU; deklarime të çmimeve të produkteve të gatshme nën çmimin e lëndës së parë; trajtimi i mallrave të kuotuar në bursë me transaksion; trajtimi i mallrave të përdorur me transaksion nën çmimin e lëndës së parë; anashkalim i indikatorit peshë për mallra me origjinë NEU, të gjitha këto, jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor.

Kriteri:- Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",* neni: 67, pika 1, shkronja "d/i"; 70, pika 2, shkronja "a"; 70, pika 3.

- Udhëzimi 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme...",* i ndryshuar, Sesioni I dhe II.

- Udhëzimi nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *"Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore",* pika 7 dhe pika 10, shkronja "h".

- Urdhëri nr.779 prot, datë 16.01.2013 të DPD *"Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE/NEU"*.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në **vlerën 34,638,400 lekë**.

Shkaku: Nga veprimi jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor si dhe urdhrave dhe udhëzimeve të MFE dhe DPD, nxjerrë për këtë qëllim.

Rëndësia: I lartë

Rekomandime: DPD në bashkëpunim me strukturat e varësisë dhe struktura dhe organe të tjera ligjzbatuese në RSH, të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore për 513 raste, **në vlerën 34,638,400 lekë,** referuar: nenit 67, pika 1, shkronja "d/i"; 70, pika 2, shkronja "a"; 70, pika 3 të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".*

Drejtimi nr. 6. *"Mbi përputhshmërinë ligjore në planifikimin dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime si dhe ankande të realizuara nga Autoriteti Kontraktor".*

Titulli i Gjetjes 10: Mos aplikimi i penalitetit në vlerën **78,336 lekë** ndaj operatorik ekonomik "**Gj.. & C..**" shpk.

Situata: Në procedurën e prokurimit me objekt **"Projekt për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë"**, me fond limit 4,493,213 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues O. "Gj.... & C."

shpk me vlerë të ofertës 4,080,000 lekë, u konstatua mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e shërbimeve në afat në vlerën **78,336 lekë**.

Kriteri:- Kontrata e sipërmarrjes me nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018 dhe amendimit të saj me nr. 19094 prot., datë 17.08.2018 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe "Gj... & C." shpk neni 12 "Sanksionet".

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e arkëtimit të detyrimeve nga sipërmarrësi.

Shkaku: Mos zbatim i afateve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes dhe mos identifikim i këtij detyrimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Rëndësia: I lartë

Rekomandime: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **78,336 lekë** nga O "Gj & C." shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 6940/5 prot., datë 04.07.2018, me objekt *"*Projekt për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë*"*, vlerë kjo e cila përfaqëson penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor ndaj sipërmarrësit për vonesa të pa justifikuara në përfundimin e shërbimeve.

Titulli i Gjetjes 11: Mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve **në vlerën 318,400 lekë** në procedurat e prokurimit.

Situata: Në procedurën e prokurimit me objekt **"*Blerje peshore rruge portative (aksiale) për mjete transporti*"**, me fond limit 3,742,000 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues O. "M&.. T....K... M....." sh.p.k, me vlerë 3,192,000 lekë, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues O. "M&.. T. K.. M..." sh.p.k, me vlerë 3,192,000 lekë**,** pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në dst. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke **shkaktuar mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën 318,400 lekë,** të llogaritur si diferencë nga oferta e shpallur padrejtësisht fituese të O. "M&... T..... K.... M...." sh.p.k minus (-) ofertën e s'kualifikuar të O. "T..... T..... C....." sh.p.k, *me vlerë më të ulët*, (3,192,000 – 2,873,600) = 318,400 lekë.

Kriteri:- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c dhe me Nenet 46, 53 dhe 55.

Ndikimi/Efekti: Kualifikim i padrejtë i fituesit të kontratës duke sjellë mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve në dispozicion.

Shkaku: Kryerja e procedurave të prokurimit në kundërshtim me LPP.

Rëndësia: I lartë

Rekomandime: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kritereve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Titulli i Gjetjes 12: Mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve **në vlerën 777,488 lekë** në procedurat e prokurimit.

Situata: Në procedurën e prokurimit me objekt **"*Projekt për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë*"**, me fond limit 4,493,213 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues O. "Gj... & C." sh.p.k, me vlerë 4,080,000 lekë, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues O. "Gj....& C." sh.p.k, me vlerë 4,080,000 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në dst. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke **shkaktuar**

mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën 777,488 lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e shpallur padrejtësisht fituese të O. "Gj.. & C..." sh.p.k minus (-) ofertën e s'kualifikuar të O. "T.. N. S.." sh.p.k, *me vlerë më të ulët,* (4,080,000 – 3,302,512) = 777,488 lekë.

Kriteri:- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c dhe me Nenet 46, 53 dhe 55.

Ndikimi/Efekti: Kualifikim i padrejtë i fituesit të kontratës duke sjellë mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve në dispozicion.

Shkaku: Kryerja e procedurave të prokurimit në kundërshtim me LPP.

Rëndësia: I lartë

Rekomandime: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kritereve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative. **Drejtimi nr. 7. *"Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerezore në përputhje me legjislacionin në fuqi"*.**

Titulli i Gjetjes 13: DPD për vitin 2018 ka zbatuar 47 vendime gjyqësore të viteve të kaluara për shpërblim dëmi dhe paga të papaguara punonjësve në shumën 49,338 mijë lekë, pa zbatuar radhën e shlyerjes së vendimeve gjyqësore duke angazhuar fonde buxhetore të këtij viti për paga të punonjësve që i përkasin periudhës që nuk kanë punuar në Institucion.

Situata: Përgjatë viti 2018 DPD ka zbatuar 47 vendime gjyqësore për shpërblim dëmi në total prej **49,338 mijë lekë**. Këto vendime gjyqësore kanë objekt të tyre rikthimin në punë të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga vendi i punës pagimin e pagave nga momenti i largimit deri në ekzekutimin e vendimit për ish-punonjësit me status ose dëmshpërblimin për largimin nga puna të ish-punonjësve me kod pune. **Akumulimi i detyrimeve ka ardhur si pasojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore ndër vite dhe zgjatjes së proceseve gjyqësore**. Referuar vendimeve të gjykatave, këto vendime i përkasin periudhave përpara çeljes së vitit 2018, shumë e shpenzuar pa efektivitet dhe në mbivlerësim të shpenzimeve të vitit 2018. Nga auditimi është konstatuar se nuk është zbatuar radha e shlyerjes së vendimeve gjyqësore sipas databazës së vendimeve gjyqësore dhe grafiku i shlyerjes nuk është bërë publik në faqen on-line. Grupi i auditimit konstatoi se shumica e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore janë kryer me përmbarues privat, duke e kaluar afatin për likuidimin vullnetar.

Kriteri:- Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 04.06.2014 *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit,* pikën 3, 5, 9.
Urdhri Nr.5151 datë 28.10.2015 i Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil", pika 3, 4, 5.
Ndikimi/Efekti: Llogaria 602/7400 *"Shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna"* është një shpenzim jo efektiv duke pasur parasysh përdorimin e këtyre fondeve buxhetore për paga të punonjësve që nuk kanë punuar për periudhën që janë paguar dhe në mbivlerësim të shpenzimeve të vitit 2018. Mosrespektimi i radhës së pagesës dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore me përmbarues privat rëndon në buxhetin e shtetit, për vlerat e ndërmjetësimit të cilat indeksohen në bazë të vlerës së padisë, shumës që përfiton kreditori gjyqfitues.

Shkaku: Vendimmarrja e gabuar e titullarëve të cilët largojnë padrejtësisht punonjësit nga puna.

Mosfunksionimi i Komisionit të Posacëm. Vendimet gjyqësore për rikthim në punë të ish-punonjësve nuk zbatohen në kohë, duke krijuar detyrime për paga mujore ndër vite të cilat ekzekutohen me një pagese të vetme ose me këste.

Rëndësia: I lartë

Rekomandime: Për shmangien e efekteve të tilla negative në Buxhetin e Shtetit KLSH rekomandon të analizohen të gjitha vendimet gjyqësore me objekt rikthimin në punë dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative ndaj personave shkaktarë. Në çdo rast, shlyerja e detyrimeve të lidhura me këto vendime të ndjekë radhën e paraqitjes së tyre në MFE, nëpërmjet publikimit të databazës dhe grafikut të shlyerjes edhe në faqen zyrtare të Institucionit.

Titulli i Gjetjes 14: KLSH konstaton vendime të gjykatave për rikthim në punë të 5 punonjësve që nuk u raportuan në databazën e vendimeve gjyqësore të DPD, 2 prej të cilëve nuk janë ekzekutuar. Grupi i auditimit nuk shprehet për detyrimet e mundshme si pasojë e mosvënies në dispozicion të evidencës së saktë të auditimit.

Situata: Gjatë auditimit janë konstatuar 5 ish-punonjës të cilët nuk na u raportuan në databazën e vendimeve gjyqësore për të cilët gjykata ka dhënë vendime që janë larguar padrejtësisht nga puna dhe që DPD duhet ti rikthejë në vendet e tyre të punës dhe pagimin e pagave nga data që janë larguar deri në rikthimin në detyrë. Pas lënies së akt-konstatimeve u evidentua se 1 prej punonjësve është në fazën e akt-rekomandimit në DAP, 1 është punësuar në dhjetor 2018 i cili nuk na u raportua në listën e të punësuarve për 2018 me vendim gjykate dhe 1 është rikthye rë punë në 23.08.2019, pas përfundimit të auditimit nga KLSH. Strukturat përgjegjëse në DPD, pjesë e komisionit të Posaçëm, nuk kanë ekzekutuar këto vendime gjyqësore që kanë sjellë situatën e krijimit të detyrimeve për DPD si pasojë e pagave vjetore të maturuara.

Kriteri:- Vendimet e gjykatave përkatëse që kërkojnë që DPD të rikthejë në punë ish-punonjësit e larguar padrejtësisht dhe dëmshërblimin e tyre nga dita e largimit deri në rikthimin e tyre sërisht.
"Shqyrtimi i fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë", të Urdhërit nr. 5151, datë 28.10.2015 "Për Zbatimin e vendimeve Gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", pika 1 dhe pika 3 e Kreut IV.
Referuar nenit 7 të Ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilietin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, njësitë ekonomike duhet të kontrollojnë ekzistencën dhe vlerësimin e detyrimeve të tij, nëpërmjet një inventarizimi të tyre dhe evidencave mbështetëse të paktën një herë në vit.

Ndikimi/Efekti: Mos paraqitja e detyrimeve që lidhen me vendimet e gjykatave krijojnë risk për nënvlerësimin e këtyre detyrimeve dhe rrjedhimisht në ekspozimin e DPD drejt nevojës për të paguar **interesa dhe shpenzime përmbarimore** si pasojë e përcaktimeve të tjera ligjore. Gjithashtu mospasja e një regjistri krijon kushtet për mosrespektimin e radhës së pagesave dhe ekzekutimin e tyre në mënyrë selektive.
Ne duam të tërheqim vëmendjen e drejtimit, se mosveprimi për rikthimin në punë të punonjësve shkakton një kosto të panevojshme për buxhetin e shtetit duke qenë se për të njejtin pozicion pune paguhen dy individë ose më shumë punonjës. Ky impakt bëhet edhe më domethënës në kushtet **kur për periudhën objekt auditimi në DPD paraqiten vende vakante**, të cilat në çdo kohë mund të përdoren për sistemimin e ish-punonjësve që presin rikthimin në punë, në mënyrë që të ndalohet akumulimi i shpenzimeve jo efektive. Mos pasja e një evidence të saktë në lidhje me të gjitha detyrimet përkundrejt të tretëve në kohë reale krijon kushtet për thyerje të vazhdueshme të udhëzimeve të konstatuara edhe gjatë auditimit, në lidhje me krijimin e detyrimeve të prapambetura, likuidimin jo

sipas radhës së paraqitjes në institucion, akumulimin e interesave nga mos shlyerja në kohë e principalit të vendimeve apo planifikim të gabuar të kërkesave buxhetore në fillim të vitit.

Shkaku: Mungesa e dhënave të përditësuara të databazës së vendimeve gjyqësore.

Rëndësia: I lartë

Rekomandime: KLSH rekomandon marrjen e masave të menjëhershme për sistemimin e punonjësve të cilët presin rikthimin në detyrë, në mënyrë që të ndërpritet rritja e shpenzimeve jo efektive. Institucioni duhet gjithashtu të vendosi mbikqyrje të përshtashme mbi këtë proces për të garantuar funksionimin e kontrolleve të brendshme. KLSH rekomandon zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë pa asnjë vonesë subjektive për të mos rënduar buxhetin e shtetit. DPD të marrë masa për hartimin e saktë dhe të përditësuar të databazës së vendimeve gjyqësore në mënyrë të menjëhershme në mënyrë që të shmangen impaktet e padëshiruara në lidhje me krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Titulli i Gjetjes 15: Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar në kundërshtim me aktet rregullatore për sa i përket vonesave dhe problematikave të konstatuara në procedurën e Ristrukturimit të Institucionit gjatë transferimit të punonjësve. Vendimmarrja për personat e prekur nga Ristrukturimi nuk është bazuar në kritere reale sic janë vjetërsia në punë, kualifikimi, vlerësimi vjetor etj. Reflektimi i Ristrukturimit të DPPD është bërë pa ndjekur fillimisht një përshkrim të pozicioneve të punës si proces paraprak vlerësimi përpara vendimmarrjes së transferimit të punonjësve.

Situata: Në zbatim të Vendimit Nr.921 datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", të ndryshuar, Ligjit Nr.152/2013 "Për Nënpunësin Civil", i ndryshuar; VKM Nr.125, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave "Për Transferimin e Përkohshëm dhe të Përhershëm të Nënpunësve Civilë"; Udhëzimit Nr.1, datë 01.03.2016 të Departamentit të Administratës Publike "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të Institucionit", si dhe në bazë të Urdhërit Nr.04 datë **24.01.2018** të Departamentit të Administratës Publike "Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit" të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, u ngrit Komisioni i Ristrukturimit.

Komisioni brenda 15 ditëve nga momenti i krijimit (24.01.2018) duhet t'i propozonte DAP transferimin e nënpunësve në një nga pozicionet e lira sipas procedurës ndërkohë që propozimet nga ana e Komisionit dhe miratimet nga DAP janë bërë deri në mars të viti 2019, duke e tejzgjatur procesin me 1 vit.

Nga auditimi konstatojmë 35 ankimime nga punonjësit pas procesit të ristrukturimit në lidhje me pozicionet e punës ku janë transferuar të cilat nuk janë trajtuar të gjitha dhe 5 në ulje në kategori, duke sjell në këtë mënyrë favorizime të disa punonjësve kundrejt të tjerëve dhe mostrajtim të barabartë të ankimimeve/kërkesave të tyre.

Nga auditimi i procesverbaleve dhe ankimimeve të punonjësve u konstatua se punonjësit kërkojnë rishikim vendimi për transferimin kryesisht për këto arsye:

-Distanca nga vendbanimi për më shumë se 45 km.

-Transferimin në qytete të tjera kur ka vende vakante në Tiranë dhe nuk është prekur/suprimuar vendi i punës.

-Për shkak të problemeve shëndetësore

-Për shkak të mospërputhshmërisë me pozicionet ku janë transferuar

-Nuk është prekur pozicioni i tyre i punës dhe as nuk ka ndryshim të përshkrimit të punës

Konstatohet se miratimet e DAP për Ristrukturimin e Degës Doganore Durrës janë bërë para propozimeve nga ana e Komisionit të Ristrukturimit pasi miratimi është bërë në datën 07.02.2019

ndërsa propozimi në datën 28.02.2019 (miratimi në DAP është bërë 20 ditë përpara propozimit nga ana e Komisionit të Ristrukturimit).

"Komisioni i ristrukturimit në vendimin e tij për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet mbi këto kritere:

a) Vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil;

b) Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë;

c) Vlerësimin e fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë.

Nga auditimi u konstatua se nuk kemi evidencë për praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi i transferimit (metodologjia dhe sistemi i pikëzimit).

Reflektimi i Ristrukturimit të DPPD është bërë pa ndjekur fillimisht një përshkrim të pozicioneve të punës si proces paraprak vlerësimi përpara vendimmarrjes së transferimit të punonjësve. Përshkrimet e punës janë miratuar nga me shkresën Nr.17960/1 Prot datë 18.09.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Ndërkohë Ristrukturimi i DPD ka nisur në shkurt 2018.

Kriteri:- VKM Nr.125 datë 17.02.2016"Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nënpunësve civil", pika 16, 17, 20.

Udhëzimi Nr.1 Datë 01.03.2016 të DAP, "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit", pika 10.

Udhëzimi Nr.1 Datë 01.03.2016 të DAP, "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit Kreu II, pika 6.

Ndikimi/Efekti: Tejkalim me 1 vit i afateve ligjore të procesit të Ristrukturimit. Transferime të punonjësve pa kritere duke rritur riskun e cënimit të cilësisë së punës. Mungesa e shpalljes së vendeve vakante në DAP për shkak të procesit të Ristrukturimit. Mungesë e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësive për secilin pozicion pune. Kryerja e procesit të Ristrukturimit formalisht pa kritere specifike.

Shkaku: Ngarkesa, vështirësitë e hasura në ripozicionim e punonjësve. Ndarja e procesit në 3 faza të ndryshme nga ana e DPD. Mosrespektim i dispozitave ligjore në fuqi.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Planifikim më i kujdesshëm për respektimin e afateve të përcaktuara me VKM dhe shmangie nga ana e Institucioneve e procesit të Ristrukturimit, proces që ndikon në stabilitetin e tyre. Të administrohen në kohë reale dhe të trajtohen me përparësi rastet e ankesave për ristrukturimin në mënyrë që të shmangen problemet e mundshme që shpesh përfundojnë edhe në konflikte gjyqësore

Pjesë e rëndësishme e reformës në administratë është konsolidimi i strukturave të ministrive. Për këtë arsye rekomandohet që ndryshimet e strukturave të mos jenë objekt i riskut në cilësinë e punës, stabilitetin e institucionit dhe punonjësve. Sistemi i Kontrollit të Brendshëm të funksionojë me të gjithë elementët e tij përbërës duke i kushtuar vëmendje respektimit të dispozitave ligjore vecanërisht në procese që prekin mirëfunksionimin dhe qëndrueshmërinë e Institucionit.

Titulli i Gjetjes 16: Nga auditimi përgjatë vitit 2018 konstatohet një numër i lartë vendesh vakante si në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ashtu dhe në Degë Doganore.

Situata: Numër i lartë vendesh vakante i shpërndarë në drejtori të ndryshme si në Drejtori të Përgjithshme ashtu dhe në Degë Doganore. Vlerat më të larta të vendeve vakante janë gjatë kohës së ndryshimit të strukurës dhe në vazhdim duke qënë se në proces Ristrukturimi nuk mund të shpallen vende të lira në DAP.

Kriteri:- Shkresa Nr.87 Prot, datë 09.01.2018 e Këshillit të Ministrave prot në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me Nr.436 Prot, datë 09.01.2018, Vendimi Nr.2 datë 08.01.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.921 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Personelin e Administratës Doganore", të ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Performanca e disa drejtorive me pak punonjës si edhe me normë të lartë të qarkullimit të stafit ndikon në kryerjen me moseficiencë të funksioneve të këtyre drejtorive apo sektorëve. Nga auditimi u konstatua se, diferenca e numrit të punonjësve nga plani në fakt lë hapësirë interpretimi se puna kryhet nga punonjësit ekzistues të cilët mbingarkohen me funksione që nuk janë kompetencë e tyre dhe kështu riskon të cënohet cilësia e punës.

Shkaku: Tejzgjatja e procesit të Ristrukturimit dhe mungesa e shpalljes së vendeve të lira në DAP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marr masa të menjëhershme, që vendet vakante të plotësohen nga punonjës që përmbushin kriteret sipas pozicionit.

Titulli i Gjetjes 17: Probleme në lidhje me procedurën e punësimit dhe mungesa e kryerjes së procedurave të konkurimit për punonjësit me kontratë të përkohshme.

Situata: *Nga auditimi u konstatua se:*

-Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit prej 3 antarësh, është nxjerr një listë e fituesit vlerësuar me pikë për këto pozicione. Në disa raste pikët e grumbulluara janë shënuar vetëm për fituesin. Nuk ka vlerësim me pikë për konkurentët e tjerë duke mos lënë gjurmë për pjesëmarrjen e konkurentëve të tjerë dhe nivelin e tyre.

-Nuk është mbajtur procesverbal nga KPP për personat që kanë marr pjesë në konkurim, datën e konkurimit, vendin etj.

-Në disa raste rezulton se nuk ka patur fitues të shpallur nga KPP. Por nuk është mbajtur relacion, informacion për vlerësimet apo arsyet e mosshpalljes së fituesit.

-Në disa raste në "Njoftimin për shpallje konkurimi" tregohet se data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë, por në dosjet e konkurimit nuk ka shkresë për njoftimet e aplikantëve, datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi, datën e daljes së rezultateve të konkurimit, mënyrën e njoftimit etj.

-Nuk ka dokumentacion që të vërtetojë njoftimin e kandidatëve "mënyrat e njoftimit.

-Janë pranuar dokumenta pas datës së vendosur në njoftimi për shpallje konkurimi.

Kriteri:- Ligjit Nr.8485 datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 60, pika 1, shkronja "c"
Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

Ndikimi/Efekti: Është cënuar konkurrimi i hapur dhe transparent në rekrutimin e punonjësve.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit ligjor në fuqi për favorizimin e kandidatëve të caktuar për punësim.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime: Rekrutimi i punonjësve të jetë sa më i hapur, transparent dhe duke plotësuar të gjitha kriteret e nevojshëm në kualifikim sipas përcaktimeve të bëra në vendet e lira të punës.
Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren të gjitha masat për respektimin e afateve të dokumentacioneve.
Komiteti i Pranimit të Përhershëm të mbaj relacion dhe evidenca mbi vlerësimin e të gjithë kandidatëve që marrin pjesë në intervistë për shpalljet e vendeve të punës.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marr masa për kryerjen e procedurave të konkurimit edhe për punonjësit me kontratë të përkohshme, për të garantuar transparencë në përzgjedhje sipas kritereve të caktuara

Titulli i Gjetjes 18: Nga auditimi mbi transferimet e përkohshme të punonjësve tejkalime të afatetve ligjore (mbi 6 muaj).

Situata: Referuar dokumentacionit dhe kohës së transferimit të përkohshëm, konstatohet se për nëpunësit civil nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 48, pika 1, shkronja "a", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, pasi transferimi ka tejkaluar afatet e përcaktuara (mbi 6 muaj).
Nga auditimi u konstatua se janë 175 nënpunës të cilët janë transferuar dhe kanë tejkaluar afatet e përcaktuara për Transferimin e Përkohshëm në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" përgjatë vitit 2018, nga të cilët 134 janë punonjës civilë dhe 41 punonjës administrativë.

Kriteri:- Ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, neni 48, pika 1, shkronja a.

Ndikimi/Efekti: Tejzgjatje e kohës së qëndrimit në pozicione ku janë transferuar; Mosqëndrueshmëri në një pozicion pune; Cënim të mbarëvajtjes dhe cilësisë së punës.

Shkaku: Mosrespektim i dispozitave ligjore.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Të nxirren përgjegjësitë pas nje hetimi administrativ për veprimet jo në përputhje të dispozitave ligjore në lidhje me afatet kohore për transferimet e përkohshme të punonjësve dhe transferimet e shpeshta në mënyrë që të shmanget risku i transferimeve të detyruara në Drejtori apo struktura të tjera varësie dhe qëndrueshmëria e funksionimit të Institucionit.

Titulli i Gjetjes 19: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve me ecuri disiplinore u konstatuan problematika në lidhje me veprimtarinë e Komisionit Disiplinor.

Situata: *Në mënyrë të përmbledhur konstatohen këto problematika:*
-Në dosjen e punonjësit për të cilën ka filluar ecuria disiplinore, mungon arsyetimi i eprorit direkt për fillimin e ecurisë disiplinore të punonjësve
-Në disa raste data e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore është më vonë se 16 ditë nga dita e marrjes së njoftimit nga nënpunësi, -Në disa raste, deklaratat për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të KD janë të nënshkruara nga anëtarët, por nuk tregohet se për cilin/cilën punonjës bëhet kjo deklaratë.
-Nuk disponohen shkresa për shtyrje të seancës dëgjimore.

Kriteri:- Vendimi nr. 115, datë 5.3.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil, Kreut II "Komisioni Disiplinor" pika 13/c, pika 7.

Ndikimi/Efekti: Konstatohen 3 ish-punonjës të DPD, larguar me Komision Disiplinor të cilët kanë hapur proces gjyqësor dhe janë në proces në Apel në Gjykatën Administrative.

Shkaku: Ngarkesa dhe numri i lartë i cështjeve të shqyrtuara.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Komisioni Disiplinor gjatë shqyrtimit të cështjeve për ecurinë disiplinore të respektojë afatet për shyrtimin e shkeljeve disiplinore, të marr masa për plotësimin e deklaratave për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të KD sipas formateve standarteve dhe të trajtojë të gjithë rastet me vëmendje maksimale për të shmangur largime të padrejta nga puna të cilat në vazhdim mund të rezultojnë me dëme dhe efekte financiare në Buxhetin e Shtetit.

Titulli i Gjetjes 20: Nga auditimi për menaxhimin e Burimeve Njerëzore u konstatua se në dosjet personale të punonjësve ka mungesa të pjesshme në dokumentacion dhe vlerësimi vjetor i tyre është me mangësi në procedurë.

Situata: -Në disa raste nuk administrohet në dosje raporti mjeko ligjor, vërtetim nga prokuroria autorizimi i konfliktit të interesit, dokumenta të kurseve kualifikuese apo gjuhëve të huaja, vërtetim nga tatim-taksat si dhe në disa raste nuk është plotësuar/përditësuar fletë inventari i dosjes.

Kriteri:- Urdhri Nr.15339 Prot datë 27.06.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e vlerësimeve vjetore për të gjithë punonjësit Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degëve Doganore"
Lidhja Nr.1 dhe Lidhjen Nr.2 të Vendimit Nr.117 datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Ndikimi/Efekti: Vlerësimet e punonjësve dhe dosjet e personelit janë me mangësi duke rritur riskun e kryerjes së rekrutimeve dhe vlerësimeve formale të punonjësve.

Shkaku: Mosrespektim i Lidhjen Nr.1 dhe Lidhjen Nr.2 të Vendimit Nr.117 datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit" dhe i Urdhrit Nr.15339 Prot datë 27.06.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm për kryerjen e vlerësimeve vjetore për të gjithë punonjësit.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime: Me qëllim vlerësimin dhe rritjen e aftësive profesionale të punonjësve, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat e menjëhershme për plotësimin e dosjeve të personelit sipas kërkesave ligjore, dhe realizimin e kujdesshëm të vlerësimeve vjetore të punonjësve tyre për çdo Drejtori në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe për Degët Doganore.

<u>Drejtimi nr. 8</u> ***"Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme"***

Titulli i Gjetjes 21: Nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm.

Situata: Nga auditimi u konstatua se nuk rezultojnë të zbatuara masa për shpërblim dëmi të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr.280/11 Prot. datë 05.10.2018, në shumën 105,142 mijë lek për 7 rekomandime. Gjithashtu nuk janë zbatuar 11 masa organizative dhe 16 masa disiplinore.

Kriteri:- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Ndikimi/Efekti: Konstatohet moszbatim i rekomandimeve të lëna më parë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në shumën totale 105,142 mijë lekë.

Shkaku: Mospranim nga ana e DPD të disa prej rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Vështirësitë në implementim dhe nevoja e një periudhe më të gjatë për zbatimin e rekomandimeve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto dy institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit të shumës prej 105,142 mijë lek, rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 280/11 Prot. datë 05.10.2018.

IV/2. *Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:*

A. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2018 rezultoi se, plani i të ardhurave për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave është përcaktuar nga Drejtoria e Analizës dhe Politikave Fiskale në MFE në vlerën 168,982 milionë lekë. Krahasuar me planin përfundimtar, të ardhurat doganore për vitin 2018, janë realizuar bruto në masën 96.2 %, pra 6,361.1 milionë lekë më pak kundrejt planit fillestar, ndërsa neto në masën 95.2 %, pra 8.004.1 milionë lekë më pak kundrejt planit fillestar. Referuar të dhënave të mësipërme, plani fillestar i të ardhurave doganore për vitin 2018, është parashikuar në vlerën 168,982 milionë lekë. Të ardhurat fiskale doganore për vitin 2018, janë realizuar bruto 3,530.9 milionë lekë më shumë se vitin 2017, ose rreth 2.2 %, ndërsa neto 1,887.9 milion lekë më shumë se vitin 2017, ose 1.1 %. DPD ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat, duke mos angazhuar strukturat e saj, sikurse është Drejtoria e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave (Sektori i Monitorimit të Ardhurave, Analizës dhe Statistikës), në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4, neni 24, ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", kap. IV. "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave".

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, në faqet nr. 14 - 22, të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Strukturat e **Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave** të DPD në bashkëpunim me strukturat përkatëse të MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, të riorganizojnë dhe mundësojnë **programimin e të ardhurave** në të gjitha fazat edhe me strukturat e DPD, duke shtuar kështu bashkëpunimin për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese që mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhurave të mos vijnë të gatshëm në DPD, si dhe të programohen drejt e pa rezerva.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, materialeve, si dhe të dhënave elektronike (data-basse) të vëna në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit, rezulton se gjendja e borxhit doganor më 01.01.2018 paraqitet me 4521 raste, 2978 subjekte debitorë në vlerën 23,946,599 mijë lekë. Gjendja e borxhit më datë 31.12.2018 paraqitet me 4520 raste, 3211 subjekte debitorë në vlerën 27,596,148 mijë lekë, pra gjatë vitit ushtrimor 2018, borxhi doganor është shtuar me 233 subjekte debitorë ose 7.8 %, ndërsa në vlerë 3,649,549 mijë lekë ose 15.2 %. Nga zyra e borxhit pranë degëve doganore nuk janë ndjekur hap pas hapi masat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin doganor si dhe udhëzimet përkatëse të nxjerra për këtë qëllim për rikuperimin e detyrimeve të papaguara nga subjektet debitoë, ku për 1203 raste, për vlerën **3,299,965,219 lekë**, nuk kanë vijuar procedurat me nxjerrjen e Urdhër Ekzekutimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, duke bërë të mundur vazhdimin e veprimtarisë doganore në sistem të subjekteve debitore, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e: nenit 245, pika 3, të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar; nenit 106, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"*; nenit 103, pika 3 dhe 4, të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 *"Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar; si dhe pikës 2.2.1, shkronja "a", pjesa IX të Udhëzimit të DPD nr. 4, datë 07.04.2016, ndryshuar me pikën 2.6, pjesa VII, të Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, në faqet nr. 22 – 36, të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: DPD të marrë të gjitha masat për analizimin e situatës për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor në vlerën 27,596,148 mijë lekë.

2.2. Rekomandimi: DPD të marrë të gjitha masat duke ngritur një grup pune për verifikimin, analizimin e situatës për veprimet kryera nga zyrat e borxhit pranë degëve doganore jo në përputhje me dispozitat ligjore për procedurat e ndjekura lidhur me rikuperimin e borxhit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit dhe nxjerrjen e përgjegjësive për të gjitha rastet e mosveprimeve ku subjektet apo agjensitë doganore edhe pse debitorë kanë vijuar aktivitetin doganor në import - eksport.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 280/11 prot., datë 05.10.2018 dhe protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 22995 prot., datë 08.10.2018 në DPD, konkretisht:
a. Zbatimin e rekomandimeve për 11 masa organizative;
b. Zbatimin e rekomandimeve për 7 masa për shpërblim dëmi në vlerën 105,142 mijë lekë;
c. Zbatimin e rekomandimeve për 16 masa disiplinore.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet nr. 158 – 173, të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e organit epror dhe Degët Doganore në cilësinë e "autoritetit doganor kompetent" të analizojnë në bashkëpunim të plotë rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për kontabilizimin e shumës prej ***105,142 mijë lekë,*** rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 280/11 prot., datë 05.10.2018 dhe protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 22995 prot., datë 08.10.2018.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i rregjistrimit të faturave në SIFQ, mbi veprimet e arkës dhe bankës, u konstatuan fatura të rregjistruara përtej afatit 30 ditë në kundërshtim me LMSB në vlerë 67,759,304 lekë dhe numër 55 raste, duke rezultuar ne thyerje te disiplines fiskale, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Nr. 9, datë 20.3.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", pika 184 ku citohet: "*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik"*.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet nr. 59 - 61 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e organit epror dhe strukturat përgjegjëse të marrin të gjitha masat për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet kryera jo në përputhje me dispozitat ligjore në lidhje me likujdimin e e detyrimeve në tejkalim të afateve të parashkruara, pasi likuidimi me vonesë i tyre përbën risk potencial ne rritjen e

shpenzimeve buxhetore, si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet për mos likuidim brenda afateve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore u konstatuan 5 ish-punonjës të cilët nuk na u vunë të dhëna në dispozicion në databazën e vendimeve gjyqësore për të cilët gjykata ka dhënë vendime që janë larguar padrejtësisht nga puna dhe që DPD duhet ti rikthejë në vendet e tyre të punës dhe pagimin e pagave nga data që janë larguar deri në rikthimin në detyrë. Pas lënies së akt-konstatimeve u evidentua se 1 prej punonjësve është në fazën e akt-rekomandimit në DAP, 1 është punësuar në dhjetor 2018 i cili nuk na u raportua në listën e të punësuarve për 2018 me vendim gjykate dhe 1 është rikthye rë punë në 23.08.2019, pas përfundimit të auditimit nga KLSH. Strukturat përgjegjëse në DPD, pjesë e komisionit të Posaçëm, nuk kanë ekzekutuar këto vendime gjyqësore që kanë sjellë situatën e krijimit të detyrimeve për DPD si pasojë e pagave vjetore të maturuara, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Urdhërit nr. 5151, datë 28.10.2015 *"Për Zbatimin e vendimeve Gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil"*, pika 1 dhe pika 3 e Kreut IV.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, në faqet nr. 109 – 129, të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për sistemimin e punonjësve të cilët presin rikthimin në detyrë, në mënyrë që të ndërpritet rritja e shpenzimeve jo efektive. Institucioni duhet gjithashtu të vendosi mbikqyrje të përshtashme mbi këtë proces për të garantuar funksionimin e kontrolleve të brendshme për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë pa asnjë vonesë subjektive për të mos rënduar buxhetin e shtetit si dhe të marrë masa për hartimin e saktë dhe të përditësuar të databazës së vendimeve gjyqësore në mënyrë të menjëhershme në mënyrë që të shmangen impaktet negative në lidhje me krijimin e detyrimeve të prapambetura

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore u konstatua se DPD ka zbatuar 47 vendime gjyqësore për shpërblim dëmi në total prej **49,338 mijë lekë**. Këto vendime gjyqësore kanë objekt të tyre rikthimin në punë të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga vendi i punës pagimin e pagave nga momenti i largimit deri në ekzekutimin e vendimit për ish-punonjësit me status ose dëmshpërblimin për largimin nga puna të ish-punonjësve me kod pune. **Akumulimi i detyrimeve ka ardhur si pasojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore ndër vite dhe zgjatjes së proceseve gjyqësore**. Referuar vendimeve të gjykatave, këto vendime i përkasin periudhave përpara çeljes së vitit 2018, shumë e shpenzuar pa efektivitet dhe në mbivlerësim të shpenzimeve të vitit 2018. Nga auditimi është konstatuar se nuk është zbatuar radha e shlyerjes së vendimeve gjyqësore sipas databazës së vendimeve gjyqësore dhe grafiku i shlyerjes nuk është bërë publik në faqen on-line. Grupi i auditimit konstatoi se shumica e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore janë kryer me përmbarues privat, duke e kaluar afatin për likuidimin vullnetar, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 04.06.2014 *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit*, pikën 3, 5, 9, si dhe Urdhrit Nr.5151 datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil", pika 3, 4, 5.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, në faqet nr. 109 – 129, të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për analizimin e të gjitha vendimet gjyqësore me objekt rikthimin në punë dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative ndaj personave shkaktarë. Në çdo rast, shlyerja e detyrimeve të lidhura me këto vendime të ndjekë radhën e paraqitjes së tyre në MFE, nëpërmjet publikimit të databazës dhe grafikut të shlyerjes edhe në faqen zyrtare të Institucionit

Menjëherë

